

**VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË NË KOSOVË
ME VËSHTRIM TË POSAÇËM NË TERRITORIN E
GJYKATËS KOMUNALE TË FERIZAJT GJATË
PERIUDHËS 2008- 2012**

Doktorant

Bahri HYSENI

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Juridike, me profil E Drejta Penale për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Lulzim Tafa

Numri i fjalëve: 68.207

Tiranë, shtator 2015

**VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË NË KOSOVË
ME VËSHTRIM TË POSAÇËM NË TERRITORIN E
GJYKATËS KOMUNALE TË FERIZAJT GJATË
PERIUDHËS 2008- 2012**

Doktorant

Bahri HYSENI

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Juridike, me profil E Drejta Penale për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Lulzim Tafa

Numri i fjalëve: 68.207

Tiranë, shtator 2015

DEKLARATË E AUTORËSISË

Me përgjegjësinë personale deklaroj se ky punim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimin e kam shkruar unë dhe nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Bahri Hyseni

Firma: _____

ABSTRAKT

Vepra penale kundër ekonomisë, është një koncept shumë kompleks, si aktivitet kriminalo-penal, është tipar i shoqërive dhe vendeve të ndryshme me prirje që të rritet më shpejt, sesa dinamikat e implementuara për ta neutralizuar atë. Sistematikisht ai ka shkaktuar shumë probleme shqetësuese në të gjitha vendet e botës.

Kosova, që nga paslufta, ka bërë reforma të vazhdueshme juridike me interes avancimin e sistemit juridik në luftim dhe parandalim të veprave penale, mirëpo hapësira juridike e krijuar pas përfundimit të luftës në vitin 1999, ka krijuar pore për rritje të aktiviteteve penale kundra ekonomisë përgjithësisht. Republika e Kosovës si vend me resurse për zhvillim ekonomik, si dhe me anomali juridike në këtë fushë paraqet një rast të veçantë, sa i përket aspekteve të veprave penale kundër ekonomisë, si për nga fakti i analizimit të tyre, i gjykitimit të tyre dhe i ekzekutimit të vendimeve të veprave penale në përgjithësi e në veçanti atyre ekonomike.

Në këtë punim përgjithësisht do të trajtohen veprat penale kundër ekonomisë, me vështrim të posaçëm në Gjykatën Komunale të Ferizajt, të kryera në periudhën 2008-2012. Si të tilla, këto veprat penale, kundër ekonomisë janë trajtuar dhe analizuar nga disa aspekte: fillimisht në aspektin juridiko-penal, në aspektin e objektit material, tipologjisë së subjekteve të kryerjes së veprave penale, aspektit krahasimor, kriminologjik, politikës së ndjekjes penale dhe politikës ndëshkimore.

Fjalët kyçe: penologji, gjykim, ekonomi, Ferizaj, kodi penal.

ABSTRACT

Criminal offenses against the economy, is a very complex concept, as criminal-criminal activity feature companies and different countries tend to grow faster than the dynamics implemented to neutralize it. Systematically he has caused many problems of concern in all countries of the world.

Kosovo after the war who made legal reform continued interest in improving justice system to combat and prevent crime, but legal space created after the war ended in 1999, has created pore growth criminal activities against the economy generally. The Republic of Kosovo as a resource for economic development and legal anomalies in this area represents a special case, as far as aspects of offenses against the economy, for the fact of their analysis, their judgment and the enforcement of criminal offenses in general, but particularly economic ones.

In this paper generally will be treated offenses against the economy, with special emphasis on the Municipal Court of Ferizaj, committed in the period 2008-2012, as such these offenses against the economy are addressed and analyzed from several aspects; primarily in criminal legal aspect, in terms of material object, typology of subjects of criminal conduct, comparative aspect, criminological, policy prosecution and sanctioning policy.

Keywords: penology, judgment, economics, Ferizaj, the penal code.

Falënderim

Duke qenë mirënjohës për të gjitha mbresat, të cilat kanë ndodhur qëkur fillova studimet në UET, përvojat që kam fituar këtu do të përpiqem që t'i falënderoj disa nga shumë persona, të cilët më ndihmuan në përkushtimin e studimeve të mia.

Shfrytëzoj nga rasti të falënderoj të gjithë profesorët, duke filluar me Prof. Dr. Ardian CIVICI dhe të gjithë të tjerët.

Një falënderim special për profesorin tim, mentorin Prof. Dr. Lulzim TAFA, për ndihmën dhe mbështetjen e çmuar që më ofroi gjatë gjithë punës sime dhe për kontributin e tij në finalizimin e disertacionit, produkti i shumë orëve konsultimi dhe mbështetjeje nga ana e tij.

Faleminderit Profesor!

Falënderoj familjen time për mbështetjen që më ka dhënë si dhe kolegët dhe bashkëpunëtorët profesionalë për mbështetjen e pakufizuar deri më tani.

Me respekt, i juaji!

Bahri HYSENI

Prishtinë, 2015

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	II
ABSTRACT	III
FALËNDËRIM	I V
PËRMBAJTJA	V
LISTA E TABELAVE	XIV
LISTA E GRAFIKËVE	XV
LISTA E SHKURTIMEVE	XVI

HYRJE	1
1. Qëllimi i punimit	1
2. Hipoteza e punimit	3
3. Pyetjet kërkimore të punimit	3
4. Metodatat dhe metodologjia e punimit	4

KAPITULLI I

VËSHTRIMI JURIDIKO-PENAL I VEPRAVE PENALE KUNDËR

EKONOMISË	8
1.1. Kuptimi i veprave penale kundër ekonomisë	8
1.2. Karakteristikat e veprave penale kundër ekonomisë	12
1.3. Specifikat e objektit material	14

1.4. Dinamika dhe mënyrat e kryerjes së veprave penale kundër ekonomisë	15
1.5. Tipologjia e subjekteve të veprave penale kundër ekonomisë	19
1.5.1. Subjekti-personi fizik si kryerës i veprave penale kundër ekonomisë	20
1.5.2. Subjekti - personi juridik si kryerës i veprave penale kundër ekonomisë	22
1.6. Teknikat e inkriminimit të veprimeve kriminale kundër veprave penale të ekonomisë	23

KAPITULLI II

ZHVILLIMI DHE HISTORIKU I LEGJISLACIONIT PENAL TË KOSOVËS KUNDËR VEPRAVE PENALE TË EKONOMISË

2.1. Vështrim historik i lindjes dhe zhvillimit të veprave penale kundër ekonomisë në Kosovë	26
2.2. Veprat penale kundër ekonomisë sipas legjislacionit të ish-Jugosllavisë të aplikuar në Kosovë deri në vitin 1977	29
2.3. Veprat penale kundër ekonomisë sipas legjislacionit penal të Kosovës të vitit 1977	30
2.4. Historiku i zhvillimi të legjislacionit penal për veprat penale kundër ekonomisë në periudhën e pasluftës 1999 në Kosovë	34
2.5. Historiku i zhvillimit të legjislacionit penal për veprat penale kundër ekonomisë pas Pavarësisë së Kosovës	37

KAPITULLI III

VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË SIPAS LEGJISLACIONIT PENAL TË KOSOVËS

	40
3.1. Hyrje	40
3.2. Cenimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike (neni 232)	41
3.3. Veprimtaria e pandërgjegjshme ekonomike (neni 233)	43
3.4. Shkaktimi i falimentimit (neni 234)	44
3.5. Dëmtimi i kreditorëve (neni 235)	46
3.6. Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi (neni 236)	47
3.7. Lidhja e kontratës së dëmshme (neni 237)	48
3.8. Kuptimi i paautorizuar i sekretit të punës (neni 238)	50
3.9. Falsifikimi i pullave postare dhe letrave me vlerë (neni 239)	51
3.10. Cenimi i së drejtës së patentës (neni 240)	53
3.11. Përdorimi i paautorizuar i firmës, markës apo modelit të huaj (neni 241)	54
3.12. Mashtrimi i blerësve (neni 242)	56
3.13. Organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm (neni 243)	58
3.14. Falsifikimi i parasë (neni 244)	59
3.15. Prodhimi dhe shfrytëzimi i shenjave të etiketave, masave dhe peshave të rreme (neni 245)	60
3.16. Tregtia e ndaluar (neni 246)	62
3.17. Prodhimi i ndaluar (neni 247)	63

3.18. Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit (neni 248)	64
3.19. Shmangia nga tatimi (neni 249)	65
3.20. Pranimi i paarsyeshëm i dhuratave (neni 250)	67
3.21. Dhënia e paarsyeshme e dhuratave (neni 251)	68

KAPITULLI IV

ASPEKTE KRAHASUESE PËR VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË DHE PËRGJEGJËSIA PENALE E PERSONAVE JURIDIKË SIPAS LEGJISLACIONIT PENAL TË KOSOVËS DHE DISA SHTETEVE TË EVROPËS	69
--	-----------

A.

4.1. Vështrim krahasues i veprave penale kundër ekonomisë	69
4.2. Vështrim i përgjithshëm për historikun e lindjes dhe zhvillimit të veprave penale në fushën e ekonomisë në Shqipëri	70
4.2.1. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë të vitit 1995	74
4.3. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Francës	78
4.4. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Italisë	81
4.5. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Kroacisë	84
4.6. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Sllovenisë	86
4.7. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Maqedonisë	88

4.8. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Serbisë	90
4.9. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Bosnjës e Hercegovinës	92
4.10. E drejta penale e Këshillit të Evropës në fushën ekonomike	93
4.10.1. Disa aspekte normative nga Konventa mbi Pastrimin, Zbulimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin (Strasburg 1990)	96
4.10.2. Disa aspekte të Konventës Penale mbi Korrupsionin (1999) dhe protokollet e saj shtesë (2003)	99
4.11. E drejta penale e Bashkimit European në fushën ekonomike	101
4.11.1. Aspekte krahasuese të Konventës për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komuniteteve Evropiane	104
4.11.2. Aspekte krahasuese nga protokoli i parë i Konventës për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komuniteteve kundër Korrupsionit	107
4.11.3. Aspekte krahasuese nga protokoli i dytë i Konventës mbi Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komuniteteve Evropiane (përgjegjësia e personit juridik dhe pastrimi i kapitalit	109
4.11.4. Kuadri normativ tregtar i mbrojtjes së interesave financiare të Bashkimit Evropian, në fushën ekonomisë nga aspekti juridiko-penal	111
4.11.5. Politika ndëshkimore në Mbrojtjen e Interesave Financiare të BE-së	113

B.

II. PËRGJEGJËSIA PENALE E PERSONAVE JURIDIKË SIPAS LEGJISLACIONIT PENAL TË KOSOVËS DHE TË DISA SHTETEVE EVROPIANE

115

4.1. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Kosovë	115
---	-----

4.1.1. Elementet themelore të përgjegjësisë penale të personave juridikë sipas legjislacionit të Kosovës	119
4.1.2. Dënimet dhe sanksionet penalo–juridike	121
4.2. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Shqipëri	123
4.3. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në disa shtete të Evropës	129
4.4. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Francë	131
4.5. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Itali	134
4.6. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Kroaci	138
4.7. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Slloveni	140
4.8. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Maqedoni	144
4.9. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Serbi	146
4.10. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Bosnjë-Hercegovinë	149

KAPITULLI V

RAPORTI I VEPRAVE PENALE KUNDËR EKONOMISË ME GRUPET E TJERA TË VEPRAVE PENALE TË ORIENTUARA SIPAS OBJEKTIT MATERIAL

153

5.1. Vështrim i përgjithshëm

153

5.2. Raporti i veprave penale kundër ekonomisë me veprat penale kundër pasurisë

154

5.3. Raporti i veprave penale kundër ekonomisë me veprat penale kundër

detyrës zyrtare

157

5.4. Raporti i veprave penale kundër ekonomisë me veprat penale kundër sigurisë së
përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë

159

5.5. Dëmtimet në fushën e pronës

161

5.6. Natyra e disa veprave penale lidhur me dëmtimet e pronës e orientuar sipas objektit
material

163

5.7. Dëmtimet në fushën financiare

164

5.8. Natyra e disa veprave penale në fushën financiare e orientuar sipas objektit
material

166

5.9. Dëmtimet në fushën doganore

169

5.10. Natyra e disa veprave penale në fushën doganore e orientuar sipas objektit
material

172

KAPITULLI VI

ASPEKTI KRIMINOLOGJIK I VEPRAVE PENALE KUNDËR EKONOMISË NË TERRITORIN E GJYKATËS KOMUNALE (THEMELORE) NË FERIZAJ NË PERIUDHËN 2008-2012

175

6.1. Hyrje

175

6.2. Disa karakteristika të fenomenologjive të veprave penale kundër ekonomisë në territorin e Gjykatës dhe Prokurorisë Komunale në Ferizaj në periudhën 2008-2012

177

6.2.1. Dinamika e veprave penale kundër ekonomisë sipas kallëzimeve penale

178

6.2.2. Struktura sipas llojit të veprave penale kundër ekonomisë

184

6.3. Disa karakteristika personale të kryerësve të veprave penale kundër ekonomisë

221

6.3.1. Mosha e kryerësit

221

6.3.2. Niveli profesional dhe social

223

6.3.3. Recidivi i kryerësve

225

6.3.4. Gjinia e kryerësve

226

6.II. DISA KARAKTERISTIKA THEMELORE ETIOLOGJIKE TË VEPRAVE PENALE KUNDËR EKONOMISË NË KOSOVË

228

6.2.1. Disa karakteristika etiologjike të veprave penale kundër ekonomisë në rajonin e komunës së Ferizajt

229

6.2.2. Kriza ekonomike

229

6.2.3. Varfëria

230

6.2.4. Papunësia

231

6.2.5. Rrethanat e krijuara shoqërore pas luftës

232

KAPITULLI VII

MASA THEMELORE PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E VEPRAVE PENALE KUNDËR EKONOMISË ME THEKS TË VEÇANTË NË TERRITORIN E GJYKATËS KOMUNALE TË FERIZAJT PËR PERIUDHËN 2008-2012

233

7.1. DISA MASA PREVENTIVE PËR VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË

233

7.1.2. Parandalimi i kriminalitetit ekonomik në Kosovë me masa legislative 234

7.1.3. Përgatitja profesionale e zyrtarëve në sistemin juridik të vendit 238

7.1.4. Hartimi i planeve dhe strategjive si preventivë në parandalimin e kriminalitetit ekonomik 239

7.1.5. Ndikimi i mjeteve të komunikimit masiv si parandalues i kriminalitetit 241

7.1.6. Roli parandalues i organeve shtetërore dhe organeve tjera në luftimin e kriminalitetit 242

7.II.DISA MASA REPRESIVE PËR VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË

245

7.2.1. Politika adekuate ndëshkimore dhe e ndjekjes penale ndaj kryerësve të veprave penale kundër ekonomis 246

7.2.2. Llojet e sanksioneve penale ndaj kryerësve të veprave penale kundër ekonomisë 247

7.2.3. Politika ndëshkimore e aplikuar ndaj kryerësve të veprave penale kundër ekonomisë në praktikën e Gjykatës Komunale të Ferizajt, për periudhën kohore 2008-2013 250

PËRFUNDIMI	254
REKOMANDIME	263
LITERATURA	267
Apendix/ Shtojca	285
Terminologjia	287

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Dinamika e veprave penale kundër ekonomisë në Gjykatën Themelore të Ferizajt	17
Tabela 2: Pasqyra e të dhënave për kallëzimet penale kundër veprave penale kundër ekonomisë	180
Tabela 3: Struktura e veprave penale kundër ekonomisë në Ferizaj për 2008	185
Tabela 4: Struktura e veprave penale kundër ekonomisë në Ferizaj për 2009	187
Tabela 5: Struktura e veprave penale kundër ekonomisë në Ferizaj për 2010	189
Tabela 6: Struktura e veprave penale kundër ekonomisë në Ferizaj për 2011	191
Tabela 7: Struktura e veprave penale kundër ekonomisë në Ferizaj për 2012	193
Tabela 8: Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale për persona për çdo vit	196
Tabela 9: Pjesëmarrja e të dyshuarve në kallëzime penale sipas gjinisë, 2008-2012	198
Tabela 10: Vendimet e Gjykatës Komunale në Ferizaj për vitin 2008	203
Tabela 11: Vendimet e Gjykatës Komunale në Ferizaj për vitin 2009	207
Tabela 12: Vendimet e Gjykatës Komunale në Ferizaj për vitin 2010	211
Tabela 13: Vendimet e Gjykatës Komunale në Ferizaj për vitin 2011	215
Tabela 14: Vendimet e Gjykatës Komunale në Ferizaj për vitin 2012	218

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1: Numri i personave kundër të cilëve janë parashtruar kallëzimet penale	182
Grafiku 2 : Kallëzimet penale të zgjidhura sipas viteve nga 2008-2012	183
Grafiku 3: Aktet akuzuese të ngritura nga ana e prokurorisë në Ferizaj	195
Grafiku 4: Numri i kallëzimeve të pazgjidhura në fillim dhe në fund	200
Grafiku 5: Procedura e konfirmimit të aktakuzës	201
Grafiku 6: Pezullimi i procedurës pas ngritjes së akuzës ose propozimakuzës	201
Grafiku 7: Vendimet gjyqësore	202
Grafiku 8 : Mosha e kryerësve	222
Grafiku 9 : Niveli arsimor	224
Grafiku 10: Recidivi i kryerësve	226
Grafiku 11: Gjinia e kryerësve	227

LISTA E SHKURTIMEVE

KPPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KPPRK	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës
BE	Bashkimi European
KE	Këshilli Evropian
OLAF	Zyra Evropiane Kundër Mashtrimeve
MIF	Mbrojtja e Interesave Financiare
EULEX	Mision Ndërkombëtar i Bashkimit European
KECQ	Komuniteti Evropian për Qymyr dhe Çelik
LP	Ligji Penal
KSAK	Krahina Socialiste Autonome e Kosovës
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
UNMIK	Mision Ndërkombëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara

HYRJE

Në shoqëritë me zhvillim të lartë civilizues, përkushtim i veçantë, i kushtohet mbrojtjes së vlerave njerëzore në nivelin më të lartë, duke u nisur nga mbrojtja juridike që iu jepet atyre. Mbrojtja mund të jetë penalo-juridike, civile-juridike, administrative, kushtetuese etj.

Ndryshimet thelbësore, që po ndodhin sot në botën bashkëkohore, posaçërisht ato në fushën ekonomike, determinojnë nevojën që të kemi një qasje pragmatike për mbrojtjen e shoqërisë dhe pasurinë e saj private dhe publike nga veprat penale kundër ekonomisë.

Në këtë punim objekt studimi janë veprat penale kundër ekonomisë në Kosovë, me vështirim të posaçëm në Gjykatën Komunale të Ferizajt, të kryera në periudhën 2008-2012, dhe pas reformave në sistemin e drejtësisë dhe legjislacion edhe për vitin 2013.

1. Qëllimi i punimit

Qëllimi i këtij studimi është njohja dhe studimi i shumanshëm i çështjeve thelbësore dhe faktorët që ndikojnë në paraqitjen, parandalimin, mënyrën e zgjedhjes, luftimin dhe ndëshkimin e kryerësve të veprave penale kundër ekonomisë, me vështirim të posaçëm në territorin e Gjykatës Komunale të Ferizajt, ku përfshihet rajoni i komunës së Kaçanikut, Hanit të Elezit, Shtërpçës dhe Shtimes.

Veprat penale kundër ekonomisë në këtë punim janë trajtuar dhe analizuar nga disa aspekte. Së pari analizimi i tyre është bërë në aspektin juridiko-penal, në aspektin e objektit material, tipologjisë së subjekteve të kryerjes së veprave penale, aspektit komparativ, kriminologjik, politikës së ndjekjes penale dhe politikës ndëshkimore.

Nga trajtimi juridiko-penal i këtij problemi është shtjelluar kuptimi, mënyrat e

kryerjes, inkriminimi i tyre sipas legjislacionit penal të disa shteteve, politika ndëshkimore dhe masat e suksesshme për ndriçimin e tyre.

Nga studimi analitik, që i është bërë legjislacionit penal, vërehet se veprat penale kundër ekonomisë, në të gjitha shtetet e Ballkanit dhe më gjerë, parashihen në legjislacionet penale dhe zënë një vend të rëndësishëm në grupin e tërësishëm të veprave penale.

Nisur nga fakti se veprat penale kundër ekonomisë, si motiv kanë pasurimin e paligjshëm, krijimin e ekonomisë joformale, destabilizimin e tregut, falimentimin e ndërmarrjeve, është e domosdoshme që shtetet me masa dhe mjete përkatëse të bëjnë luftimin dhe parandalimin e tyre.

Veprat penale të trajtura në punim kërkojnë vërtetim se a janë ndriçuar këto vepra penale në masën e duhur, cila kategori e veprave penale kundër ekonomisë përbën numrin më madh të tyre, cila është dinamika e prurjes së kallëzimeve penale, zgjidhja dhe struktura e tyre e përcjellë me vendime gjyqësore.

Në këtë punim është trajtuar tipologjia e subjekteve në kryerjen e veprave penale kundër ekonomisë jo vetëm në Kosovë por edhe në disa shtete të Bashkimit Evropian, ngase siç argumentohet nga E. Bekker dhe A. Briz, shoqëritë tregtare kanë një karakter pasuror. Ato janë krijuar për një qëllim të posaçëm tregtar dhe ju mungon kapaciteti juridik, gjë që ndikon që të mos jetë subjekt i përgjegjësisë penale.

Andaj, punimi ka për qëllim të hedhë në dritë edhe faktin se çfarë ka ekzistuar në legjislacionin e Kosovës, Ballkanit dhe më gjerë mbi çështjen e përgjegjësisë penale të personave juridikë, dhe ajo që është më thelbësore se çfarë mund të bëhet më mirë në të ardhmen në sferën e kuadrit normativ dhe ligjor të kësaj natyre.

2. Hipotezat e punimit

Si një kërkesë e rëndësishme e punimit është të vihet në dukje fakti se sa ligjvënësi kosovar i ka dhënë mbrojtje juridiko-penale afarizmit ekonomik, këtij segmenti me rëndësi të madhe në ruajtjen e ekonomisë dhe sistemit ekonomik në përgjithësi. Prandaj parashtrojmë hipotezat si më poshtë:

Hipoteza 1 - Veprat penale në fushën e ekonomisë janë në përputhje me aktet ndërkombëtare.

Hipoteza 2 - Politika penale në lidhje me veprat penale në sferën e ekonomisë nuk është adekuate.

Nevoja për këtë studim qëndron në faktin se këto vepra penale në të kaluarën janë studiuar fare pak. Me të drejtë pohohet se studimi i tyre është i vështirë, sepse fatkeqësisht shumica e kryerësve të këtyre veprave penale, kundër ekonomisë, i përkasin kategorive të lidhura me strukturat shtetërore, fakt që pengon zbulimin e tyre.

Pra, synimi kryesor i këtij studimi shkencor është të japë përgjigje pyetjeve të mëposhtme kërkimore.

3. Pyetjet kërkimore të punimit

- Sa është paraqitja e veprave penale kundër ekonomisë, cila është dinamika dhe struktura, cila është mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale dhe e vendimeve gjyqësore, për periudhën hulumtuese 2008-2012?
- Ç'është mbrojtja juridiko-penale që ofron legjislacioni penal i Kosovës, ai i vendeve ballkanike si dhe i disa shteteve të Evropës, për veprat penale të ekonomisë?

- Legjislacioni penal i Kosovës në fushën e ekonomisë a është në harmoni me aktet ndërkombëtare ?
- Politika Penale a është zbatuar siç duhet me veprat penale në sferën ekonomike?
- Cilat janë veçoritë e kriminalitetit, si për shembull, personaliteti i të gjykuarve, i të proceduarve, gjinia , mosha, recidivi për veprat penale kundër ekonomisë të parashikuara nga neni 232-251, në Kodin Penal (2004), për periudhën hulumtuese 2008-2012, të ndodhura në Ferizaj?
- Çfarë mund të rekomandohet për të përmirësuar, kuadrin normativ, mënyrën e ruajtjes së lëndëve, rritjen e efikasitetit në zgjidhjen dhe në procedimin e tyre?

Natyra komplekse e veprave penale kundër ekonomisë kërkon një qasje sistematike për të kuptuar vlerësimin efikas të dispozitave ligjore, instrumenteve për luftimin dhe parandalimin e tyre, identifikimin e pengesave normative në zbatimin e legjislacionit penal dhe propozimin për nxjerrjen e normave më të përparuara për të pasur efekt në zbatimin e tyre në marrëdhëniet e caktuara konkrete. Andaj, gjatë studimit të kësaj problematike është kërkuar që në punim të përdoren metoda të ndryshme shkencore dhe një metodologji shkencore interdisiplinare.

4. Metodatat dhe metodologjia e kërkimit

Gjatë punimit të disertacionit, për të pasur rezultatet e duhura, më është dashur të përdor metoda dhe teknika hulumtuese të kombinuara : metodën historike, komparative, juridike, empirike, të vrojtimit dhe statistikore. Përmes metodës historike, kemi trajtuar lindjen e veprave penale, dinamikën e tyre si produkt i veprimeve të kundërligjshme,

legjislacionin penal të Kosovës si dhe legjislacionin penal të disa shteteve të Bashkimit Europian, politikën ndëshkimore, standardet dhe parimet bashkëkohore të

legjislacionit që parashihen në aktet ndërkombëtare.

Për sistemimin dhe grupimin e veprave penale, është zbatuar metoda statistikore përmes së cilës është shtjelluar vëllimi, struktura, dinamika e veprave penale kundër ekonomisë në territorin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, për periudhën 2008-2012, dhe vëllimi, struktura dhe dinamika e kallëzimeve penale të paraqitura në Prokurorinë Komunale në Ferizaj, për periudhën e njëjtë.

Metoda krahasimore është përdorur për të krahasuar legjislacionin penal të Kosovës dhe të disa vendeve të Bashkimit European për veprat penale kundër ekonomisë dhe përgjegjësinë penale të personave juridikë. Vlen të theksohet se këtë metodë e kam kombinuar edhe me metodën grafike dhe kam arritur në përfundime shkencore që do t'i japin kontribut problemit të trajtuar.

Një rëndësi të veçantë me vlerë shkencore është fituar përmes metodës empirike dhe vrojtimit apo observimit indirekt me çrast janë analizuar në mënyrë të tërthortë rastet e shumta të lëndëve dhe vendimeve gjyqësore nga praktika e Gjykatës Komunale në Ferizaj, gjatë periudhës hulumtuese.

Në këtë studim metodat e përdorura janë sasiore dhe cilësore të kërkimit. Metoda sasiore është mbështetur në aspektin shpjegues dhe përshkruar të dukurive që po studiohen në këtë studim, ndërsa përmes metodës cilësore, kam pasur synim njohjen e vërtetë të objektit të studimit. Qasje me rëndësi metodike në këtë studim është qasja normative, e cila konsiston jo për të konstatuar gjendjen, por të tregoj se si duhet të jetë. Metodologjia, e përdorur në këtë studim, bazohet në kthimin e përgjigjeve për pyetjet kërkimore të parashtruara në studim. Metodologjia e studimit është e bazuar në parimet e objektivitetit, besueshmërisë dhe saktësisë. Gjatë angazhimit, për të siguruar të dhënat

në prokurori dhe gjykatë, kemi hasur padyshim edhe në vështirësi për grumbullimin e tyre me faktin se mungon sistemi adekuat për ruajtjen e lëndëve.

Objekt studimi i këtij punimi është trajtuar në shtatë kapituj dhe nënkapituj, ku shqyrtohen problematika dhe tema të ndryshme.

Në kapitullin e parë me titull “Vështirimi juridiko-penal i veprave penale kundër ekonomisë”, analizohen kuptimi dhe karakteristikat e përgjithshme të veprave penale kundër ekonomisë, mënyra e kryerjes, struktura dhe dinamika e kryerjes, tipologjia e subjekteve të veprave penale dhe teknikat e inkriminimit të veprimeve kriminale.

Në kapitullin e dytë të titulluar “Zhvillimi dhe historiku i legjislacionit penal të Kosovës kundër veprave penale në fushën e ekonomisë”, është trajtuar paraqitja dhe zhvillimi i legjislacionit penal të Kosovës para luftës që nga Ligji Penal i KSAK i vitit 1977 si dhe pas përfundimit të luftës më 1999. Historiku i zhvillimit të legjislacionit përfshin edhe periudhën pas pavarësisë së Kosovës, 17 Shkurt 2008.

Kapitulli i tretë “Veprat penale kundër ekonomisë sipas legjislacionit penal të Kosovës”, i është bërë një trajtim i hollësishëm veprave penale kundër ekonomisë sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Në kapitullin e katërt janë përfshirë “Aspektet krahasuese për veprat penale kundër ekonomisë dhe përgjegjësia penale e personave juridikë sipas legjislacionit penal të Kosovës dhe disa shteteve të Evropës”.

Në pjesën e parë është shtjelluar aspekti komparativ (krahasimtar) i veprave penale kundër ekonomisë, duke përfshirë përmbajtjen dhe politikën ndëshkimore, ndërsa në pjesën e dytë është krahasuar përgjegjësia penale e personave juridikë në Kosovë dhe disa shtete të Evropës. Në këtë kapitull është krahasuar edhe legjislacioni penal i

Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Europian në fushën ekonomike, me theks të veçantë instrumentet ndërkombëtare dhe politika ndëshkimore që i parashohin ato.

Kapitulli i pestë i titulluar “Veprat penale kundër ekonomisë dhe raporti i tyre me grupet e tjera të veprave penale të vështuara sipas objektit material”, trajton raportin e veprave penale kundër ekonomisë me veprat penale kundër pasurisë, detyrës zyrtare dhe veprave penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë, në fushën e pronës dhe në fushën financiare e doganore.

Në kapitullin e gjashtë me titull “Aspekti kriminologjik i veprave penale kundër ekonomisë në territorin e Gjykatës Komunale në Ferizaj për periudhën 2008-2012”, janë trajtuar problemet themelore që kanë të bëjnë me aspektin kriminologjik, duke *përfshirë* disa karakteristika personale të kryerësve të veprave penale: si moshën e kryerësve, nivelin profesional dhe social, recidivin dhe gjininë e tyre, gjithashtu është prekur çështja e fenomenologjisë dhe shkaqet e paraqitjes, siç janë kriza ekonomike, varfëria, papunësia, rrethanat e krijuara shoqërore pas luftës së fundit në Kosovë.

Në kapitullin e fundit janë trajtuar masat parandaluese dhe represive që kanë ndikuar në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit kundër ekonomisë, dhe si përfundim apo përmbyllje janë përmbledhur disa rekomandime lidhur me këtë fushë.

Konsideroj që bibliografia e përdorur për trajtimin e kësaj problematike është bashkëkohore, ajo është pasuruar veçanërisht me ligjet që e mbulojnë këtë fushë, akte dhe raporte vendore e ndërkombëtare, praktika gjyqësore dhe statistikat e siguruara në gjykatë dhe prokurori. Një vend me rëndësi e zënë lëndët gjyqësore dhe të dhënat tjera të siguruara për veprat penale kundër ekonomisë.

KAPITULLI I

VËSHTRIMI JURIDIKO-PENAL I VEPRAVE PENALE KUNDËR EKONOMISË

1.1. Kuptimi i veprave penale kundër ekonomisë

Së fundmi, veprat penale kundër ekonomisë janë në rritje të vazhdueshme. Prandaj, me të drejtë ky grup i veprave penale është paraparë në legjislacionin e të gjitha vendeve demokratike, që synim kanë sundimin e rendit dhe ligjit. Veprat penale kundër ekonomisë pa dyshim shkaktojnë pasoja të shumta për ekonominë, sistemin ekonomik dhe financiar të secilit shtet, qoftë ai edhe me ekonomi të zhvilluar dhe me sundim të rendit dhe ligjit.

Krizat dhe pasojat që sjell ky grup i veprave penale kanë ndikim të fuqishëm në paraqitjen e kriminalitetit ekonomik dhe krimin në përgjithësi¹. Andaj, këto vepra penale duhet të luftohen dhe parandalohen nga ana e shtetit me masa preventive adekuate dhe akte ligjore përkatëse. Nisur nga fakti se veprat penale kundër ekonomisë si motiv kryesor e kanë pasurimin e paligjshëm shpeshherë kryerës të tyre janë edhe vetë personat të cilët janë të thirrur për t'i luftuar dhe parandaluar ato. Ky realitet ka ndikuar që shteti dhe shoqëria në përgjithësi të kenë një qasje pozitive për ti dhënë mbrojtje ekonomisë dhe pronës nga këto dukuri negative përmes së drejtës penale, ngase zhvillimi ekonomik kushtëzohet nga shumë faktorë të ndryshëm politikë, shoqërorë,

¹ Vula. Veton, *Krimi i organizuar*, botuar nga Kolegji Evropian “Dukagjini”, Prishtinë, 2013, fq. 304.

ekonomikë². Ky angazhim i ligjvënësit është shoqëruar me ndryshimin e konceptit tradicional, duke vepruar në drejtim të reformave në legjislacion nga ana e shteteve me qëllim të plotësimit të legjislacionit penal, për t'iu përgjigjur nevojës për mbrojtje nga format e reja të kriminalitetit dhe shumë të përsosura e në veçanti nga veprimet e kryesëve të këtij grupi të veprave penale. Pasuria është një e mirë, një kategori juridike që është objekt i veprave penale, prandaj me të drejtë duhet të jetë në mbrojtje të dispozitave juridiko penale³. Për kuptimin apo nocionin e veprave penale kundër ekonomisë janë dhënë përkufizime të ndryshme nga shumë autorë që nga e kaluara e gjerë më sot, të cilat përkufizime kanë nxjerr në pah edhe dallime të caktuara.

Veprat penale kundër ekonomisë, prekin interesat ekonomike të personave fizikë, ose personave juridikë apo të shtetit, andaj me të drejtë ato bëhen objekt i diskutimit shkencor nga legjislacioni penal, për format e paraqitjes së tyre në praktikë, pasojat që i shkaktjnë ekonomisë dhe buxhetit, figurës së veprës penale⁴. Veprat e kundërligjshme kuptohen ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme të drejtuara kundër sistemit ekonomik, marrëdhënieve dhe afarizmit ekonomik në një vend⁵. Si të tilla veprimet e kundërligjshme kanë për qëllim përfitimin e kundërligjshëm të pasurisë me qëllim që kjo pasuri më vonë të shkëmbehet ose të transferohet, për të fshehur origjinën e paligjshme ose në raste të caktuara, duke i dhënë ndihmë ndonjë personi që është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme. Shpesh dëgjojmë termin “kriminalitet ekonomik” që e përdorin shumë autorë në teorinë juridiko-penale dhe kriminologjike në vend të termit veprave penale kundër ekonomisë. Mirëpo kriminaliteti ekonomik ka një

2 Limani. Musa, *Rrjedhat ekonomike të Kosovës në fazën e tranzicionit*, botuar në revistën shkencore “Norma”, Kolegji Gjilani, 2012, fq. 14.

3 Elezi. Ismet, *E drejta penale* (pjesa e posaçme), botimet Erik, Tiranë, 2009, fq. 202.

4 Po aty, fq. 203.

5 Tomić. Zvonimir, *Krivično pravo (posebni dio)*, Magistrat, Sarajevo, 2003 fq. 147.

kuptim më të gjerë dhe përfshin edhe vepra të tjera penale, të cilat legjislacioni aktual penal i Kosovës i ka veçuar nga grupi i veprave penale kundër ekonomisë, siç janë korrupsioni dhe krimi i organizuar, skema piramidale dhe bixhozit të paligjshëm, shpërlaja e parave.

Nocioni i kriminalitetit ekonomik nuk është përcaktuar qartë as në teorinë penalo-juridike e as në praktikën e shteteve të ish-Jugosllavisë, në këtë aspekt pikëpamjet e autorëve mes vete dallojnë shumë pak midis tyre. Shumë autorë veprat e kriminalitetit ekonomik i paraqesin si sjellje të personave fizikë dhe juridikë, që shkaktojnë rrezik shoqëror dhe dëmtojnë politikat ekonomike. Një grup tjetër mendon se këto vepra janë sulm në organizimin dhe funksionimin e sistemit ekonomik. Më e përhapura është pikëpamja që bazohet në klasifikimin juridik të së drejtës penale materiale, e cila veprat penale në fushën e ekonomisë, i konsideron si veprimtari dhe sulm ndaj sistemit ekonomik nacional, të cilat veprime janë të inkriminuara në kodin penal.⁶

Nëse duhet të japim kuptimin e qartë të kriminalitetit ekonomik nuk mjafton të mbështetemi vetëm në dispozitat juridike sepse këto vepra penale paraqiten si fenomen shoqëror në të gjitha rregullimet shoqërore. Veprat penale në sferën ekonomike financiare përfshin një gamë të gjerë të veprave penale në shoqëritë tregtare, krimet në fushën e doganave, veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet, falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë, veprat penale në fushën e falimentimit⁷.

Meqenëse sektori më i rëndësishëm i zhvillimit dhe stabilitetit shtetëror është ekonomia e një vendi, pa dyshim që shtetet bëjnë punën e tyre në forcimin e pushtetit shtetëror që ka për qëllim të ruajë e forcojë bazën ekonomike dhe rendin shoqëror të një

6 Sućeska. Mersida, *Bazat e kriminalitetit ekonomik*, Universiteti AAB, Prishtinë, 2006, FSK/07.

7 Elezi. Ismet & Hysi. Vasilika, *Politika kriminale*, PEGI, Tiranë, 2006, fq. 109- 110.

vendi,⁸ përfitimit material e financiar. Andaj, ky lloj kriminaliteti është një dukuri e dëmshme. Veprat penale kundër ekonomisë në bazë të legjislacionit penal të vendit tonë, por edhe aty të Bashkimit European kryesisht kryhen me dashje, në mënyrë të kundërligjshme dhe me qëllim të përfitimit joligjor nga shoqëria në përgjithësi dhe qytetari në veçanti. Me anë të këtyre veprave rrezikohet siguria e vendit, vlerat më vitale të njeriut, pasuria, liria e lëvizjes së mallrave dhe kapitalit, dhe një varg vlerash tjera individuale, kombëtare dhe ndërkombëtare⁹.

Për shkak të peshës që kanë veprat penale, në sferën ekonomike dhe pasojat që i shkaktojnë ekonomisë së vendit, ato zënë vend të konsiderueshëm në statistikën e kriminalitetit¹⁰.

Mbrojtja e sistemit ekonomik dhe funksionimi normal, ndaras nga kriminaliteti si dukuri shoqërore negative, imponon nxjerrjen e legjislacionit adekuat në fushën juridiko-penale që në të drejtën bashkëkohore quhet e drejta penale ekonomike¹¹. Se mbrojtja juridiko-penale e ekonomisë është shumë e rëndësishme, vërtetohet më së miri nga fakti se mbrojtja e saj është paraparë nga shtetet në ligjet e tyre penale dhe me aktet më të larta juridike ndërkombëtare.

Kosova në Kodin Penal, në kapitullin XXII, i ka inkriminuar veprat penale kundër ekonomisë.¹² Kodi Penal i Kosovës, por edhe ligjet tjera penale, veprat penale kundër ekonomisë i paraqesin si cenim i një të mire juridike të mbrojtur me ligj. Mendojmë se për ta definuar, nga aspekti kriminologjik, kriminalitetin ekonomik duhet të kuptojmë

⁸ Po aty, fq. 113.

⁹ Shala. Afrim, *Hyrje në të drejtën penale*, Qendra Juridike e Kosovës, 2011, fq. 2.

¹⁰ Elezi. Ismet, *E drejta penale* (pjesa e posaçme), botimet Erik, Tiranë, 2009, fq. 202.

¹¹ Beka. Agron, *Abuzimet në lëmin e qarkullimit të pronës së paluajtshme në Kosovë*, Universiteti "AAB", Prishtinë, 2007, fq. 36.

¹² Kodi Penal i Përkohshëm i Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut nr. /2003/25, 6 prill, 2004.

saktë se çka është në të vërtetë ai në praktikë¹³. Disa mendimtarë i përkufizojnë si vepra të drejtura kundër organizimit dhe funksionimit të sistemit ekonomik. Në kuptimin më të thellë kriminaliteti përfshin të gjitha veprat penale, të cilat rrezikojnë të atakojnë dhe të dëmtojnë sistemin ekonomik dhe marrëdhëniet ekonomike të vendit¹⁴.

1.2. Karakteristikat e veprave penale kundër ekonomisë

Veprat penale kundër ekonomisë, si tërësi, janë veprime të paraqitura në forma të ndryshme të aktivitetit kriminal, të drejtura kundër sistemit ekonomik dhe funksionimit të tij, pavarësisht se a janë ndërmarë kundër afarizmit ekonomik apo jashtë tij.

Kjo kategori e veprave penale, si dukuri negative e kundërligjshme dhe e rrezikshme për shoqërinë, në radhë të parë shprehet në bazën materiale duke u bërë pengesë e zhvillimit ekonomik.¹⁵ Nëse i vështrojmë veprat penale në fushën e ekonomisë, do të vërejmë se ato i kanë karakteristikat e veta që i dallojnë nga grupet e tjera të veprave penale, por në anën tjetër kanë edhe elemente të përbashkëta me disa grupe të veprave penale kundër pasurisë, korrupsionit zyrtar dhe veprat kundër detyrës zyrtare. Tipare kryesore, të këtyre veprave penale, janë përfitimi material ose të mira të tjera, pavarësisht prej formës dhe vlerës së tyre, “shifrat e errëta”, dinamika dhe përshtatja me të gjitha ndryshimet ekonomike e normative¹⁶. Si kryerës të këtyre veprave penale mund të paraqiten personat fizikë dhe juridikë, persona me cilësi të caktuar, apo edhe secili person. Nga praktika është vërtetuar se këto vepra penale më së

¹³ Pešić . V, *Bitne karakteristike i stanje privrednog kriminaliteta u Jugoslaviji u savremenim uslovima, Privredni Kriminalitet*, Institut za kriminološka i sociološka istraživanja, Beograd, 1977, fq.9.

¹⁴ Demolli. Haki, *Kriminaliteti ekonomik në Kosovën e viteve të tetëdhjeta*, Fakulteti Juridik, Prishtinë, shtator 2009, fq. 30.

¹⁵ Latifi. Vesel, *Kriminalistika*, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2006, fq. 326.

¹⁶ Sućeska. Mersida, *Bazat e kriminalitetit ekonomik*, Universiteti “AAB”, Prishtinë, 2006, FSK/07/ fq. 16.

shumti kryhen nga persona përgjegjës, që janë të thirrur për të mbrojtur ligjin dhe ekonominë e vendit. Disa vepra penale të parapara në Kodin Penal të Kosovës në fushën e ekonomisë si: “Marrja e ryshfetit” (neni 428), “Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi”, (neni 236), Shmangia nga tatimi, (neni 249) etj. shpeshherë si kryerës të këtyre veprave paraqiten personat të cilët janë zyrtarë publikë si doganierë, zyrtarë të taksave, zyrtarë komunalë etj. Duhet potencuar faktin se në një hulumtim të bërë nga zyrtarët e Zyrës së Kombeve të Bashkuara, në lidhje me korrupsionin në Kosovë, ka rezultuar me të gjetura, se zyrtarët publik që paraqesin rrezik më të madh për marrje ryshfeti në bashkëveprim me bizneset janë: zyrtarët e doganave, zyrtarët tatimorë, zyrtarët e të hyrave dhe zyrtarët komunalë¹⁷. Sipas anketës, nga të gjithë bizneset që kanë pasur kontakt me një zyrtar publik në 12 muaj, 3.2% prej tyre i kanë paguar ryshfet një zyrtari publik¹⁸.

Karakteristikë e veprave penale, kundër ekonomisë, është se në disa raste edhe pse kryerësi nuk ka arritur ta kryejë veprën penale si për shembull te vepra penale “falsifikim i parasë”, (neni 244), paraja i konfiskohet personit deri në vendimin përfundimtar të gjykatës edhe pse vepra ka mbetur vetëm në tentativë dhe ende nuk është vërtetuar se a është paraja e falsifikuar. Konfiskimi mund të jetë dylojesh, i zgjeruar kur gjykata merr vendim që të konfiskoje të gjitha përfitimet e kriminelit që kanë ardhur nga e gjithë e kaluara kriminale, sidomos për krimet e rënda, pastaj konfiskimi në vlerë, ku nga kriminelit konfiskohet pasuria e cila nuk mund të provohet

17 Raport nga United Nations Office on Drugs and Crime, Biznesi, *Korrupsioni dhe krimi në Kosovë*, botuar në mbështetje financiare të Bashkimit Europian, Qeverive të: Gjermanisë, Norvegjisë dhe të Suedisë në vitin 2013, fq. 5.

18 Po aty.

se është fituar nga ndonjë burim kriminal¹⁹. Karakteristikë e këtyre veprave penale është se kohën e fundit për kryerjen e tyre përgjegjësi penale mbajnë edhe personat juridikë.

1.3. Specifikat e objektit material

Veprat penale kundër ekonomisë, përveç karakteristikave të veçanta, në raport me grupet e tjera të veprave penale, kanë specifika edhe sa i përket objektit material. Objektivi i kryerësve të veprave penale, kundër ekonomisë, është specifik, sepse në raste të caktuara nuk është vetëm pasurimi i paligjshëm material, por edhe prishja e konkurrencës lojale, falimentimi, financimi i krimit të organizuar, andaj ata shfrytëzojnë të gjitha rrugët përmes veprimeve kriminale për ta kufizuar qarkullimin e lirë të mallrave dhe kapitalit; të kufizojnë organizatat e ndryshme të biznesit në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve, cenimin e barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, afarizmin e pandërgjegjshëm, ku pasojat e këtij kriminaliteti në radhë të parë shprehen në bazën materiale të shoqërisë, andaj me të drejtë mund të thuhet se kjo dukuri është pengesë për zhvillimin e shoqërisë²⁰. Secila nga veprat penale kundër ekonomisë i ka specifikat e veçanta të objektit material, por specifikë e përbashkët e objektit material dhe mbrojtës, nga aspekti juridiko penale janë: sistemi ekonomik, afarizmi ekonomik dhe marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar veprimtari normale në ekonomi. Në vazhdim po i theksojmë specifikat e objektit material të disa veprave penale në fushën e ekonomisë: falsifikimi i parasë (neni 244) në Kodin Penal të Kosovës dhe falsifikimi i monedhave, siç e parasheh Kodi Penal i Shqipërisë. Objekt i krimit të veprat e përmendura janë: marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar

19 Latifi. Vesel, *Luftimi i korrupsionit dhe konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale*, revista "Juridica" Instituti Evropian për Studime Juridike dhe Administratë Publike, Prishtinë, 2011, fq. 9.

20 Latifi. Vesel, *Kriminalistika*, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2006, fq. 326.

veprimtarinë e rregullt të sistemit monetar e të kreditit dhe për ta siguruar nga inflacioni, të mbrojtur me legjislacion penal kundër veprimeve apo mosveprimet kriminale²¹. Pra, në objektin material të krimit hyjnë të gjitha llojet e monedhave.

Nga aspekti i nocionit material vepra penale është veprim apo sjellje e njeriut e cila e dëmton, rrezikon vlerat themelore elementare të njeriut, shoqërisë dhe sistemit juridik dhe ekonomik të vendit. Ndërsa në aspektin e nocionit materialo-formal veprat penale në ekonomi janë veprime të kundërligjshme të njeriut, të qëllimshme, të rrezikshme dhe të parapara me ligj. Kodi Penal i Kosovës e përvetëson nocionin formalo-material të veprës penale, ku veprën penale e parasheh si vepër e kundërligjshme e paraparë me ligj, me të janë paraparë tiparet dhe sanksionet penale²².

Kodi Penal i Kosovës, dhe legjislacioni penal në përgjithësi, duke pasur parasysh specifikat e objektit material të veprat penale, në fushën e ekonomisë, ka paraparë mbrojtje përmes dispozitave penalo-juridike, dhe sanksioneve penale.

1.4. Dinamika dhe mënyrat e kryerjes së veprave penale kundër ekonomisë

Në Kosovën e pasluftës, rrethanat shoqëro-ekonomike të krijuara pas çlirimit për shkak të dëmeve të krijuara nga lufta në të gjitha segmentet e jetës, me theks të veçantë në fushën e ekonomisë, vetëm gjatë okupimit 10 vjeçar nga Serbia (1989-1999), Kosova u shndërrua në tokë të djegur dhe pasojat ishin katastrofale për ekonominë e saj. Po përmendim vetëm faktin se nga 335.333 shtëpi të shqiptarëve, 200 mijë prej tyre ishin

21 Elezi. Ismet, *E drejta penale* (pjesa e posaçme), Botimet Erik, Tiranë, 2009, fq. 307.

22 Kodi Penal i Kosovës, *Rregullorja e UNMIK-ut*, 2003/25, prill 2004, neni 6.

demoluar, kurse 100 mijë nga ato ishin shkatërruar me themel²³. Kjo gjendje ka ndikuar që për një kohë Kosova të mos ketë konsolidim të institucioneve efikase dhe legjislacion adekuat penal për të luftuar kriminalitetin ekonomik si sfidë e shteteve posaçërisht atyre në tranzicion.

Ndër problemet e theksuara përmenden disa karakteristika të kriminalitetit që vijnë nga: funksionimi joefikas i pushtetit për shkak të transformimit të tij prej një forme në formën tjetër: strukturat paralele, numri i madh i personave që kishin nevojë për ndihmë humanitare, ekonomia e rrënuar, numri shumë i madh i njerëzve pa punë. Pasojë e këtyre problemeve ka qenë shkalla e dezorganizimit të subjekteve që merren me luftën kundër këtyre dukurive natyrore²⁴.


Në vijim do të paraqesim numrin e veprave penale kundër ekonomisë në Gjykatën Komunale - Themelore në Ferizaj, për periudhën 2011-2012-2013.²⁵

23 Bashota. Nuri, *Zhvillimi ekonomik i Kosovës dhe sot dhe në perspektivë*, revista shkencore ndërkombëtare "Iliria", botuar nga Bordi i Universitetit "Iliria", Prishtinë, 2010, fq. 15.

24 Demolli. Haki, *Disa karakteristika të kriminalitetit në Kosovën e pasluftës*, "E Drejta", nr. 1-2, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2008, fq. 69.

25 Raport i përgjithshëm për veprat penale në Gjykatën Komunale -Themelore në Ferizaj, për periudhën, 2011-2013.

Tabela 1. Dinamika e veprave penale kundër ekonomisë në Gjykatën Themelore të Ferizajt, në raport me numrin e përgjithshëm të veprave penale



Burimi: Gjykata Themelore, Ferizaj

Nga të dhënat e paraqitura në formë tabelare për periudhën 2011-2013 në territorin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, vërehet se janë kryer gjithsej 112 vepra penale kundër ekonomisë. Nëse krahasohet dinamika në raport me veprat penale kundër ekonomisë në ish Gjykatën e Qarkut, për periudhën 1999-2005, ku gjithsej ishin paraqitur 44.864 dhe që emërtoheshin vepra penale kundër detyrës zyrtare, ekonomisë dhe shëndetit publik, në krahasim me numrin e përgjithshëm të veprave penale të paraqitura në Kosovë në këtë periudhë që ishte 426.048, nxjerrim këtë përfundim se veprat penale kundër ekonomisë merrte pjesë me 10.53%. Nëse e krahasojmë me veprat penale kundër personit të kryera në vitin 2001 (9367 apo 18.93%), kundër pasurisë të kryera në vitin 2001 që është 20.767 apo 18.08%, është e qartë se veprat penale në fushën e ekonomisë kanë një rritje sidomos në periudhën 2004 (9657 apo 21.52%) apo

në vitin 2005 (9243 apo 20.60%)²⁶. Nga krahasimi shihet se ka një rënie të veprave penale kundër personit dhe pasurisë dhe një ngritje kundër veprave penale në fushën e ekonomisë. Vlen të përmendet periudha për të cilën është bërë krahasimi që i takon periudhës kur veprat penale në fushën e ekonomisë nuk ishin të ndara në kapitull të veçantë, siç janë sot.

Ndërsa, sa i përket mënyrës së kryerjes dhe dinamikës mund të theksojmë se ky grup i veprave penale ka karakteristikat e veçanta që e bëjnë të dallohet nga veprat e tjera penale, duke pasur parasysh se veprimet të ky lloji i kriminalitetit nuk janë të karakterit klasik, pra pasojat nuk janë të dukshme dhe transparente për shoqërinë në përgjithësi e as për jetën e përditshme në veçanti. Mënyra e kryerjes së këtij lloji kriminaliteti është e sofistikuar, nuk ka ndërrime të dukshme të kryerësit dhe një numër i caktuar i këtyre veprave mbetet i pazbuluar, hetimet zgjasin dhe janë më të komplikuar. Nga paraqitja e të gjitha fazave procedurale, deri te gjykimi me vendim të formës së prerë zgjasin më shumë se veprat tjera penale²⁷. Të dëmtuarit nga këto krime shpeshherë duken si të panjohur dhe abstrakt në shikimin e parë dhe ndaj këtij kriminaliteti veprohet vetëm pasi të delë në shesh veprimtaria kriminale. Kjo e bën shumë më të vështirë zbulimin dhe kapjen e kryesëve të veprave penale, ndërsa dëmet materiale të këtyre krimeve rriten gjithnjë e më tepër²⁸.

Globalizimi ekonomik i mbështetur në integrimet e tregjeve, lëvizja e lirë e mallrave dhe kapitalit, kanë minimizuar rëndësinë e kufijve në mes shteteve dhe ka

26 Raport i përgjithshëm për veprat penale në Gjykatën Komunale -Themelore në Ferizaj, për periudhën 2011-2013, fq. 74-77.

27 Licenoski. B., *Tok i trajanje postupka po predmetima privrednog kriminaliteta*, Privredni Kriminalitet, Institut za Kriminoloska i Socioloska Istrazivanja, Beograd, 1977, fq. 50.

28 Halili. Ragip, *Kriminologjia*, AAB- Riinvest, Prishtinë, 2011, fq. 195-205.

krijuar një favor për rritjen e kriminalitetit ekonomik. Veprat penale në fushën e ekonomisë mbeten pa dyshim një nga brengat dhe shqetësimet madhore të shoqërive të ndryshme për dekadat e fundit, sepse krimi ekonomik shkakton humbje të të ardhurave publike si dhe deformon ekonominë kombëtare dhe sistemin ekonomik.

1.5. Tipologjia e subjekteve të veprave penale kundër ekonomisë

Veprat penale, kundër ekonomisë, përbëjnë një nga krerët më të rëndësishëm në pjesën e posaçme të kodit penal, si nga aspekti teorik ose praktik. Në teorinë e së drejtës penale subjekt apo kryerës të veprave penale janë personat që marrin drejtpërsëdrejti veprimin për kryerjen e veprës penale. Pra, subjekt të veprës penale mund të jetë çdo person fizik i cili ka mbushur moshën katërmëdhjetëvjeçare, në të kundërtën në Kodin Penal të Kosovës në nenin 11, par. 2, thuhet personi nuk ka përgjegjësi penale nëse nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetëvjeçare²⁹.

Për disa vepra penale kundër ekonomisë subjekt mund të jetë çdo person fizik e juridik, ndërsa për disa të tjera, si kryerës të veprave penale mund të paraqiten subjekte me cilësi të ndryshme. Vlen të theksohet fakti se pas një kohe shumë të gjatë është bërë një hap pozitiv sa i përket përgjegjësisë penale nga ana subjekteve në Kosovë dhe Shqipëri që personat juridikë të mos përgjigjen vetëm në pikëpamje të së drejtës civile dhe delikteve ekonomike për veprat penale të realizuara nga përgjegjësit e tyre, por edhe në kuadrin e së drejtës penale, si subjekte penalisht përgjegjëse.³⁰

Sipas doktrinės penalo-juridike thuhet se përgjegjësia penale është individuale dhe

29 Kodi Penal i Përkohshëm i Kosovës, *Rregullorja e UNMIK-ut*, 2003/25, 6 prill 2004, neni 11 par. 2.

30 Bozheku. Ersi, *Probleme interpretuese dhe aspekte krahasuese me legjislacionin italian*, Përgjegjësia penale e personave juridikë, revista shkencore, Ligji dhe shoqëria, Fakulteti Juridik, Tiranë, 2010, fq. 187.

se elementi që përbën figurën e veprës penale mund të gjendet vetëm te personi fizik, (faji). Mirëpo, ligjvënësi nga realiteti dhe praktika ka pasur parasysh se kohën e fundit po rritet kriminaliteti ekonomik me protagonistë kryesorë personat juridikë apo personat që veprojnë në emër dhe në dobi të tyre.

1.5.1. Subjekti-personi fizik si kryerës i veprave penale kundër ekonomisë

Shikuar historikisht personat fizikë nuk ishin subjekt i së drejtës në të gjitha periudhat kohore. Në kohën e romakëve skllëvërit jo që nuk ishin subjekt i së drejtës por ata konsideroheshin si objekt sende (res). E drejta civile, si degë pozitive, personin fizik si subjekt të së drejtës e konsideron nga lindja me kusht që ai të lindë i gjallë dhe me tiparet e njeriut. Kjo aftësi subjektive përfundon kur ai vdes, apo me shpalljen e personit fizik për të vdekur³¹. Për dallim nga aftësia juridike, aftësia për veprim e personave fizikë fillon nga mosha madhore d.m.th. nga momenti kur ata mbushin 18 vjet, apo përjashtimisht kur ata martohen para kësaj moshe. Deri në moshën e përmendur personat fizikë kanë aftësi veprimi të kufizuar dhe pjesëmarrja e tyre në qarkullimin privato-juridik bëhet përmes përfaqësuesve ligjorë. Mirëpo edhe në raste e tilla kemi dallime varësisht se në cilën moshë ata janë. Deri në moshën katërmëdhjetë vjeçare ata konsiderohen fare pa zotësi veprimi.

Në ditët e sotme personat fizikë me të lindur e fitojnë statusin e subjektit të së drejtës. Në teorinë e së drejtës penale subjekt i veprës penale konsiderohet kryerësi i veprës penale, personat fizikë që ndërmarrin veprimin e drejtpërsëdrejt për kryerjen e veprës penale, por edhe personat si: shtytësi (nxitësi), ndihmësi dhe organizatori i shoqatës kriminale.

31 *E Drejta Civile*, doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2009, fq 305.

Në bazë të moshës kryerësit e veprës penale ndahen në të mitur dhe madhorë.

Të mitur të rinj janë nga mosha 14-16 vjeç, ndërsa të mitur të rritur nga mosha 16-18 vjeç, kurse sipas kësaj dispozite ligjore madhorë konsiderohen personat mbi moshën 18 vjeç, ndërsa madhor të rinj nga mosha 18 deri në 21 vjeç³². Nëse merret parasysh aftësia psikike e kryerësve të veprës penale ato ndahen në: persona të papërgjegjshëm dhe persona me përgjegjësi të zvogëluar. Nëse merret për bazë pozita në të drejtën penale, atëherë njihen dy subjekte të veprës penale: subjekti aktiv dhe subjekti pasiv.³³

Në përfundim mund të themi se personat fizikë si subjekt të së drejtës kanë atributet e tyre që janë të lidhura me subjektivitetin e tyre e që ndihmojnë në identifikimin, shënimin dhe caktimin juridik të tyre.

Pra, atributet e personit fizik janë:

- Emri;
- Vendbanimi;
- Shtetësia dhe
- Gjendja civile.

Pra, çdo qenie njerëzore që lind e gjallë dhe ka tiparet e njeriut (nuk është monstrum) trajtohet si person fizik me cilësi të subjektivitetit të së drejtës, ndërsa zotësia e veprimit, zotësia e deliktit dhe përgjegjësia penale vijnë në shprehje vetën kur plotësohen kushtet e parapara me dispozita ligjore (mosha).

32 Kodi i Drejtësisë për të Mitur në Kosovë me nr. 03-L-193, 8 korrik 2010, neni 2.

33 Kodi Penal i Kosovës, *Rregullorja e UNMIK-ut*, nr. 2003/25, 6 prill 2004, neni, 11. par 1, 12 par 2.

1.5. 2 . Subjekti - personi juridik si kryerës i veprave penale kundër ekonomisë

Subjekt i së drejtës, përveç personave fizikë si krijesë natyrore, janë edhe personat juridikë që janë krijesë shoqërore e përbërë nga një grup apo disa njerëz të organizuar në bazë të ligjit. Personi juridik, si krijesë shoqërie, duhet t'i plotësojë disa kushte për ta fituar statusin e subjektit të së drejtës dhe atë ³⁴:

- Të ketë organizimin formal që nënkupton (organet dhe aktet normative),
- Të ketë pasuri të veten për t'u përgjigjur në rastet kur rezultojnë detyrime nga marrëdhëniet e ndryshme civile-penale
- Të ushtrojë veprimtari të caktuar dhe
- Të jetë i regjistruar sipas ligjit.

Personat juridikë, me cilësi të subjektit të së drejtës, janë disa llojesh dhe se edhe subjektiviteti i tyre fitohet në mënyra të ndryshme, varësisht se për cilët persona juridikë është fjala.

Në legjislacionin aktual, personi juridik e fiton cilësinë e subjekti në momentin kur ai regjistrohet në regjistrin zyrtar në organin kompetent.

Në vazhdim po përmendim disa nga personat juridikë: ndërmarrjet e ndryshme punuese, shoqëritë tregtare, shoqatat e ndryshme, partitë politike, ndërsa shteti dhe institucionet e tjera e fitojnë këtë cilësi juridike nga vetë kushtetuta dhe ligji.

Përderisa te personi fizik subjektiviteti shuhej në momentin e vdekjes apo shpalljes së personit të vdekur, te personi juridik subjektiviteti shuhet në momentin e çregjistrimit nga regjistri zyrtar. Në aspektin e përgjegjësisë penale, që është edhe

³⁴ *E Drejta Civile*, doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2009, fq. 313.

synimi ynë për ta studiuar, personi juridik ka përgjegjësi për veprat penale të kryera në emër dhe në dobi të tij, nga përfaqësuesi gjegjësisht organet e tij drejtuese dhe administrative³⁵.

Me të drejt mund të thuhet se cilësinë e subjektit të së drejtës e kanë personat fizikë dhe juridikë, zotësia juridike dhe veprimet ndryshojnë te personat juridikë nga ajo e personave fizikë, sepse personat juridikë e kanë zotësinë juridike dhe të veprimit të specializuar, e që është më e ngushtë dhe shumë më e kufizuar se ajo e personit fizik. Personat juridikë bartin të drejta dhe detyrime vetëm brenda aktit me të cilin janë themeluar me ligj apo statut.

1.6. Teknikat e inkriminimit të veprimeve kriminale kundër veprave penale të ekonomisë

Kriminaliteti ekonomik dhe problemi i zbulimit të tij, mbeten sfidë e organeve përgjegjëse të ndjekjes dhe hetimit, të cilat janë të autorizuar për ta luftuar këtë dukuri kriminale.

Teknikat që po përdoren, nga personat e inkriminuar në këtë fushë, kanë përparuar shumë, gjë që po e bëjnë më të vështirë zbulimin dhe ndëshkimin e kryesëve të këtyre veprave penale. Nëse veprat penale i shohim vetëm në aspektin e teknikës së zbulimit, atëherë kemi dy kategori themelore të veprave penale.

Kategoria e parë e këtyre veprave është më lehtë e zbulueshme sepse, te këto vepra penale, pasojat janë të dukshme p.sh.: vrasjet, vjedhjet grabitqare, lëndimet e

35 Çerekja. Besnik, *Përgjegjësia penale e personave juridikë nën këndvështrimin e legjislacionit penal shqiptar*, revista Studime juridike, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2009, fq. 237.

rënda trupore.

Ndërsa, kategoria e dytë përfshin veprat penale kundër ekonomisë për faktin se kanë vështirësi në zbulimin e tyre për shkak se nuk duken fillimisht e as nuk dyshohet për to, por pasojat nga këto vepra shfaqen më vonë dhe në mënyra të ndryshme.³⁶

Pra, nga ky aspekt mund të kuptojmë se veprat penale kundër ekonomisë kanë karakteristika të veçanta që i dallojnë nga kriminaliteti klasik.

Vështruar nga aspekti i teknikave të zbulimit dhe luftimit këto vepra kanë këto specifika³⁷:

- Fshtësia e kriminalitetit ekonomik;
- Ndryshueshmëria e kriminalitetit ekonomik;
- Kryerja e pandërprerë dhe në një kohë të gjatë e veprave penale;
- Paraqitja e personave në cilësinë e kryerësit, dhe
- Dokumentet e shkruara si burim kryesor i provave të kriminalitetit ekonomik.

Karakteristikë e formës së paraqitjes së këtyre veprave penale janë format e reja që janë rrjedhojë e zhvillimit të hovshëm të teknologjisë kompjuterike, profili i kryerësve, kuadri profesional, përvoja në punë që me sukses relativ mund t'i fshehin dhe t'i kryejnë veprat penale në ekonomi³⁸.

Forma me të cilën organet e ndjekjes dhe zbulimit e posaçërisht edhe organet e

36 Demolli. Haki, *Kriminaliteti ekonomik në Kosovën e viteve të tetëdhjeta*, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2009, fq. 77.

37 Po aty, fq. 63.

38 Latifi. Vesel, *Kriminalistika*, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2006, fq. 326.

sigurimit publik kuptojnë paraqitjen apo përgatitjen e tyre janë përmes³⁹ :

- Veprimtarisë informative kriminalistike;
- Paraqitjes nga pjesëtarët e policisë;
- Paraqitja përmes të dëmtuarve;
- Përmes dëshmitarëve;
- Paraqitja nga vetë kryerësit;
- Mjeteve të informimit publik.

Teknika e inkriminimit, të veprimet kriminale, të kësaj kategori të veprave penale është zhvilluar shumë, sidomos pas evoluimeve të teknologjisë informative - teknologjisë kompjuterike, kuadrit profesional, dhe përvojës në punë. Kryerësit kanë përsosur veprimet e tyre kriminale, që për pasojë kanë vështirësuar zbulimin e shpejtë të informacioneve për përgatitjen e këtyre veprave, kryerjen dhe kryerësit të këtyre veprave.

Gjithashtu, të këto vepra, teknika e inkriminimit është e padukshme, ndërsa baza e dyshimit drejtohet diku tjetër dhe pasojat zbulohen më vonë.

39 Vodinelić. Vlado, *Kriminalistika*, Savremena administracija, Beograd, 1978, fq. 48.

KAPITULLI II

ZHVILLIMI DHE HISTORIKU I LEGJISLACIONIT PENAL TË KOSOVËS KUNDËR VEPRAVE PENALE TË EKONOMISË

2.1. Vështrim historik i lindjes dhe zhvillimit të veprave penale kundër ekonomisë në Kosovë

Historia e së drejtës penale, si çdo fenomen tjetër juridik, është zhvilluar dhe ndryshuar gjatë shekujve mbi bazën ndryshimeve në rendin shoqëror. Historia e së drejtës penale, nga shumë mendimtarë konsiderohet si një nga disiplinat që për bazë ka studimin e fushës së legjislacionit penal, zhvillimin dhe ndryshimet e ligjeve penale, historinë e dënimit-sanksionit penal, si dhe zhvillimin e ideve dhe teorive juridike penale.

Natyrisht, gjatë zhvillimit historik, shteti dhe e drejta si dy fenomene shoqërore janë zhvilluar mbi bazën e kushteve dhe zhvillimeve politike dhe ekonomike të çdo vendi⁴⁰.

Për të kuptuar historikun e lindjes dhe zhvillimit të së drejtës penale në Kosovë, do të shohim lindjen dhe zhvillimin e kësaj dege, si nevojë për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti në përgjithësi e posaçërisht në fushën ekonomike.

Kosova ka pasur një zhvillim specifik në historikun e zhvillimit të legjislacionit penal në fushën e ekonomisë. Këtë zhvillim e karakterizon fakti që Kosova, për disa shekuj me radhë, ishte e pushtuar dhe në territorin e saj zbatohesh legjislacioni i huaj.

Gjatë periudhës së sundimit të Perandorisë Osmane, Kosova si njësi e veçantë

40 Elezi. Ismet & Ela. Elezi, *Historia e së drejtës penale*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë, 2010, fq. 11.

administrative e quajtur “Vilajeti i Kosovës”, kishte aplikuar legjislacionin e huaj me gjithë përpjekjet e bëra nga e drejta zakonore shqiptare t’i kundërvihet.⁴¹ Historiku i lindjes së legjislacionit penal të Kosovës është i ndërlidhur me statusin e saj politik të pazgjidhur që nga okupimi e deri te ndarja e padrejtë e saj nga Shqipëria, me vendim të Fuqive të Mëdha më 1913, në Londër⁴². Kosova u vu nën sovranitetin e mbretërisë serbe, kroate dhe sllovene. Legjislacioni penal që zbatohet në Kosovë në këtë kohë ishte: Kodi Penal i Serbisë mbi krimet kundër shtetit mbretit dhe kushtetutës, kapitulli IX-XI, ndërsa në zonat malore të vendit, ku ruhej vetëqeverisja, marrëdhëniet juridike rregulloheshin nga e drejta zakonore shqiptare (Kanuni i Lekë Dukagjinit).⁴³

Sa i përket statusit të Kosovës, nuk ndryshoi esencialisht as pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova fillimisht mbeti në kuadër të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, e pastaj vazhdoi në kuadër të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ). Ndryshime pati pas aprovimit të amendamenteve kushtetuese të vitit 1968 dhe 1971, posaçërisht Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974⁴⁴. Këtu fillon një epokë e re për legjislacionin e Kosovës, ngase deri në atë kohë legjislacioni penal në përgjithësi, por edhe ai në fushën ekonomike, ishte i paraparë në legjislacionin penal të ish-Jugosllavisë⁴⁵. Aprovimi i Kushtetutës së vitit 1974, përveç që ndryshon statusin e

41 Shih: Noel Malcolm, Kosovo: A Short History, London, 1998, fq. 191-193. Marrë nga: <http://www.h-net.org/reviews/showpdf.php?id=3058> (parë më 3 mars 2014).

42 Bahri Hyseni: Roli i OKB-së në zgjidhjen e krizave, rasti i Kosovës, (tema e masterit), Universiteti ‘Iliria’, Prishtinë, 2010; Konferenca e Ambasadorëve në Londër e mbajtur më 1912 dhe 1913, e njohur edhe si “Konferenca e Paqes në Londër”, më 29 korrik 2013, ambasadorët njohën me një vendim formal njohjen e Principatës së Shqipërisë si shtet të pavarur, por fatkeqësisht la jashtë territoreve të saj Kosovën, e cila iu dha Serbisë.

43 Elezi. Ismet & Elezi. Ela: *Zhvillimi historik i mendimit teoriko-juridik*, botimet Erik, Tiranë, 2010, fq. 28.

44 *Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974*.

45 Latifi. Vesel, Elezi. Ismet, Vaselika. Hysi: *Politika e luftimit të kriminalitetit*, Instituti Evropian për Studime Juridike dhe Administrim Publike “Juridica”, Prishtinë, 2012, fq. 95.

Kosovës, duke u bërë element konstituiv i ish-Federatës Jugosllave, asaj i mundëson që disa vite më vonë, më 1977, të nxjerrë për herë të parë Ligjin Penal të Kosovës⁴⁶. Me gjithëkëtë, zhvillimi pozitiv, Kosovës por edhe republikave tjera nuk iu mundësua nxjerrja e Ligjit të Procedurës Penale. Ato detyrimisht zbatuan Ligjin e Procedurës Penale të RSFJ-së⁴⁷.

Në këtë kohë edhe pse Kosova fitoi të drejta që nuk i kishte asnjëherë më parë, legjislacioni penal i saj ishte i kontrolluar dhe jo plotësisht i kompletuar sidomos në sferën ekonomike. Në vitin 1989 deri te intervenimi ushtarak ndërkombëtar, Kosovës iu suprimua autonomia dhe krahas saj edhe sistemi gjyqësor, ndërsa filloi të zbatohet legjislacioni penal i Serbisë, që ishte në kundërshtim me të gjitha standardet ndërkombëtare.

Në Kosovë, pas vitit 1999, u krijua një realitet i ri me prezencën ndërkombëtare dhe me këtë rast u suprimuan ligjet diskriminuese me to edhe ligjet penale të aprovuara nga organet e dhunshme të shtetit serb deri më 15 qershor 1989⁴⁸.

Kosova, në vitin 2004, nxori Kodin e Përkohshëm Penal dhe Procedural, të bazuar në legjislacionin bashkëkohor, i cili u amendamentua më 2008.

Ndërsa, pas shpalljes së pavarësisë dhe reformave në sistemin e drejtësisë, nga viti 2013 në Kosovë janë në fuqi, Kodi i ri Penal dhe Procedural, ligje të miratuara me vullnetin dhe përgjegjësitë e shtetit të pavarur dhe demokratik.

46 Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, i miratuar në mbledhjen e Dhomës së Punës së Bashkuar, të mbajtur më 28 Qershor 1977.

47 Ligji mbi Procedurën Penale të RSFJ-së (Gazeta zyrtare e RSFJ-së, Nr. 4/77) 1 korrik. 1977.

48 Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1, neni 3, që rregullon çështjen e ligjit të aplikueshëm në Kosovë, të cilat kanë qenë në fuqi deri me 22 mars të vitit 1989.

2.2. Veprat penale kundër ekonomisë sipas legjislacionit të ish-Jugosllavisë të aplikuara në Kosovë deri në vitin 1977

Kosova, me ndryshimet kushtetuese të vitit 1968 e 1971 dhe pas miratimit të Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974, ka vazhduar zbatimin e legjislacionit penal të ish-Jugosllavisë deri në nxjerrjen e ligjit penal të saj, në vitin 1977. Andaj, në atë kohë, veprat penale në fushën ekonomike janë rregulluar me legjislacionin penal të RSFJ-së.

Ligji penal i Republikës Socialiste të Jugosllavisë në kreun XVIII, ka paraparë kategorinë e veprave penale në fushën e ekonomisë me emërtimin: “Veprat Penale Kundër Ekonomisë dhe Unitetit të Tregut Jugosllav”⁴⁹. Me qëllim të ruajtjes së ekonomisë së vendit, nga kriminaliteti ekonomik, ligji i kishte dhënë mbrojtje juridiko-penale, duke inkriminuar veprimet si vepra penale kundër ekonomisë të sistemuara nga neni 161 e deri në nenin 173⁵⁰.

Në vazhdim po i paraqesim veprat penale, pa hyrë në trajtimin e veçante të tyre, sepse një krahasim i këtyre veprave do të bëhet në raport me disa vepra penale në fushën e ekonomisë, të parapara me Ligjin Penal të Kosovës, të vitit 1977.

Veprat penale kundër ekonomisë dhe unitetit të tregut jugosllav sipas Ligjit Penal të RSFJ-së, i vitit 1977.

- Shkelja e barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike (neni 161),
- Shkelja e barazisë në inkuadrimin në punë (neni 162),
- Krijimi i pozitës monopoliste dhe shkaktimi i çrregullimeve në treg (neni 163),

49 Ligji Penal i Republikës Socialiste të Jugosllavisë, i vitit 1977, kreu XVIII, fq. 77.

50 Ibid.

- Konkurrenca jolojale në punët e qarkullimit të tregtisë së jashtme (neni 164),
- Përdorimi i paautorizuar i firmës së huaj (neni 165),
- Ushtrimi i paautorizuar i ndërmjetësimit ose i përfaqësimit në punët e qarkullimit të tregtisë së jashtme (neni 166),
- Tregtimi me monedha ari, me valutë të huaj dhe me deviza (neni 167),
- Falsifikimi i parave (neni 168),
- Falsifikimi i shenjave për vlerë (neni 169),
- Përgatitja, futja në dorë ose tjetërsimi i mjeteve për falsifikim (neni 170),
- Falsifikimi i shenjave për marketimin e mallit, të masave e të peshave të mallit (neni 171),
- Lëshimi i çekut pa depozitë (neni 172),
- Dhënia e dënimit konfiskim i pasurisë (neni 173)⁵¹.

Ligji kishte paraparë gjithsej 13 vepra penale përmes të cilave ligjvënësi i asaj kohe i ka dhënë mbrojtje juridiko-penale ekonomisë shoqërore të asaj kohe, posaçërisht konkurrencës jolojale në fushën e tregtisë.

2.3. Veprat penale kundër ekonomisë sipas legjislacionit penal të Kosovës të vitit 1977

Me Kushtetutën e vitit 1974 Kosova fitoi statusin politik si Krahinë Autonome brenda Federatës Jugosllave. Ky avancim i statusit politik i mundësoi asaj që përmes

⁵¹ Ligji Penal i Republikës Socialiste të Jugosllavisë, i vitit 1977, kreu XVIII, fq. 77 deri 82.

organeve të veta të asaj kohe e në mbështetje të nenit 283, parag. 1, pika 11 e Kushtetutës së Kosovës të nxjerrë Ligjin e parë Penal të saj, të vitit 1977⁵². Me të drejtë mund të thuhet që ai ligj vendosi bazat e rregullimit të çështjeve në sferën juridiko-penale, posaçërisht edhe në fushën e ekonomisë.

Ligji në kreun e katërmbëdhjetë i ka paraparë veprat penale kundër ekonomisë nga neni 105 e deri te neni 133, që gjithsej ishin 29 vepra penale. Vlen të përmendet fakti që Ligji Penal i Kosovës veprat penale kundër pasurisë i ka sistemuar në grup të veçantë në kreun e pesëmbëdhjetë⁵³. Në vazhdim po i paraqesim veprat penale kundër ekonomisë të parapara sipas Ligjit Penal të KSAK, të vitit 1977:

- Veprimtaria e pandërgjegjshme në ekonomi (neni 105),
- Shkaktimi i falimentimit (neni 106),
- Dëmtimi i kreditorëve (neni 107),
- Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi (neni 108),
- Lidhja e kontratës së dëmshme (109),
- Dhënia dhe marrja pa autorizim i sekretit të punës (neni 110),
- Uzurpimi pa të drejtë i tokës në pronësinë shoqërore (neni 111),
- Dëmtimi i ndërtesave dhe lokaleve të banimit dhe të punës (neni 112),
- Bërja dhe përdorimi i shenjave të rreme të vlerës ose i letrave me vlerë (neni 113),

52 Punimet e Kuvendi të KSAK-së, nga mbledhja e Dhomës së Punës së Bashkuar dhe Dhomave Shoqërore Politike, të mbajtur më 28 qershor të vitit 1977, Kuvendi i Kosovës, nr. 011-25/77.

53 Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Kuvendi i Kosovës nr. 011-25/77 i vitit 1977, fq. 88-98.

- Bërja, furnizimi ose tjetërsimi i mjeteve të falsifikimit (neni 114),
- Mashtrimi i blerësve (neni 115),
- Tregtia e palejuar (neni 116),
- Prodhimi i palejuar (neni 117),
- Shfrytëzimi i palejuar i punës së huaj (neni 118),
- Disponimi i palejuar i banesave (neni 119),
- Shkelja e dispozitave mbi çmimet (neni 120),
- Favorizimi i blerësve (neni 121),
- Matja jo e saktë (neni 122),
- Fshehja e tatimit (neni 123),
- Prodhimi i preparateve të dëmshme për mjekim të bagëtisë dhe shpezëve (neni 124),
- Dhënia e pandërgjegjshme e ndihmës veterinarë (neni 125),
- Përhapja e sëmundjeve ngjitëse të kafshët, bimët dhe drunjtë (neni 126),
- Ndotja e ushqimit të kafshëve dhe ujit (neni 127),
- Asgjësimi i fidanëve me përdorimin e materies së dëmshme (neni 128),
- Shkretimi i pyjeve (neni 129),
- Vjedhja e pyjeve (neni 130),
- Gjuetia e paligjshme (neni 131),
- Peshkimi i paligjshëm (neni 132),

- Dhënia e dënimit konfiskim i pasurisë (neni 133)⁵⁴.

Ligji Penal i KSAK-së këto vepra i ka paraparë me emërtimin “Veprat penale kundër ekonomisë” që për mendimin tim emërtimi është më i qëlluar dhe më adekuat sesa emërtimi që kishte ligji penal RSFJ-së, “Veprat penale kundër ekonomisë dhe tregut unik jugosllav”. Gjithashtu vërehet se një pjesë e veprave penale, që kanë të bëjnë me: shkretimin e pyjeve, me peshkimin e paligjshëm, me gjuetinë e paligjshme, me ushqimin e kafshëve dhe shfrytëzimin e banesave etj., Ligji Penal i RSFJ-së i kishte trajtuar në kapituj të tjerë dhe me të drejtë sepse konsideroj se këto vepra penale duhet të trajtohen veçmas nga veprat penale kundër ekonomisë.

Me gjithë ndryshimet e theksuara, vërehen edhe ngjashmëri në trajtimin e veprave penale në fushën e ekonomisë si te vepra penale: “falsifikimi i parasë”, “falsifikimi i shenjave me vlerë për prejardhjen e mallit”, “lëshimi i çekut pa depozitë”. Sa i përket sanksioneve penale dënimi dhe konfiskimi i pasurisë ishin të parapa në të dy ligjet. Vlen të përmendet se në ligjin jugosllav ishin paraparë edhe vepra penale “Konkurrenca jolojale në punët e qarkullimit të tregtisë së jashtme” dhe “Krijimi i pozitës monopolistike dhe shkaktimi i çrregullimeve në treg”, që në Ligjin Penal të Kosovës nuk ishin paraparë. Këto vepra ishin paraparë me emërtime si vepra penale “Shfrytëzimi i palejuar i punës së huaj”, “Tregtia e palejuar”, në fakt ndryshimet nuk ishin vetëm në emërtim por edhe në elementet që e përbënin figurën e veprës penale.

Sa i përket sanksioneve penale vërehet se të dy ligjet kishin paraparë dënime të rrepta deri në 20 vite burgim, për shembull, sipas Ligjit Penal të Kosovës të vitit 1977, vepra penale: “Bërja dhe përdorimi i shenjave të rreme të vlerës ose i letrave me vlerë”

⁵⁴ Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Kuvendi i Kosovës nr. 011-25/77 i vitit 1977, fq. 74-88.

(neni 113) dënohej jo më pak se 5 vjet ose burgim prej 20 vjetësh.

Ndërsa sipas Ligjit Penal të Jugosllavisë, të vitit 1977, vepra penale “Lëshimi i çekut pa depozitë”, kryerësi dënohej jo më pak se 5 vjet burgim ose 20 vjet burg.

Gjatë krahasimit vërehet se ligjet, jo për të gjitha veprat, kanë paraparë masën e konfiskimit të pasurisë.

2.4. Historiku i zhvillimi të legjislacionit penal për veprat penale kundër ekonomisë në periudhën e pasluftës në Kosovë

Pas vendosjes së Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, bëri përpjekje që të funksionalizojë jetën në Kosovë, me çrast nxori vendim ekzekutiv që t’i suprimojë nga fuqia të gjitha ligjet diskriminuese, të cilat i kishin nxjerrë organet e dhunshme të pushtetit serb deri më 22 qershor 1989⁵⁵. Me formimin e Institucioneve të Përkohshëm Vetëqeverisë në Kosovë, në sajë të dokumentit fillestar “Kornizës Kushtetuese të Kosovës”⁵⁶ u miratuan: Kodi i Përkohshëm Penal dhe Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, të cilat kode filluan të zbatohen nga 6 prilli i vitit 2004⁵⁷. Me zbatimin e këtyre kodeve Kosova u shkëput tërësisht nga sistemi gjyqësor i Serbisë dhe këtu filloi sistemi i ri gjyqësor i pavarur nga shteti serb.

Specifikë e veçantë, e kësaj periudhe, ishte fakti se tani Kosova, edhe pse kishte

55 Rregullorja e UNMIK-ut për shfuqizimin e ligjeve diskriminuese të aplikuara në Kosovë deri më 12 dhjetor 1999, shih Rregulloren me nr. 1999-25.

56 Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme e Kosovës, si akti më i lartë juridik, 15 Maj 2001.

57 Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës është shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2003 /25, datë 6 korrik dhe hyri në fuqi me 6 prill 2004.

organet e saj legjitime të dala nga zgjedhjet e lira parlamentare, prapëseprapë ende ekzistonin sfida, që ajo në mënyrë të pavarur, të miratojë ligjin penal dhe procedural. Situata e tillë u argumentua me faktin që dy kodet e Kosovës, ai penal dhe procedural, ishin të përkohshme si pasojë se në këtë kohë ende Kosova nuk e kishte të zgjidhur përfundimisht statusin e saj politik, që imponoi emërtimin dhe miratimin e tyre si të përkohshëm.

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, veprat penale kundër ekonomisë, i parasheh në kreun XXV me emërtimin: “Veprat penale kundër ekonomisë”, nga neni 232 e deri te neni 251⁵⁸, gjithsej 20 vepra penale përmes të cilave ligjvënësi ka pretenduar që të mbrohej: ekonomia e vendit, sistemi financiar, prona, buxheti i Kosovës dhe fusha të tjera të inkriminuara me këtë ligj. Krahasuar me numrin e veprave penale kundër ekonomisë, që i kishte ligji penal i Kosovës, shihet Kodi Penal i Përkohshëm që kishte 9 vepra më pak se ai i vitit 1977, kurse me atë jugosllav 7 vepra më shumë.

Pra, Kodi Penal i Përkohshëm i vitit 2004, për dallim nga Ligji Penal i Kosovës, i vitit 1977, kishte këto vepra të reja penale të cilat në vazhdim po i përmendim: “Cenimin e barazisë në ushtrimin e barazisë ekonomike” (neni 232), “Cenimi i të drejtës së patentës” (neni 240), “Organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm” (neni 243), “Falsifikimin e parasë” (neni 244), “Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë ose keqpërdorimi i kartelave të bankës apo kreditit” (neni 248), “Pranimi i paarsyeshëm i dhuratave”(neni 250) dhe “Dhënia e paarsyeshme e dhuratave” (neni 251)⁵⁹.

Gjatë krahasimit me Ligjin Penal të Kosovës të vitit 1977, ligjvënësi me të drejtë

58 Po aty, neni 232 deri te neni 251.

59 Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut, 2003/25, 6 prill, 2004, neni 232 deri te neni 251.

ka shtuar këtë numër të veprave penale me qëllim të luftimit të kriminalitetit ekonomik nga vetë fakti që këto vepra penale, për shkak të zhvillimit të teknologjisë bashkëkohore dhe zhvillimit ekonomik, kanë qenë domosdoshmëri e kohës, për shkak se krimi i organizuar dhe format e organizimeve të ndryshme piramidale do të rrezikonin seriozisht ekonominë e vendit. Kodi me të drejtë nuk i ka paraparë veprat penale që i kishte ligji penal, siç ishin: “Prodhimi i preparateve të dëmshme për mjekim të bagëtisë dhe shpezëve” (neni 124), “Dhënia e pandërgjegjshme e ndihmës veterinarë” (neni 125), “Përhapja e sëmundjeve ngjitëse të kafshët, bimët dhe drunjtë” (neni 126), “Ndotja e ushqimit të kafshëve dhe ujit” (neni 127), “Asgjësimi i fidanëve me përdorimin e materies së dëmshme” (neni 128), “Shkretimi i pyjeve” (neni 129), “Vjedhja e pyjeve” (neni 130), “Gjuetia e paligjshme” (neni 131), “Peshkimi i paligjshëm” (neni 132). Me të drejtë Kodi i Përkohshëm Penal këto vepra penale i ka paraparë në grup të veçantë në kapitull XXIV me emërtimin: “Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore”. Për mendimin tim me të drejtë sepse objekti material, të këto vepra penale, dallohet nga veprat penale kundër ekonomisë edhe në aspektin e anës objektive, subjekteve, materiale dhe elementeve që e përbëjnë figurën e veprës penale. Sa i përket veprave penale kundër pasurisë ky kod ashtu si Ligji Penal i Kosovës i ka rregulluar në kapitull të veçantë, që ne mendojmë se këto vepra, përveç që cenojnë pasurinë, ata paraqesin rrezik edhe për integritetin trupor, posaçërisht “Vepra penale e grabitjes”.

2.5. Historiku i zhvillimit të legjislacionit penal për veprat penale kundër ekonomisë pas Pavarësisë së Kosovës

Ndryshimet që ndodhën në Kosovë, pas shpalljes së Pavarësisë, më 17 shkurt të vitit 2008, determinuan nevojat e domosdoshme për reforma në sistemin e drejtësisë dhe krahas saj, ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal dhe Procedural të Kosovës, të cilat gjer në këtë kohë ishin të karakterit të përkohshëm. Andaj, më 20 prill 2012, Parlamenti i Kosovës miratoi Kodin e ri Penal të Kosovës, i cili hyri në fuqi më 1 janar të vitit 2013.

Kodi Penal është bashkëkohor e në pajtueshmëri me standardet dhe direktivat e Bashkimit Evropian. Specifikat e Kodit Penal janë se ai ka inkriminuar disa veprime si vepra penale, të cilat paraqesin ndryshim të madh, krahasuar me Kodin e Përkohshëm Penal të vitit 2004. Ky kod veprat penale, në fushën ekonomike, i ka paraparë në kapitullin XXV dhe me të njëjtin emërtim:” Veprat penale kundër ekonomisë” ,ashtu si ligjet e mëparshme penale të viteve 1977 dhe 2004. Për dallim nga Kodi i Përkohshëm Penal i vitit 2004. Ky kod penal ka paraparë një numër më të madh të veprave kundër ekonomisë dhe atë 34 vepra të sistemuara nga neni 284 deri te neni 318⁶⁰. Gjatë krahasimit vërehet se ligjvënësi kosovar ka inkriminuar ,14 vepra penale më shumë që kjo fushë me rëndësi të veçantë për ekonominë e vendit të rregullohet në mënyrë më të plotë.

Në vazhdim do t’i paraqesim vetëm veprat e reja penale në fushën ekonomike, që i ka paraparë Kodi Penal që është në fuqi nga viti 2013, të cilat nuk kishin qenë të

60 Shih Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 19/13) kapitulli XXV.

parapara në Kodin Penal (2004), për të parë se a kanë qenë të domosdoshme këto vepra për kohën në të cilën është duke u zbatuar. Veprat e reja penale në fushën e ekonomisë janë:

- Shkaktimi i falimentimit të rrejtshëm (neni 287),
- Mashtrimi në procedurën e falimentimit (neni 288),
- Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve ose debitorëve (neni 289),
- Cenimi i të drejtës së autorit (neni 296),
- Shmangia e masave teknologjike (neni 297),
- Mashtrimi i konsumatorëve (neni 298),
- Keqpërdorimi i pozitës së monopolit (neni 301),
- Shpëlarja e parave (neni 308),
- Marrëveshjet për kufizimin e konkurrencës përmes ftesave për tender (neni 309),
- Mashtrimi në shkëmbimin e letrave me vlerë (neni 310),
- Keqpërdorimi i informatave të brendshme (neni 311),
- Marrëveshja dhe mashtrimi me letrat me vlerë të Qeverisë (neni 312),
- Dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin (neni 314),
- Kontrabandimi i mallrave (neni 317),
- Shmangia nga pagesat e tarifave të detyrueshme doganore (neni 318).⁶¹

61 Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr .04/L-82, i miratuar më 20 prill, 2012, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr. 13/19).

Ky numër i shtuar i veprave penale kundër ekonomisë si: “Shpërlaja e parave” (neni 308), e cila konsiderohet si njëra ndër veprat që e stimulon krimin e organizuar dhe korrupsionin, pastaj vepra penale, “Marrëveshja dhe mashtrimi me letrat me vlerë të Qeverisë” (neni 312) vepër që për herë të parë është paraparë në legjislacioni penal të Kosovës të vitit (2012), pas luftës ishin domosdoshmëri e kohës.

Politikën ndëshkimore kodi aktual e ka më të ashpër se kodi penal i përkohshëm. Këtë pohim e mbështes me krahasimet në vijim p.sh. vepra penale “Cenimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike” (neni 284), parasheh që kryerësi të dënohet prej 6 muajve deri në 5 vjet, ndërsa me kodin e përkohshëm, dënimi ishte prej 3 muajve deri në 3vjet, apo “Falsifikimi i parasë” (neni 302 parag. 5), në kodin aktual dënimi për kryerësin është jo më pak se 3 vjet, kurse në atë paraprak dënimi parashihej deri në një vit. Ndërsa ligjvënësi, sa i përket veprave të reja penale, ka paraparë dënime të larta për shembull për veprën penale “Marrëveshja dhe mashtrimi me letrat me vlerë të Qeverisë” (neni 312), ka paraparë dënimin me burgim prej 3 deri në 12 vjet.

Kosova ka pasur një histori të veçantë, sa i përket legjislacionit në fushën ekonomisë. Ajo një kohë të gjatë ka aplikuar legjislacionin e ish-Jugosllavisë deri në vitin 1977, një kohë të Serbisë deri në abrogimin përfundimtar më 1999, gjatë prezencës ndërkombëtare deri në shpalljen e pavarësisë (2008) ka zbatuar rregulloret e UNMIK-ut. Tani Kosova ka në zbatim Kodin Penal dhe Procedural që për mendimin tim në mënyrë solide i ka të rregulluar veprat penale në fushën ekonomike.

KAPITULLI III

VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË SIPAS LEGJISLACIONIT PENAL TË KOSOVËS

3.1. Hyrje

Ekonomia e zhvilluar pa dyshim është shtyllë kryesore për zhvillimin dhe funksionimin e sistemit ekonomik dhe politik të çdo vendi, kurse ekonomia e pazhvilluar është pengesë serioze në zhvillim, por është edhe faktor që mund të sjellë, dukuri negative që vijnë nga pasojat e moszhvillimit të saj, siç janë: korrupsioni, kontrabandimi, mashtrimet, falsifikimet, dëmtimet, prodhimet e ndaluara etj. Është vërtetuar se shtetet në tranzicion, me ekonomi të pazhvilluar, janë më pak imun ndaj veprave penale të drejtuara kundër ekonomisë. Andaj, të gjitha shtetet kanë nxjerrë legjislacion për t'i dhënë mbrojtje juridiko-penale ekonomisë. Ligjvënësi kosovar e ka bërë një gjë të tillë përmes Kodit Penal të Përkohshëm dhe ligjeve tjera. Krimi ekonomik, nëse vështrohet nga aspekti social ekonomik, mund të thuhet se krimi ekonomik në Kosovë, nganjëherë shërben për të mbijetuar e nganjëherë për të përmirësuar gjendjen materiale të individëve, duke pasur parasysh që të ardhurat e popullatës në Kosovë janë tejet të ulëta⁶². Kosova para okupimit nga ana e Serbisë, në kohën e suprimimit të institucioneve të saj kishte 845 organizata punuese në sektorin shoqëror me 172.794 të punësuar dhe 253 ekonomi individuale private me 5.818 të

62 Msc. Osmani. Ilir, PhD candidate, *Krimi ekonomiko-financiar si pengesë për zhvillim të Kosovës*, revista shkencore "Juridica" Instituti Evropian për Studime Juridike dhe Administratë Publike, Prishtinë, 2011, fq. 138.

punësuar⁶³. Ekonomia e saj u godit rëndë nga shkatërrimet dhe kjo situatë determinoi përgatitjen e shtetit në luftimin e kriminalitetit ekonomik me masa legislative në këtë fushë. Në vazhdim do të paraqiten veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit të Përkohshëm Penal, të parapara në kreun XXII⁶⁴, me qëllim të trajtimit në aspektin përmbajtësor dhe objektiv, anën subjektive të tyre, mënyrën e kryerjes dhe dënimet.

3.2. Cenimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike (neni 232)

Veprën penale, “Cënimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike” e kryen personi i cili keqpërdor detyrën zyrtare apo autorizimin e tij, me të cilin veprim kufizon qarkullimin e lirë të kapitalit në territorin e Kosovës, mohon të drejtën e organizatës së biznesit apo personit juridik që të merret me qarkullimin e lirë të mallit dhe shërbimeve në territorin e Kosovës, apo i vë ato në pozitë të pabarabartë në raport me personin juridik apo organizatën e biznesit tjetër, lidhur me kushtet e punës apo kryerjen e qarkullimit të lirë të mallit apo shërbimeve të tjera, të cilat shkaktojnë dëm të madh për personat tjerë. Karakteristikë e kësaj vepre penale është se ajo kryhet vetëm me dashje, me veprim ose mosveprim dhe kryesisht nga personat zyrtarë që kryen shërbime publike, qoftë duke kryer detyrat, por duke i tejkaluar përgjegjësitë ose duke mos i kryer detyrat e përcaktuara sipas ligjit.

Kjo vepër penale mund të kryhet edhe në bashkëkryerje. Si kryerës të kësaj vepre penale mund të jenë personat fizikë dhe personit juridikë. Këto të fundit veprojnë në

63 Bashota. Nuri, *Zhvillimi ekonomik i Kosovës, dje sot dhe në perspektivë*, revista shkencore ndërkombëtare”Iliria”, botuar në shkurt të vitit 2010, Prishtinë, fq. 17.

64 Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës është shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2003/25, datë 6 korrik dhe hyri në fuqi më 6 prill 2004.

cilësinë e subjekteve ekonomiko-private dhe publike, shoqëritë tregtare etj. që në forma të ndryshme ndihmojnë kryerjen e kësaj veprë penale. Veprimi i kryerjes së veprës penale, cenimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike sipas, Dr. Ismet Salihut, është përcaktuar në mënyrë alternative dhe konsiston në: kufizimin e qarkullimit të lirë të kapitalit, mohimin apo kufizimin e të drejtës së organizatës së biznesit ose personit juridik, që në territorin e Kosovës të merret me qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve, vënien e organizatës së biznesit apo personit tjetër juridik në pozitë të pabarabartë në raport ndaj organizatës së biznesit ose personit juridik dhe kufizimin e këmbimit të lirë të mallit dhe shërbimeve, nëpërmjet formave të veprimit, duke krijuar vështirësi faktike në këto veprimtari⁶⁵.

Kjo vepër penale është sistemuar në kundër të veprave penale kundër ekonomisë. Ligjvënësi përmes inkriminimit të kësaj vepreje ka dashur që të sigurojë barabarësi për pjesëmarrësit në fushën e ekonomisë, konkurrencë lojale dhe të garantojë stabilitet financiar dhe çmime stabile për mallrat. Sipas kodit penal, për këtë vepër penale, është paraparë dënimi nga tre muaj deri në tre vjet⁶⁶. Këtë vepër penale e ka inkriminuar Kodi Penal i Kosovës, i vitit 2012, dhe ka paraparë dënim me burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet⁶⁷, ndërsa Ligji Penal i KSA të Kosovës nuk e kishte paraparë këtë vepër penale. Sipas mendimit tim, duke pasur parasysh faktin, që personat këtë vepër penale e kryen me qëllim të realizimit të fitimit të konsiderueshëm për atë organizatë biznesi apo person juridik apo t'i shkaktojë dëm pasuror, konsideroj se dënimi i paraparë, sipas kodit të ri penal, është më adekuat.

65 Salihu. Ismet, E drejta penale e posaçme, botuar në Kolegjin "Fama" Prishtinë 2009, fq. 299.

66 Shih: Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut, 2003/25, 6 prill, 2004, neni 232.

67 Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 04/L-82, miratuar më 20 prill 2012, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr. 13/19).

3.3. Veprimtaria e pandërgjegjshme ekonomike (neni 233)

Vepra penale, veprimtaria e pandërgjegjshme ekonomike nënkupton përgjegjësinë e personit përgjegjës në organizatën e biznesit ose në personin juridik, i cili vepron në mënyrë haptas të pandërgjegjshme, duke shkelur ligjin dhe rregullat e afarizmit ekonomik me çrast i shkakton dëm të konsiderueshëm material organizatës së biznesit apo personit juridik. Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës ka paraparë mënyrën e cilësuar të kryerjes së kësaj vepre penale, kur ajo rezultonte me likuidim të detyrueshëm dhe falimentim të organizatës së biznesit apo personit juridik, dënimi që mund t'i shqiptohet personit ishte nga 6 muaj deri në 5 vjet⁶⁸. Kjo vepër penale kryhet me dashje apo dashje eventuale dhe nga praktika gjyqësore me veprim dhe mosveprim, që haptas vërehet se personi përgjegjës po vepron kundër rregullave dhe standardeve afariste ngase ai është i orientuar për të shkaktuar dëm substancial material, me vetëdije, organizatës ose personit juridik. Sipas Ismet Salihut “vepra penale si veprimtari e pandërgjegjshme në ekonomi është e karakterit blanket”. Kjo vepër penale ka qenë e sanksionuar në Ligjin Penal të KSAK, dhe dënimi për këtë vepër penale ka qenë i paraparë varësisht prej dëmit të shkaktuar në të holla, sipas paragrafit të parë të nenit 105, kryerësi dënohej me gjobë ose burgim deri në tre vjet, ndërsa sipas paragrafit të dytë, nëse personi juridik kishte rënë në falimentim kryerësi dënohej me burgim nga 6 muaj deri në 5vjet⁶⁹. Ligjvënësi i Kosovës këtë vepër penale e ka inkriminuar edhe në Kodin Penal të Kosovës, të vitit 2012⁷⁰, me qëllim që të promovojë raporte korrekte në

68 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut, 2003/25, 6 prill 2004, neni 233, parag. 2.

69 Shih: Ligji Penal i Krahinës Socialiste të Kosovës i miratuar në mbledhjen e Dhomës së Punës së Bashkuar, të mbajtur më 28 qershor 1977, neni 105, parag. 1 dhe 2.

70 Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr .04/L-82, miratuar më 20 prill 2012, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr. 13/19), neni 285.

zhvillimin ekonomik dhe të bizneseve, dënimi është i njëjtë me kodin e mëparshëm penal. Kodi Penal i Maqedonisë, i vitit 1996⁷¹ dhe i Shqipërisë i vitit 1995⁷², nuk e kanë paraparë këtë vepër penale.

3.4. Shkaktimi i falimentimit (neni 234)

Sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, veprën penale shkaktimi i falimentimit e kryen personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo në personin juridik, i cili duke ditur paaftësinë paguese të organizatës së biznesit apo personit juridik, krijon shpenzime joracionale të mjeteve apo e bën transferin e tyre me çmime tejet të ulët, lidh kontrata apo bën përtëritjen e tyre në mënyrë të paarsyeshme me personat e paaftë për pagesë, merr detyrime joproporcionale, krijon borxh të tepruar ose nuk realizon me kohë kërkesat dhe me këtë shkakton falimentimin. Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë: në shpenzimet joracionale të mjeteve, transferim të mjeteve me çmime tejet të ulëta, ngarkim i tepruar me borxh, duke marrë përsipër detyrime joproporcionale, duke lidhur ose përfunduar kontrata në mënyrë të paarsyeshme me personat e paaftë për pagesë, ose duke mos i realizuar kërkesat me kohë⁷³.

Kjo vepër penale kryhet nëse personi përgjegjës, në organizatën e biznesit apo personin juridik, ndërmerr njërin nga veprimet e përmendura. Pasojat e kësaj vepre penale konsistojnë në falimentim. Vepra penale konsiderohet që është kryer kur

71 Shih: Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare nr. 37/96, botuar më 29 korrik 1996), kreu i XXV.

72 Shih: Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i vitit 1995, (ligji me nr. 7895 i dt. 27.01.1995), kreu III. Marrë nga; www.ligjet.org (parë më 3.4.2014).

73 Shala. Afrim, *Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore*, Kolegji Universitar "Gjilani", Gjilan 2010, fq. 206.

organizata e biznesit ose personi juridik me vendim të plotfuqishëm është falimentuar. Nga ana subjektive kjo vepër penale kryhet me dashje, por personi përgjegjës që të konsiderohet i fajshëm duhet të ishte në njohuri se me veprimet e tij do të shkaktojë falimentimin e organizatës apo personit juridik, të ishte në njohuri se ajo nuk ishte në gjendje të paguajë borxhet. Vepra penale është e dënueshme vetëm me burg dhe dënimi është paraparë prej 6 muajve deri në 5 vjet burg⁷⁴.

Kjo vepër penale ishte e inkriminuar në Ligjin Penal të Kosovës, të vitit 1977, dhe në Kodin Penal të Shqipërisë, të vitit 1995, në grupin e veprave penale në fushën e falimentimit, në seksionin IX, e sistemuar në katër nene dhe atë: falimentimi i provokuar⁷⁵, fshehja e gjendjes së falimentimit⁷⁶, fshehja e pasurisë pas falimentimit⁷⁷ dhe shkelja e detyrimeve⁷⁸. Ligjvënësi kosovar këtë vepër penale e ka paraparë edhe në Kodin e Ri Penal, të vitit 2012, duke i dhënë një mbrojtje më të gjerë juridiko-penale fushës së falimentimit me qëllim të mos lejohen veprime kundër standardeve dhe rregullave të afarizmit që do të shkaktonin apo do të bënin të papërdorshëm asetet, dhe të prokuron mallra, shërbime dhe kredi, apo të ndërmerre veprimtari që krijojnë borxhe tepër të mëdha e që shkaktojnë falimentimin. Vepra penale kryhet edhe nga pakujdesia. Dënimi për këtë vepër penale është me burg nga 6 muaj deri në 5 vjet, ndërsa nëse kryhet nga pakujdesia deri në 3 vjet⁷⁹.

74 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, *Rregullorja e UNMIK-ut*, 2003/25, 6 prill, 2004, neni 234.

75 Shih: Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995, (Ligji me nr. 7895, i dt. 27.01.1995), neni 193.

76 Shih: Kodi Penal i Shqipërisë të vitit 1995, (Ligji me nr. 7895, i dt. 27.01.1995), neni 194.

77 Po aty, neni 195.

78 Po aty, neni 196.

79 Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 04/L-82, miratuar më 20 prill 2012, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr.13/19), neni 286.

3.5. Dëmtimi i kreditorëve (neni 235)

Veprën penale, dëmtimi i kreditorëve e kryen personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo personin juridik, i cili është në njohuri se organizata e biznesit apo personi juridik me pagimin e borxhit apo përmes ndonjë veprimi tjetër do të vë në pozitë më të volitshme ndonjë kreditor dhe në mënyrë të konsiderueshme do t'i dëmtojë kreditorët e tjerë. Kryerësi i kësaj vepre penale parashihet të dënohet më rëndë kur ai e din që organizata e biznesit apo personi juridik ka falimentuar, kurse ai me qëllim që të mashtrtojë apo t'i shkaktojë dëm kreditorit lidh kontrata të rreme, pranon kërkesa të pavërteta apo me veprime mashtruese e dëmton kreditorin e organizatës apo personin juridik. Për këtë vepër penale kodi penal i përkohshëm ka paraparë dënimin vetëm me burg, për paragrafin e parë deri në 3 vjet⁸⁰, ndërsa për mënyrën e kualifikuar të kësaj vepre penale kur dëmi i kreditorëve kalon shumën 250.000 euro ose kur pala e dëmtuar i nënshtrohet riorganizimit apo procedurës së falimentimit, kryerësi mund të dënohet deri në dhjetë vjet burgim⁸¹.

Nga praktika kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje, ndërsa sa i përket qëllimit të kryerësit apo personit përgjegjës ai dëshiron të krijojë favore për të apo kompaninë që punon, duke i vënë në pozitë të disfavorshme një apo më shumë kreditorë. Nëse kryerësi nuk e ka pasur këtë qëllim mashtrues dhe përfitues, atëherë nuk plotësohen e elementet themelore të kësaj vepreje penale. Sipas Ismet Salihut kjo vepër penale konsiston në dëmtimin e kreditorëve, e që numri i kreditorëve nuk është me rëndësi, por nëse numri i tyre është i madh atëherë merret si rrethanë gjatë matjes së dënimit⁸².

80 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, *Rregullorja e UNMIK-ut*, 2003/25, 6 prill 2004, neni 235.

81 Po aty, parag. 3.

82 Salihu. Ismet, *E drejta penale e posaçme*, botuar në Kolegjin "Fama", Prishtinë, 2009, fq. 304.

Kjo vepër penale ka qenë e inkriminuar edhe në Ligjin Penal të Kosovës, dënimi për rastet e zakonshme ka qenë nga 6 muaj deri në 5 vjet burgim, kurse në rastet veçanërisht të rënda të veprës dënimi ka qenë deri në dhjetë vjet burgim⁸³. Ligjvënësi kosovar, në Kodin Penal të vitit 2012, e ka paraparë këtë vepër penale me emërtimin mashtrim ose dëmtim i kreditorëve dhe debitorëve, me çrast i ka dhënë mbrojtje juridiko-penale edhe debitorëve. Dënimi për kryerësin e kësaj vepreje penale caktohet varësisht nga mënyra e kryerjes dhe dëmit material të shkaktuar. Kryerësi për mënyrën e rëndë të veprës, kur i dëmtuari detyrohet t'i nënshtrohet procedurës së riorganizimit ose falimentimi apo dëmi i shkaktuar tejkalon 250.000 euro, dënohet deri në dhjetë vjet burgim⁸⁴.

3.6. Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi (neni 236)

Veprën penale, keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi e kryen personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo në personin juridik, i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për kompaninë që punon ose për personin tjetër kryen ndonjërin nga veprimet e mëposhtme: krijon apo mban fonde të palejuara në Kosovë apo ndonjë vend tjetër, përpilon dokumente me përmbajtje të rrejshme, bilanc të rremë, inventarizim ose prezantim të rremë, në mënyrë të rremë prezanton rezultatet e veprimtarisë ekonomike, i shmanget pagesës së tatimeve dhe detyrimeve fiskale të caktuara me ligj, shfrytëzon mjetet në kundërshtim me qëllimin e tyre të paraparë, apo në mënyrë të rëndë cenon ligjin dhe rregullat e afarizmit lidhur me përdorimin dhe

⁸³ Shih: Ligji Penal i Kosovës i viti 1977, (K.K .nr. 011-25/77, 28 qershor, Prishtinë) neni 107, parag. 2 dhe 3.

⁸⁴ Shih: Kodi Penal i Kosovës nr. 04/L-82, miratuar më 20 prill 2012, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr. 13/19), neni 289, parag. 3.

administrimin e pasurisë. Për të gjitha mënyrat e kryerjes së kësaj vepre penale përgjegjës është vetëm personi përgjegjës i organizatës, i cili punon për kompaninë dhe me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për të. Kryerësi i kësaj vepre penale, sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, dënohet nga 6 muaj deri në 5 vjet burgim, ndërsa nëse fitimi material kalon mbi 100.000 euro, kryerësi në raste të tilla dënohet deri në tetë vjet burgim⁸⁵. Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, ndërsa qëllimi i kryerësit është fitimi i dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme për punëdhënësin. Kjo vepër penale është e paraparë me Ligjin Penal të Kosovës, të vitit 1977, dënimi për formën veçanërisht të rëndë të kryerjes së kësaj vepre penale ishte nga 1 deri në 10 vjet burg⁸⁶. Kodi Penal i Shqipërisë e ka paraparë këtë vepër por ajo ndryshon në emërtim dhe përmbajtje. Ndërsa Kodi Penal i Kosovës, i vitit 2012, e ka paraparë këtë vepër penale me emërtim të njëjtë, por ka paraparë dënim kumulativ për kryerësin me gjobë dhe burg si për shembull neni 290 parag. 1 parasheh dënimin me gjobë dhe burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet⁸⁷.

3.7. Lidhja e kontratës së dëmshme (neni 237)

Veprën penale, lidhja e kontratës së dëmshme e kryen personi përgjegjës apo personi i autorizuar në organizatën e biznesit apo në personin juridik, që ushtron veprimtari ekonomike e që lidh çfarëdo kontrate të dëmshme e për të cilën është i vetëdijshëm se ajo është e dëmshme dhe do të dëmtojë interesat e organizatës së biznesit apo personit juridik për të cilin ai punon.

85 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, *Rregullorja e UNMIK-ut*, 2003/25, 6 prill 2004, neni 236, par 1 dhe 2.

86 Shih: Ligji Penal i Kosovës i vitit 1977, (K.K .nr. 011-25/77, 28 qershor, Prishtinë), neni 108.

87 Shih: Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr. 13/19).

Kryerja e kësaj vepreje penale bëhet në dy mënyra: kontrata e nënshkruar nga personi duhet të jetë e dëmshme dhe të mos jetë e lidhur për organizatën e biznesit, që është pronë e tij dhe kontrata e lidhur nga personi përgjegjës të jetë bërë në kundërshtim me autorizimet e tij. Kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje, ngase kryerësi duhet të jetë në dijeni se është duke lidhur kontratë të dëmshme dhe duke vepruar jashtë autorizimeve të tij. Për ekzistimin e kësaj vepre penale duhet të përmbushet elementi objektiv dhe subjektiv⁸⁸. Forma e kryerjes së kësaj vepre penale mund të jetë e rëndë kur kryerësi i kësaj vepre penale merr ryshfet, apo nëse dëmi i shkaktuar është 100.000 euro. Për këtë formë të kualifikuar të veprës penale është paraparë dënimi nga 1 deri në 10 vjet burgim⁸⁹. Vepra penale është e inkriminuar edhe në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012⁹⁰, me përmbajtje dhe dënim të njëjtë, ashtu si e kishte paraparë Kodi i Përkohshëm Penal. Dënimi për këtë vepër penale, sipas Ligjit Penal të Kosovës, ka qenë nga 6 muaj e deri në 5 vjet burgim, ndërsa për mënyrën e cilësuar të veprës penale kur kryerësi merr ryshfet apo në raste veçanërisht të rënda kryerësi dënohet jo më pak se 1 vit burg⁹¹. Vlen të theksohet fakti se këtë vepër penale nuk e kishte paraparë Kodi Penal i Shqipërisë, në grupin e veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike⁹², e as ai i Maqedonisë në grupin e veprave penale kundër financave publike, qarkullimit pagësor dhe ekonomisë⁹³.

88 Salihu. Ismet, *E drejta penale e posaçme*, botuar në Kolegjin “Fama”, Prishtinë, 2009, fq. 307.

89 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, *Rregullorja e UNMIK-ut*, 2003/25, 6 prill 2004, neni, 237. parag. 2

90 Shih: Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr. 13/19), neni, 291.

91 Shih: Ligji Penal i Kosovës i vitit 1977, (K.K. nr. 011-25/77, 28 qershor, Prishtinë), neni 109, parag. 1 dhe 2.

92 Shih: Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995, (Ligji me nr 7895, i dt. 27.01.1995), kreu tre, marrë nga: www.ligjet.org (parë më 15.3.2014).

93 Shih : Kodi Penal i Maqedonisë i vitit 1996, (Gazeta zyrtare nr. 37/96), kreu i njëzetepestë.

3.8. Kuptimi i paautorizuar i sekretit të punës (neni 238)

Veprën penale, kuptimi paautorizuar i sekretit të punës e kryen kushdo që në kundërshtim me detyrat e tij të punës nxjerr informata nga organizata e punës ku punon, edhe pse është përgjegjës për ruajtjen e sekretit të punës dhe këto informata ia kumton personit tjetër, qofshin ato sekret pune apo afarizmi apo në atë mënyrë që i mundëson personit tjetër qasjen në mbledhjen e të dhënave të tilla me qëllim që ato t'i dorëzohen personit të paautorizuar. Në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, në nenin 238, parag. 5, është përcaktuar se çka nënkuptojmë me sekret pune: sekret pune do të thotë, zbulimi i të dhënave që janë përcaktuar me ligj ose akte tjera të organizatës apo personit juridik e që kanë të bëjnë me zbulimin e sekretit të prodhimit, rezultatet e punës hulumtuese dhe dizajnit, afarizmit ekonomik dhe tregtisë, e që zbulimi i tyre për ndonjë person të paautorizuar do të kishte pasoja të dëmshme për interesin ekonomik të organizatës⁹⁴. Vepra penale konsiderohet e kryer kur kryerësi i dorëzon, i komunikon apo i mundëson qasje në të dhënat që kompania përmes ndonjë akti juridik i konsideron sekret. Kjo veprë penale mund të kryhet me dashje dhe nga pakujdesia. Forma themelore e kësaj vepre penale konsiderohet edhe kur cilido me qëllim të përdorimit, në mënyrë të paautorizuar dhe në mënyrë të kundërligjshme, arrin deri te të dhënat që ruhen si sekrete të tregtisë. Kjo formë e veprës penale kryhet vetëm me dashje dhe dënimi për këtë mënyrë të kryerjes së kësaj vepre penale është paraparë deri në 3 vjet burgim⁹⁵. Mënyra e kualifikuar e kësaj vepre penale është kur të dhënat nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni janë me një rëndësi të posaçme ose nëse të dhënat e tilla personi i dorëzon me qëllim që ato ti nxjerrë jashtë Kosovës apo nëse vepra është kryer me

94 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, *Rregullorja e UNMIK-ut*, 2003/25, 6 prill 2004, neni, 238, parag. 5.

95 Po aty, neni 238 parag. 2 lidhur me parag. 1.

qëllim të përfitimit material, në këto raste dënimi për kryerësin e kësaj vepre penale është deri në 5 vjet burg⁹⁶.

Edhe kjo formë e veprës penale kryhet vetëm me dashje dhe kryerës mund të jetë çdo person. Vepra penale nga paragrafi i 1 dhe 3, mund të kryhet edhe nga pakujdesia. Kryerësi për këtë mënyrë të kryerjes së kësaj vepre penale dënohet deri në një vit burgim⁹⁷. Vepra penale ka qenë e inkriminuar me Ligjin Penal të Kosovës të vitit 1977, me emërtimin “Dhënia dhe marrja pa autorizim të sekretit të punës”. Dënimi për formën themelore të veprës penale ka qenë prej 3 muaj deri në 5 vjet burgim, ndërsa për formën posaçërisht të rëndë dënimi ka qenë jo më pak se 1 vit burgim⁹⁸. Ndërsa, sipas këtij ligji mënyrat e kryerjes së kësaj vepre penale janë dashja dhe pakujdesia. Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012, e ka të inkriminuar veprën penale me emërtimin “Komunikimi i paautorizuar i sekretit tregtar”. Dënimi për formën e rëndë të kryerjes së kësaj vepre penale është me gjobë dhe burgim deri në 5 vjet⁹⁹. Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995 dhe i Maqedonisë i vitit 1996, nuk e ka inkriminuar këtë vepër penale.

3.9. Falsifikimi i pullave postare dhe letrave me vlerë (neni 239)

Sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, veprën penale, falsifikimi i pullave postare dhe letrave me vlerë e kryen kushdo që prodhon pulla fiskale ose postare, ndryshon ato me qëllim të përdorimit si të vërteta, apo i jep tjetrit për t'i përdorë pullat e rreme me vlerë materiale të imituar sipas ligjeve të Kosovës (parag. 1 i KPK). Veprimi i

96 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, *Rregullorja e UNMIK-ut*, 2003/25, 6 prill 2004, neni 238. parag. 3.

97 Po aty, neni 238 parag. 4.

98 Shih: Ligji Penal i Kosovës i vitit 1977, (K.K .nr. 011-25/77, 28 qershor, Prishtinë), neni 110, parag. 1, 2 dhe 3.

99 Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr. 13/19), neni, 292.

kryerjes së kësaj vepre penale përcaktohet në mënyrë alternative dhe ajo kryhet përmes njëres nga format e përmendura. Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person. Vepra penale kryhet vetëm me dashje. Vepra penale mund të kryhet në formën themelore, dënimi për kryerësin në këtë formë është deri në 1 vjet burgim¹⁰⁰. Forma e kualifikuar e kësaj vepre penale është kur përfshihen pulla me vlerë që tejkalon 10.000 euro, kryerësi dënohet me burgim deri në 3 vjet¹⁰¹.

Forma e cilësuar e rëndë konsiderohet kur ndokush prodhon letra të rreme me vlerë të imituar në bazë të ligjeve të Kosovës ose ndryshon ndonjërin nga këto lloje të letrave me qëllim që t'i përdorë si të vërteta apo i jep personit tjetër këto letra t'i përdorë si të vërteta, kryerësi dënohet nga 3 muaj deri në 5 vjet burgim¹⁰².

Pullat dhe letrat me vlerë të rreme konfiskohen sipas paragrafit 6 (neni 239 i KPK-së). Tentativa për kryerjen e veprës penale nga paragrafi 1, 2 dhe 4 është e dënueshme. Kjo vepër penale është paraparë edhe në Kod Penal të Kosovës të vitit 2012, me emërtimin “falsifikimi i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës”. Sipas këtij kodi letra me vlerë ose instrumente të pagesës përfshin letrat me vlerë ose instrumentet e pagesës të falsifikuara ose letrat me vlerë ose instrumentet e pagesës të vërteta të cilat janë ndryshuar në aspektin material dhe me qëllim që të përdoren për qëllime mashtruese. Dënimi për mënyrën e cilësuar të kryerjes së veprës penale kur përdoren letrat me vlerë dhe instrumentet e pagesës që tejkalojnë 10.000 euro, kryerësi dënohet nga 1 deri në 8 vjet burgim¹⁰³. Ligji Penal i Kosovës i vitit 1977, nuk e ka inkriminuar

100 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, *Rregullorja e UNMIK-ut*, 2003/25, 6 prill 2004, neni, 239, parag. 1.

101 Po aty, neni 239, parag. 2.

102 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, *Rregullorja e UNMIK-ut*, 2003/25, 6 prill 2004, parag. 3.

103 Shih: Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr. 13/19), neni, 293, parag. 4.

këtë vepër penale¹⁰⁴. Ndërsa, Ligji Penal i RSFJ-së, e ka paraparë këtë vepër penale me emërtimin “falsifikimi i shenjave me vlerë”. Forma e rëndë e kësaj veprë penale konsiderohej kur ndokush prodhon, ndryshon apo përdor letrat me vlerë të falsifikuara me çrast shkakton çrregullime të mëdha për ekonominë e vendit, dënimi i paraparë për kryerësin e kësaj vepër penale ishte nga 5 vjet deri në 20 vjet burg¹⁰⁵.

Vepra penale është e paraparë edhe në Kodin Penal të Shqipërisë me emërtimin “falsifikimi i letrave me vlerë”, dënimi për kryerësin e kësaj veprë penale është nga 3 deri në 10 vjet burg¹⁰⁶.

3.10. Cenimi i të drejtës së patentës (neni 240)

Veprën penale, cenimi i të drejtës së patentës e kryen kushdo i cili në kudër të veprimtarisë ekonomike pa autorizim e përdor patentën e regjistruar të mbrojtur me ligj, ose përdor në mënyrë të paautorizuar topografin e një qarku të mbyllur apo të një gjysmëpërçuesi¹⁰⁷. Kjo vepër penale, në kohën e fundit, ku subjektet kanë arritur një zhvillim të madh në aspektin e teknologjisë, shpikjeve dhe zbulimeve të ndryshme kërkimore, dizajneve industriale, ka filluar të jetë e pranishme në veprimtaritë ekonomike, andaj shtetet kanë ndërmarë veprime për t’u mbrojtur në aspektin juridiko-penal nga shfrytëzimi i paautorizuar i patentës. Ligjvënësi kosovar këtë veprimtari e ka rregulluar me ligj të veçantë “Ligjin për patenta”, i cili në nenin 4 parasheh: zyrën për pronësi industriale të Republikës së Kosovës si organ i pavarur administrativo-shtetëror

104 Shih: Ligji Penal i KSAK, i vitit 1977, (K.K .nr. 011-25/77, 28 qershor, Prishtinë).

105 Shih: Ligji Penal i RSFJ-së, të vitit 1977, neni 169, parag. 2.

106 Shih: Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995, (Ligji me nr. 7895, i dt. 27.1.1995, fletorja zyrtare nr. 22), neni,184.

107 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, *Rregullorja e UNMIK-ut*, 2003/25, 6 prill 2004, neni, 240, parag. 1.

e themeluar në bazë të Ligjit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, e cila është përgjegjëse për mbrojtjen ligjore të shpikjeve, markave tregtare, dizajneve industriale, emërtimeve të origjinës, treguesve gjeografikë, treguesve dhe topografie të qarqeve të integruara, si dhe çështje tjera që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare, nënshkruese e të cilave është Republika e Kosovës¹⁰⁸. Këtë vepër penale mund ta kryejë çdo person. Vepra penale kryhet vetëm me dashje. Për këtë vepër penale dënimi është paraparë në mënyrë alternative me gjobë ose burgim deri në 3 vjet. Ndërsa kodi ka paraparë konfiskimin e sendeve të prodhuara pa autorizim (par. 2 i KPK). Vepra penale e tillë nuk ka qenë e inkriminuar në ligjin penal të Kosovës të vitit 1977, e as në ligjin penal të RSFJ-së të vitit 1977.

Gjithashtu, Kodi Penal i Shqipërisë nuk e ka të inkriminuar në kuadër të grupit të veprave penale “kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”. Siç po shihet kjo vepër penale është një risi dhe inkriminimi i saj ka qenë domosdoshmëri për mbrojtjen e ekonomisë në ditët e sotme. Këtë e dëshmon fakti që kjo vepër penale është e paraparë në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012, dënimi dhe përmbajtja e neneve është e njëjtë me Kodin e Përkohshëm Penal.

3.11. Përdorimi i paautorizuar i firmës, markës apo modelit të huaj (neni 241)

Veprën penale, përdorimi i paautorizuar i firmës, markës apo modelit të huaj, e kryen kushdo që gjatë veprimtarisë ekonomike bën përdorimin e firmës apo markës së huaj, qoftë markën e mallit apo markën e shërbimeve të huaja apo markën lidhur me prejardhjen gjeografike, duke e përdorur në firmën e vet, në markën e vet, apo në shenjat e

108 Shih: Ligji për Patenta të Kosovës, nr. 04/L-029, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 29 korrik 2011, i shpallur me dekretin e presidentit nr. DL-016-2011, më 9.8.2011.

veta të posaçme të mallit me qëllim të mashtrimit të blerësit apo shfrytëzuesit të shërbimeve. Kryerësi përmes kësaj veprë penale krijon identitet të rrejshëm të mallit dhe prejardhjes së tij me qëllim që ta fusë në qarkullim produktin e caktuar me çrast krijon konkurrencë jolojale në raport me subjektet e tjerë ekonomike në fushën e prodhimit, afarizmit ekonomik apo shërbimeve tjera.

Vepra penale konsiderohet se është kryer nëse është marrë njëri nga këto veprime: nëse personi prodhon dhe vë në qarkullim shumë prodhime, mandej në rastet e tilla konsiderohet që e ka kryer veprën penale në vazhdim dhe kur një person prodhon pa autorizim artikuj sipas mostrës dhe modelit të huaj, ndërsa personi tjetër i vë në qarkullim, në rastin e tillë konsiderohet se janë kryer dy vepra penale¹⁰⁹.

Objekti material i kësaj veprë penale është marka apo shenja e huaj e mallit. Kjo vepër penale kryhet nga çdo person dhe vetëm me dashje. Dënimi për këtë vepër penale ishte paraparë vetëm me burgim dhe kryerësi mund të dënohej deri në 2 vjet burgim¹¹⁰. Sendet nga paragrafi 1 dhe 2 në mënyrë obligative konfiskohen. Kjo vepër penale e tillë nuk ka qenë e inkriminuar në Ligjin Penal të Kosovës të vitit 1977¹¹¹, e as në Ligjin Penal të RSFJ-së¹¹². Veprën e tillë penale nuk e ka paraparë as Kodi Penal i Shqipërisë i viti 2001¹¹³. Edhe kjo vepër penale është risi për grupin e veprave penale kundër ekonomisë, por nuk është inkriminuar në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012¹¹⁴.

109 Salihu. Ismet, E drejta penale e posaçme, botuar në Kolegjin “Fama” Prishtinë, 2009, fq. 316.

110 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, *Rregullorja e UNMIK-ut*, 2003/25, 6 prill 2004, neni, 241, parag. 1.

111 Shih: Ligji Penal i KSAK, i vitit 1977, (K.K .nr. 011-25/77, 28 qershor, Prishtinë),

112 Shih: Ligji Penal i RSFJ-së, i vitit 1977.

113 Shih: Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 2001, (Ligji nr. 8733, Fletorja zyrtare nr. 4 shkurt, 2001).

114 Shih: Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr. 13/19), kapitulli XXV.

3.12. Mashtrimi i blerësve (neni 242)

Me veprën penale mashtrimi i blerësve, nënkuptojmë mashtrimin të cilin shitësi i bën blerësit, duke vënë në qarkullim produktin me të dhëna të cilat nuk i përgjigjen përmbajtjes, llojit, peshës, prejardhjes apo kualitetit të produktit apo vë në qarkullim produktet pa shenja të cilat tregojnë përmbajtjen, prejardhjen dhe cilësinë e produktit të kërkuar sipas ligjit. Kjo veprë penale kryhet edhe në rastet kur shitësi reklamon rrejshëm me qëllim të mashtrimit se është zbritur çmimi i mallit apo pritet rritja e çmimit për mallin.

Vepra penale mashtrimi i blerësve është inkriminuar në Kodin e Përkohshëm Penal në nenin 242 parag. 1 dhe 2. Dënimi për këtë veprë penale është paraparë në mënyrë alternative me gjobë apo burgim. Për paragrafin 1 kryerësi dënohet me gjobë apo burgim deri në 3 vjet, ndërsa sipas paragrafit 2 me gjobë apo burgim deri në 1 vit¹¹⁵. Kjo veprë penale konsiderohet se është kryer nëse personi kryen njërën nga këto forma:

1. Nëse personi vë në qarkullim prodhimin apo produktin me shenja në të cilën janë shënuar të dhënat, të cilat nuk i përgjigjen përmbajtjes, prejardhjes, kualitetit të produktit.

2. Forma tjetër është nëse personi vë në qarkullim për shitje produktin që nuk përmban peshën dhe cilësinë që është shënuar në produktin e ofruar për shitje me çrast vë në lajthim blerësin.

3. Apo në rastet kur personi lëshon në qarkullim produktin, pa shenja që tregojnë përmbajtjen, prejardhjen dhe cilësinë e produktit, të kërkuar me ligj.

Kjo veprë penale mund të kryhet nga çdo person, kurse mënyra e kryerjes së

115 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës i vitit 2004, *Rregullorja e UNMIK-ut*, 2003/25.

veprës penale është vetëm me dashje dhe duhet të ekzistojë qëllimi që të mashtrojë blerësin. Veprën penale e ka inkriminuar edhe Ligji Penal i Kosovës i vitit 1977, dënimi për kryerësin e veprës penale ka qenë alternativ me gjobë ose burg deri në 1 vit për paragrafin 2, ndërsa kumulativ me gjobë dhe burgim deri në 3 vjet¹¹⁶.

Këtë vepër penale e ka inkriminuar edhe Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995, por vetëm si mashtrim pa e specifikuar për blerësin apo persona tjerë. Dënimi për kryerësin e kësaj veprë penale është alternativ me gjobë ose burgim deri në 5 vjet¹¹⁷. Kosova me qëllim të ruajë konsumatorët nga mashtrimet e ndryshme që mund të vijnë nga shitësit e ndryshëm, pasi që vepra penale mashtrimi i blerësve është e pranishme, shumë shpesh në veprimtarinë ekonomike ka nxjerr: Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorëve¹¹⁸.

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë dhe mbrojë të drejtat themelore të konsumatorëve gjatë blerjes së mallrave, shërbimeve dhe formave të tjera në tregun e lirë. Ligji siguron mbrojtjen e shëndetit, mjedisit dhe interesave ekonomike të konsumatorit.

Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012, e ka inkriminuar këtë vepër penale. Dënimi për kryerësin e kësaj veprë penale është alternativ me gjobë ose burgim deri në 3 vjet (parag. 1)¹¹⁹. Për këtë vepër penale të gjitha shtetet bashkëkohore me ligjet e tyre penale, apo me ligje të veçanta, kanë ofruar mbrojtje juridiko-penale apo mbrojtje ligjore për konsumatorët.

116 Shih: Ligji Penal i RSFJ-së, i vitit 1977, neni 115, parag. 1 dhe 2.

117 Shih: Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995, (Ligji me nr. 7895, i dt. 27.1.1995, Fletorja zyrtare nr. 22), neni, 143.

118 Shih: Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit në Kosovë, me nr. 2004/17, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës me dt. 16.6.2004, neni 1.

119 Shih: nenin 299, parag. 1 të Kodit Penal të Kosovës i vitit 2012.

3.13. Organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm (neni 243)

Me veprën penale “organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm” nënkuptojmë veprimtarinë e kundërligjshme kriminale me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo persona tjerë, duke ngritur skema piramidale dhe duke mashtruar qytetarët që të deponojnë parat e tyre në këto skema, duke iu premtuar rrejshëm se ato do të përfitojnë kamata shumë të larta se në institucionet bankare.

Vepra penale kryhet edhe në rastet kur me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit dhe lojërave të fatit për të cilat nuk është dhënë më parë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent¹²⁰. Dënimi për këtë vepër penale, nëse ajo rezulton me dëm më të madh se 25.000 euro, kryerësi dënohet me burgim deri në 12 vjet¹²¹.

Kjo vepër penale paraqet rrezik të madh për pasurinë e qytetarëve ngase ata humbin mjetet e deponuara në këto lloje të institucioneve bankare fiktive. Gjithashtu kjo vepër penale rrezikon të prodhojë edhe trazira të mëdha shoqërore duke krijuar destabilitet në organet e shtetit e posaçërisht ato në fushën e sigurisë dhe zhvillimit ekonomik. Këtë fakt më së miri e vërteton humbja e parave në skemat piramidale në Shqipëri, në vitin 1997, ku me mija qytetarë kishin humbur parat e deponuara në skemat piramidale “Vefa” dhe “Gjathisa”. Humbja e parave kishte rezultuar me trazira të mëdha në Shqipëri që lanë një numër të njerëzve të vrarë dhe thuaj për pak nuk përfundoi me anarki totale në tërë territorin e shtetit. Nga ana objektive vepra penale kryhet me organizimin e lotarive të palejuara, lojërave të fatit dhe element themelor i

120 Shih: nenin 243, parag. 1 dhe 2, të Kodit të Përkohshëm Penal, të vitit 2004.

121 Po aty.

anës objektive është kundërligjshmëria¹²².

Kryerës i kësaj vepre penale është çdo person i cili organizon apo i themelon skemat piramidale apo organizon, ndihmon krijimin e lojërave të fatit për të cilat më parë nuk është dhënë leja me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror.

Vepra penale kryhet vetëm me dashje. Vepra penale është risi për veprat penale në fushën e ekonomisë për faktin se kjo vepër nuk ka qenë e inkriminuar në ligjet e më parshme të Kosovës. Kodi Penal i Shqipërisë e ka paraparë këtë vepër penale dhe dënimi për këtë vepër penale është nga 10 deri në 20 vjet burg¹²³, që është dënimi më i lartë i paraparë për grupin e veprave penale kundër ekonomisë jo vetëm në Shqipëri por edhe në shumicën e shteteve të Bashkimit Europian. Ky dënim, për mendimin tim, është si pasojë e skemave piramidale të ndodhura në këtë vend disa vjet më parë. Kosova i ka dhënë mbrojtje juridiko-penale qytetarëve të saj nga kjo vepër pasi që e njëjta është inkriminuar në Kodin Penal të vitit 2012. Dënimi për formën e rëndë të kësaj vepre penale, kur rezulton me dëm më të madh se 25.000 euro, kryerësi dënohet nga 2 deri në 12 vjet burgim.

3.14. Falsifikimi i parasë (neni 244)

Vepra penale , “Falsifikimi i parasë”, sipas paragrafit 1 të nenit 244 të KPK, kryhet nga kushdo i cili prodhon para të falsifikuara, me qëllim për t’i vënë në qarkullim si të vërteta ose e ndryshon paranë e vërtetë me qëllim për ta vënë në qarkullim, apo kushdo që paranë e tillë të falsifikuar e vë në qarkullim. Mënyra e

122 Elezi. Ismet, *Pjesa e posaçme e drejta penale*, botimet Erik, Tiranë, 2009, fq. 338.

123 Kodi Penal i Shqipërisë, i vitit 2001, (Ligji nr. 8733, Fletorja zyrtare nr. 4 shkurt, 2001), neni 143.

veprimit të kryerjes së kësaj vepre penale është alternative dhe kryhet në tri forma: duke prodhuar para të falsifikuara, duke ndryshuar paranë e vërtetë apo duke vënë në qarkullim paranë e falsifikuar.

Në ditët e sotme kjo vepër penale është mjaft prezente dhe prin për nga numri i rasteve nga veprat e tjera penale kundër ekonomisë. Pasojat e kësaj vepre penale janë shumë të mëdha për qytetarët dhe ekonominë e vendit. Personat që e falsifikojnë paranë kanë për qëllim mashtrimin e të tjerëve, ndërsa për vete përfitimin e kundërligjshëm material. Dënimi për kryerësin e kësaj vepre penale nga paragrafi 1 dhe 2 është me burgim deri në 10 vjet¹²⁴.

Paraja e falsifikuar dhe pajisjet për prodhimin e saj konfiskohen (parag. 4). Vepra penale kryhet vetëm me dashje, ndërsa tentativa për ta kryer veprën penale është e dënueshme. Vepra penale nuk ka qenë e inkriminuar në Ligjin Penal të Kosovës, të vitit 1977. Për mendimin tim kjo nuk e justifikon faktin që Kosova nuk e kishte valutën e vet, për faktin se objekt i kësaj vepre penale janë parat të cilat janë në qarkullim brenda shtetit të Kosovës apo jashtë. Gjithashtu, këtë e mbështet fakti që, edhe tani Kosova nuk e ka valutën e vetë, por Kodi Penal i vitit 2012 dhe ai i Përkohshëm i vitit 2004 e kanë inkriminuar si vepër penale.

3.15. Prodhimi dhe shfrytëzimi i shenjave të etiketave, masave dhe peshave të rreme (neni 245)

Veprën penale , “Prodhimi dhe shfrytëzimi i shenjave të etiketave, masave dhe peshave të rreme”, e kryen kushdo që me qëllim të përdorimit si të vërteta prodhon

124 Shih: neni 244, parag. 1 dhe 2 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, të vitit 2004.

shenja të rreme për etiketimin e mallit, ndryshon shenjat e vërteta, apo shenjat e rreme i përdor si të vërteta (parag. 1 i nenit 245 të KPK). Këtë vepër penale e kryen edhe kushdo që pa autorizim furnizon, shet apo jep në përdorim mjetet për prodhimin e vulave për shenjimin e mallit ose të masave dhe peshave të rreme (parag. 3 i nenit 245 të KPK).

Mënyra e veprimit të kryerjes së kësaj vepre penale është alternative, që nënkupton se vepra penale kryhet kur dikush: prodhon këto shenja, ndryshon shenjat e vërteta, apo shenjat dhe vulat e rreme i përdor si të vërteta. Vepra penale kryhet vetëm me dashje dhe nga çdo person i cili ka për qëllim tre veprimet e përmendura më lart. Dënimi për këtë vepër penale është vetëm me burg dhe atë nga 3 muaj deri në 5 vjet, me këtë dënim mund të dënohet edhe falsifikuesi.

Shenjat e rreme të etiketave, vulat, masat dhe peshat si dhe pajisjet për prodhimin e tyre konfiskohen¹²⁵. Ligji Penal i KSAK i vitit 1977¹²⁶ dhe Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995 dhe 2001¹²⁷, nuk e kishin paraparë këtë lloj të veprës penale. Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012¹²⁸ e ka inkriminuar këtë vepër penale.

Përmbajtja e dispozitës ligjore dhe dënimi për kryerësin është e njëjtë me Kodin e Përkohshëm Penal të vitit 2004. Kjo vepër penale është risi që ligjvënësi kosovar e ka paraparë në ligjet penale pas luftës dhe sjell mbrojtjen juridiko-penale dhe siguri më të madhe me rastin e qarkullimit ekonomik.

125 Shih: nenin 245, nga paragrafi 1 deri në 4, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, të vitit 2004.

126 Shih: Ligji Penal i KSAK i vitit 1977.

127 Shih: Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë i vitit 1995 dhe 2001, kreu III.

128 Shih: Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012, neni 303.

3.16. Tregtia e ndaluar (neni 246)

Veprën penale, “Tregtia e ndaluar”, konsiderohet se e kryen kushdo i cili pa autorizim shet, blen apo bën shkëmbimin e mallit apo të sendeve, qarkullimi i të cilave është i ndaluar apo i kufizuar me ligj (paragrafi 1 i nenit 246 të KPK). Mënyra e kryerjes së kësaj vepre penale është alternative dhe ajo realizohet kur: personi shet mallin, blen mallin apo sendet dhe shkëmben mallin apo sendet. Personi konsiderohet se e kryen veprën penale nëse kryen njërën nga këto veprime. Dënimi për këtë formë të veprës penale është paraparë nga 3 muaj deri në 3 vjet burgim¹²⁹.

Nëse kryerësi i veprës penale, nga paragrafi i parë ka organizuar rrjetin e stërshitësve ose të ndërmjetësve, apo ka realizuar përfitim që kalon dëmin mbi 15.000 euro, dënohet prej 6 muajve deri në 5 vjet¹³⁰. Malli dhe sendet nga tregtia e ndaluar apo e kufizuar konfiskohen. Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje. Tregtia, si degë e rëndësishme ekonomike, prej së cilës varet shumë edhe zhvillimi ekonomik i vendit është e mbrojtur me dispozita juridiko-penale edhe në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012, dënimi për formën e rëndë të kryerjes së kësaj vepre penale është nga 1 deri në 8 vjet burg¹³¹.

Vepra penale “Tregtia e ndaluar” ka ekzistuar edhe në Ligjin penal të Kosovës të vitit 1977¹³². Kodi Penal i Shqipërisë, këtë vepër penale e ka paraparë me emërtimin “Tregtimi i mallrave që janë kontrabandë”, dhe për këtë vepër penale dënimi është alternativ me gjobë ose burgim gjer në 5 vjet¹³³. Ligjvënësi kosovar fushën e tregtisë e

129 Shih: neni 246, parag. 1 i Kodit të Përkohshëm Penal i Kosovës i vitit 2004.

130 Po aty, paragrafi 2.

131 Shih: neni 305 parag. 2 i Kodit Penal të Kosovës i vitit 2012.

132 Shih: Ligji Penal i Kosovës i vitit 1977, neni 116.

133 Shih: Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995, neni 178.

ka rregulluar edhe me ligje të veçanta dhe atë: Ligjin për Tregtinë e Brendshme nr. 2004/18, ndryshuar dhe plotësuar me ligjin 2011/04-L-005, Ligjin për Tregtinë e Jashtme nr. 2011/04-L-048 etj. Nga ky aspekt del se tregtia e ndaluar është vepër penale e karakterit blanket sepse me ligjë të veçanta janë përcaktuar mallrat dhe sendet për të cilat kërkohet autorizim i veçantë për tregtimin e tyre.

3.17. Prodhimi i ndaluar (neni 247)

Veprën penale “Prodhimi i ndaluar” e kryen personi i cili pa autorizim prodhon, përpunon mallin, përpunimi i të cilit me ligj është i ndaluar (paragrafi 1 i nenit 247 të KPK). Edhe te kjo vepër penale mënyra e kryerjes është alternative, ngase vepra konsiderohet se kryhet nëse personi prodhon apo përpunon mallin e ndaluar me ligj. Dënimi për këtë vepër penale, sipas Kodit të Përkohshëm Penal të vitit 2004, është dënim alternativ me gjobë apo burgim deri në 3 vjet, ndërsa malli dhe mjetet për prodhimin dhe përpunimin e mallit konfiskohen¹³⁴. Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person dhe vepra penale kryhet vetëm me dashje. Vepra penale ka qenë e inkriminuar në Ligjin Penal të Kosovës të vitit 1977, me emërtimin “prodhimi i palejuar”. Dënimi për këtë vepër penale ka qenë gjithashtu alternativ me gjobë ose burgim deri në 3 vjet¹³⁵.

Vepra penale është e inkriminuar në Kodin e ri Penal të Kosovës¹³⁶, me emërtim ,përmbajtje dhe sanksion penal të njëjtë si në Kodin e Përkohshëm Penal. Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995 dhe 2001, nuk e ka paraparë këtë vepër penale në kuadër të

134 Shih: neni 247 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, të vitit 2004.

135 Shih: neni 117 i Ligjit Penal të KSAK, i vitit 1977.

136 Shih: neni 306 i Kodit Penal i Kosovës të vitit 2012.

“veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”. Vepra penale “Prodhimi i ndaluar” është e karakterit blanket, ngase me ligje të veçanta përcaktohet se cilat mallra apo artikuj nuk mund të prodhohen apo të përpunohen.

3.18. Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit (neni 248)

Veprën penale “Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit” mund ta kryejë kushdo i cili ka për qëllim që vetes apo tjetrit t’i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, duke vënë në qarkullim çekun për të cilin e dinë se nuk ka mbulesë të mjeteve apo duke e vënë në qarkullim çekun e rremë ose kartelën e falsifikuar të kredisë (paragrafi 1 i nenit 248 të KPK). Këtë vepër penale e kryen po ashtu edhe personi që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror e përdor kartelën e bankës në automatin e bankës, për tërheqjen e parave të gatshme për të cilat e di se nuk ka mbulesë në llogarinë rrjedhëse, (paragrafi 2 neni 248). Mënyrat e veprimit të kësaj vepër penale janë alternative dhe ato shprehen përmes këtyre formave: Vënia e çekut në qarkullim pa mbulesë dhe nëse e përdor çekun e rremë apo kartelën e falsifikuar dhe e din se nuk ka mbulesë. Kjo vepër penale sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës ka qenë e sanksionuar dhe dënimi për paragrafin 1 dhe 2 ka qenë deri 3 vjet burg¹³⁷. Ndërsa forma e rëndë e kësaj vepre penale konsiderohej kur dobia pasurore tejkalon 15.000 euro, dënimi për kryerësin është nga 6 muaj deri në 5 vjet burgim¹³⁸.

137 Shih: neni 248, parag. 1 dhe 2 i Kodit të përkohshëm Penal të Kosovës i vitit 2004.

138 Po aty, paragrafi 3.

Vepra penale për nga aspekti i përgjegjësisë penale kryhet vetëm me dashje. Vepra penale nuk ka qenë e inkriminuar në Ligjin Penal të Kosovës, të vitit 1977¹³⁹, dhe as në Kodin Penal të Shqipërisë të vitit 1995¹⁴⁰. Ligjvënësi kosovar duke parë rëndësinë që kanë çeket dhe kartelat e bankës, pasi ato përdoren si mjete për pagesë, ka siguruar mbrojtje juridiko-penale duke i inkriminuar këto veprime si vepër penale në Kodin e ri Penal të Kosovës të vitit 2012.

Dënimi për këtë vepër penale për formën themelore është kumulativ me gjobë dhe burgim deri në 3 vjet¹⁴¹, ndërsa për formën e rëndë të kësaj vepre penale kur dëmi rezulton me dobi pasurore mbi 5.000 euro, kryerësi dënohet me burg nga 6 muaj deri në 5 vjet¹⁴².

3.19. Shmangia nga tatimi (neni 249)

Këtë vepër penale e kryen personi i cili me qëllim të përfitimit për vete apo personin tjetër i shmangen pagesës së tatimit pjesërisht apo tërësisht ose i shmanget tarifave dhe kontributeve të parapara me ligj me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm. Personi këtë vepër penale e kryen edhe duke paraqitur të dhëna të pavërteta jo të plota për të ardhurat e veta apo nuk i përfshin informatat lidhur me të ardhurat e tij, gjendjen ekonomike apo fakte tjera për vlerësimin e detyrimeve tatimore (paragrafi 1, i nenit 249 të KPK).

139 Shih: Ligji Penal të KSAK, i vitit 1977.

140 Shih: Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995.

141 Shih: neni 307, parag. 1 dhe 2 i Kodit Penal të Kosovës i vitit 2012.

142 Po aty, paragrafi 3.

Mënyra e kryerjes së kësaj veprë penale bëhet në dy forma: e para ekziston ku personi paraqet të dhëna jo të plota me qëllim që t'i caktohet shkallë më e ulët e tatimit dhe kontributeve, ndërsa forma e dytë ekziston në rastet ku ai fare nuk paraqet të dhëna për të ardhurat apo pasurinë në bazë të së cilës do të përcaktohej edhe obligimi tatimor. Dënimi për këtë veprë penale sipas Kodit Penal të Përkohshëm ishte kumulativ, për mënyrën e kryerjes së zakonshme të veprës penale kryerësi dënohej me dënim me gjobë dhe burgim deri në 3 vjet¹⁴³, ndërsa për mënyrën e cilësuar të kryerjes kur shmangia e tatimit kalon mbi 15.000 euro kryerësi dënohet me gjobë dhe burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet¹⁴⁴.

Vepra penale kryhet vetëm me dashje. Kjo veprë penale ka qenë e paraparë në Ligjin Penal të Kosovës të vitit 1977, me emërtimin “Fshehja e tatimit”, dënimi për formën e rëndë të kryerjes së veprës penale ishte kumulativ me burgim prej 1 deri në 10 vjet burgim dhe me gjobë¹⁴⁵. Tatimet dhe kontributet janë forma kryesore përmes të cilave mbushet buxheti. Ligjvënësi kosovar i ka dhënë mbrojtje juridiko-penale edhe në Kodin e ri Penal të Kosovës të vitit 2012. Dënimi për mënyrën e cilësuar të kësaj veprë penale sipas këtij kodi është kumulativ me gjobë dhe dënim me burg nga 1 deri në 8 vjet¹⁴⁶.

Vepra penale “Shmangia nga tatimi” është e karakterit blanket, ngase me ligj të veçantë është paraparë pagesa e tatimit. Po i përmendim vetëm disa nga ligjet: Ligji për Tatimin në Pronën e Luajtshme, Ligji për Pronën e Paluajtshme, Ligji për Tatimin në të Ardhurat Individuale, Ligji për Tatimin e të Ardhurave të Korporatave etj.

143 Shih: neni 249, parag. 1 i Kodit të Përkohshëm Penal i Kosovës 2004.

144 Po aty, paragrafi 2.

145 Shih: neni 123, paragrafi 2 i Ligjit Penal të KSAK, i vitit 1977.

146 Shih: neni 313, paragrafi 3 i Kodit Penal të Kosovës, 2012.

3.20. Pranimi i paarsyeshëm i dhuratave (neni 250)

Veprën penale “Pranimi i paarsyeshëm i dhuratave” e kryen personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo personin juridik, i cili gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike e me qëllim të përfitimit joproporcional kërkon shpërblim apo pranon dhurata, duke lënë anash interesat e organizatës apo personit juridik të tij apo qëllimisht i shkakton dëm organizatës së tij gjatë lidhjes së kontratës ose pajtohet për kryerje të ndonjë shërbimi (paragrafi 1 neni 250 i KPK). Kjo vepër penale kryhet nëse personi përgjegjës, kërkon apo pranon dhurata apo ndonjë shpërblim pas lidhjes së kontratës apo kryerjes së shërbimit (paragrafi 3). Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është përcaktuar në mënyrë alternative dhe ajo ekziston kur: personi kërkon apo pranon dhuratë apo ndonjë shërbim. Vepra penale kryhet vetëm me dashje. Dënimi për këtë vepër penale sipas Kodit të Përkohshëm Penal është alternativ vetëm për paragrafin 1 me gjobë apo burgim deri në 3 vjet¹⁴⁷, ndërsa për paragrafin 2 kryerësi dënohet vetëm me burg deri në 3 vjet¹⁴⁸. Dhuratat e pranuar apo shpërblimet konfiskohen¹⁴⁹. Kjo vepër penale nuk ka qenë e inkriminuar në Ligjin Penal të Kosovës të vitit 1977¹⁵⁰.

Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995, këtë vepër penale e ka inkriminuar në grupin e veprave penale “Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbimin publik”, dhe atë: vepra penale “kërkim për dhënie të mitos” dhe vepra penale “marrja e mitos”. Dënimi për këto vepra penale ishte paraparë nga 3 vjet gjer në 10 vjet burgim¹⁵¹.

147 Shih: neni 250, paragrafi 1 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, 2004.

148 Po aty, paragrafi 2.

149 Po aty, paragrafi 3.

150 Shih: Ligji Penal i KSAK, të vitit 1977, kreu XIV.

151 Shih: neni 259 dhe 260 i Kodit Penal të Shqipërisë i vitit 1995. Për më tepër: www.ligjet.org.

3.21. Dhënia e paarsyeshme e dhuratave (neni 251)

Veprën penale “Dhënia e paarsyeshme e dhuratave” e kryen personi i cili me qëllim të sigurimit të një përfitimi për vete ose personin tjetër, tenton të japë, premtan dhuratë apo shpërblim joproporcional për personin që ushtron veprimtari ekonomike, me qëllim që ai të lë anash interesat e organizatës apo personit juridik me rastin e lidhjes së kontratës ose kryerjes së ndonjë shërbimi (paragrafi 1 i nenit 251 të KPK). Mënyra e kryerjes së kësaj vepre penale është alternative dhe ajo shprehet në rastet kur: personi tenton të japë dhuratë, apo premtan se do të japë dhuratë apo ndonjë shpërblim. Vepra penale kryhet vetëm me dashje dhe tentativa për kryerjen e veprës penale është e dënueshme. Ligjvënësi ka paraparë mundësinë që kryerësin e kësaj vepre penale ta lirojë nga dënimi nëse ai e lajmëron veprën para se të zbulohet nga organe e ndjekjes. Kjo vepër penale është e sanksionuar në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës të vitit 2004.

Dënimi për këtë vepër penale është deri në 3 vjet¹⁵². Dhurata apo shpërblimi i dhënë konfiskohen¹⁵³. Këtë vepër penale nuk e kishte paraparë në kudër të veprave penale kundër ekonomisë Ligji Penal i KSAK¹⁵⁴, dhe Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995¹⁵⁵. Vepra penale është e sanksionuar në Kodin e ri Penal të Kosovës, dënimi për këtë vepër penale është kumulativ me gjobë dhe burgim deri në 3 vjet¹⁵⁶.

152 Shih: neni 251, paragrafi 1 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, i vitit 2004.

153 Po aty, paragrafi 4.

154 Shih: Ligji Penal të KSAK, i vitit 1977, kreu XIV.

155 Shih: Kodi Penal i Shqipërisë, i vitit 1995.

156 Shih: neni 316, paragrafi 1 i Kodit Penal i Kosovës, i vitit 2012.

KAPITULLI IV

ASPEKTE KRAHASUESE PËR VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË DHE PËRGJEGJËSIA PENALE E PERSONAVE JURIDIKË SIPAS LEGJISLACIONIT PENAL TË KOSOVËS DHE DISA SHTETEVE TË EVROPËS

A.

4.1. Vështrim krahasues i veprave penale kundër ekonomisë

Veprat penale, në fushën e ekonomisë, sot shumica e shteteve i kanë çështje sfiduese në vendet e tyre, duke përfshirë edhe shtetet më bashkëkohore. Shtetet në aspektin e mbrojtjes juridiko-penale, këtij grupi të veprave penale i kanë kushtuar kujdes të posaçëm dhe trajtim të veçantë. Shikuar nga aspekti përmbajtësor posaçërisht politikës ndëshkimore, ekzistojnë dallime midis kodeve penale që ofrojnë mbrojtje juridike për veprat penale në fushën e ekonomisë.

Në vazhdim, gjatë trajtimit të kësaj teme, do të paraqiten aspekte krahasuese të veprave penale në fushën e ekonomisë dhe disa nga standardet që i kanë kodet penale të disa shteteve evropiane që ofrojnë mbrojtjen juridiko-penale në fushën e ekonomisë.

Ky angazhim i shteteve vjen nga fakti që nga viti 1960, lëvizja e kapitalit ka filluar gradualisht liberalizimin¹⁵⁷, dhe nga ky aspekt ka filluar edhe bashkëpunimi më i madh ekonomik ndërmjet shteteve. E rëndësishme është që shteti dhe bizneset të jenë të vetëdijshme për ekzistencën e tyre dhe të përgatiten për t'u mbrojtur nga sfidat dhe

¹⁵⁷ Zajmi. Iva, *Qarkullimi i lirë i kapitalit bashkimi ekonomik dhe monetar*; revista, Studime juridike, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2009, fq. 117.

rreziqet që mund t'i shoqërojë hapja e ekonomisë, ndaj tregjeve globale¹⁵⁸.

Në vazhdim do të paraqesim disa aspekte krahasimore të disa kodeve penale dhe atë: Kodit Penal i Shqipërisë të vitit 1995, Kodi Penal i Francës të vitit 1994, Kodi Penal i Italisë të vitit 1992, Kodi Penal i Kroacisë të vitit 2011, Kodi Penal i Sllovenisë të vitit 2004, Kodi Penal i Serbisë të vitit 2012, Kodi Penal i Maqedonisë 1996-2004, dhe Kodi Penal i Bosnjës e Hercegovinës të vitit 2003. Nga ky kapitull vlen të ceket se është pranuar dhe publikuar punimi shkencor: *Comperative Aspects of Criminal Legislation for Criminal Offenses in the Field of Economy in Kosovo and some European Countries*, me referencen SBSPRO18842¹⁵⁹.

4.2. Vështrim i përgjithshëm për historikun e lindjes dhe zhvillimit të veprave penale në fushën e ekonomisë në Shqipëri

Fillimisht dua të theksoj se janë disa arsye përse kam vendosur të bëjë një vështrim më të gjerë për lindjen dhe zhvillimin e veprave penale në fushën e ekonomisë në Shqipëri: E para, për faktin se ky punim i doktoratës do të mbrohet në këtë shtet dhe është e domosdoshme që të studiohet shkurtimisht rruga e zhvillimit të legjislacionit që ka ndjekur Shqipëria; e dyta, lidhjet historike edhe në fushën e legjislacionit që ka Kosova me Shqipërinë; e treta, historiku i zhvillimit të legjislacionit në këtë vend është tejet specifike për faktin se është zhvilluar nëpër etapa të ndryshme të zhvillimit politik nga mbretëria e deri te sistemi parlamentar, me qëllim të krahasimit me Kosovën e cila

158 Uruçi. Esmeralda, MBA Albana. Borici - Begani, *Globalizimi dhe ekonomia botërore*, revista shkencore ndërkombëtare "Iliria" Universiteti Mbretëror "Iliria", Prishtinë, 2009, fq. 84.

159 Mr.sc. Bahri Hyseni, *Comperative Aspects of Criminal Legislation for Criminal Offenses in the Field of Economy in Kosovo and some European Countries* me referencen SBSPRO18842, në Rivistën shkencore ndërkombëtare, *Procedia- Sociall and Behavioral Sciences*, Iasi, Rumania, 5 shtator, 2014, fq. 409-416. Marrë nga: <http://authors.elsevier.com/sd/article/S1877042814048836> (parë më 10 shtator 2014).

ka pasur gjithashtu një rrugë specifike për hartimin e legjislacionit.

Shqipëria që në regjimin e Ahmet Zogut kishte nxjerr ligje që rregullonin tatimet, taksat dhe të ardhurat shtetërore¹⁶⁰. Shqipëria kishte bërë përpjekje të vazhdueshme për të nxjerrë akte normative që përmbanin norma penale dhe kjo ndodhi sidomos pas Kongresit të Lushnjës në vitet e 20-ta, suksesin e arriti me 3 qershor të vitit 1927, kur miratoi Kodin Penal Shqiptar¹⁶¹. Kodi ishte votuar nga parlamenti dhe senati në kohën e Republikës së Zogut. Ky kod, i pari në Shqipëri, kishte paraparë veprat penale kundër pasurisë që i përshtateshin kohës sepse tani shumica e këtyre veprave rregullohen në kapituj të veçantë.

Më 15.12.1944, Shqipëria nxori ligj të veçantë “mbi vjedhësit e pasurisë së shtetit”, ku në nenin 1 të këtij ligji, thuhej ata që vjedhin pasurinë e shtetit dhe popullit dënohen me gjyq ushtarak me burgim dhe konfiskim të pasurisë të tundshme dhe të patundshme dhe i humbin të drejtat e tyre të përhershme civile dhe politike¹⁶². Pra, gjatë gjithë kësaj kohe bëheshin përpjekje të ndryshme për ta luftuar kriminalitetin që shfaqej në forma të ndryshme për shembull si kontrabanda, falsifikimi i monedhave. Në këtë kohë u nxor ligji me rëndësi të madhe juridike me nr. 373, “Mbi ndjekjen e tregtisë së ndaluar, spekulimit dhe sabotimit ekonomik”, i datës 12.12.1946¹⁶³. Sipas ligjit tregti e ndaluar ishte “çdo veprimtari ekonomike që ushtrohej në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë tregtinë, gjithashtu ligji parashihte edhe format e tregtisë së ndaluar për shembull shitja e mallrave me çmim më të lartë nga ajo që e përcaktonte organi

160 Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri pjesa e dytë, shtëpia botuese “Laurasi”, Tiranë 1994, fq. 132-133.

161 Kodi Penal Shqiptar i vitit 1927, (Fletorja zyrtare nr. 1 janar 1928).

162 Po aty. fq. 152.

163 Ligji nr. 373, mbi ndjekjen e tregtisë së ndaluar, të spekulimit dhe sabotimit ekonomik, (Gazeta zyrtare nr. 118, datë 28 dhjetor 1946).

kompetent, gjithashtu ligji parashihte spekulimin dhe sabotimin ekonomik, ku me spekulim kuptohej çdo veprimtari ekonomike që ka për qëllim realizimin e një fitimi jashtë mase me anë të grumbullimit apo rishitjes së sendeve të nevojës së parë apo konsumit të gjerë. Ndërsa me “Sabotimin ekonomik, sipas këtij ligji, kuptohej çdo veprim apo mosveprim i bërë me qëllim që të pengohej, vështirësohej ose të vihet në rrezik funksionimi i shpejtë apo i rregullt i ndërmarrjeve apo punishteve ekonomike dhe transporti i shtetit”¹⁶⁴. Pra shihet se deri në nxjerrjen e Kodit Penal të vitit 1957, veprat penale në fushën e ekonomisë kanë qenë të rregulluara në kapituj të ndryshëm dhe me emërtime që pak janë unike me emërtimet dhe përmbajtjen që kanë sot.

Shqipëria pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, kishte bërë arritje pozitive sepse për herë të parë nxori Kodin Penal i cili përmbante pjesën e përgjithshme dhe të posaçme. Kodi hyri në fuqi me datë 01.09.1952¹⁶⁵. Ky kod kishte paraparë në kapitullin e dytë veprat penale kundër pasurisë shtetërore dhe shoqërore por nuk kishte paraparë vepra penale adekuate kundër ekonomisë. Kodi në kapitullin e tretë kishte parapa veprat penale si “krime kundër sistemit socialist të ekonomisë”¹⁶⁶. Nga përmbajtja e neneve të këtij grupi të veprave penale shihet se dispozitat ligjore rregullojnë krimet në fushën e industrisë dhe të ndërtimit në pjesën e parë që nuk janë adekuate dhe nuk parashohin rregullimin e fushës ekonomike. Në kreun e katërt dhe të pestë Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1952, ka paraparë “Krimet në fushën e financave” dhe “Krimet në lidhje me tatimin dhe detyrimet”, ku vepra penale “Falsifikimi i monedhave dhe letrave të tjera me vleftë” dhe “Falsifikimi i pullave dhe i dokumenteve të udhëtimit”, kanë ngjashmëri plotësisht edhe në përmbajtje me veprat penale që i ka paraparë Ligji Penal i KSAK 1977 dhe atë:

164 Elezi. Ismet & Elezi. Ela: *Historia e së drejtës penale*, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2010, fq. 158.

165 Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë i vitit 1952, (Gazeta zyrtare nr. 15, datë 01.8.1952).

166 Po aty, pjesa e posaçme, neni 87.

“Bërja dhe përdorimi i shenjave të rremet të vlerës ose i letrave me vlerë” (neni 113)¹⁶⁷ dhe vepra penale “Falsifikimi i shenjave me vlerë” e paraparë në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2013, neni 294”¹⁶⁸.

Kodi Penal i vitit 1952 me gjithë arritjet pozitive në kompletimin e legjislacionit penal, duke pasur parasysh që është kodi i parë që ka edhe pjesën e posaçme, konsideroj që nuk ka arritur që veprat penale në fushën e ekonomisë t’i sistemojë në mënyrë adekuate, por i ka shpërndarë në pesë krerë duke krijuar paqartësi.

Ndryshimet kushtetuese në Shqipëri, në vitin 1976, determinuan ndryshimet e Kodit Penal të vitit 1952. Andaj, me ligjin nr. 5591 të datës 15.06.1977, u miratua Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë i vitit 1977¹⁶⁹. Kodi ishte krijuar nën urdhrat e Komitetit Qendror të Partisë së Punës edhe pse kishte një komision tejet profesional mund të thuhet se gjatë hartimit të kodit pati ndikim më shumë politika dhe diktatura e njerëzve në pushtet sesa profesionalizmi. Kodi në pjesën e posaçme kishte paraparë “krimet kundër pasurisë shtetërore ose shoqërore dhe kundër sistemit të ekonomisë”. Krahasuar me Kodin paraprak Penal të vitit 1952, ai kishte ruajtur kategorizimin e veprave penale kundër pasurisë si grup i veçantë por kishte bërë hapa progresivë në sistemimin dhe emërtimin e veprave penale në fushën ekonomike. Kodi në kreun e tretë kishte paraparë veprat penale në fushën ekonomike të emërtuara: “Krimet kundër sistemit socialist të ekonomisë”¹⁷⁰.

Në këtë kategori të veprave penale, kodi kishte paraparë 14 vepra penale, të cilat ishin ndarë në: “Krime në fushën e industrisë, të ndërtimit dhe bujqësisë “. Në grupin e

167 Shih: Ligji Penal i KSA-së, të vitit, 1977, neni 113.

168 Shih: Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012.

169 Shih: Ligji nr. 5591, miratuar më 15.6.1977, (Gazeta zyrtare nr. 3, 1977), fq. 27-96.

170 Shih: Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1977, neni 69-82.

dytë kishte paraparë: “Krimet në fushën e tregtisë”, veprat penale ishin: “Kontrabanda” (neni 72), “Ushtrimi i tregtisë së ndaluar” (neni 73), “Mashtrimi në peshë dhe matje” (neni 74), “Shitja e mallrave me çmim më të lartë” (neni 75), “Falsifikimi i monedhave” (neni 76), “Shkelja e dispozitave mbi valutën dhe arin” (neni 77), ndërsa në pjesën e tretë kishte paraparë: “Krimet në fushën e transportit”¹⁷¹. Pra, ky grup i veprave të parapara në fushën e transportit, të sistemuara në grupin e veprave penale kundër ekonomisë, janë vepra plotësisht të reja në raport me veprat penale në fushën e ekonomisë të parapara në kodet penale të Kosovës, që nga ai i vitit 1977 e deri te ai i vitit 2013.

4.2.1. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë të vitit 1995

Ndryshimet e thella politike, që ndodhën në Shqipëri pas përmbyesjes së shtetit totalitar dhe ndryshimeve social-ekonomike, lindi nevoja për reforma në legjislacionin penal. Andaj, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 7895 të datës 27.01.1995, miratoi Kodin e Ri Penal, i cili hyri në fuqi më 1 qershor 1995¹⁷². Kodi ishte i hartuar në pajtim me kodet penale të shteteve perëndimore, kishte përmbajtje demokratike e cila garantonte se do të mbrojtë shoqërinë dhe shtetin nga kriminaliteti në përgjithësi e në veçanti nga ai ekonomik. Kodi në kreun e tretë kishte parapa “Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”¹⁷³.

Në seksionin e parë kodi ka paraparë veprat penale të pasurisë.

171 Shih: Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1977, nga neni 69-82.

172 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i vitit 1995, (Fletore zyrtare nr. 22, 1995). Për më tepër: www.ligjet.org.

173 Po aty.

Në seksionin e dytë kodi ka paraparë veprat penale "Mashttrimet", ku në vazhdim po i paraqesim këto vepra: "Mashtrimi" (neni 143), "Mashtrimi në subvencione" (neni 144), "Mashtrimi në sigurime" (neni 145), "Mashtrimi për veprat e artit dhe kulturës" (neni 147), "Botimi i veprës me emrin e vet" (neni 148).

Në seksionin e tretë Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995, ka paraparë veprat penale: "Shkatërrimi i pronës" që me përjashtim të veprës penale "shkatërrimi i pronës me zjarr" (neni 151), "shkatërrimi i rrjetit elektrik" (neni 156), "shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit" (neni 160). Këto vepra penale janë paraparë në grupin e veprave penale "kundër pasurisë" dhe "shërbimeve komunale" në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012.

Në seksionin IV kodi ka paraparë veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare. Ky grup i veprave ka rëndësi të madhe nga fakti që shoqëritë tregtare, në sistemin e ekonomisë së tregut të lirë, kanë rëndësi të madhe në gjallërimin e tregut dhe furnizimin e popullit me artikuj të nevojshëm. Disa nga këto vepra si: "Vepra penale falsifikimi i nënshkrimeve" (neni 165), apo "përpilimi i deklaratave të rreme" (neni 163) etj. Kodi penal i Përkohshëm i Kosovës nuk i ka paraparë në grupin e veprave penale kundër ekonomisë¹⁷⁴.

Në seksionin V kodi ka paraparë: "Krimet në fushën e doganave", në këtë kategori është paraparë kontrabanda dhe të gjitha format e saj, që si vepër penale paraqet rrezik të madh për interesat shtetërore, duke pasur parasysh që shteti përmes taksave dhe tatimeve doganore nxjerr të ardhura të konsiderueshme për buxhetin¹⁷⁵. Kjo kategori e veprave penale në Kosovë dhe në Shqipëri është e rregulluar edhe me ligje të veçanta-kode doganore. Nëse e krahasojmë kodin penal të vitit 1995, me kodin e mëparshëm në

174 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës i vitit 2004.

175 Elezi. Ismet, *E drejta penale* (pjesa e posaçme), botimet Erik, Tiranë, 2009, fq. 280.

Shqipëri të vitit 1977, shohim një ndryshim të madh dhe pozitiv ngase ai ka siguruar një mbrojtje juridike-penale më të efektshme, ku parasheh nëntë dispozita penale për kontrabandën, për dallim nga i mëparshmi që kishte paraparë vetëm një. Nëse e krahasojmë me Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012 shohim se ai ka paraparë vetëm në një dispozitë ligjore veprën penale “Kontrabandimi i mallrave” (neni 317)¹⁷⁶. Kodi në seksionin VI ka rregulluar veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet. Ky grup i veprave penale jo vetëm për shtetin e Shqipërisë por për të gjitha shtetet ka rëndësi të veçantë sepse grumbullon të hyrat publike që mbushin buxhetin e shtetit, bile nëse mund të themi se në shtetet tona taksat dhe tatimet janë burim kryesor për mbushjen e buxhetit. Ky grup i veprave penale është i rregulluar me ligje të veçanta në Kosovë dhe Shqipëri. Kodi Penal i Kosovës i vitit 2013, këto vepra gjithashtu i ka paraparë në grupin e veprave penale kundër ekonomisë me pak dallime në përmbajtje dhe emërtim si p.sh: në Shqipëri Kodi Penal i vitit 1995 ka paraparë veprën penale “Mospagimi i taksave dhe tatimeve” (neni 181)¹⁷⁷, ndërsa në Kosovë Kodi Penal i vitit 2012, ka paraparë veprën penale “Shmangia nga tatimi “ (neni 313)¹⁷⁸. Kodi në seksionin VII ka paraparë veprat penale “falsifikimin i monedhave dhe lerave me vlerë”.

Ky grup i veprave penale ka ndikim në veprimtarinë financiare të shtetit, sistemin monetar dhe kreditor të tij. Andaj në mbrojtje të sistemit monetar Kodi Penal i Shqipërisë i ka kushtuar rëndësi të veçantë këtyre veprave penale: “Falsifikimi i monedhave” (neni 183), “falsifikimi i letrave me vlerë” (neni 184), dhe “prodhimi i mjeteve për falsifikim” (neni 185)¹⁷⁹. Këto vepra penale në kodin penal të Kosovës janë

176 Shih Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012, neni 317.

177 Shih Kodin Penal të Shqipërisë të vitit 1995, neni 181.

178 Shih Kodin penal të Kosovës të vitit 2012, neni 313.

179 Shih Kodin Penal të Shqipërisë të vitit 1995.

të paraparë në grupin e veprave penale kundër ekonomisë, në (nenin 293, 294, dhe nenin 302)¹⁸⁰.

Në seksionin VIII, kodi ka paraparë veprat penale: “falsifikim i dokumenteve”. Kujtojmë se ky grup i veprave penale nuk e ka vendin në grupin e veprave penale kundër ekonomisë dhe këtë e mbështes mbi faktin se disa kode penale dhe ky i Kosovës këto vepra penale i ka paraparë në kapitullin e veprave penale “kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike”¹⁸¹.

Në seksionin IX janë paraparë veprat penale në fushën e falimentimit me qëllim që sistemi i ekonomisë së tregut, prona publike dhe private, ndërmarrjet e ndryshme publike dhe private të gëzojnë mbrojtje juridiko-penale. Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995, ka paraparë këto vepra në një seksion të veçantë sepse kështu e kanë të rregulluar edhe shumica e shteteve evropiane. Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012, këtë grup të veprave penale e ka të rregulluar në grupin e veprave penale kundër ekonomisë, ndërsa Kodi i Përkohshëm Penal i vitit 2004 kishte paraparë veprën penale “shkaktimi i falimentimit” (neni 234)¹⁸². Në seksionin X kodi ka paraparë veprat penale në fushën e lojërave të fatit, që është kategori e re e veprave penale të cilat nëse zhvillohen konform ligjit sjellin përfitim për ekonominë e shtetit, e posaçërisht për argëtimin e njerëzve që janë dhënë pas tyre¹⁸³. Shteti i Kosovës dhe Shqipërisë këtë kategori të veprave penale e kanë rregulluar me ligje të posaçme. Poashtu kodet penale të Kosovës dhe Shqipërisë ofrojnë mbrojtje juridiko-penale në të gjitha rastet kur këto lojëra zhvillohen në kundërshtim me dispozitat ligjore.

180 Shih Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012.

181 Po aty, kapitulli XXXII.

182 Shih Kodin Penal të Kosovës të vitit 2004, neni 234.

183 Elezi. Ismet, *E drejta penale* (pjesa e posaçme), botimet Erik, Tiranë, 2009, fq. 337.

Kosova ka ligjin për lojërat e fatit, ndërsa në Kodin Penal në nenin 300, në grupin e veprave penale në fushën e ekonomisë është paraparë vetëm vepra penale “organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm”.

Në seksionin e fundit XI, kodi ka paraparë veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës, që në kodin penal të Kosovës të vitit 2004 dhe 2012, nuk janë paraparë në grupin e veprave penale në fushën e ekonomisë. Nga krahasimi vërehet se Kodi Penal i vitit 1995, ka bërë progres të madh, ku ligjvënësi i ka kushtuar kujdes veprave penale në këtë fushë duke i paraparë gjithsej 67 nga neni 134 e deri në nenin 200.

4.2.3. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Francës

Arsyeja pse e kam marr që të krahasoj Francën dhe legjislacionin e saj penal kundër veprave penale në fushën e ekonomisë është fakti se është shtet i Bashkimit Evropian. Legjislacioni i Francës në Kosovë, në periudhën e mbikëqyrjes nga ana misionit të OKB-së, UNMIK-ut, ka qenë model për hartimin e legjislacionit të Kosovës. Kjo ndoshta edhe për faktin që njeri nga kryeadministratorët e shumtë në Kosovë, në periudhën e tranzicionit, ishte nga ky vend ku kishte rolin përfundimtar për nënshkrimin e ligjeve dhe hartimin e rregulloreve. Franca konsiderohet shteti që ka pasur vështirësi gjatë reformave për aprovimin e kodit të ri penal, pas përpjekjeve të komisionit të parë të reformave më 1892, pastaj komisioneve tjera më 1932 dhe 1976, më 1986 hartohet teksti final, ndërsa në vitin 1992, aprovohet kodi penal i cili hyri në fuqi më 1 mars. 1994¹⁸⁴.

Kodi Penal i Francës i vitit 1994, ka paraparë shumë vepra penale përmes të cilave

184 Dr. Kambovski. Vlado, Kazneno- pravna reforma pred predizvicite na XXI vek, Pravni Fakultet Skopje, 2002, fq.156.

ka arritur të mbrojë vlerat shoqërore dhe individuale të shtetit francez. Krahas veprave penale të përgjithshme, kodi penal ka parashikuar edhe veprat penale në sferën e ekonomisë me emërtimin: “Mashttrimet, fitimet dhe veprat e ngjashme” nga neni (313-1 deri me 313-9)¹⁸⁵. Përmes këtyre veprave Franca ka arritur të mbrojë ekonominë e vendit nga kriminaliteti ekonomik, që është sfidues për shumicën e shteteve të rajonit.

Karakteristikat e përbashkëta të veprave penale kundër ekonomisë janë të ngjashme me shumicën e ligjeve penale, të mos them se janë të njëjta. Njëzëri pranohet fakti se stabiliteti ekonomik i vendit varet shumë nga mënyra se si përmes ligjit i janë qasur luftës kundër kriminalitetit ekonomik¹⁸⁶.

Natyrisht që dallime ka në figurat konkrete të këtyre veprave penale dhe në politikën ndëshkimore që e zbatojnë shtetet. Disa nga veprat penale që janë paraparë në legjislacionin francez, në fushën e ekonomisë janë: mashttrimet duke përdorur emrin e rremë apo kapacitetet fiktive, ose përmes pronarëve të paligjshëm duke e shtyrë personin të veprojë kundër pasurisë së tij apo fondeve të tij. Për kryerësin e kësaj vepre penale ligji ka paraparë dënim kumulativ me burg deri në 5 vite dhe gjobë 375 euro. Kodi penal ka paraparë gjithashtu mënyrën e cilësuar të veprës penale, kur ajo kryhet nga zyrtarët publikë dhe në dëm të qytetarëve me dobësi të veçanta siç janë: të moshuarit, të sëmurët etj. Dënimi i paraparë në raste të tilla është me burg 7 vite dhe gjobë 750 euro.

Vepër tjetër penale është ajo e “tenderimit publik”, ku tenderimi kufizohet në forma të ndryshme, qoftë përmes dhuratave, premtimeve apo mjeteve tjera mashtruese. Dënimi për këtë vepër penale është me burg deri në 6 muaj dhe gjobë 22.500 euro.

185 Kodi Penal i Francës (Gazeta zyrtare 22 shtator 2002). Marrë nga: <http://legifrance.gouv.fr> (parë më 11.07.2014).

186 Elezi. Ismet, Mbrojtja juridiko-penale e pasurisë, Albin, Tiranë, 2002.

Tentativa për ta kryer veprën është e dënueshme sipas ligjit. Kodi Penal i Francës ka paraparë edhe veprën penale “Keqpërdorimi i besimit”, kur dikush keqpërdor fondet dhe gjërat me vlerë, pastaj veprën penale “Pastrimi i parasë”, ku dënimi për këtë vepër penale është paraparë 5 vite burg dhe 375 euro. Kujtoj se legjislacioni francez, për veprat penale në fushën ekonomike, përveç mënyrës së zakonshme të kryerjes, ka paraparë edhe mënyrën e cilësuar të kryerjes në rastet e caktuara. Gjithashtu ligjvënësi francez ka paraparë në ligjin penal konfiskimin e pasurisë dhe mjeteve me të cilat kryhet vepra penale. Masat tjera që janë paraparë: ndalimin për të ushtruar detyrën kur personat janë zyrtarë publikë, ndërsa për personat juridikë ekziston përgjegjësia penale dhe dënimet ndaj tyre mund të jenë me gjobë dhe ndalimi për të ushtuar veprimtari afariste për 5 vite, pastaj ndalesa që të marrin pjesë në tenderët publike për 10 vite, ndalimi për lëshuarjen e çeqeve për një periudhë pesëvjeçare. Legjislacioni Penal i Francës ka një standard të lartë përmes të cilit ka inkriminuar veprat penale në ekonomi, ajo që e dallon nga Kosova është se ka paraparë veprën penale të cilësuar në rastet e caktuara kur ajo kryhet nga personat që janë të veshur me pushtet dhe kur kryhet vepra ndaj kategorive të veçanta të njerëzve, që vuajnë nga ndonjë sëmundje apo janë në moshë të shtyrë.

Ligji Penal i Francës mendoj se nuk ka bërë një ndarje të qartë të veprave penale në sferën e ekonomisë, por në këtë grup ka përfshirë edhe vepra penale që janë të drejtuara kundër pasurisë dhe pronës.

4.2.4. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Italisë

Krahasimi i legjislacionit penal të Italisë është marrë për faktin se ky shtet ka legjislacion të përafërt me Shqipërinë. Një aspekt tjetër me rëndësi është fakti se Italia është anëtare e familjes së madhe evropiane, andaj krahasimi i legjislacionit në fushën e ekonomisë do të ishte sadopak një kontribut për shtetin e Kosovës që gjatë harmonizimit të legjislacionit me atë të Bashkimit European t'i merrë praktikën e mira të këtij shteti në këtë fushë, duke pasur parasysh faktin se shteti i Kosovës, e në veçanti ai Shqipërisë, kanë raporte të mira diplomatike dhe të fqinjësisë me Italinë.

Duke pasur parasysh faktin se shteti italian është përballë me krim të organizuar ngase ka prezent organizata të njohura kriminale siç janë: “Cosa Nostra” në Sicili, pastaj “Ndrangheta” në Kalibri¹⁸⁷, ekonomia e këtij vendi atakohet shpesh nga veprat penale në këtë fushë, andaj kjo situatë ka determinuar reforma në kodin e saj penal me qëllim të ndryshimit të politikës ndëshkimore për luftë të suksesshme kundër krimit në përgjithësi e në veçanti atij ekonomik.

Kodi penal i Italisë sikur edhe shumica e kodeve penale në rajon i ka kushtuar mbrojtje juridiko-penale me një rëndësi të veçantë, veprave penale në fushën e ekonomisë. Veprat penale kundër ekonomisë, Kodi Penal i Italisë, i vitit 1992, i ka rregulluar në kapitullin e shtatë në grup të veçantë me emërtimin “Krimet kundër ekonomisë kombëtare, industrisë dhe tregtisë”¹⁸⁸. Ky kod veprat penale kundër ekonomisë i ka rregulluar në dy pjesë: në krimet kundër ekonomisë kombëtare dhe krimet kundër prodhimit dhe tregtisë. Kodi Penal i Italisë ka paraparë këto vepra penale

187 Vlado. Kambovski, Kažneno- pravna reforma pred predizvicate na XXI vek, Pravni Fakultet Skopje, 2002, fq. 189.

188 Shih: Kodi Penal i Italisë i vitit 1992, nga neni 387 deri te neni 397. Marrë nga: <http://legislationline.org/documents/section/criminal-codes> (parë më 17.07.2014).

kundër ekonomisë kombëtare dhe atë:

- “Shkatërrimin e materialeve të papërpunuara, agro-kulturore ose industriale apo mjeteve të prodhimit” (neni 387),
- “Përhapja e sëmundjeve të bimëve dhe kafshëve” (neni 388),
- “ Rritja ose ulja mashtruese e çmimeve në tregun publik” (neni 389),
- ”Bllokimi dhe greva” (neni 390),
- “Uzurpimi i paautorizuar i ndërmarrjes agro-kulturore, industriale ose sabotimi” (neni 391) etj.

Nga përmbajtja e këtyre veprave penale mund të konstatojmë se kodi italian ka paraparë vepra që nuk janë të inkriminuar në Kodin Penal të Kosovës dhe gjithashtu ka vepra që janë të veçanta. Gjatë trajtimit të këtij grupi, të veprave penale kundër ekonomisë, nuk i kam hasur në asnjërin nga kodet penale të krahasuar në këtë kapitull si për shembull vepra penale “bllokimi dhe greva”, ku për këtë vepër penale ligjvënësi ka parapa dënim me gjobë për punëdhënësin dhe punëtorët. Kjo vepër penale ka inkriminuar veprimet kundër ekonomisë me karakter socialist apo shtetëror dhe në atë kohë ka pasur rëndësinë e saj. Ndërsa sot kujtoj se inkriminimi i kësaj veprë penale nuk mund të ketë rol të veçantë, për faktin se tani kemi kaluar në ekonominë e tregut të hapur dhe të lirë. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të këtyre veprave penale vërehet se ligjvënësi italian i ka kushtuar rëndësi të veçantë mbrojtjes penalo – juridike të veprave penale në sferën e agro-kulturës si degë e veçantë e ekonomisë. Por, ajo që e bën të dallohet nga Kodi Penal i Kosovës por edhe nga shumica e kodeve të shteteve evropiane është fakti që ai nuk ka paraparë në grupin e veprave penale kundër ekonomisë, veprat penale në fushën doganore si: “shmangia nga tatimi”, “kontrabandimi i mallrave”.

Në pjesën e dytë kodi italian ka inkriminuar veprat penale në fushën e prodhimit dhe tregtisë si veprën penale:

- “Shkelja e lirisë së prodhimit dhe tregtisë”, (neni 393),
- “Mastrimet kundrejt industrisë kombëtare”, (neni 394),
- “Mastrimet në veprimtarinë e tregtisë”, (neni 395),
- “Shitja e produkteve të pavërteta si të vërteta”, (neni 396),
- “Shitja e produkteve industriale me shenja të rrejshme”, (neni 397).

Gjatë krahasimit të këtyre veprave penale, në fushën e ekonomisë, vërehen ndryshime në emërtimin e veprave me Kodin Penal të Kosovës, por qëllimi i mbrojtjes penalo-juridik është i njëjtë, sepse ligjvënësi me kujdes të veçantë ka inkriminuar veprimet në fushën e prodhimit dhe tregtisë si dy sfera, nga të cilat varet shumë ekonomia dhe stabiliteti i sistemit financiar në vend. Sa i përket politikës ndëshkimore dënimet që mund t’i shqiptohen kryerëseve të këtyre veprave penale janë gjoba dhe dënimi me burg deri në 12 vite.

Kujtojmë se, kodi italian ka aplikuar standarde të larta në luftën kundër kriminalitetit ekonomik, pavarësisht që numri i veprave penale kundër ekonomisë kombëtare, industrisë dhe tregtisë është tejet i vogël. Ky grup i veprave penale në fushën e ekonomisë ka vetëm 11 vepra, të orientuar në tri fusha, të cilat pa dyshim janë ndër më të rëndësishmet për ekonominë kombëtare, andaj inkriminimi i veprimeve të drejtuara kundër këtij grupi është garanci për stabilitet ekonomik. Vlen të theksohet se legjislacioni italian është ndryshuar dhe plotësuar në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian.

4.2.5. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Kroacisë

Arsyeja përse kam vendosur që të krahasoj legjislacionin penal, kodet penale në fushën e ekonomisë, për të gjitha shtetet e ish-Federatës Jugosllave, duke përfshirë Kroacinë dhe Slloveninë si anëtare tani të Bashkimit Evropian, qëndron për faktin që të gjitha këto shtete duke përfshirë edhe Kosovën, për një kohë të gjatë, deri në shkatërrimin e Jugosllavisë në vitet e nëntëdhjeta kanë pasur në zbatim edhe legjislacionin penal të ish RSFJ-së.

Kjo situatë nuk ka penguar që secila nga republikat e kësaj federate të kenë edhe legjislacionin e tyre penal por të bazuar në atë federativ. Andaj krahasimi i legjislacionit të këtyre vendeve e posaçërisht ai i shtetit slloven dhe kroat do të ndihmonin shtetet e tjera të Ballkanit si Kosovën, Serbinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Bosnjë e Hercegovinën me praktikën e mira gjatë reformave në legjislacionin penal, në fushën e ekonomisë, që ka treguar rezultate konkrete në zhvillimin e ekonomive të tyre dhe luftën e suksesshme ndaj korrupsionit dhe dukurive negative. Një arsye tjetër ka qenë edhe një mundësi e mirë për t'u pajisur me literaturë dhe informata të nevojshme për këtë punim doktore. Kodi Penal i Kroacisë, i miratuar në vitin 2011, e që ka filluar të zbatohet nga viti 2013, ka paraparë standardet e larta ndërkombëtare dhe konsiderohet ndër ligjet më bashkëkohore. Kodi kroat i ka sistemuar veprat penale në fushën ekonomike si grup në vete me emërtim të ri “veprat penale kundër ekonomisë” në kapitullin XXIV nga neni 246 e deri te ai 265¹⁸⁹. Nëse e krahasojmë me Ligjin Penal të Kroacisë të vitit 1997, ky grup i veprave penale ndryshonte si në përmbajtje ashtu edhe në emërtimin e tyre. Kodi Penal i vitit 1977, këto vepra i kishte paraparë si “veprat

189 Shih: Kodi Penal i Republikës së Kroacisë, i vitit 2011, (Gazeta zyrtare me nr. 124/11). Marrë nga: http://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2011_11_125_2498.html (parë më 10.06.2014)

penale kundër sigurisë në qarkullimin financiar dhe afarist”¹⁹⁰. Duke pasur parasysh faktin që Kodi Penal i Kroacisë është hartuar plotësisht në përputhje me standardet dhe direktivat e Bashkimit Evropian, ka arritur që në një masë të madhe të rregullojë dhe inkriminojë veprimet kriminale në fushën ekonomike, duke paraparë edhe politika ndëshkimore të larta për këto vepra penale dhe atë: dënime me gjobë dhe burgim deri në 10 vjet, pastaj ka paraparë konfiskimin e pasurisë të fituar me vepër penale. Ligjvënësi kroat ka ndëshkuar edhe tentativën për ta kryer veprën penale për disa nga veprat e parapara shprehimisht me ligj. Ndërsa, nëse e krahasojmë politikën ndëshkimore me atë të vendit tonë shohim se sanksionet penale që i ka paraparë Kodi Penal i Kosovës për këto vepra sa i përket dënimit me burgim janë më të larta sepse për disa nga veprat penale parashihet dënimi deri në 12 vjet burg. Mendoj që Ligji Penal i Kroacisë është përcaktuar për privimin nga liria vetëm në masën sa është e domosdoshme për ekzekutimin e sanksioneve penale në pajtim me ligjet pozitive në fuqi dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.¹⁹¹

Vlen të theksohet fakti që ligji Penal Kroat ka paraparë disa vepra si “detyrimi për mbajtjen e librave të biznesit” vepër të cilën Kodi Penal i Kosovës nuk e inkriminon dhe nuk e ka në kuadër të veprave penale kundër ekonomisë, pastaj veprën penale “Keqpërdorimi i prokurimit publik” që sipas kodit kroat sanksioni penal për këtë vepër është paraparë deri në 10 vite burg. Gjatë krahasimit shihet se këtë vepër penale e ka paraparë edhe Kodi Penal i Kosovës me emërtimin “Marrëveshja për kufizimin, konkurrencën, përmes ftesave për tender”, dënimi sipas Kodit Penal të Kosovës parashihet deri në 5 vite.

190 Shih: Ligji Penal i Republikës së Kroacisë, (Gazeta zyrtare nr. 110/1997, kreu XXI. Marrë nga: http://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/1997_10_110_1668.html (parë më 10.06.2014).

191 Mr.sc. Sadiku. Isuf, Ekzekutimi i sanksioneve penale në dritën e akteve më të reja ndërkombëtare, botuar nga autori, Prishtinë, 2010.

Vlen të theksohet fakti se tani në grupin e veprave penale kundër ekonomisë nuk është paraparë vepra penale “krijimi i kushteve monopoliste në treg”, që e kishte Ligji Penal i vitit 1997, ndërsa tani këtë vepër penale e ka paraparë Kodi Penal i Kosovës në fuqi në (nenin 301), për dallim që Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës nuk e kishte paraparë në kuadrin e vet. Me gjithë ndryshimet pozitive, që i ka Ligji Penal i Kroacisë, si ligji më bashkëkohor, nga përmbajtja e tij shihet se në kuadër të kapitullit të veprave penale kundër ekonomisë nuk e ka përfshirë “kontrabandimin e mallrave”, ndërsa “Falsifikimin e parasë” dhe “Falsifikimin e letrave me vlerë” i ka inkriminuar në kapitull të veçantë dhe grup të veçantë të veprave penale, që ndryshon nga Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012, që këto vepra i ka sistemuar në grupin e veprave penale kundër ekonomisë. Kodi Penal i Kroacisë mendoj se ka vendosur standarde të larta në luftimin e veprimeve kriminale, në fushën e ekonomisë, me gjithë plotësimet dhe ndryshimet e bëra në frymën e standardeve ndërkombëtare ka trashëguar dispozita ligjore nga legjislacioni penal i ish-Jugosllavisë.

4.2.6. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit penal të Sllovenisë

Krahasimi i Kodit Penal të Sllovenisë është bërë me qëllim që të shihet qartë rruga e ndryshimeve demokratike, që ka pasur ky shtet, duke u bërë pjesë e familjes europiane, pa marrë parasysh faktin që ishte pjesë e ish-federatës jugosllave, ku një pjesë e republikave tjera ende janë në fillim të rrugës të aderojnë në këtë familje. Gjithashtu, do të ishte me interes të shihet se si i ka rregulluar Kodi Penal Slloven veprat penale kundër ekonomisë, e cila është politika ndëshkimore dhe sa ka qenë ndikimi i faktorit ndërkombëtar për ndryshimet e bëra.

Kodi Penal i Sllovenisë në kapitullin 24, i ka paraparë 26 lloje të ndryshme të veprave penale kundër ekonomisë, të cilat i ka sistemuar në kaptinë të veçantë. Gjatë trajtimit të këtyre veprave penale vërehet qartë ndikimi që ka pasur legjislacioni penal i RSFJ-së, siç është vërejtur edhe me rastin e trajtimit të veprave penale dhe ligjeve penale të vendeve tjera që ishin pjesë e RSFJ-së. Për dallim nga shtetet e tjera të Ballkanit, Sllovenia ka treguar një gatishmëri të lartë për ta luftuar veprimtarinë kriminale në fushën e ekonomisë.

Kodi Penal i Sllovenisë përmban këto vepra penale kundër ekonomisë¹⁹² si:

- “Keqpërdorimi i pozitës së monopolit”,
- “Mashtrimi i kreditorëve”,
- “Mashtrimi i letrave me vlerë”,
- “Komunikimi i paautorizuar i sekretit tregtar”,
- “Falsifikimi i parasë”,
- “Shpëlarjen e parasë dhe evazionin fiskal”,
- “Kontrabanda”.

Gjatë krahasimit të veprave penale kundër ekonomisë, sipas Kodi Penal të Sllovenisë, vërehet se ka shumë ngjashmëri, por ka edhe dallime që vlen të përmenden jo vetëm në përmbajtje, por edhe në llojin dhe numrin e tyre. Kodi Penal i Kosovës, i vitit 2012, ka paraparë 34 lloje të veprave penale¹⁹³, që disa prej këtyre veprave si: “Cenimi i të

192 Shih: Kodi Penal i Sllovenisë i vitit 2004 (Gazeta zyrtare e R S), nga neni 225 deri më 250. Marrë nga <http://legislationline.org/documents/section/criminal-codes> (25.8.2014).

193 Shih Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012 (Gazeta zyrtare e R së Kosovës nr. 19/13) kapitulli XXV.

Shih më gjerësisht në www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Kodi%20penal.pdf (Parë më 2.3.2014).

drejtës së patentës”, “Cenimi i të drejtës së autorit”, “Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm”, “Tregtia e ndaluar”, “Prodhimi i ndaluar”, “Marrëveshja dhe mashtrimi me letrat e qeverisë”, janë disa nga veprat penale që nuk i ka paraparë ligjvënësi slloven, në kapitullin e veprave penale kundër ekonomisë. Nëse e vështrojmë në aspektin e politikës ndëshkimore mund të konstatojmë se dënimet e parapara për vepra penale kundër ekonomisë, sipas Ligjit Penal të Sllovenisë janë të larta. Ligji parasheh dënime me gjobë dhe me burg deri në 12 vite, për shembull për veprën penale “Evazioni fiskal”, dënimi me burg është paraparë deri në 12 vite burg për kryerësin, ndërsa për veprat penale “Falimentimi”, “Falsifikimi dhe shpërlaja e parave” deri në 10 vjet burg. Ligjvënësi slloven me të drejtë ka paraparë këto dënime të larta për këto vepra, duke pasur parasysh që ekonomia e vendit të ruhet nga falimentimi dhe veprat që kanë ndikim në destabilizimin e ekonomisë së vendit apo më mirë të themi që e varfërojnë buxhetin e vendit dhe që ndikojnë në rritjen e informalitetit dhe krimit ekonomik.

4.2.7. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Maqedonisë

Maqedonia njihet si shteti i cili që nga braktisja e kodit penal të vjetër të vitit 1977, ka pasur ndryshime shumë të shpeshta të kodit penal. Ndryshimet e mëdha në legjislacionin penal kanë filluar me reformat e viteve të nëntëdhjeta¹⁹⁴. Ndryshimet në kodin penal të vitit 1996 ishin bërë edhe në grupin e veprave penale “financat publike dhe pagesat në ekonomi”. Andaj, krahasimi i Kodit Penal të Maqedonisë me kodet e tjera penale të shteteve të dala nga ish-Jugosllavia do të ishte me interes për të parë

194 Dr. Kambovski. Vlado, Kažneno - pravната reforma pred predizvicite na XXI vek, Pravni Fakultet Skopje, 2002, fq. 339.

përse ky shtet ka pasur ndryshime të shpeshta të kodit penal dhe cilat janë arsyet, si i ka sistemuar veprat penale kundër ekonomisë, cila është politika ndëshkimore dhe sa e ka në harmoni, legjislacionin me atë të Bashkimit Evropian.

Kodi Penal i Maqedonisë i vitit 1996, me ndryshimet dhe plotësimet e vitit 2004, sikurse edhe shumica e kodeve penale të krahasuar i ka kushtuar kujdes të veçantë ekonomisë së vendit duke i dhënë mbrojtje penalo-juridike veprave penale kundër ekonomisë. Edhe Kodi Penal i Maqedonasë, veprat penale kundër ekonomisë i ka sistemuar në grup të veçantë të veprave penale, në kreun e njëzetepes, të emërtuara si: “Veprat penale kundër financave publike, qarkullimit pagësor dhe ekonomisë”¹⁹⁵.

Kodi Penal i Maqedonisë ka paraparë 17 vepra penale kundër ekonomisë nga neni 268 e deri te ai 287. Gjatë krahasimit të veprave penale të parapara në këtë kod vërehet një inkriminim më i varfër i veprimtarisë kriminale në ekonomi

Edhe pse në këtë grup të veprave penale janë paraparë veprat penale që atakojnë tri fusha dhe atë: veprat penale kundër “financave publike, qarkullimit pagësor dhe ekonomisë”, vërehet se ky kod ka lënë jashtë këtij kapitulli edhe shumë vepra tjera penale, të cilat konsideroj se e kanë vendin pikërisht në kapitull të veprave penale kundër ekonomisë, si për shembull vepra penale “shpëlarja e parasë”, “evazioni fiskal”, “mashtrimi i kreditorëve dhe blerësve”etj. Ndërsa sa i përket politikës ndëshkimore ky kod ka paraparë, dënimin me gjobë dhe burgim. Dënimin më të lartë që ligjvënësi maqedonas ka paraparë për këto vepra penale është dënimi me burg deri në 10 vite.

Veprat që i ka paraparë Kodi Penal i Maqedonisë janë paraparë edhe në Kodin

195 Shih: Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare nr.37/96), botuar më 29 korrik 1996). Marrë nga <http://www.pravda.gov.mk/documents/KRIVICEN%20ZAKONIK%20precisten%20%20tekst.pdf> (Parë më 30.8.2014).

Penal të Kosovës, të vitit 2012 dhe Kodit Penal të Përkohshëm të Kosovës, të vitit 2004. Mendoj që për dallim nga shumë shtete, por edhe Kosovës që kanë ndërtuar legjislacion bashkëkohor që garanton luftë të suksesshme kundër kriminalitetit ekonomik, Ligji Penal i Maqedonisë, sipas mendimit tim, nuk i plotëson kriteret e një ligji bashkëkohor, ngase është i ndikuar dhe i orientuar në luftimin e ekonomisë së centralizuar, që ka lindur si pasojë për shkak të ndikimit të madh që ka pasur legjislacioni penal i ish-Jugosllavisë.

4.2.8. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Serbisë

Kodi Penal i Republikës së Serbisë, veprat penale kundër ekonomisë, i ka paraparë në kreun njëzet e dy si grup të veçantë të sistemuar nga neni 223 e deri te ai 245¹⁹⁶. Ligjvënësi serb ka inkriminuar veprat penale kundër ekonomisë, në 25 lloje, duke qenë ligji i dytë në rajon, pas atij të Kosovës, të vitit (2012), për nga numri i veprave penale të inkriminuar në fushën e ekonomisë. Sikur shumica e ligjeve të rajonit edhe ky ligj penal i ka kushtuar kujdes të rëndësishëm mbrojtjes juridiko-penale nga veprat penale kundër ekonomisë.

Në vazhdim po paraqes disa vepra penale që i ka Kodi Penal i Serbisë¹⁹⁷, kundër ekonomisë e që janë të inkriminuar edhe në Kodin Penal të Kosovës siç janë:

- “Falsifikimi i parasë”,
- “Falsifikimi i letrave me vlerë”,
- “Shpëlarja e parasë”,

196 Shih: Kodi Penal i Republikës së Serbisë, i vitit 2012, (Gazeta zyrtare nr. 121/2012). Marrë nga <http://legislationline.org/documents/section/criminal-codes> (Parë më 27.8.2014).

197 Ibid.

- “Keqpërdorimi i pozitës së monopolit”,
- “Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi”,
- “Tregtia e ndaluar”, etj.

Këto vepra penale të specifikuara më lart gjenden në të gjitha ligjet penale bashkëkohore, të cilat janë hartuar, bazuar në standarde të kërkuara nga Bashkimi Evropian. Gjatë analizimit të dispozitave ligjore të këtij ligji penal shihet se ai është krijuar nga ndikimi i drejtpërdrejtë i Ligjit Penal të RSFJ-së¹⁹⁸, e cila praktikë i ka përcjellë edhe republikat e tjera të ish-RSFJ-së. Në aspektin e politikës ndëshkimore ligjvënësi serb është përcaktuar për dënime tejet të ashpra. Dënimet e parapara për këto vepra penale janë dënimi me gjobë dhe burg, pra dënime kumulative.

Kodi Penal i Serbisë, ka paraparë konfiskimin e pasurisë në rastet e parapara shprehimisht me ligj. Dënimi më i lartë me burg, në kuadër të këtij grupi të veprave penale, është paraparë për veprën penale “Falsifikimi i parasë”, sidomos për mënyrën e kualifikuar të kryerjes deri në pesëmbëdhjetë vjet burg dhe dënimi me gjobë.

Gjatë krahasimit të këtij ligji, duke parë anët pozitive dhe negative të tij, mund të konstatojmë se ligji në fjalë ka arritur një përparim të theksuar në inkriminimin e veprave penale kundër ekonomisë, por kujtoj se ende nuk i plotëson standardet e një ligji bashkëkohor, i cili do të garantojë sukses në luftën kundër kriminalitetit ekonomik e në veçanti kundër evazionit fiskal.

198 Shih: Ligji Penal i RSFJ-së, i vitit 1997.

4.2.9. Veprat penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Bosnjës e Hercegovinës

Kodi Penal i Bosnjës e Hercegovinës, veprat penale kundër ekonomisë i ka parashikuar si grup në vete në kapitullin e tetëmbëdhjetë¹⁹⁹ me emërtimin “Veprat penale kundër ekonomisë së tregut unik dhe veprat penale në fushën e doganave”. Ky kod, në kuadër të këtij grupi të veprave penale, ka paraparë pesëmbëdhjetë lloje të vepra penale, të sistemuar nga neni 202 e deri te ai 216²⁰⁰.

Duke pasur parasysh këtë numër të veprave penale që është relativisht në numër i vogël, përmes të cilave pretendohet të luftohet kriminaliteti ekonomik në një vend që ka dalë nga lufta me shkatërrime të mëdha dhe me një prezencë të madhe të kriminalitetit në fushën ekonomisë, konsideroj se nuk i plotëson standardet e një ligji bashkëkohor që siguron stabilitet ekonomik dhe fiskal në Bosnjë e Hercegovinë.

Gjatë krahasimit të Ligjit Penal të Bosnjë e Hercegovinës shohim përafërsisht se edhe ai si shumica e ligjeve bashkëkohore për ta ruajtur ekonominë e vetë nga kriminaliteti ekonomik, ka inkriminuar këto vepra penale dhe atë:

- “Falsifikimin e parasë”,
- “Falsifikimin e letrave me vlerë”,
- “Mospagesën e tatimit”,
- “Shpërlarjen e parave”,

199 Shih: Kodi Penal i Bosnjë e Hercegovinës i vitit 2003, (Fletorja zyrtare e B. e H. nr. 37/2003). Marrë nga <http://legislationline/documents/section/criminal-codes> (Parë më 20.8.2014).

200 Ibid.

- “Shmangien nga tatimi”²⁰¹ etj.

Nëse e krahasojmë me veprat penale të inkriminuar në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012, në këtë ligj mungojnë shumë vepra penale si: “Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm”, Vepra penale “Mashtrimi në procedurën e falimentimit”, “Keqpërdorimi i pozitës së monopolit”, etj. Natyrisht që nuk ka dyshim se inkriminimi i këtyre veprave penale e rendit Kodin Penal të Kosovës në grupin e shteteve që kanë legjislacion me standarde të larta, që garanton sukses në luftën kundër kriminalitetit ekonomik. Sa i përket politikës ndëshkimore ky ligj ka paraparë dënimin me gjobë dhe burg për kryerësit e veprave penale. Dënimi më i latë që parasheh ky ligj është 10 vjet burg. Ligji parasheh konfiskimin e mjeteve dhe pasurisë që është krijuar me vepër penale. Gjatë shqyrtimit të Ligjit Penal të Bosnjë e Hercegovinës vërehet se si të gjithë ligjet penale, të ish-republikave të ish-Jugosllavisë, nuk kanë arritur të lirohen nga ndikimet që ka lënë Ligji Penal i RSFJ-së i vitit 1977, me gjithë ndryshimet pozitive në frymën e standardeve, që i kërkon bashkësia ndërkombëtare.

4.2.10. E Drejta Penale e Këshillit të Evropës në fushën ekonomike

Me qëllim që krahasimi i legjislacionit penal të jetë më i plotë dhe të shihet se shtetet e krahasuara në këtë punim doktrate a e kanë hartuar legjislacionin e tyre, bazuar në legjislacionin penal të dy organizatave evropiane Bashkimit European dhe Këshillit të Evropës, në fushën e ekonomisë, janë bërë përpjekje të analizohen edhe disa nga instrumentet - konventat ndërkombëtare për të parë se si e kanë rregulluar këtë

201 Shih: Kodin Penal i Bosnjë e Hercegovinës i vitit 2003, (Fletorja zyrtare e B. e H. nr. 37/2003), nga neni 202 deri te ai 216. Marrë nga <http://legislationline/documents/section/criminal-codes> (Parë më 20.8.2014).

fushë, a janë ratifikuar nga shtetet nacionale dhe a janë pjesë e legjislacionit nacional.

Në ditët e sotme krahas të Drejtës Penale të çdo shteti ekziston edhe e Drejta Penale Ndërkombëtare, e cila nga praktika zgjedh të gjitha çështjet penale, të cilat kalojnë kufijtë kombëtarë të vendeve dhe dalin në planin ndërkombëtar. Andaj, shtetet anëtare të Këshillit të Evropës²⁰², kanë justifikuar krijimin e së Drejtës Penale Evropiane si nevojë e domosdoshme për ta luftuar kriminalitetin në përgjithësi edhe atë në fushën ekonomike. Fakt tjetër që determinon zhvillimin e mëtutjeshëm të legjislacioni penal evropian është efikasiteti në zgjidhjen e rasteve penale, në aspektin rajonal. Ideja për ta bërë Evropën një vend të përbashkët ekonomik kishte filluar që në vitet e 50-ta nga ideatori R. Schuman por ajo ide u realizua me miratimin e Traktatit të Romës, me të cilin krijohet Komuniteti Ekonomik Evropian²⁰³. Traktati krijoi tregun e përbashkët, duke hequr tarifat doganore dhe duke krijuar lëvizje të lirë të kapitalit. Sot Këshilli i Evropës ka krijuar legjislacion penal në shumë sektorë por ne do të trajtojmë vetëm atë në fushën e kriminalitetit ekonomik. Kjo organizatë sot numëron mbi 200 traktate evropiane dhe mbi 25 konventa dhe instrumente tjera gjyqësore, që kanë për qëllim të ndihmojnë bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në fushën penale²⁰⁴.

Në vazhdim po paraqesim disa nga instrumentet e bashkëpunimit penal të Këshillit të Evropës në fushën e kriminalitetit ekonomik²⁰⁵ si:

- Konventa mbi pastrimin, zbulimin, sekuestrimin dhe të mirave materiale të

202 Këshilli i Evropës u krijua më 5 maj 1949 në Londër, gjithsej ka 47 shtete anëtare, ndërsa Shqipëria u bë anëtare e kësaj organizate në vitin 1994.

203 Nënshkrimi i traktatit për komunitetin ekonomik në Romë, më 25.7.1957. Marrë nga Online Education Center <http://www.dadalos-europe.org/alb> (Parë më 1.9.2014).

204 Hoxha. Artan, *Ekstradimi dhe urdhri evropian i ndalimit*, "Morava", Tiranë, 2011, fq. 117.

205 Jean. Pardel, Geert. Corstens & Gert. Vermeulen, *E drejta penale evropiane*, botimi Papiruse, Tiranë, 2009, fq. 54.

fituara nga krimi, nënshkruar në Strasburg, më 8 nëntor 1990, hyri në fuqi më 1 shtator 1993.

- Konventa e Këshillit të Evropës mbi pastrimin, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të mirave materiale të fituara nga krimi dhe mbi financimin e terrorizmit, e nënshkruar në Varshavë, më 16 maj 2005.

- Konventa penale mbi korrupsionin, nënshkruar në Strasburg, më 15 maj 2003, hyri në fuqi më 1 shkurt 2005.

Deri në vitin 1957 për veprat penale në fushën financiare, doganore, këmbim valute nuk lejohej ekstradimi si formë e ndërsjellë e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale, por e drejta evropiane tani njeh institutin e ekstradimit në rastet kur personat kryen vepra penale në fushën e ekonomisë, si mospagimi i taksave doganore, taksave dhe tatimeve pastaj veprave penale në fushën financiare lejohet ekstradimi i këtyre personave me kusht që të respektohet neni 5 i konventës për ekstradim, të vitit 1957, ku sipas saj kërkohet paraprakisht marrëveshja ndërmjet shteteve anëtare për këtë kategori veprash që të jetë i mundur ekstradimi.

Këshilli i Evropës, duke parë që sot kriminaliteti ekonomik është sfidues për të gjitha vendet e botës, ka ndërmarrë hapa konkretë në legjislacionin penal, ashtu që ka ndryshuar nenin 5, të konventës për ekstradim, me protokollin e dytë shtesë, të Konventës të miratuar në mars 1978, ku ka paraparë citojmë: “Në fushën e taksave dhe tatimeve, të doganave dhe të këmbimit ekstradimi do të autorizohet nga shtetet anëtare, në përputhje me dispozitat e Konventës”. Në bazë të këtij neni ekstradimi zbatohet pavarësisht marrëveshjeve të shteteve anëtare me kusht që të ekzistojë parimi i inkriminimit të dyfishtë, të vërtetohet vepra e dyshuar dhe të përmbushet kriteri i

kohëzgjatjes së maksimumit dhe minimumit për veprën penale.

Pra, tani komuniteti evropian ka braktisur parimin se kryerësit e veprave penale në fushën ekonomike nuk mund të ekstradohen, por ekstradimi është bërë i detyrueshëm dhe nuk mund të refuzohet për faktin se një shtet në legjislacionin e tij nuk ka paraparë llojin e njëjtë të taksave dhe tatimeve dhe veprave në fushën e doganave dhe këmbimit.

4.2.10.1. Disa aspekte normative nga Konventa mbi pastrimin, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit (Strasburg, 1990)

Fillimisht është menduar se Konventa mbi pastrimin, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit e vitit 1990, ka të bëjë me të gjitha krimet, por realisht kjo ka të bëjë vetëm me krimet që sjellin përfitime financiare, ndërsa ne do të shtjellojmë vetëm çështjen e pastrimit të parave, si vepër penale e inkriminuar në legjislacionin nacional dhe ndërkombëtar në fushën ekonomike.

Konventa u krijua si rezultat i punës, që u bë në dy konferencat ad hoc të mbajtura në Strasburg, më 1983 dhe 1985, dhe Konferencës së Ministrave Evropian të Drejtësisë, të mbajtur në Oslo, më 1986. Qëllimi i konferencave ishte krijimi i një bashkëpunimi në ndjekjen e një politike penale të përbashkët kundër pastrimit të parave dhe konfiskimin e produkteve nga krimi dhe krijimin e normave dhe parimeve për konfiskimin e pasurive të krijuara me veprimtari kriminale. Konventa u miratua në shtator 1990 nga Komiteti i Ministrave dhe u hap për nënshkrim në tetor 1990²⁰⁶.

Synimi i Konventës ishte plotësimi i instrumenteve ndërkombëtare të Këshillit të

206 Shih Raporti shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës mbi pastrimin, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit, e vitit 1990, nr. 1 deri 7. Marrë nga: <http://www.conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/Html/198.htm> (parë më 13.8.2014).

Evropës dhe ajo përshkruan masat që duhet të ndërmerren në shkallë kombëtare për konfiskimin, hetimin dhe teknikat e hetimit, aktet ligjore, ndihmën e ndërsjellë gjyqësore, transmetimin e informacioneve, ekzekutimin e konfiskimit. Konventa gjithashtu kishte për qëllim rregullimin e çështjeve dhe letërporosive penale dhe së fundi procedurën e veprimeve hetimore dhe provave. Nga kjo rrjedhë se Konventa nuk kishte për qëllim zbulimin dhe konfiskimin e pasurive, të cilat mund të konfiskohen më vonë²⁰⁷.

Neni 8 i Konventës nuk e përjashton ndihmën e ndërsjellë në zbulimin dhe sekuestrimin e pasurive, që dalin nga rezultati i krimit. Synimi i tretë i përpilueseve të Konventës ishte detyrimi i shteteve që në legjislacionet e tyre kombëtare të parashohin masa të rrepta kundër kriminalitetit të rëndë dhe konfiskimin e pasurive, si çështje diskutuese. Në Kosovë, vazhdimisht Bashkësia Ndërkombëtare është duke bërë presion që organet e drejtësisë të jenë më efikas në çështjen e konfiskimit të pasurisë që është fituar si rezultat i veprës penale. Në nenin 6 parashihet Inkriminimi i pastrimit të parave, ku sipas këtij neni të gjitha shtetet janë të obliguara të inkriminojnë veprimet që kanë të bëjnë me pastrimin e parave, pastaj transferimin e të mirave materiale nga personat që e dinë se ato vijnë si rezultat i veprimeve kriminale dhe që kanë për qëllim të fshehin prejardhjen e paligjshme të investimeve, pronësisë mbi sendet. Gjithashtu është kërkuar edhe inkriminimi i veprimeve për blerjen, përdorimin dhe mbajtjen e të mirave materiale të krijuara me vepër penale²⁰⁸.

207 Jean. Pardel, Geert. Corstens & Gert. Vermeulen, *E drejta penale evropiane*, botimi Papirus, Tiranë, 2009, fq. 180.

208 Lexo raportin shpjegues të Konventës së Këshillit të Evropës mbi pastrimin, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit e vitit 1990 , nr. 18. Marrë nga <http://www.conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/Html/198.htm> (parë më 13.8.2014).

Nga aspekti hetimor sipas nenit 4 secila palë ka të drejtë të ndërmarrë hapa ligjorë për t'i mundësuar organeve shtetërore të bëjnë “dërgimin ose bllokimin e dosjeve bankare, financiare ose tregtare”. Ky nen nuk ia jep mundësinë asnjërës palë të kundërshtojë zbatimin në emër të sekretit tregtar apo diçkaje tjetër. Shtetet janë të lira të zhvillojnë procedura hetimore të veçanta për të siguruar prova të nevojshme për zbulimin e çështjeve që kërkohen. Në kuadër të këtyre masave janë: urdhri për mbikëqyrjen e llogarive bankare, masat e fshehta teknike - përgjimet telefonike apo kompjuterike, vëzhgimet e ndryshme, kontrollet e dokumenteve etj. Masat e tilla mund të jenë të përhershme sipas nenit 2.1 të konventës. Shtetet janë obligative të krijojnë mekanizma për konfiskimin e të mirave materiale, të krijuara nga aktiviteti kriminal, ndërsa masat e përkohshme hetimore janë paraparë në nenin 3, ku identifikohen të gjitha sendet që duhet konfiskuar që janë produkt i veprës penale me qëllim të pengimit për transferim apo tjetërsimin e tyre. Në aspektin e bashkëpunimit ndërshtetëror për pastrimin e parave, shtetet zbatojnë dy parime: Parimi i parë është se shtetet sipas nenit 7 vendosin bashkëpunimin ndërmjet tyre për hetimin dhe procedurat e konfiskimit të instrumenteve dhe produkteve²⁰⁹, ndërsa parimi i dytë sipas nenit 8 është se shtetet ndihmojnë njëri-tjetrin në identifikimin e sendeve dhe të mirave materiale që duhet të konfiskohen.

Risi e bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën penale të Këshilli të Evropës është paraparë në nenin 10, ku një shtet mund t'i komunikojë shtetit tjetër informata për sendet apo produktet që duhet konfiskuar me qëllim që ai pasi të marrë informatat të zhvillojë procedurë hetimore pa bërë fare kërkesë edhe pse parimisht këto informata

209 Shiko raportin shpjegues të Konventës së Këshillit të Evropës mbi pastrimin, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit të vitit 1990 nr. 35. Marrë nga: <http://www.conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/Html/198.htm> (parë më 13.8.2014).

shtetet i japin vetëm pas kërkesës së një shteti²¹⁰. Konfiskimi është i paraparë në nenin 14 dhe 15, legjislacioni që merret për bazë në këtë rast është ai i shtetit të kërkuar (lex fori), kjo është rregull ndërkombëtare. Pra, nga shtjellimi i disa aspekteve penale të kësaj konvente me theks të veçantë inkriminimin e pastrimit të parasë shihet se kjo vepër penale është inkriminuar në të gjitha legjislacionet nacionale të shteteve dhe në legjislacionin ndërkombëtar.

Sa i përket regjimit të konfiskimit, Kosova edhe pse nuk është anëtare e Këshillit të Evropës ka arritur standarde të larta ndërkombëtare në legjislacionin e saj penal, por ka ngecur në zbatimin praktik të legjislacionit penal sidomos në konfiskimin e pasurisë dhe produkteve të fituara nga kriminaliteti për të cilën çështje është potencuar edhe në raportin e progresit për Kosovën.

4.10.2. Disa aspekte të Konventës Penale mbi korrupsionin (1999) dhe protokollet e saj shtesë (2003)

Korrupsioni, si dukuri negative në të gjitha format që paraqitet, ai paraqet plagën më të rëndë për sistemin ekonomik të çdo vendi e posaçërisht në vendin tonë. Në këtë drejtim për ta inkriminuar këtë vepër penale ka pasur përkushtim të veçantë edhe Këshilli i Evropës, ashtu që më 27 janar 1999, ka nënshkruar Konventën Penale kundër Korrupsionit me nr. 173, e cila hyri në fuqi më 1 shkurt 2005, e plotësuar me protokollin shtesë të Strasburgut më 15 maj 2013. Grupi i shteteve kundër korrupsionit-GRECO-, përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, ka paraqitur 20

²¹⁰ Po aty, shiko raportin shpjegues nr. 38.

parime bazë se si duhet të luftohet korrupsioni²¹¹, të cilat parime u miratuan me anë të rezolutës nr.(97) 24, më 6 nëntor 1997.

Konventa kishte për qëllim të kërkojë nga shtetet që të unifikojnë legjislacionin e tyre të brendshëm me këtë akt ndërkombëtar, duke lehtësuar dukshëm bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit në atë mënyrë që të ndalin: zyrtarët e administratës publike, anëtarët e asambleve kombëtare dhe ndërkombëtare, funksionarët publikë kombëtarë e ndërkombëtarë, gjyqtarë dhe shumë persona të tjerë në detyrë që shfrytëzojnë rastin, qoftë përmes korrupsionit aktiv ose pasiv të sigurojnë favore për vete ose për të tjerët. Në këtë drejtim është kërkuar nga shtetet të krijojnë me ligje struktura të specializuara që do të merren vetëm me gjykimin e çështjeve të tilla, ngase krimi i organizuar është sofistikuar shumë dhe për ta luftuar këtë dukuri duhen njerëz me përgatitje profesionale.

Vlen të përmendet fakti që kjo konventë ka rregulluar çështjen e korrupsionit edhe në sektorin privat. Këtyre veprave i bashkëngjiten edhe pastrimi i pasurive të krijuara me korrupsion, krijimi i dokumenteve të rreme përmes kontabilitetit. Konventa, gjithashtu, ka paraparë bashkëpunimin e shteteve për hartimin e masave kur vepra penale kryhet në territorin e tyre këtu hyjnë teknikat speciale të hetimi lidhur me sekuestrimin e dosjeve bankare, fiskale ose tregtare²¹². Neni 26 i Konventës parasheh bashkëpunimin ndërshtetërorë dhe ajo “duhet të jetë sa më e gjerë që të jetë e mundur”. Por nga ky rregull ka përjashtim shteti nuk e zbaton kërkesën në qoftë se i cenohet sovraniteti kombëtar apo siguria kombëtare. Nga vështrimi problemet më të mëdha të shtetet paraqiten të rasti i sekreteve bankare, ku në raste të caktuara kërkohet edhe

211 Rakipi. Arben, *Korrupsioni & evazioni fiskal*, Shtypshkronja ”Klean”, Tiranë, 2003, fq. 11.

212 Jean. Pardel, Geert. Corstens & Gert. Vermeulen, *E drejta penale evropiane*, botimi Papirus 2009, Tiranë, fq. 195.

vendimi i gjyqtarit apo prokurorit për një çështje të tillë. Kodi ynë penal ka paraparë veprat penale që klasifikohen si korrupsion në kapitullin XXXIV²¹³ dhe i ka emërtuar “veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare” nga neni (422 e deri te ai 437).

Nga pamundësia për të analizuar të gjitha dispozitat e cekura më lart vërejmë se përkufizimet për veprat penale të korrupsionit, të dhëna nga Konventa Penale për Korrupsion, janë pothuaj plotësisht të njëjta me Kodin Penal të Kosovës. Kodi përdor emërtimin person zyrtar²¹⁴, që nënkupton të gjithë zyrtarët që ushtojnë detyra publike për dallim nga Konventa që përdor termin “zyrtar në shërbimin publik”, që për mendimin tim është plotësisht e njëjtë. Nga kjo dispozitë shohim që legjislacioni ynë penal ka lënë jashtë kësaj përgjegjësie personat në sektorin privat, kujtoj se në të ardhmen duhet të inkriminohen edhe veprimet e tyre. Legjislacioni i Kosovës njeh korrupsionin e nivelit të lartë dhe kjo vepër ekziston atëherë kur në të janë përfshirë zyrtarë të lartë shtetërorë si: Presidenti, kryeparlamentari, kryeministri dhe ministrat, kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët etj.

4.11. E Drejta Penale e Bashkimit European në fushën ekonomike

Përzgjedhja për të krahasuar të Drejtën Penale të Bashkimit European, qëndron në rendësinë që ka kjo organizatë në integrimin e Kosovës në këtë familje. BE ka qenë dhe mbetet aktive në Kosovë në mënyra të ndryshme përmes: Misionit të EULEX-it,

213 Shih: Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012.

214 Shih: Kodi Penal i Kosovës në fuqi në nenin 120, ku jep përkufizimin e personit zyrtar, në pikën 2.1, ku thuhet person i zgjedhur ose i emëruar në një organ shtetëror, 2.2. person i autorizuar në një organ shtetëror, organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik, i cili sipas ligjit apo ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë nga ligji, ushtron detyra të posaçme dhe 2.3. personi që ushton detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimeve të dhëna me ligj.

Komisionit Evropian, Agjencisë Evropiane për Rindërtim (AER)²¹⁵. Gjithashtu edhe Kosova ka krijuar mekanizma që bashkëpunojnë me BE-në, siç janë: Komisioni Parlamentar për Integritet Evropian, Qendra Qeveritare për Koordinim dhe Integritet Evropian (QKZIE).

E Drejta Penale ka qenë dhe mbetet fusha kryesore e bashkëpunimit ndërmjet shteteve të Bashkimit Evropian. Këtë qëndrim dhe zhvillim të Së Drejtës Penale e konfirmon Traktati i Lisbonës, i cili i jep një vend edhe më të rëndësishëm të drejtës penale dhe drejtësisë duke e vendosur në rangun e parë brenda Bashkimit Evropian. Neni 3.2 i Traktatit të ri të BE parasheh: “Bashkimi Evropian u ofron qytetarëve të vetë një hapësirë lirie, sigurie dhe drejtësie pa kufi të brendshëm dhe një treg të brendshëm, ku konkurrenca është e lirë dhe e pandikuar”. Roli në rritje gjithnjë e më shumë të drejtës penale mbështetet edhe në luftën kundër dukurisë së mashtrimit në nivel evropian. Nga ky fakt lind mendimi për unifikimin e drejtës penale të njësuar me qëllim që organet e Bashkimit Evropian të jenë sa më efikas në parandalimin dhe luftimin e veprave penale në përgjithësi me theks të veçantë në fushën ekonomike.

Këto qëndrime determinuan idenë për krijimin e Prokurorisë Evropiane, në mbështetje të nenit 36.1 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, “Për të luftuar shkeljet që cenojnë interesat financiare të Bashkimit Evropian”. Kjo prokurori do të kishte kompetenca për të nxjerrë para organeve të drejtësisë autorët e veprave penale në fushën ekonomike, para juridiksionit të shteteve anëtare. Inkriminimi i të drejtës penale të përbashkët dhe asaj penale ekonomike mbetet sfidë e Bashkimit Evropian për faktin që vendet e BE kanë dallime të mëdha sa i përket sanksioneve dhe legjislacionin

215 Stephan. Heidenhain, *Hyrje në të drejtën evropiane*, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2010, fq. 131-133.

që e aplikojnë. Disa vende tradicionalisht këtë kriminalitet e luftojnë me ligje, përmes drejtësisë penale, ndërsa disa të tjera me sistemin e akteve administrative.

Pra, kjo organizatë ndërkombëtare evropiane, në fushën e të drejtës penale, ka krijuar organe në nivelin e policisë dhe drejtësisë. Neni 29 i TBE, flet për EUROPOL-in²¹⁶ (zyra e policisë evropiane), si organ që ndihmon shtetet në dhënien e informacioneve dhe të dhënave për kriminalitetin, pra nuk ka kompetenca ekzekutive. Organ tjetër, i cili ndihmon bashkëpunimin e shteteve në fushën e drejtësisë është Eurojust²¹⁷, i cili u formua me qëllim të koordinimit sa më të mirë ndërmjet autoriteteve kombëtare të ngarkuara për ndjekjen dhe hetimin e krimit. Rrjeti Gjyqësor Evropian është krijuar më 29 qershor 1998²¹⁸, me qëllim të krijimit të kontakteve direkt mes autoriteteve gjyqësore të shteteve anëtare për bashkëpunim gjyqësor penal, kundër kriminalitetit në kuadër të Bashkimit Evropian. Ky organ funksionon në tri mënyra: fillimisht ofron ndihmë në vendosjen e kontakteve ndërmjet pikave të kontaktit të shteteve anëtare, organizon mbledhje ndërmjet përfaqësuesve të shteteve anëtare dhe gjithashtu jep informacione për krimin në çdo kohë. Bashkimi Evropian i ka dhënë prioritet drejtësisë penale në atë mënyrë që ka krijuar legjislacion për unifikimin e veprimeve për të luftuar kriminalitetin e posaçërisht atë në fushën e ekonomisë. Si risi vlen të përmendet fakti i lindjes së idesë për krijimin e Prokurorisë Evropiane.

216 Konventa e Europol-it e dt. 26 korrik 1995, është baza mbi të cilën funksionon Evropoli (Policia Evropiane) si organ i cili shkëmben informata dhe të dhëna për kriminalitetin në përgjithësi. Pra, nuk parasheh kompetenca ekzekutive.

217 Eurojust- Njësi e krijuar nga gjyqtarët, prokurorët dhe oficerë policie fillimisht si njësi e përkohshme që filloi punën më 1 mars 2001, pastaj e zëvendësuar nga Eurojust prej viti 2003.

218 S. Weatherill and P. Beaumont, EU Lawrd edition, Penguin Books, University of Oxford Press, London, 1999. Marrë nga: <http://www.law.ox.ac.uk/profile/Weatherills> (parë më 15.8.2014).

4.11.1. Aspekte krahasuese të Konventës për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komuniteteve Evropiane

Konventa për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komuniteteve Evropiane, ka hyrë në fuqi më 17 nëntor 2002. Konventa përkohësisht kishte shuar debatin për kompetencat e komuniteteve në fushën e të drejtës penale. Pasi u konfirmua që e drejta penale është fushë që varet nga shtetet anëtare, Këshilli më 18 dhjetor 1995 vendosi të nxjerrë rregulloren për mbrojtjen e interesave financiare të komuniteteve evropiane²¹⁹.

Konventa mashtrimin kumunitar e përkufizon se ai: është mashtrim që cenon interesat komunitare të shteteve. Konventa parasheh se çdo veprim i qëllimshëm në lidhje me mashtrimet në fushën e shpenzimeve dhe të ardhurave si:

- Paraqitjen e deklaratave ose dokumenteve të falsifikuara, të pasakta ose të paplotë që kanë për qëllim marrjen e fondeve që vijnë nga buxheti i përgjithshëm ose i administruar nga Komuniteti Evropian,

- Mosdhënia e një informacioni duke i kundërvënë kështu një detyrimi specifik, që ka të njëjtin efekt,

- Përdorimi i fondit për qëllime të tjera nga ai për të cilin është dhënë.

Në fushën e të ardhurave, çdo veprim ose mosveprim i qëllimshëm në lidhje me:

- Paraqitjen apo përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, të pasakta ose të paplota që kanë si efekt zvogëlimin e paligjshëm të burimeve të të ardhurave të buxhetit të përgjithshëm ose të administruar të Komunitetit Evropian, për llogari të tyre,

219 Council Regulation(EC, EURATOM) NO.2988/95 OF 18 December 1995 on the protection of the European Communities financial interest . Marrë nga:
http://europa.eu/legislation_summaries/fight_against_fraud/protecting_european_communitys_financial_interests/I33018_en.htm (parë më 19.9.2014).

- Mosdhënia e një informacioni, duke i kundërvënë kështu një detyrimi specifik, që ka të njëjtin efekt,
- Përvetësimin e një avantazhi të krijuar në mënyrë të ligjshme, që ka të njëjtin efekt.²²⁰

Nga ky përkufizim shihet qartë se mashtrimi komunitar përjashtohet nga çdo veprë që nuk ka qëllim ta dëmtojë buxhetin komunitar. Sipas Konventës nuk ka mashtrim komunitar nëse nuk ka pasur dashje, pra nëse kryerësi nuk e din që dokumenti që e ka prezantuar është i falsifikuar, apo edhe nëse ka qenë neglizhent personi që do të duhej ta dinte se dokumenti është i falsifikuar normalisht, pra edhe në këtë rast nuk ka mashtrim në mbështetje të nenit 1 të Konventës. Konventa nuk ka paraparë asgjë rreth lajthimit të mundshëm. Gjatë krahasimit të përmbajtjes së dispozitave ligjore që i parasheh Kodi Penal i Kosovës, i vitit 2012 dhe mashtrimin komunitar që e parasheh Konventa për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komuniteteve Evropiane shihen pak dallime në përmbajtje sepse në të dyja rastet mashtrimi ekziston nëse ka qëllim apo dashje për të mashtruar përmes paraqitjes së dokumenteve të rrema apo të falsifikuar me qëllim t'i shkaktohet dëm buxhetit, qoftë të komunitetit evropian apo shtetit anëtar, ndërsa në të dy rastet përdoren dokumente të falsifikuara të cilat nuk prezantojnë realisht të dhënat në fushën e shpenzimeve, të ardhurave, falimentimit, apo edhe lidhë kontratë të rrejshme me qëllim të përfitimit të parave, pasurisë, shpërblim, përparësi ose premtim. Kosova edhe pse ende nuk është anëtare e Bashkimit Evropian në Kodin Penal të saj në grupin e veprave penale kundër pasurisë ka paraparë veprën penale: “Mashtrimi lidhur me pranimin e fondeve nga Komuniteti Evropian”, neni 337 parag. 1,

220 Jean. Pardel, Geert. Corstens dhe Gert. Vermeulen, *E drejta penale evropiane*, botimi Papirus, Tiranë 2009, fq. 628-629.

ku parashihet se “Kushdo që qëllimisht përdor ose paraqet dokumente të rrejshme, të pasakta apo jo të plota dhe si rezultat i këtij veprimi pranon ose merr fonde në mënyrë të kundërligjshme nga buxheti i përgjithshëm i komunitetit evropian ose buxhetet e menaxhuara nga apo në emër të komunitetit evropian, dënohet me burgim prej një 1 deri në pesë 5 vjet²²¹.

Në nenin 337 parag. 2 thuhet: “ Kushdo që fsheh të dhëna në shkelje të detyrimit të posaçëm për zbulimin e të dhënave të tilla dhe si rezultat i kësaj pranon apo mban në mënyrë të kundërligjshme fonde nga buxheti i përgjithshëm i komunitetit evropian ose buxhetet e menaxhuara nga apo në emër të komunitetit evropian, dënohet me gjobë ose burgim prej 1 deri në 3 vjet. Ndërsa paragrafi 3 parasheh: “Kushdo që përdor fondet nga buxheti i përgjithshëm i komunitetit evropian apo buxhetet e menaxhuara nga apo në emër të komunitetit evropian për tjera qëllime, nga ato për të cilat janë dhënë, dënohet me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet.²²²

Andaj, Kosova, edhe pse nuk e ka ratifikuar Konventën ajo ka përfshirë në Kodin Penal të saj mashtrimin me fondet e komunitetit evropian duke paraparë dënime edhe më të larta sesa vetë konventa e cila në nenin 2.2 ka paraparë mashtrimet e vogla, ku vlera nuk kalon 4000 euro në këto raste personat nuk përgjigjen penalisht por mund të marrin dënime nga më të ndryshmet. Tentativën nuk e ka e inkriminuar as Konventa e as Kodi Penal aktual i Kosovës. Neni 3 i Konventës i detyron shtetet anëtare të parashohin përgjegjësi penale për drejtuesit e ndërmarrjeve dhe personat e autorizuar në rast mashtrimi me fondet financiare të komunitetit evropian, nëse veprohet për fitime në

221 Shih Kodi Penal i Kosovës nr. 04/L-82,të dt. 2. prill 2012, që ka hyr në fuqi më 1 janar 2013, neni 337, paragrafi 1.

222 Shih Kodi Penal i Kosovës nr. 04/L-82,të dt. 20 prill 2012, që ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, neni 337.

dobi të ndërmarrjes. Edhe këtë dispozitë ligjore të Konventës legjislacioni ynë e ka paraparë ngase të në ekziston ligji për përgjegjësinë penale të personit juridik që parasheh përgjegjësi penale nëse ata kryen veprën penale mashtrime me fondet e Komunitetit Evropian. Ne kujtojmë që, Bashkimi Evropian me nxjerrjen e Konventës për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komunitetit Evropian ka ndihmuar shtetet anëtare të Bashkimit Evropian në unifikimin e legjislacionit nacional me atë ndërkombëtar me qëllim të luftimit të kriminalitetit në fushën ekonomike.

4.11.2. Aspekte krahasuese nga Protokoli i parë i Konventës për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komuniteteve kundër korrupsionit

Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian me qëllim të luftimit të dukurisë së korrupsionit të kryer nga: “Zyrtarë të nivelit kombëtar apo komunitar përgjegjës për marrjen, administrimin ose shpenzimin e fondeve komunitare që janë nën kontrollin e tyre”. Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian kanë nënshkruar protokollin e parë të Konventës për Mbrojtjen e Interesave Financiare, më 27 shtator 1996²²³.

Protokolli, gjithashtu, ka të bëjë me mashtrimin komunitar të kryer nga ana ose në drejtim të funksionarëve komunitarë. Protokolli njeh korrupsionin aktiv dhe pasiv, ashtu siç është paraparë në kodet penale kombëtare. Sipas nenit 3.1 “Korrupsioni pasiv konsiderohet veprimi me dashje i çdo personi për të premtuar ose dhënë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet personit të tretë përfitime të ndryshme në favor të një funksionari, për kryerjen ose moskryerjen e një detyre që përfshihet në përgjegjësinë e tij që bie ndesh me interesat financiare të komuniteteve evropiane”. Kosova ka nxjerrë ligjin kundër

223 Council Act of 27 September 1996, draëing up a protocol to the convetion on the protection of the European communities financial interests (official journal C 313 of 23.10.1996). Marrë nga: <http://www.akk-ks.org/index.php?cid=1.44> (parë më 19.9.2014).

korruptionit²²⁴, por për dallim nga protokoll i parë i Konventës të MFI, ligji nuk e ka bërë ndarjen e korruptionit në aktiv dhe pasiv. Ligji korruptionin e definon si “shkelje të detyrës së personave zyrtarë ose përgjegjës në subjekt juridik dhe çdo veprimtari e iniciatorëve dhe përfituesve të kësaj sjellje, është e drejtuar si një përgjigje ndaj një shpërblimi që direkt ose indirekt është premtuar, ofruar, dhënë, kërkuar, pranuar apo është pritur për të marrë për veten apo për një person tjetër”.

Gjatë krahasimit shohim se nuk ekzistojnë dallime të theksuara të nocionit të korruptionit sipas përkufizimit të ligjit dhe protokollit për korruptionin pasiv dhe aktiv. Protokoll i, gjithashtu, përdor të njëjtën teknikë ashtu sikur Konventa e MIF, që i detyron shtetet anëtare që të parashohin në ligjet e tyre nacionale këto forma të korruptionit aktiv dhe pasiv, t’i trajtojë si vepra penale dhe të parashehë dënime duke përfshirë edhe dënimin me burg (neni 2.2 dhe 3.2). Për dallim nga Konventa, protokoll i nuk parasheh prag mbi të cilën vepra konsiderohet e rëndë dhe nuk e parasheh shprehimisht tentativën.

Bashkimi Evropian për ta luftuar dukurinë e korruptionit ka nxjerrë: Konventën kundër korruptionit që shtetet anëtare e njohin si “Konventa anti-korruption”, e cila për dallim nga protokoll i parë i konventës MIF, ka një shtrirje shumë të gjerë në luftën kundër korruptionit sepse ajo inkriminon të gjitha format e korruptionit, qoftë atij aktiv apo pasiv, ku janë të përfshirë funksionarët e komunitetit evropian ose të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Vendi ynë nuk është anëtar i BE, por në aktin më të lartë juridik të saj, në Kushtetutë²²⁵, ka paraparë zbatimin e akteve ndërkombëtare.

224 Shih: Ligji Kundër Korruptionit i Kosovës, nr. 2004/34, miratuar më 22 prill 2005.

225 Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosovës që hyri në fuqi më 15 qershor 2008, në nenin 22 parasheh zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe akteve ndërkombëtare, edhe pse shprehimisht nuk ka

4.11.3. Aspekte krahasuese nga Protokollin e dytë i Konventës mbi Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komuniteteve Evropiane (përgjegjësia e personit juridik dhe pastrimi i kapitalit)

Bashkimi Evropian ka vazhduar luftën kundër veprave korruptive në përgjithësi e me theks të veçantë atë në fushën e ekonomisë, pasi që korrupsioni dhe evazioni fiskal paraqesin sfida për ekonominë e çdo shteti anëtar.

Në këtë drejtim ai ka vazhduar në kompletimin e infrastrukturës ligjore kështu që më 19 qershor 1997²²⁶ ka nënshkruar protokollin e dytë të Konventës, që ka të bëjë me dukurinë e pastrimit të kapitalit dhe përgjegjësinë penale të personave juridikë si institut relativisht i ri për një pjesë të shteteve anëtare. Protokollin e dytë i MIF, kërkon që shtetet anëtare të penalizojnë veprimtarinë e pastrimit të kapitaleve që nënkupton: pastrimin e parave, mashtrimet dhe fitimet nga to, korrupsionin aktiv dhe pasiv që përkufizimi i tyre është i njëjtë me atë që ka përkufizuar Konventa për Mbrojtjen e Interesave Financiare në protokollin e parë. Neni 2 ka paraparë “pastrimin e parave”, ku shtetet anëtare obligohen që në legjislacionet e tyre penale ta inkriminojnë si vepër penale.

Kodi Penal i Kosovës në (nenin 308) e ka inkriminuar pastrimin e parasë si vepër penale në grupin e veprave penale, në fushën ekonomike dhe kryerësi i veprës penale do të përgjigjet sipas ligjit në fuqi për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit²²⁷. Ky ligj në (nenin 36), ka paraparë Bashkëpunimin Ndërkombëtar që thotë: “Autoritetet kompetente të Kosovës ndërmarrin masat më të gjera të mundshme të

paraparë zbatimin e Konventës Kundër Korrupsionit të vitit 1997, në të nënkuptohet se ajo zbaton konventat ndërkombëtare.

226 Shih: Protokollin e dytë i hartuar në mbështetje të nenit K-3 të Traktatit të Bashkimit Evropian, të Konventës për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komunitetit Evropian, Gazeta zyrtare C 221, 19.07.1997. P0012-0022. Marrë nga : <http://www.akk-ks.org/index.php?cid=1.44> (parë më 20.09.2014).

227 Shih: Ligji për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit të Kosovës, nr. 03/L-196, të miratuar më 30 shtator 2010.

bashkëpunimit me autoritetet e shteteve të huaja, me qëllim të këmbimit të informacioneve për hetimin dhe zbatimin e procedurave gjyqësore në lidhje me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë dhe urdhrave për konfiskim, lidhur me mjetet për shpëlarjen e parave dhe pasurisë së fituar nga këto vepra penale, me qëllim të ndjekjes së kryerësve të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit”.

Neni 3 ka paraparë përgjegjësinë e personave juridikë në rastin kur ata marrin pjesë në veprimet e inkriminuara nga ana e protokollit si rastet e mashtrimeve, korrupsionit aktiv e pasiv dhe pastrimin e kapitalit. Kjo dispozitë ka obliguar shtetet anëtare të ndërmarrin masa që të inkriminojnë veprimet korruptive të personave juridikë si vepra penale në legjislacionet e tyre kombëtare në të gjitha rastet kur ata veprojnë individualisht, përmes përfaqësuesve apo të autorizuarve të tyre, organeve drejtuese apo kontrollues të tyre, por që veprojnë në llogari të personave juridikë duke nxitur vepra mashtruese, korrupsion pasiv apo aktiv dhe pastrim të parave ata do të përgjigjen penalisht dhe ndaj tyre do të shqiptohen edhe dënime. Protokoli ka inkriminuar edhe tentativën për veprimet e tilla.

Nga krahasimet e bëra vërehet se Kosova edhe pse ende nuk është anëtare e familjes evropiane ka hartuar ligjet konform standardeve që kërkon konventa dhe protokoli, ndërsa disa shtete anëtare të BE, ende hezitojnë për ta pranuar këtë institut për përgjegjësi penale të personave juridikë si: Spanja, Gjermania , Italia dhe Portugalia. Këto shtete janë të interesuara të zgjerojnë në sistemet e tyre të drejtën penale administrative²²⁸, për dallim nga vendet e sistemit common law, Belgjika, Holanda dhe Franca, të cilat kanë pranuar përgjegjësinë penale të personave juridikë.

228 Jean. Pardel, Geert. Corstens & Gert. Vermeulen, *E drejta penale evropiane*, botimi Papirus, Tiranë 2009, fq. 641.

Karakteristikë e veçantë e protokollit është se neni 3-1 i detyron shtetet anëtare në legjislacionet e tyre të parashohin përgjegjësinë e personave juridikë por nuk e përdor shprehimisht fjalën “përgjegjësi penale”, me çka i mundëson shteteve në “raste të caktuara të shqiptojnë edhe dënime jopenale, por administrative që sipas nenit 4 janë të specifikuara si më poshtë:

- Përfshirja nga e drejta për fitime publike,
- Masa e ndalimit të përkohshëm ose të përhershëm në ushtrimin e veprimtarisë tregtare,
- Vendosja në masa dhe mbikëqyrje gjyqësore për aktivitetin.

Ndërsa neni 5 parasheh konfiskimin, sipas protokollit, shtetet anëtare detyrohen të marrin masa për t'i konfiskuar të gjitha produktet që janë si rezultat i veprës penale të mashtrimit, korrupsionit dhe pastrimit të kapitalit, pa i dëmtuar palët e treta që produktet i kanë fituar me mirëbesim.

Konsiderojmë që Kosova ka legjislacion adekuat për ta luftuar këtë dukuri negative, meqë ligjet tona parashohin bashkëpunimin ndërkombëtar për luftimin e kësaj dukurie dhe nuk kemi asnjë pengesë për koordinimin sa më të mirë të veprimeve të përbashkëta.

4.11.4. Kuadri normativ tregtar i mbrojtjes së interesave financiare të Bashkimit European në fushën ekonomisë nga aspekti juridiko-penal

Ideja për bashkimin e shteteve të Europës, me qëllim të krijimit të politikave të përbashkëta tregtare me qëllim të mbrojtjes financiare në fushën ekonomike është krijuar para se të krijohet Komuniteti Evropian. Qëllimi i këtij integrimi ishte: eliminimi

i pengesave në lëvizjen e lirë të mallrave, personave, kapitalit, shërbimeve, vendosjes së taksave doganore dhe kufizime të tjera, ashtu siç parashihen në nenin 3 të Traktatit të Komunitetit Evropian²²⁹.

Në vazhdim do të paraqesim ndikimin që ka e drejta e komunitetit evropian në raport me të drejtën penale nacionale, ngase në të gjitha rastet kur një dispozitë penale kombëtare nuk është në përputhje me atë kumunitare, kjo dispozitë nuk mund të aplikohet pra duhet të shfuqizohet. Kjo epërsi është e garantuar në Kushtetutën e Kosovës²³⁰.

Në legjislacionet nacionale importimi i mallrave që vijnë nga ndonjë shtet anëtar dhe nxjerrja e tyre në treg për shitje pa autorizim është veprim i inkriminuar, por inkriminimi i tillë bie ndesh me (nenin 8 të KE), parasheh qarkullim të lirë të mallrave, duke ndaluar çfarëdo kufizimi në sasi apo çdo mase të njëjtë²³¹. Një situatë e ngjashme është edhe në rastin kur shteti i jep përparësi shitjes së mallit të njëjtë, që është prodhuar në atë shtet.

Shkeljet e dispozitave të Traktatit të Komunitetit Evropian ekzistojnë edhe në rastet kur për qarkullimin e lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitaleve në qarkullimin ndërkombëtar parashihen dënime më të larta se ato që mund t'i shqiptohen kryerësve për shkeljet e ngjashme, por për qarkullimin e brendshëm.

Nga krahasimi konstatohet se Komuniteti Evropian ka krijuar një rend juridik që nuk është i karakterit striktë, ai duhet të zhvillohet me qëllim që të zbatohen detyrimet

229 Shih: Traktati i Komunitetit Evropian dhe Protokollin e Statutit të ESCB-së, (Fletorja zyrtare e Bashkimit Evropian e dt. 30 mars 2010).

230 Kushtetuta e Republikës së Kosovës që hyri në fuqi më 15 qershor 2008, në nenin 22 të saj thotë: "Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare.

231 Jean. Pardel, Geert. Corstens & Gert. Vermeulen, *E drejta penale evropiane*, botimi Papirus, Tiranë, 2009, fq. 608.

që rrjedhin nga e drejta komunitare, që është objektiv i aspektit legjislativ. Ndërsa pjesa ekzekutive mbetet ende dominim i shteteve kombëtare, ashtu siç është paraparë në (nenin 10, të KE), sepse Komuniteti Evropian ka pak kompetenca në këtë drejtim.

4.11.5. Politika ndëshkimore në Mbrojtjen e Interesave Financiare të BE-së

Politika ndëshkimore e BE-së, në fushën tregtare në mbrojtjen e interesave financiare komunitare, kishte arritur një zgjerim në të gjitha fushat. Ky konstatim vërtetohet mbi faktin e shqiptimit të sanksioneve në fushën e konkurrencës si, sanksionet që imponohen nga Banka Qendrore Evropiane, sanksionet nga Traktati i KEQO-së, dhe Euroatom, sanksionet në fushën e transporteve sipas rregullores 11/60, sipas nenit (75 të KE) etj. Në bazë të Rregullores 17/62²³², Komisioni vendos gjopa kundër ndërmarrjeve, nëse janë shkelur nenet (81-1 ose 82 të KE), me dashje apo nga pakujdesia në qoftë se marrëveshjet e kompanive ceçnojnë tregtinë e shteteve anëtare dhe kanë për qëllim të shmangin apo pengojë konkurrencën brenda tregut të përbashkët. Dënimet që mund të shqiptohen janë nga 1.000 deri në 1.000.000 euro. Sipas Traktatit të KEQO-së, dënimet që shqiptoheshin ndaj ndërmarrjeve, për shkak të mosrespektimit të vendimeve, lidhur me kapitalin, prodhimin, çmimet, konkurrencën i ka paraparë në formë të gjobave dhe detyrimeve dhe shqiptimi i dënimeve bëhej për shkelje procedurale dhe materiale²³³. Ndërsa sipas traktatit të Euratomit se në sanksionet komunitare, të cilat i aplikon komisioni nuk parashihen gjobat sipas (nenit 83 të Euratomit), por ndaj shkelësve të rregullave parashihen masa në formë të paralajmërimeve dhe atë: heqja nga përfitimet e caktuara, nga asistenca financiare ose

232 Shih: Rregullorja e Këshillit të aprovuar më 6.2.1962. Marrë nga : http://www.wipo.int/wipolex/en/text.jsp?file_id=331030 (parë më 25.09.2014).

233 Ibid.

ndihma teknike, vendosja e ndërmarrjes nën mbikëqyrjen e një bordi apo personi për 4 muaj me marrëveshje sipas komisionit dhe shtetit ku ndodhet ndërmarrja, tërheqja e materialeve në mënyrë të plotë apo të pjesërishtme të materialeve bruto ose materialeve speciale²³⁴.

Siç shihet këto sanksione nuk kanë karakter shpërblyes. Nga krahasimi i politikave ndëshkimore mund të konstatojmë se BE, në fushën tregtare me qëllim të mbrojtjes financiare të BE-së, parasheh dënime deri në njëzetëfishin e vlerës së mallit të transportuar, nëse nuk respektohet vendimi i komisionit sipas nenit (75-1 KE) dhe gjoba mund të shqiptohet deri në 10.000 euro neni (18-2). Pra, karakteri i gjobave të paraqitura nuk është me karakter penal, por vendosja e tyre bëhet duke u mbështetur në kërkesat bazë të së drejtës penale. Njohja e karakterit penal të gjobave të vendosura nga komisioni nënkupton zbatimin e së drejtës penale.

234 Shih: Traktatet për Bashkimin Europian, posaçërisht atë të Romës, Romë 25 mars 1957, themelimi gradual i tregut të përgjithshëm, të përbashkët (EEC) dhe Bashkësia Europiane e Energjisë Atomike (EAEC ose Euratom). Marrë nga : <http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/st06655-re01.en08.pdf> (parë më 25.9.2014).

B.

II. PËRGJEGJËSIA PENALE E PERSONAVE JURIDIKË SIPAS LEGJISLACIONIT PENAL TË KOSOVËS DHE TË DISA SHTETEVE EVROPIANE

4.1. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Kosovë

Përgjegjësia penale e personave juridikë, jo vetëm për të drejtën penale në Kosovë por në përgjithësi edhe për të drejtën penale ndërkombëtare është institut relativisht i ri.

Njohja e përgjegjësisë penale për personat juridikë vjen si rezultat i shumë faktorëve, por ndër më të rëndësishmit ishin: rritja e kriminalitetit ekonomik, kriminaliteti në shoqëritë tregtare, krimi i organizuar si pasojë e zhvillimit industrial etj. Parimi qindravjeçar se shoqëria nuk mund të kryejë krime, bazuar në parimin se personi juridik, shprehja e të cilit janë edhe shoqëritë tregtare, nuk mund të përgjigjet penalisht në pamundësi për të shprehur vullnetin si element subjektiv i veprës penale u demantua nga fakti se e drejta penale iu kundërpërgjigj këtij parimi të lashtë, duke sanksionuar përgjegjësinë penale të personave juridikë²³⁵.

Një fakt tjetër nxitës i pranimi të përgjegjësisë penale të personave juridik ishte përfshirja gjithënjë e më tepër e tyre në sferën ekonomike dhe politike në vend, gjithashtu domosdoshmëria e bashkëpunimit ndërkombëtar për shkak të ndërvarësisë së shoqërive tregtare, me rastin e ushtrimit të aktiviteteve ekonomike. Lidhur me

235 Qerekja. Besnik, *Përgjegjësia Penale e Personave Juridikë nën këndvështrimin e legjislacionit penal shqiptar*, Revista: Studime juridike, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë 2009, fq. 235.

përgjegjësinë penale të personave juridikë ndeshen dy koncepte dhe atë: teoria e fiksonit apo romane dhe teoria e realitetit apo gjermane. Sipas teorisë së parë personat juridikë janë diksion i rëndomtë dhe ligjor, sepse vetëm personat fizikë janë subjekt të së drejtës. Personat juridikë nuk kanë vullnet personal, andaj nuk mund të përgjigjen për veprimet e përfaqësuesve të tyre dhe se vullnetin e marrin nga personi fizik, prandaj është vështirë të vërtetohen elementet e përgjegjësisë penale. Gjithashtu problem paraqet edhe shqiptimi i sanksionit penal sepse ai do t'i godasë të gjithë anëtarët e personit juridik dhe jo vetëm ata që kanë marrë pjesë në veprën konkrete që bie ndesh me parimet e drejtësisë²³⁶.

Sot pasi që personat juridikë janë pjesë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik, andaj kjo rëndësi i hap rrugë teorisë së realitetit.

Koncepti i përgjegjësisë penale të personave juridikë në Kosovë ka qenë e inkriminuar dhe ka kaluar nëpër faza të ndryshme. Vlen të theksohet se pas Luftës së Dytë Botërore, në disa ligje ishte paraparë përgjegjësia penale e personave juridikë dhe atë në Ligjin për pengimin e spekulimit të palejuar dhe sabotimit ekonomik, të vitit 1945 dhe Ligji për veprat penale kundër popullit dhe shtetit, i vitit 1947. Kodi penal i vitit 1947, në pjesën e posaçme kishte paraparë dispozita për përgjegjësinë penale të personave juridikë por vetëm për veprat penale të paraparar shprehimisht me ligj. Me ligjin e posaçëm penal të vitit 1948 dhe Kodit Penal të Jugosllavisë, të vitit 1951 braktiset ky koncept i përgjegjësisë penale për personat juridikë dhe në vend të tij vendoset përgjegjësia për një kategori të re të përgjegjësisë, asaj për shkelje ekonomike. Në vitin 1960 dhe 1976, nxirren ligjet e posaçme për shkelje ekonomike që rregullonin

236 Osmani. Afrim, *Përgjegjësia Penale e Personave Juridikë në Republikën e Maqedonisë*, Revista edukative, kulturore dhe shkencore "Vepra": Marrë nga: <http://www.furkan.com.mk/VEPRA%2099.pdf> (parë më 22.1.2014).

materien e pjesës së përgjithshme dhe procedurën për shkelje ekonomike që ishte kompetencë e gjykatave të posaçme ekonomike.

Në Kosovë me hyrjen në fuqi të Ligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale, pushojnë të vlejnë: Ligji për delikte ekonomike, (Teksti i spastruar) “Gazeta zyrtare e RSFJ” nr. 10/86²³⁷. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji deliktet ekonomike të parapara me ligjet e veçanta bëhen kundërvajtje, ndërsa ligji parasheh se procedura për deliktet ekonomike të ngritura deri me hyrjen në fuqi të këtij ligji do të kryhen në gjykatat, ku ka filluar procedura, më së voni deri më 31.12.2012²³⁸. Andaj, nga hyrja në fuqi e ligjit në janar 2013, është tejkaluar gjendja e shkeljeve të personave juridikë ku parashiheshin me akte nënligjore, tani personat juridikë mund të përgjigjen penalisht për çfarë do veprë penale si p.sh.: “shmangie nga tatimi” dhe për vepra tjera penale të ngjashme.

Kodi Penal i Kosovës, i vitit 2012, gjithashtu ka paraparë përgjegjësinë penale të personave juridikë. Personi juridik është përgjegjës për veprën penale të personit përgjegjës, i cili ka kryer veprën penale duke vepruar në emër të personit juridik, brenda autorizimeve të tij, me qëllim të përfitimit të dobisë për apo ka shkaktuar dëm për atë person juridik. Përgjegjësia penale e personit juridik ekziston edhe nëse veprimet e personit juridik kanë qenë në kundërshtim me politikat afariste ose me urdhrat e personit juridik, gjithashtu sipas kodit ai është përgjegjës për veprën penale edhe atëherë kurë personi që ka kryer veprën penale nuk dënohet²³⁹. Dobia pasurore e fituar me anë të veprës penale konfiskohet nga organizata e biznesit ose personi juridik. Fillimisht në

237 Shih Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Veprat Penale të Kosovës, nr. 04/L-30, i miratuar më 31 gusht 2011.

238 Shih: Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Veprat Penale të Kosovës, nr. 04/L-30, i miratuar më 31 gusht 2011, neni 33 parag. 1 dhe 2.

239 Shih: Kodi Penal i Kosovës të vitit 2012, neni 40, paragrafi 1 dhe 2.

legjislacionin e shteteve të ndryshme të botës, por edhe atyre evropiane, në parim nuk pranohej përgjegjësia penale për personat juridikë, sepse këtë çështje e kishin rregulluar dhe paraparë me ligje të veçanta dhe atë në të drejtën penale ose administrative për natyrën e veprave penale në fushën ekonomiko-financiare. Rol të veçantë parimor për parashikimin e përgjegjësisë penale të personave juridikë ka luajtur Konventa nga Palermo e OKB-së, “kundër krimit të organizuar” nga viti 2000. Në bazë të Konventës shtetet obligohen të parashohin përgjegjësinë penale të personave juridikë për pjesëmarrje në kriminalitet.

Me rëndësi të veçantë është gjithashtu Konventa penalo-juridike për pengimin e korrupsionit, e Këshillit të Evropës e vitit 1998, ku gjithashtu obligon shtetet që të vënë si obligim përgjegjësinë penale edhe për personat juridikë. Konceptin për përgjegjësinë penale të personave juridikë që duhet të proklamohet në vendet anëtare e rrumbullakon Konventa për Mbrojtjen Interesave Financiare të Unionit Evropian, e vitit 1995. Andaj, shteti i Kosovës si pretendues për të hyrë në familjen evropiane iu ka bashkëngjitur këtij koncepti për përgjegjësinë penale të personit juridikë të legjitimuar në fushën ekonomike në shumë vende të botës, duke përfshirë SHBA-të, Francën etj. Vendi ynë ka një ekonomi jo të zhvilluar por me intencë të zhvillimit dhe globalizimit të saj, prandaj konsideroj se bërja e këtij ligji ka qenë e domosdoshme për faktin që, Kosova përherë të parë po krijon legjislacion pa ndërhyrje nga jashtë, pas ndryshimit të statusit të sajë politik, dhe kjo do të ketë efekt pozitiv për rregullimin e realitetit ekonomik por njëkohësisht do të bëjë një shpëputje nga legjislacioni imponues ish-RSFJ-së dhe Serbisë.

4.1.1. Elementet themelore të përgjegjësisë penale të personave juridikë sipas legjislacionit të Kosovës

Në bazë të Ligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për veprat penale nr. 04/L-30, në Republikën e Kosovës, personat juridikë të vendit dhe të huaj janë përgjegjës për vepra penale të kryera në territorin e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, sipas ligjit, personi juridik i huaj është përgjegjës për veprat penale të kryera jashtë shtetit por në dëm të Republikës së Kosovës, shtetasit të saj apo personit juridik të vendit. Personi juridik i vendit përgjigjet edhe për veprat penale të kryera jashtë vendit. Përfundimisht ky ligj nuk aplikohet në këto raste kur janë plotësuar kushtet e veçanta për ndjekje penale nga dispozitat e Kodit Penal të Kosovës²⁴⁰. Për ekzistimin e përgjegjësisë penale të personit juridik duhet të plotësohen kushtet e parapara nga neni 5 i Ligjit²⁴¹ “Përgjegjësia e Personave Juridikë për Vepra Penale”, i cili parasheh se personi juridik ka përgjegjësi për veprat penale të kryera:

- Në emër, në dobi të tij, në kuadër të autorizimeve dhe në kundërshtim me politikën afariste apo urdhrat e tij.
- Personi juridik është përgjegjës për vepër penale edhe në rastet kur personi përgjegjës që ka kryer veprën penale nuk është dënuar për atë vepër .
- Përgjegjësia e personit juridik bazohet në fajësinë e personit përgjegjës.
- Elementet subjektive të veprës penale të cilat ekzistojnë te personi përgjegjës do të çmohen në raport me personat juridikë vetëm nëse është realizuar baza e përgjegjësisë në bazë të pikës së parë.

240 Shih: Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Veprat Penale të Kosovës, neni 4.

241 Po aty neni 5.

Në bazë të ligjit nëse personi juridik pushon së ekzistuari para se procedura të përfundojë, dënimi në të holla, masa e sigurisë dhe konfiskimi i dobisë pasurore mund t'i shqiptohen personit juridik, nëse më parë është përcaktuar përgjegjësia e personit juridik, i cili ka pushuar së ekzistuari. Personi juridik në falimentim dënohet për veprë penale të kryer para ngritjes apo gjatë procedurës së falimentimit²⁴². Personi juridik është përgjegjës edhe për veprën penale në tentativë, në qoftë se me ligj është paraparë se tentativa është e dënueshme. Pra, për të ekzistuar përgjegjësia penale e personit juridik duhet të plotësohen njëkohësisht këto elemente, mjafton të mungojë njëri nga elementet atëherë personi juridik do të përjashtohet nga përgjegjësia penale. Ligjvënësi kosovar me të drejtë ka paraparë edhe përgjegjësinë penale për kategorinë e personave që janë nën autoritetin e tij me qëllim që të ndalojë mundësinë e bartjes së përgjegjësisë në nivele të ulëta të punonjësve sepse shpeshherë pretendimet e drejtuesve të personave juridikë janë se vepra penale është kryer nga punonjësit e tyre. Ligjvënësi gjithashtu elementet subjektive të veprës penale, që janë të lidhura me personin përgjegjës me të drejtë i ka paraparë se do të çmohen në raport me personin juridik dhe nëse janë plotësuar elementet e përgjegjësisë penale nga neni 5 i ligjit²⁴³. Por, profesorët Ersi Bozheku dhe Ismet Elezi, mendojnë se ligjvënësi kosovar nuk e ka pasur të qartë ndryshimin thelbësor midis fajësisë së personit juridik, që duhet kuptuar në aspektin normativ për më tepër lexo librin e poshtëshënuar.²⁴⁴ Në lidhje me këto pretendime nuk mjafton që personi juridik të vendosë vetëm rregulla dhe urdhra për t'i zbatuar punonjësit e personit juridik gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, ngase shpeshherë ato

242 Shih: Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Vepra Penale të Kosovës, nr. 04/L-30, i miratuar më 31 gusht 2011, neni 6 parag. 1 dhe 3.

243 Shih: Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Veprat Penale të Kosovës, neni 5. Marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,191> (parë më 15.2.2014).

244 Dr. Av. Buzheku. Ersi N. & Elezi. Ismet, Përgjegjësia Penale e Personave Juridik, Botimet "Teona" Tiranë, 2012, fq. 296-297.

vetë në mënyrë të heshtur bëjnë presion tek punonjësit që të veprojnë në mënyrë jo të rregullt për të arritur objektivat që i kanë në biznes. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga Gjykata Amerikane në çështjen *United States v Hilton Hotels Corporation*, e cila u dënua për veprimet që cenojnë konkurrencën e ndershme²⁴⁵. Ky shembull ka për qëllim të forcojë bindjen se personat juridikë kanë përgjegjësi penale edhe në rastet kur punëtorët e tyre kanë vepruar në kundërshtim me urdhrat dhe politikat afariste të personit juridik.

4.1.2. Dënimet dhe sanksionet penalo-juridike

Në kreun e tretë të ligjit “Për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale” janë paraparë dënimet dhe sanksionet penale që mund t’u shqiptohen kryerësve për veprat penale e ato janë:

- Dënimet,
- dënimi me kusht, dhe
- masat e sigurisë.

Ndërsa dënimet që mund t’u shqiptohen për vepra penale personave juridikë janë:

- Dënimi me gjobë, dhe
- Pushimi i personit juridik.

Dënimi me gjobë vlerësohet në bazë të rrethanave rënduese dhe lehtësuese brenda kufijve ligjorë, duke pasur parasysh rrethanat në të cilat është kryer vepra penale,

245 Bala. Eriselda, Dënimi penal i personave juridikë, gusht 3.2012. Marrë nga: <http://drejtesiashqiptare.com/?p=1856> (parë më 20.1.2014).

pasojat që janë shkaktuar apo kanë mund të shkaktohen, fuqinë ekonomike dhe madhësinë e personit juridik, masat e ndërmarra nga personi juridik pas kryerjes së veprës penale, pranimin e përgjegjësisë penale, raporti ndaj viktimës së veprës penale etj. Dënimi me gjobë fillon nga 1000 euro dhe mund të shqiptohet deri në 100.000 euro për veprat penale, ku është paraparë dënimi me burgim afatgjatë²⁴⁶. Ky dënim pas hyrjes në fuqi të kodit të ri penal është zëvendësuar me burgim të përjetshëm dhe kjo determinon ndryshimin e ligjit me qëllim të harmonizimit me Kodin Penal të Kosovës.

Personit juridik mund t'i shqiptohet dënimi me pushim të veprimtarisë, kur ai është themeluar me qëllim të kryerjes së veprave penale apo veprimtarinë kryesisht e ka shfrytëzuar për këtë qëllim. Përfshirë nga ky dënim kanë partitë politike dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale. Sipas ligjit, personit juridik mund t'i shqiptohet edhe dënim me kusht deri në 50.000 euro, i cili nuk do të ekzekutohet në qoftë se brenda periudhës së verifikimit personi juridik nuk kryen vepër të re penale. Ky dënim mund të shqiptohet edhe në rastet kur ai nuk e kthen dobinë pasurore të përfituar me vepër penale apo nuk i përmbush detyrimet e tjera si kompensimin e dëmit të paraparë me dispozitat penalo-juridike. Caktimi i dënimit me kusht, efekti dhe revokimi i tij bëhen sipas nenit 50-56 të Kodit Penal të Kosovës²⁴⁷. Për vepra penale, për të cilët është përgjegjës personi juridik, mund të caktohen këto masa të sigurisë:

- Ndalimi i kryerjes së veprimtarisë dhe punëve të caktuara,
- marrja e sendit, konfiskimi i dobisë pasurore dhe
- shpallja publike e aktgjykimit.

246 Shih: Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Veprat Penale, nr. 04/L-030, 31 gusht 2011. neni 9.

247 Shih: Kodi Penal i Kosovës, nr. 04/L-82, 20 prill 2012, nga neni 50 deri 56.

Masat e tilla janë paraparë edhe në Kodin Penal të Kosovës²⁴⁸.

Kujtojmë se për shkak të rrezikshmërisë së madhe shoqërore, që paraqesin veprimet e kundërligjshme të personave juridikë, veprimet e tilla ka qenë e domosdoshme të mbrohen me legjislacion të veçantë penal sepse një mbrojtje me masa administrative do të ishte e pamjaftueshme. Andaj, konsideroj se Ligji për përgjegjësinë e personave juridikë dhe Kodi Penal i Kosovës, dënimet, sanksionet penale dhe masa të tjera i ka rregulluar në mënyrë adekuate. Ndërsa konsideroj se harmonizimi i Ligjit me Kodin Penal është i domosdoshëm sepse Ligji është aprovuar para hyrjes në fuqi të Kodit Penal dhe Procedural, andaj duhet të fillohet ndryshimi dhe plotësimi këtij ligji.

4.2. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Shqipëri

Në Republikën e Shqipërisë Instituti i përgjegjësisë penale të personave juridikë ka qenë i inkorporuar në Kodin Penal të vitit 1995. Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor nëse ka provuar se një person juridik ushtron veprimtari që përbën vepër penale, ajo ka urdhëruar mbylljen tërësisht apo pjesërisht të veprimtarisë dhe ka konfiskuar të ardhurat, mjetet dhe pasurinë e përfituar nga ajo veprimtari²⁴⁹. Kjo dispozitë ligjore ka krijuar bazë për përgjegjësinë penale të personit juridik, por sipas mendimit tim ka qenë jo e mjaftueshme dhe ka lënë zbrazëtira të mëdha me rastin e implementimit në praktikë.

Me plotësimet dhe ndryshimet e Kodit Penal të vitit 2001, u shfuqizua ky institut

248 Shih: Kodi Penal i Kosovës, nr. 04/L-82, 20 prill 2012, neni 69, 70 dhe 99.

249 Shih: Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë i vitit 1995, nenin 45.

dhe pastaj në vitin 2004 u shtua përsëri që lë të kuptohet se ligjvënësit shqiptarë kanë pasur dilema rreth këtij instituti, që në përgjithësi edhe për botën demokratike, ishte relativisht i ri. Duke pasur parasysh faktin që Shqipëria ka objektiva të jetë anëtare në familjen evropiane dhe pjesëmarrëse në procesin e globalizimit të ekonomisë kujtoj që ky institut ka hyrë si domosdoshmëri në legjislacionin shqiptar dhe si kërkesë për të plotësuar legjislacionin në përputhje me standardet e Bashkimit European.

Aktualisht baza mbi të cilën është paraparë përgjegjësia penale e personave juridikë është ligji me numër 99754 i vitit 2007²⁵⁰, i cili plotësoi mungesat nga neni 45 i Kodit Penal 2001 dhe 2004, si ligj special edhe pse konsideroj që nga përmbajtja e ligjit mund të konstatohen mangësi në përcaktimin e veprave penale për të cilat do të përgjigjet personi juridik. Pas hyrjes në fuqi të ligjit në Shqipëri, në vitin 2007, filloi aplikimi i përgjegjësisë penale për dallim që deri në atë kohë parashihej përgjegjësia administrative e personave juridikë. Ligji nuk e ka penguar aplikimin e sanksioneve administrative nga organet e administratës publike²⁵¹. Neni 2 parasheh zbatimin e ligjit, ku subjekt të këtij ligji janë personat privatë dhe publikë të vendit dhe të huaj, me kusht që personat juridikë të huaj të jenë krijuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë. Ligji zbatohet ndaj personave juridikë përderisa nuk është parashikuar ndryshe në Kodin Penal dhe Procedural apo dispozita tjera penale. Ligji ka rregulluar mirë rastet kur personi juridik është para përgjegjësisë penale dhe atë e ka inkriminuar në nenin 3, ku thuhet personi juridik ka përgjegjësi penale për vepra të kryera penale:

- Në emër e në dobi të tij , nga organet dhe përfaqësuesit e tij,

250 Shih: Ligji për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë në Shqipëri, me nr. 9754 i datës 14.6.2007.

251 Fana. Neshat, *“Përgjegjësia Penale e Personave Juridikë”* Tema e masterit në Universitetin e Tiranës, faqe 36.

- Në emër ose në dobi të tij, nga një person që është nën autoritetin e personit që përfaqëson, drejton dhe administron personin juridik,

- Në emër ose në dobi të tij, për shkak të mungesës së kontrollit apo të mbikëqyrjes nga personi që drejton, përfaqëson apo administron personin juridik²⁵².

Nga elementet themelore, të veprës penale mund të konstatojmë se për të ekzistuar përgjegjësia penale e personave juridikë duhet të plotësohen njëkohësisht dy kriteret: kryerja e veprës penale në emër dhe në dobi të personit juridik, mungesa e njërit nga këto elemente do të përjashtonte përgjegjësinë penale.

Mirëpo, doktrina botërore ka theksuar se një shoqëri tregtare nuk përgjigjet për çdo vepër penale por vetëm ato që sjellin përfitim ekonomik²⁵³. Nëse e krahasojmë në raport me elementet e veprës penale, që duhet të përmbushen të përgjegjësia penale e personave juridikë në Kosovë, ka pak ndryshime. Kriteret e para janë të njëjta, ndërsa ndryshime ka vetëm se në Kosovë personi juridik është përgjegjës edhe në rastin kur personi që ka kryer veprën penale nuk është dënuar për atë vepër.

Sipas ligjit rrethi i subjekteve që kryejnë veprën penale përfshinë dy nivelet e punonjësve, ata të cilët drejtojnë apo administrojnë me personin juridik dhe kategoria e punonjësve që janë nën autoritetin e personit juridik, që për mendimin, ligjvënësi shqiptar ka vepruar drejt sepse mospërfshirja në përgjegjësi penale e punëtorëve nën varësinë e personit juridik do të krijonte mundësi shpeshherë që personi juridik të bartë përgjegjësinë apo fajësinë të kjo kategori. Në të njëjtën mënyrë është shprehur edhe Gjykata e Lartë e Japonisë, e cila ka vendosur se: personat juridikë duhet të hartojnë

252 Shih: Ligji për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë të Shqipërisë, me nr. 9754, i datës 14.6.2007, neni 3. Marrë nga: <http://www.pp.gov.al/ve...> (parë më 11.6.2015).

253 Dr. Av Buzheku. Ersi N. & Elezi. Ismet, *Përgjegjësia Penale e Personave Juridik*, Botimet Toena Tiranë, 2012, fq. 45.

politika dhe të ndërmarrin veprime për të parandaluar punonjësit e tyre që gjatë kryerjes së detyrave të punës të mos kryejnë vepra penale. Nëse personi juridik ka qëndrim neglizhent ndaj këtyre politikave atëherë ai do të jetë penalisht përgjegjës për neglizhencën që ka treguar për të mbikëqyrur punën e vartësve të tij²⁵⁴. Sipas mendimit tim ligji në mënyrë të qartë ka rregulluar elementet themelore të përgjegjësisë penale të personave juridikë, ajo që mbetet e paqartë në ligj është mospërcaktimi se për cilat vepra penale. Ne kujtojmë ligji ka lënë pa rregulluar një çështje shumë delikate, se a mund të mbetet vepra penale e personit juridik në tentativë? Konsideroj që këtë institut e ka rregulluar mirë Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridikë në Kosovë në nenin 7, ku thuhet se tentativa është e dënueshme, gjithashtu në legjislacionin e Kosovës është parapa edhe instituti i dënimit me kusht në nenin 12²⁵⁵.

Mungesa e kësaj dispozite ligjore në ligjin shqiptar lë një mangësi në aplikimin e sanksioneve penale, gjë që nuk arrihet qëllimi i përmirësimit në funksionimin e personave juridikë. Nga përmbajtja e ligjit shqiptar shihet se nga përgjegjësia penale e personave juridikë janë përjashtuar institucionet shtetërore.

Mirëpo pavarësisht këtij përjashtimi, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë: në nenin 45 parag. 2 parashikon “Njësitë e qeverisjes vendore përgjigjen penalisht vetëm për veprimet e kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, të cilat mund të ushtrohen nëpërmjet delegimit të shërbimeve publike”. Të njëjtën gjë e ka paraparë edhe legjislacioni kosovar, ku në nenin 4 pika 3 thuhet “Republika e Kosovës, organet e administratës shtetërore, dhe të vetëqeverisjes lokale dhe organizatat e huaja qeveritare

254 Bala. Eriselda, *Dënimi penal i personave juridikë*, 3 gusht 2012. Marrë nga: <http://drejtesiashqiptare.com/?p=1856> (parë më 20.01.2014).

255 Shih: Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Veprat Penale të Kosovës, nr. 04/L-030,31 gusht 2011. neni 7 dhe 12.

që veprojnë në Kosovë nuk përgjigjen penalisht për veprat penale, por vetëm personi përgjegjës i tyre mban përgjegjësi penale”.

Sa i përket politikës ndëshkimore ligji nga neni 8 deri te neni 19, ka paraparë dënimet që aplikohen ndaj personave juridikë. Ndarja e dënimeve bëhet konform dispozitave të nenit 29 dhe 30 të Kodit Penal të Shqipërisë në:

- dënime kryesore , dhe
- dënime plotësuese.

Ndaj personave juridikë, që kanë përgjegjësi për kryerjen e veprës penale si dënime kryesore, shqiptohen këto dënime:

- Dënimi me gjobë dhe
- mbarimi i personit juridik (që në parim është ekuivalent me dënimin me vdekje për personin fizik).

Nëse bëjmë një krahasim të sistemit të ndarjes së dënimeve, shohim se legjislativi në Kosovë dhe Shqipëri më tepër ka preferuar dënimin me gjobë që të mos lejojë destabilitet në fushën ekonomiko financiare, ndërsa ligjvënësi me qëllimi nga ky dënim ka përjashtuar personat juridikë-publikë, (institucionet shtetërore) që është e logjikshme sepse ekzekutimi i dënimeve ndaj personave juridikë-publikë do të ishte i pamundur dhe me pasoja edhe në aspektin e organizimit institucional dhe kushtetues.

Dënimet plotësuese, sipas Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridikë në Shqipëri, që mund të aplikohen njëkohësisht me dënimet kryesore janë këto:

- Mbyllja e një apo më shumë veprimtarive apo strukturave të personit juridik,
- Vendosja e personit juridik nën administrim të kontrolluar,

- Ndalimi për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit për fondet publike,
- Heqja e së drejtës së marrjes së përdorimit dhe licencave, autorizimeve, koncesioneve ose subvencioneve,
- Ndalimi për të kërkuar publikisht fonde publike,
- Heqja e së drejtës për të ushtruar një ose më shumë veprimtarive ose operacioneve,
- Detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor²⁵⁶.

Dënimeve plotësuese përveç që mund të shqiptohen krahas dënimeve kryesore ndaj personit juridik, në raste të caktuara, mund të shqiptohen edhe dy dënime plotësuese. Dënimi me të holla shqiptohet nga 300 mijë lekë për kryerjen e një kundërvajtje penale e deri në 50 milionë lekë për dënimet me burgim të përjetshëm. Mbarimi i personit juridik si dënim vjen në shprehje kur ai është krijuar me qëllim që të kryejë vepra penale apo në një masë të madhe e ka përdorur veprimtarinë e tij për të, i shërbyer kryerjes së veprave penale etj.

Si dënim plotësues ligji ka paraparë edhe vendosjen e personit juridik nën administrim të kontrolluar për një kohë nga një deri në 5 vjet, me qëllim të efektit parandalues. Kjo masë zbatohet kur personi juridik pajtohet me veprën penale të kryer. Kjo masë vjen në shprehje për personat juridikë që kryejnë shërbime në interes të përgjithshëm për qytetarët dhe mbarimi i tyre do të sillte pasoja të mëdha ekonomike në punësim, zhvillim ekonomik, mbrojtje të mjedisit etj.

Instituti i rehabilitimit është aplikuar edhe për personat juridikë dhe kjo mundëson

256 Shih: Ligji për Përgjegjësinë Penale të personave juridikë të Shqipërisë, me nr. 9754 i datës 14.6.2007, neni 10.

që nëse personi juridik brenda 5 viteve nuk ka kryer ndonjë vepër të re penale konsiderohet i padënuar. Ligji “Përgjegjësia Penale e Personave Juridikë”, në Shqipëri, sa i përket dënimeve ka mangësi sepse nuk ka paraparë dënimin me kusht që e kanë shumë ligje të shteteve evropiane e posaçërisht edhe Kosova, pastaj nuk e ka rregulluar çështjen e veprës penale në tentativë dhe sanksionin penal për këtë çështje. Por, në përgjithësi, mund të thuhet se kjo fushë është e legjitimuar, ndryshimi apo plotësimi eventual i ligjit do të ndikonte pozitivisht në plotësimin e instituteve që janë lënë jashtë tij.

4.3. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në disa shtete të Evropës

Koncepti i përgjegjësisë penale për personat juridikë tanimë ekziston në shumicën e shteteve të Evropës dhe dilemat rreth çështjes se a kanë përgjegjësi penale personat juridikë tani janë të kaluara. Problemi mbetet tek fakti se cili nga subjektet juridike (personi fizik apo juridik), janë objektivë e parë e ligjit. Për këtë fakt ka mendime dhe konceptime të ndryshme në demokracinë evropiane. Gjeneza për rregullimin e përgjegjësisë penale të personave juridikë me ligj lindi si nevojë pas industrializimit dhe fuqizimit të korporatave që kishin marrë një pjesë të madhe të tregut. Fillimisht ky institut për përgjegjësinë penale të personave juridikë edhe pse i vonuar u paraqit në shekullin XX, si nevojë e penalizimit të veprimeve të korporatave në shtetet anglosaksone: SHBA, Kanada, Mbretëria e Bashkuar etj. që kishin fituar fuqi ekonomike të madhe në vend dhe mund të ndikonin edhe në rritjen e krimit ekonomik.

Andaj, korporatat u vunë para përgjegjësisë penale në vitin 1842 në SHBA²⁵⁷. Në të njëjtin drejtim, sa i përket përgjegjësisë penale, shkon edhe Australia. Procedimi penal i korporatave (personave juridikë), shikohet si një mjet për të testuar “kulturën tregtare” të personave juridikë, vënia në zbatim e rregullave, politikave afariste nga korporatat²⁵⁸.

Ndërsa, evropianët këtë institut e parashikuan me skepticizëm të madh, për faktin se ata mendojnë se vetëm personat fizikë janë subjekt të së drejtës, (teoria e fiksionit). Gjithashtu, skepticizëm kishte edhe me rastin e aplikimit të dënimit, duke pasur parasysh që dënimi është individual ndërsa te personi juridik i godet të gjithë anëtarët e personit juridik, që është në kundërshtim me parimet e drejtësisë se personat e pafajshëm nuk duhet dënuar. Shto këtu parimin se përgjegjësia penale është personale dhe dënimi ka qëllim riedukues, duke synuar rehabilitimin moral të të dënuarve me burgim²⁵⁹.

Ky është një argument shtesë i skepticizmit, duke pasur parasysh faktin që dënimi me burgim nuk aplikohet ndaj personit juridik. Koncepti i përgjegjësisë penale te personat juridikë jo vetëm që ndryshon nga ai i shteteve anglosaksone, por ai ndryshon brenda edhe vetë shteteve të Evropës. Në Francë përgjegjësia penale e korporatave është e përcaktuar me ligj për shembull: prezantimi i kontabilitetit fiktiv, dividendët fiktivë etj. Në Gjermani dominon mendimi se përgjegjësia penale është e tepërt, ngase mjafton ajo administrative. Zvicra gjithashtu qartë përcakton me ligj se kur korporatat mund të përgjigjen penalisht si për shembull për aktivitete kriminale, financim të terrorizmit etj.

257 Ndrepepaj. Valbona, *Përgjegjësia penale e personave juridik*, 19 mars 2012. Marrë nga: <http://drejtesiashqiptare.com/?p=1669> (parë më 25.2.2014).

258 Tashi. Igli, Tregu i pamonitoruar, Revista “Monitor”, botuar në Media Union, Tiranë, 2007.

259 Qerekja. Besnik, *Përgjegjësia Penale e Personave Juridikë në këndvështrimin e legjislacionit penal shqiptar*, Revista: Studime Juridike, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2009. fq. 239.

Andaj, ndryshimet në legjislacionet penale evropiane nxitën edhe përcaktime të reja të Bashkimit Evropian dhe atë në dy drejtime: në ashpërsinë e politikave të përgjegjësisë penale të organeve dhe përfaqësuesve të personit juridik dhe përgjegjësinë e personave juridikë si subjekt i së drejtës. Konventa “Për mbrojtjen e interesave financiare të BE” e vitit 1995, rumbullakon konceptin kryesor për përgjegjësinë penale të personat juridikë, që duhet të zbatohet në vendet anëtare²⁶⁰.

Në vazhdim do të krahasojmë legjislacionin “Për përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë” të disa shteteve të Evropës dhe shteteve të Ballkanit për të paraqitur një vështrim krahasimor, ku do të shiheshin anët pozitive apo negative të ligjeve, mungesa e instituteve si dhe politika ndëshkimore.

4.4. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Francë

Përgjegjësia penale e personave juridikë në Francë është paraparë në Kodin Penal të Francës të vitit 1994²⁶¹. Instituti i përgjegjësisë penale i personave juridikë ishte debatuar si problem që nga mesi i shekullit 20, por për herë të parë është paraparë në kodin penal francez në vitin 1992. Neni 121-2, ka paraparë përgjegjësi penale për të gjithë personat juridikë, përveç shtetit. Përgjegjësia penale e personave juridikë e paraparë në nenin 121-4 dhe 121-7, (në rastet e parapara me ligj apo akte me fuqi

260 Ndrepepaj. Valbona, *Përgjegjësia penale e personave juridikë*, 2012. Marrë nga: <http://drejtesia.shqiptare.com/?p=1669> (parë më 25.2.2014).

261 Kodi Penal i Francës i vitit 1994, Gazeta zyrtare e Republikës së Francës (JORF), nr. 298. Marrë nga: <http://legifrance.gouv.fr> (parë më 20. 08. 2014).

ligjore)²⁶², mund të fillohet nëse plotësohen kumulativisht dy kushte:

- Vepra penale të jetë kryer nga organi ose përfaqësuesi i personit juridik dhe
- në dobi të personit juridik.

Përgjegjësia penale e personit juridik nuk e përjashton përgjegjësinë penale të personit fizik, qoftë si autor apo bashkautor në kryerjen e veprës penale²⁶³. Përgjegjësia penale aplikohet ndaj personave juridikë privatë të cilët e kanë statusin e personit juridik, pavarësisht faktit se a e ushtrojnë veprimtarinë e tyre për fitim. Gjithashtu kjo përgjegjësi aplikohet edhe ndaj personave juridikë publikë, me përjashtim të shtetit dhe komunave kur këto të fundit kryejnë shërbime me interes publik. Neni 121-4 përcakton se kryerësi i veprës penale konsiderohet personi që kryen veprim të inkriminuar penalisht apo tenton të shkaktojë dëm, andaj nga kjo shihet qartë se ligji nuk ka një specifikim të qartë për të përcaktuar bazën mbi të cilën mbështetet përgjegjësia e personit juridik. Pra, nuk është sqaruar fakti se a duhet të marrë dobi personi juridik nga vepra penale e kryer, gjithashtu nuk është përcaktuar kriteri i përgjegjësisë penale të personit juridik mbi parimin e përgjegjësisë personale apo fajësisë. Përgjegjësia penale e personave juridik në Francë është përgjegjësi objektive²⁶⁴.

Personi juridik mund të kryejë veprën penale edhe nga pakujdesia (neni 121-3). Tentativa për veprën penale është e dënueshme (neni 121-5). Franca, për dallim nga disa shtete të Evropës, por edhe Kosovës, në ligj përcakton qartë përgjegjësinë penale të korporatave, e cila vjen në shprehje kur ato prezantojnë kontabilitet fiktiv, kur ata

262 Shkëputje nga teksti në ndryshimet e Kodit Penal të Francës, të vitit 1994, hyrja në fuqi më 25.12.2005.

263 Bozheku. Ersi & Elezi. Ismet: "Përgjegjësia Penale e Personave Juridikë", botimet "Toena", Tiranë, 2012, kreu III, fq. 282.

264 Po aty., fq. 283.

vlerësojnë jorealisht aktivitetet e korporatës, pastaj për cilësinë e produkteve, abuzimet me fonde etj. Pra, Franca ka aplikuar modelin e përgjegjësisë penale të personave juridikë në kaskat. Dënimet që mund t'i shqiptohen personit juridik në rast të kryerjes së veprës penale janë :

- Dënimi me gjobë,
- Ndalimi për ushtrimin e aktiviteteve përkohësisht apo përfundimisht,
- Mbyllja e personit juridik përkohësisht apo përfundimisht e sektorit të caktuar që ka kryer veprën penale,
- Vendosja e personit juridik nën administrimin e kontrolluar,
- Ndalimi për të realizuar pagesat e ndryshme me para apo forma tjera të pagesës-çeqeve,
- Konfiskimi i dobisë pasurore dhe mjeteve të fituara me vepër penale,
- Publikimi i vendimeve,

Franca këtë institut e ka të rregulluar në Kodin Penal të saj, për dallim që shumica e vendeve si Kroacia, Serbia, Italia dhe Kosova, që kanë ligje të posaçme për përgjegjësinë penale të personave juridikë.

Dallimi thelbësor që ekziston sa i përket legjislacionit të Francës dhe Kosovës për këtë institut është sistemi i përgjegjësisë penale. Kosova ka pranuar sistemin e përgjegjësisë penale të përgjithshme të personit juridik²⁶⁵, ndërsa Franca ka përcaktuar shprehimisht se cilat shkelje të ligjit sjellin para përgjegjësisë penale personin juridik. Sa i përket dënimeve, dallimi ekziston në faktin që Franca në legjislacionin e saj nuk e

265 Sipas Ligjit “Përgjegjësia e Personave Juridikë për Vepra Penale në Kosovë me nr. 04/L-030, parashihet se përgjegjësia penale e personave juridikë mund të aplikohet për kryerjen e çdo vepre penale.

ka paraparë dënimin me kusht, ndërsa ligji ynë e ka paraparë në nenin 12, kurse një pjesë e dënimeve si ndalimi i kryerjes së veprimtarisë, marrja e sendit, konfiskimi i dobisë pasurore janë paraparë në kuadër të masave të sigurisë neni 13)²⁶⁶.

4.5. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Itali

Italia për herë të parë institutin e përgjegjësisë penale të personave juridikë e kishte paraparë me ligjin nr. 231, të miratuar më 8 qershor 2001, në mbështetje të parimeve të kërkuara nga Bashkimi Europian²⁶⁷. Nga ky moment për herë të parë drejtpërsëdrejti ishte paraparë përgjegjësia e kompanive, subjekteve tjera, drejtuesve dhe vartësve të tyre kur veprojnë në emër të personit juridik, në dobi të tij dhe kanë realizuar veprimin e kundërligjshëm.

Në Itali edhe pse procedura për përgjegjësinë penale është e bazuar në kodin e procedurës penale Italiane, ligji ka paraparë përgjegjësinë administrative dhe jopenale për personat juridikë që kryen vepra penale²⁶⁸. Ligji përgjegjësinë penale të personit juridik e mbështet mbi parimin e përgjegjësisë personale - fajësisë që është konform nenit 27, parag. 1, të Kushtetutës së Italisë²⁶⁹. Në Itali duhet të plotësohen këto kushte për përgjegjësinë penale të personave juridikë sipas ligjit nr. 231/2001:

266 Po aty, neni 13.

267 Shih: Dekreti legjislativ nr. 231/01 i datës 8.6.2001, të Republikës së Italisë. Marrë nga: https://it.m.wikipedia.org/wiki/Responsabilit _penale_degli_enti#Italia (par  m  11.6.2014).

268 Dr. Av. Bozheku. Ersi & Dr. Elezi. Ismet: *"P rgjegj sia Penale e Personave Juridik "*, botimet "Teona", Tiran , 2012, kreu III, fq. 288.

269 Shih: Kushtetuta e Italis , ku n  nenin 27 paragrafi 1 thuhet "P rgjegj sia penale  sht  personale", q   sht  n  p rputhje me parimet e s  drejt s penale se p rgjegj sia penale  sht  individuale dhe mb shtetet mbi parimin e faj sis  si element themelor i  do vepr  penale. Marr  nga: <http://wwwext.comune.fi.it/costituzione/albanese.pdf> (11.06.2014).

- Vepra penale duhet të jetë kryer nga personi fizik, pavarësisht a është ai drejtues apo vartës,

- Vepra penale të jetë kryer në dobi dhe interes të personit juridik dhe kjo dobi të jetë e paligjshme.

Nga përgjegjësia penale janë përjashtuar sipas ligjit nr. 231/2001 i dt. 8 qershor 2001, shteti, organet e qeverisjes lokale, partitë politike, sindikatat. Sipas ligjit nga fajësia²⁷⁰, janë përjashtuar personat juridikë nëse:

- vërtetohet se ai përmes personave përgjegjës ka vepruar me efikasitet, ka pasur organizim të mirëfilltë për të penguar kryerjen e veprës penale,

- nëse individët që kanë kryer veprën penale e kanë kryer për interes të tyre të veçantë apo për interes të personit të tretë dhe nuk lidhet me interesin apo avantazhin e kompanisë,

- Kur personi juridik ka emëruar një organ të pavarur për kontroll dhe mbikëqyrje

- Nuk ka pasur mungesë të mbikëqyrjes nga ana e organit të kontrollit.

Legjislacioni italian ka paraparë modelet organizative në kompani si bazë për të vërtetuar fajësinë apo jofajësinë e personave juridikë për veprën penale, pra modeli organizativ është detyrim për menaxhmentin e një kompanie. Në Itali është bërë një sondazh në shoqatën e korporatave, ku 77% e kompanive²⁷¹ kanë deklaruar se kanë *adoptuar* ose janë në procesin e *adoptimit* të modelit organizativ.

270 Bozheku. Ersi, *Probleme interpretuese dhe aspekt krahasuese me legjislacionin italian*, Revista shkencore, *Përgjegjësia penale e personave juridikë*, Revista shkencore, Ligji dhe shoqëria, Fakulteti Juridik, Tiranë, nr. 4/2010. fq. 204.

271 Shih: Sondazhi i korporatave në Itali në linkun. Marrë nga: www.cliffordchance.com për më gjerë informata shfrytëzoni Mc Dermott www.mëe.com (parë më 20.7. 2014).

Sa i përket politikës ndëshkimore ligji nr. 231/2001 në nenin 9 ka paraparë këto dënime që mund t'i shqiptohen personit juridik;

- Dënimi me gjobë,
- Sanksione ekonomike,
- Dënime plotësuese,
- Konfiskimi i dobisë pasurore,
- Publikimi i vendimeve.

Nëse personi juridik ka arritur të përfitojë një dobi pasurore të konsiderueshme dhe vepra penale është kryer nga drejtuesit e personit juridik, ose vepra penale është kryer si pasojë se ka mangësi organizuese, ose kur personi juridik në vazhdimësi ka kryer vepra penale, atëherë në këto raste mund të shqiptohen dënime plotësuese si ndërprerje e aktivitetit të personit juridik, heqja apo pezullimi i lejeve, ndalimi që personi juridik të ketë lehtësime ekonomike, donacione apo kontribute, ndalimi për të bërë publikimin dhe reklamimin e mallit. Ndërsa, masa e administrimit të kontrolluar ndaj personit juridik vjen në shprehje në rastet kur personi juridik kryen shërbime në interes të përgjithshëm dhe nëse do të ndërpritej veprimtaria e tij do të ishte me pasoja për shoqërinë. Italia ka treguar rezultat pozitiv në zbatimin e ligjit 231/2001, ngase numri i padive²⁷² të ngritura ndaj korporatave dhe kompanive të vogla është në rritje.

Ne kujtojmë se, ligji italian nr. 231/2001 i dt. 8 qershor 2001, parasheh përgjegjësi administrative e jo përgjegjësi penale për personin juridik.

Një dallim që ekziston në mes të këtyre ligjeve është se në Itali personi juridik

272 Shih: Numri i padive të ngritura në Itali ndaj korporatave dhe kompanive të vogla në linkun. Marrë nga: www.cliffordchance.com - corporate liability in Europe (parë më 20.7.2014).

lirohet nga përgjegjësia kur personi fizik ka vepruar për interesin e tij të veçantë apo në interes të personit të tretë, ndërsa në Kosovë personi juridik përgjigjet edhe në rastet kur personi fizik ka vepruar në kundërshtim me politikat dhe urdhrin e personit juridik, kjo nënkupton që ligjvënësi kosovar nuk e ka marrë parasysh fajësinë si element themelor subjektiv²⁷³, pra nuk i ka dhënë mundësi personit juridik për të kundërshtuar përgjegjësinë edhe në rastet kur ai nuk e ka dashur as dobinë pasurore dhe as kryerjen e veprës penale.

Gjithashtu Ligji për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridike në Kosovë, për dallim nga ai italian, ka paraparë përgjegjësi për personin juridik edhe për veprat e mbetura në tentativë nëse shprehimisht janë paraparë me ligj (neni 7). Gjithashtu neni 17, ka paraparë mundësinë që vepra penale të kryhet edhe përmes formave si ndihmës, shtytjes, nevojës ekstreme që janë të parapara në pjesën e përgjithshme në dispozitat e kodit penal²⁷⁴ e që nuk janë paraparë në ligjin italian.

Sa i përket dënimeve konsideroj që dy ligjet kanë ngjashmëri dënimi, kryesore janë dënimi me gjobë dhe mbarimi i personit juridik, ndërsa ligjvënësi kosovar ka paraparë edhe dënimin me kusht.

273 Shala. Afrim, *Hyrje në të Drejtën Penale*, Qendra juridike e Kosovës, Prishtinë, 2011, fq. 20.

274 Shih: Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e R.K. nr. 19/13), korrik 2012, neni, 13-32-33.

4.6. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Kroaci

Koncepti i përgjegjësisë për personat juridikë në Kroaci në aspektin normativ ishte trajtuar që nga vitet e 50-ta, në kuadër të ligjeve jugosllave²⁷⁵. Si sanksion i vetëm ishte paraparë konfiskimi i pasurisë²⁷⁶. Ndikimi i mjeteve të informimit publik dhe opinionit publik në dhjetë vitet e fundit në Kroaci dhe obligimet që dolën nga konventat ndërkombëtare të Këshillit të Evropës²⁷⁷, detyruan ligjvënësit kroatë që për herë të parë me ligj të posaçëm të rregullojë institutin për “përgjegjësinë penale të personave juridikë për vepra penale”²⁷⁸.

Kroacia, deri në vitin 1973, ka aplikuar modelin e supsidiaritetit që ka nënkuptuar se personi juridik për veprimet e dënueshme ka pasur përgjegjësi, ndërsa vetëm kur nuk është arritur të vërtetohet përgjegjësia e personit juridik, atëherë procedura ka filluar ndaj personit fizik. Sipas ligjit aktual Kroacia përdor sistemin kumulativ të përgjegjësisë që nënkupton përgjegjësi penale për personin juridik dhe fizik. Përgjegjësia e personit juridik bazohet në fajësinë e personit përgjegjës (neni 5, parag. 1), gjithashtu personi juridik dënohet për veprat penale të personit përgjegjës edhe në rastet kur vërtetohet ekzistimi i pengesave ligjore dhe të vërteta për të vërtetuar përgjegjësinë e personit përgjegjës (neni 5, paragrafi 2). Në të gjitha shtetet, ku është paraparë ky institut por

275 Ligji për pengimin e spekulimit të palejuar dhe sabotimin ekonomik nga viti 1945 dhe ligji për veprat penale kundër popullit dhe shtetit nga viti 1947.

276 Ligji për pengimin e spekulimit të palejuar dhe sabotimin ekonomik i dt. 23.04.1945, neni 9, parag. 3, (Fletorja zyrtare RSFJ, nr. 26/45).

277 Konventa penalo-juridike “Për pengimin e korrupsionit”, e Këshillit të Evropës (1999), Konventa “për mbrojtjen e ambientit” në aspektin e të drejtës penale (1998). Marrë nga: <http://www.akk-ks.org/index.php?cid=1.44> (parë më 13.8.2014).

278 Ligji për “Përgjegjësia e Personave Juridike për Vepra Penale” në Kroaci, dt. 24 shtator 2003, (Gazeta zyrtare nr. 151). Marrë nga: <http://www.zakon.hr/z/110/Zakon-o-odgovornosti-pravnih-osoba-za-kaznena-djela> (parë më 24.7.2014).

edhe në shtetin kroat, mbisundon doktrina botërore se personi juridik nuk mund të përgjigjet për çfarëdo vepër penale, por vetëm për ato vepra penale të cilat sjellin përfitim ekonomik²⁷⁹, ndërsa sa i përket, (nenit 5, parag. 2), ligji kroat është në harmoni me paragrafin 2 të Konventës së Brukselit²⁸⁰, e datës 26.05.1995, ku precizohet se shteti ka obligim që të vendosë masa të përshtatshme, në mënyrë që ai të deklarohet përgjegjës në rast të mungesës së kontrollit, që ka bërë të mundur realizimin e korrupsionit dhe veprave të tjera penale në llogari të personit juridik. Nga përgjegjësia penale është përjashtuar shteti kroat dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale me kusht që këto të fundit të mos kenë kryer vepra penale jashtë veprimtarisë së tyre, (neni 6, parag. 1 dhe 2). Dënimet dhe sanksionet penale që mund t'i shqiptohen personit juridik janë:

- Dënimi me gjobë dhe
- përfundimi i personit juridik.

Përfundimi i personit juridik konsiderohet dënimi më i rëndë dhe ky dënim vjen në shprehje vetëm në rastet kur personit juridik është krijuar me qëllim të kryerjes së veprave penale, apo veprimtaria e tij ka qenë në një masë të madhe në shërbim të kryerjes së veprave penale (neni 12) për shembull eksportimi i lëndëve narkotike, skemat piramidale etj. Ligji gjithashtu ka paraparë dënimin me kusht dhe masat e sigurisë, ndërsa konfiskimi i dobisë pasurore të personit juridik të fituar me vepër penale bëhet në bazë të dispozitave të (nenit 77), të kodit penal kroat²⁸¹. Dobia pasurore mund t'i merret edhe personave të cilët është bartur pasuria në qoftë se nuk është

279 Dr. Av. Bozheku. Ersi & Dr. Elezi. Ismet: *"Përgjegjësia penale e personave juridikë"*, botimet "Teona", Tiranë, 2012, fq. 45.

280 Shih: Konventa e Brukselit e datës 26.5.1995, e përgatitur në bazë të nenit K-3, të Bashkimit Evropian, Mbi mbrojtjen e interesave financiare të komuniteteve evropiane". Marrë nga: <http://www.akk-ks.org/index.php?cid=1,44> (parë më 27.7.2014).

281 Shih: Kodi Penal i Kroacisë, i miratuar me datë 21 tetor 2011, (Gazeta zyrtare nr. 125/11 dhe 144/12. Marrë nga: <http://legislationline.org/documents/section/criminal-codes> (parë më 22.5.2014).

krijuar me mirëbesim. Legjislacioni kroat “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, është në përputhje të plotë me kriteret që i kërkojnë standardet e Bashkimit European. Gjatë krahasimit me ligjin e Kosovës “Për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale”, mund të konkludojmë se nuk ka ndryshime përmbajtjesore, përveç që në ligjin tonë në kuadër të masave të sigurisë është paraparë edhe konfiskimi i dobisë pasurore (neni 13, parag. 1, pika 1.3), ndërsa ky dënim në Kroaci është paraparë vetëm në kodin penal (nenin 77). Gjithashtu në ligjin kroat nuk është paraparë tentativa për kryerjen e veprës penale.

4.7. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Slloveni

Sllovenia pas shkëputjes nga Jugosllavia dhe shpalljes së pavarësisë në vitin 1991, kishte filluar nxjerrjen e ligjeve të saja. Akti i parë në Slloveni që ka paraparë përgjegjësinë e personave juridikë për kundërvajtje penale ishte ai vitin 1999²⁸², që u pasua me ndryshimet për përgjegjësinë penale të personave juridikë me ligjin e vitit 2004²⁸³ dhe 2008²⁸⁴.

Në nenin 4 të Ligjit për përgjegjësinë penale të personave juridikë të vitit 2008 janë paraparë kushtet të cilat sjellin para përgjegjësisë penale personin juridik dhe atë:

282 Akti mbi përgjegjësinë e personave juridikë për kundërvajtje penale (Gazeta zyrtare e R. së Sllovenisë, nr. 59/99) i dt. 23.7.1999.

283 Ligji për ndryshimin e ligjit për përgjegjësi penale të personit juridik (Gazeta zyrtare e R. së Sllovenisë me nr. 50/04) i dt. 6.5.2004. Marrë nga: <http://www.uradni-list.si/1/content?id=51152> (parë më 24.5.2014).

284 Ligji për ndryshimin e ligjit për përgjegjësi penale të personit juridik (Gazeta zyrtare e R. së Sllovenisë, me nr. 65/08) i dt. 30.6.2008. Marrë nga: http://www.mp.gov.si/si/zakonodaja_in_dokumenti/veljavni_predpisi/s_pravosodja/kazenska_in_zakonodaja_podrocja_varstva_osebni_h_podatkov/ (parë më 25.04.2014).

- kur kryerësi kryen veprën penale në emër dhe dobi të personit juridik,
- Në qoftë se veprimi i paligjshëm kundër rendit nga kryerësi është bërë me vendim të menaxhmentit, organeve drejtuese apo mbikëqyrëse të personit juridik,
- Në qoftë se menaxhmenti ose mbikëqyrësi kanë ndikuar apo nuk e kanë penguar kryerësin në kryerjen e veprës penale,
- Në qoftë se personi juridik ka krijuar të ardhura nga kryerja e veprës penale,
- Në qoftë se organet drejtuese apo mbikëqyrëse kanë detyruar punonjësit e tyre vartës të braktisin veprimtarinë e ligjshme,

Amendimi i fundit i ligjit për përgjegjësinë penale të personave juridikë në vitin 2012,²⁸⁵ ka sjellë risi sa i përket përgjegjësisë penale për personat juridikë, neni 1 i ligjit ka paraparë se ”Personi juridik është penalisht përgjegjës për vepër penale sipas kushteve të parapara në kodin penal²⁸⁶”.

Përgjegjësia penale e personit juridik nuk do të përjashtojë përgjegjësinë penale të individëve apo personave përgjegjës që kanë kryer veprën penale. Gjithashtu personi juridik përgjigjet për vepër penale nga pakujdesia nën kushtet e nenit 4, paragrafi 4 (neni 5 i ligjit). Nga përgjegjësia penale janë të përjashtuar shteti dhe organet e vetëqeverisjes lokale, kurse përgjegjësi penale mbajnë personat juridikë vendës dhe të jashtëm për veprat e kryera në territorin e Sllovenisë. Personi juridik mund të përgjigjen për vepër penale të kryer edhe jashtë territorit të Sllovenisë me kusht që vepra penale të jetë kryer ndaj shtetit slloven apo qytetarëve të saj (neni 3). Tentativa për kryerjen e

285 Ndryshimet e ligjit për përgjegjësinë penale të personave juridikë (Gazeta zyrtare e R. së Sllovenisë. nr. 98/04, me korrigjimet nr. 65/08) i dt. 26.7.2012. Marrë nga: http://www.mp.gov.si/si/zakonodaja_in_dokumenti/veljavni_predpisi/s_pravosodja/kazenska_in_zakonodaja_podrocja_varstva_osebni_h_podatkov/ (parë më 25.4.2014).

286 Shih: Kodi Penal i Sllovenisë.

veprës penale është e dënueshme nëse është paraparë shprehimisht me ligj (neni 8). Nëse dy apo më shumë persona juridikë e kryen në bashkëpunim veprën penale përgjigjen për bashkëkryerje (neni 10).

Përgjegjësia penale e personave juridikë është inkriminuar në kodin penal slloven të vitit 2008²⁸⁷ (neni 42). Në bazë të kësaj dispozite ligjore, përgjegjësia penale ekziston kur kryerësi vepron në emër apo dobi të personit juridik, ndërsa paragrafi 2 parasheh se përgjegjësia penale e personit juridik nuk e përjashton përgjegjësinë penale të personit fizik si kryerës, nxitës, apo bashkëpunëtor në kryerjen e veprës penale. Në teori ekzistojnë tre qëndrime për përgjegjësinë penale të personave juridikë:

- sipas mendimit të parë personat juridikë nuk kanë përgjegjësi penale dhe asnjë përgjegjësi tjetër,
- sipas mendimit të dytë personat juridikë nuk kanë përgjegjësi penale por ata kanë përgjegjësi kundërvajtëse për shkelje në fushën ekonomike dhe
- teoria e tretë përgjegjësia penale e personave juridikë është e arsyetuar²⁸⁸.

Në Slloveni është zbatuar teoria e dytë, kurse nga hyrja në fuqi e ligjit për përgjegjësinë penale të personave juridikë të vitit 2008²⁸⁹, personat juridikë kanë përgjegjësi penale. Sanksionet penale që mund t'i shqiptohen personave juridikë në Slloveni janë paraparë në (nenin 12) dhe ato janë:

287 Shih: Kodi Penal i Sllovenisë, 2008, neni 42. Marrë nga:

<http://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/en/si/si045en.pdf> (parë më 25.04.2014).

288 Stojanović. Zoran, Krivično Pravo (Opsti Deo), Pravni Fakultet, Univeziteta u Beogradu, Beograd, 2006, fq. 192.

289 Shih: Ligji për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë (Gazeta zyrtare e Republikës së Sllovenisë), nr. 97/08.

- Dënimi me gjobë,
- Marrja e pasurisë,
- Mbarimi i personit juridik,
- Ndalimi i personit juridik të marrë pjesë në tenderët, prokurimin publik,
- Ndalimet që i bëhen personit juridikë në fushën tregtare dhe financiare.

Si dënim më i rëndë konsiderohet: mbarimi i personit juridik i cili dënim aplikohet kur veprimtaria e personit juridik ka qenë kryesisht ose tërësisht e organizuar për kryerjen e veprave penale (neni 15), dhe konfiskimi i pasurisë që mund t'i konfiskohet gjysma apo më shumë se gjysma e pasurisë kur vepra penale është e dënueshme më shumë se 5 vite(neni 14). Sllovenia ka afirmuar parimin se përgjegjësia penale e personit juridik është e pavarur nga përgjegjësia penale e personit fizik.

Për dallim nga ligji i Kosovës, i cili nuk e ka bërë të qartë dallimin ndërmjet fajësisë së personit juridik në raport me fajësinë e personit fizik d.m.th., sipas ligjit të Kosovës me një mënyrë është fshehur përgjegjësia objektive e cila ndeshet me parimin e fajësisë në kuptimin normativ, ndërsa ligji slloven këtë çështje e ka të rregulluar qartë nga fakti që personit juridik i jepet mundësia që të vërtetojë faktin që ai nuk e ka dëshiruar dobinë pasurore të realizuar me vepër penale. Ligji slloven ka paraparë në nenin 25 veprat penale shprehimisht të inkriminuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal Slloven për të cilat personi juridik mban përgjegjësi penale që dallon nga legjislacioni kosovar, ku përgjegjësia penale e personave juridikë është e përgjithshme. Sa i përket sanksioneve penale, që mund t'i shqiptohen personave juridikë dhe lartësia e tyre nuk vërehen dallime që vlen të theksohen.

4.8. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Maqedoni

Përgjegjësia penale e personave juridikë në Republikën e Maqedonisë ka kaluar nëpër disa faza pas Luftës së Dytë Botërore dhe inkriminimi i saj është paraparë në disa ligje²⁹⁰. Ligji për kundërvajtje në Maqedoni në vitin 1997, ka shfuqizuar ligjin për shkelje ekonomike të vitit 1960 dhe 1976, ku disa shkelje ekonomike i ka paraparë si kundërvajtje, ndërsa disa prej tyre i ka deroguar. Andaj me këto ndryshime në Maqedoni është pranuar koncepti ligjor sipas të cilit personat juridikë përgjigjen për veprat penale të kryera.

Maqedonia inkriminimin e veprimeve të personave juridikë për përgjegjësi penale e ka paraparë në Kodin Penal të vitit 2004²⁹¹. Personi juridik përgjigjet për vepër penale në qoftë se:

- vepra është kryer me veprimin apo lëshimet e personit mbikëqyrës të organit apo përgjegjës në personin juridik,
- Nëse vepra është kryer nga personi fizik i cili ka qenë i autorizuar të veprojë në emër të personit juridik dhe brenda autorizimeve të tij,
- Nëse veprën penale e ka kryer personi fizik, duke tejkaluar autorizimet e tij me qëllim që personi juridik të ketë dobi pasurore.

290 Shih: Ligji për pengimin e spekulimit të palejuar dhe sabotimin ekonomik, i vitit 1945, pastaj Ligji për veprat penale kundër popullit dhe shtetit i vitit 1947, ku përgjegjësia penale e personave juridikë parashihej vetëm shprehimisht me ligj, pastaj me Ligjin për shkeljet ekonomike të viti 1960 dhe 1976 që përgjegjësinë e ka kufizuar vetëm në shkelje ekonomike, ku për këto shkelje ka vendosur Gjykata Ekonomike.

291 Shih: Kodi Penal i Maqedonisë (Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë) nr. 19/2004) neni 28-a. Marrë nga: <http://www.pravda.gov.mk/documents/KRIVICEN%20ZAKONIK%20precisten%20%20tekst.pdf> (parë më 20.5.2014).

Sipas legjislacionit penal të Maqedonisë përgjegjësia penale e personit juridik nuk e përjashton përgjegjësinë penale të personit fizik që kryen veprën penale. Përgjegjësi penale përveç shtetit mbajnë të gjithë personat juridikë duke përfshirë edhe personat juridikë të huaj nëse e kryejnë veprën penale brenda territorit të Maqedonisë.

Në bazë të legjislacionit në fuqi Maqedonia ka përfaqësuar konceptin e përgjegjësisë së supozuar²⁹², që nënkupton se personi juridik përgjigjet për veprimet e organeve dhe personave që veprojnë në emër të tij. Sa i përket dënimeve ligjvënësi maqedonas ka përfaqësuar sistemin e thjeshtë të dënimit²⁹³ dhe masave të tjera për t'iu kundërvënë me sukses luftës kundër krimit në fushën ekonomike posaçërisht veprave penale si: shpëlarja e parave, korrupsioni, mashtrimi, shmangia e tatimit) etj.

Dënimet që mund t'i shqiptohen personit juridik janë:

- Dënimi kryesor (dënimi me gjobë) dhe
- Dënime sekondare, (ndalimi i personit juridik që të marrë pjesë në procedurat e tenderimit publik, ndalimi i personit juridik që të marrë licencën, lejen dhe autorizime tjera të parapara me ligj, ndalimi i subvencioneve dhe kredive të volitshme, ndalimi i kontratave për furnizim publik, ndalesa e përkohshme për të kryer veprimtari të caktuar, ndalesa e përhershme për të kryer veprimtari të posaçme, ndalesa për themelimin e personit juridik të ri, mbarimi i personit juridik).

Masat e tilla dhe dënimet janë paraparë në (nenin 96-a dhe 96-b në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë, të vitit 2004). Përveç këtyre dënimeve ligjvënësi maqedonas

292 Osmani. Afrim, “Përgjegjësia penale e personit juridik në Republikën e Maqedonisë”, Revista edukativo, kulturore dhe shkencore “Vepra”, <http://www.furkan.com.mk/VEPRA%2099.pdf> (parë më 20.5.2014).

293 Ndrepepaj. Valbona, *Përgjegjësia penale e personave juridikë*, 2012. Marrë nga: <http://drejtesiashqiptare.com/?p=1669> (parë më 25.02.2014).

ka paraparë edhe mundësinë për shqiptimin e dënimit me kusht dhe konfiskimin e pasurisë dhe dobisë pasurore (neni 96-d), ndërsa pushimi i personit juridik shqiptohet kur ai kryen veprën penale për të cilën është paraparë dënimi me burg jo më pak se 5 vjet, në këto raste mund të shqiptohet kumulativisht edhe dënimi me gjobë.

Nga krahasimi vërehet se përgjegjësia penale e personit juridik në Maqedoni është paraparë në kod penal, pra ligjvënësi maqedonas ende nuk ka nxjerr ligj të veçantë për këtë institut, sa i përket konceptit, Maqedonia ka pranuar parimin e përgjegjësisë së supozuar të personit juridik për veprimet e kryerësve apo përfaqësuesve të tij, për mendimin tim ka afirmuar parimin e pavarësisë së përgjegjësisë penale të personit juridik nga ajo e personit fizik. Sa i përket sanksioneve dënimi që mund t'i shqiptohet personave juridikë është i kufizuar në disa dënime dhe atë: dënime me të cilat përvetësohet pasuria, ndalimet e veprimtarisë dhe pushimi i personit juridik, ndërsa legjislacioni i Kosovës ka paraparë edhe masat e sigurisë që në parim janë të njëjta me dënimet sekondare të parapara në legjislacionin e Maqedonisë.

4.9. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Serbi

Përgjegjësia penale e personave juridikë si institut është relativisht i ri për shtetin e Serbisë, duke pasur parasysh se ky koncept ishte braktisur me ligjin e posaçëm penal të Jugosllavisë në vitin 1948 dhe Kodin Penal të Jugosllavisë, të vitit 1951, duke kaluar në një koncept të ri të përgjegjësisë për shkelje ekonomike të legjitimuar me ligjet e posaçme për shkelje ekonomike të vitit 1960 dhe 1976.

Që nga viti 2008, në Republikën e Serbisë ekziston ligji “Për Përgjegjësinë Penale

të personave juridikë”, ku në nenin 2 të ligjit thuhet se personat juridikë mund të përgjigjen për veprat penale nga pjesa e posaçme e kodit penal dhe ligjeve tjera, nëse janë plotësuar kushtet për përgjegjësinë penale të personave juridikë nga ky ligj²⁹⁴. Nga ky nen mund të konstatojmë se Serbia është përcaktuar për sistemin e përgjithshëm të përgjegjësisë penale, ku personi juridik përgjigjet penalisht për të gjitha veprat penale për të cilat mund t’i ngarkohen personit juridik e jo për sistemin e përgjegjësisë penale, ku personat juridikë kanë përgjegjësi vetëm për veprat e parapara shprehimisht me ligj.

Në nenin 3 të Ligjit për përgjegjësinë penale të personave juridikë të Serbisë thuhet: Republika e Serbisë, krahina autonome, organet e administratës shtetërore dhe lokale nuk përgjigjen për vepra penale si persona juridikë. Nga kjo përgjegjësi janë të përjashtuar edhe personat juridikë të cilëve me ligj u është besuar kryerja e autorizimeve juridike nëse kryejnë vepër penale gjatë ushtrimit të atyre autorizimeve. Pra, në Serbi nga përgjegjësia penale nuk janë të përjashtuar organizatat ndërkombëtare.

Nën përgjegjësinë e personit juridik konsiderohen personat fizikë nëse juridikisht apo faktikisht i janë besuar disa punë në kuadër të personit juridik, personat e autorizuar, apo personat që konsiderohen se janë të autorizuar të veprojnë në emër të personit juridik (neni 5, paragrafi 2). Kjo dispozitë është e bazuar në nenin 112, parag. 5 në Kodin Penal të Serbisë²⁹⁵. Pavarësisht kësaj baze ligjore Goran Ilić profesor i Fakultetit Juridik, në Universitetin e Beogradit, konsideron se duhet pasur kujdes se personat përgjegjës sipas (nenit 112, parag. 5 të Kodit Penal të Serbisë), mund të

294 Shih: Ligji për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridik, Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë nr. 97/2008, të dt. 27.10.2008. Marrë nga: <http://www.zavodsz.gov.rs/PDF/zakoni/24.Закон%20o%20одговорности%20правних%20лица%20за%20кривична%20дела.pdf> (parë më 05.04. 2014).

295 Shih: Kodi Penal i Serbisë (“Fletorja zyrtare RS”), nr. 85/2005, 88/2005, (plotësuar), 107/2005, (plotësuar), 72.2009, 111/2009 dhe 121/2012.

kryejnë vetëm ato vepra penale të parapara shprehimisht me ligj (si për shembull mosndërmarrja e masave për ruajtjen e ambientit jetësor, neni 261 i Kodit Penal të Serbisë), ndërsa në aspektin e dytë personi përgjegjës (nga neni 5, parag. 2), mund të kryej çfarëdo vepre penale për të cilën personi juridik mund të përgjigjet²⁹⁶.

Kushtet që duhet të plotësohen që personat juridikë të kenë përgjegjësi penale janë të parapara në nenin 6 të ligjit për përgjegjësinë e personit juridik të Serbisë:

- Personi juridik përgjigjet penalisht për veprat penale në kuadër të veprimtarisë së tij, ose për veprimet e personave të autorizuar, nëse personi juridik ka realizuar dobi.
- Përgjegjësia penale e personave juridikë ekziston edhe atëherë kur në mungesë të rregullave dhe kontrollit nga ana e personave përgjegjës është mundësuar kryerja e veprave penale në dobi të personit juridik nga ana e personit fizik, i cili vepron nën autorizimin dhe kontrollin e personit përgjegjës.

Tentativa për kryerjen e veprës penale është e dënueshme, nëse shprehimisht është paraparë me ligj. Sanksionet penale që mund t'i shqiptohen personave juridikë janë:

- Dënimet,
- Dënimi me kusht, dhe
- Masat e sigurisë të parapara në (nenin 12).

Dënimi më i rëndë që mund t'i shqiptohet personit juridik është përfundimi i tij, nëse konstatohet se veprimtaria e tij në përgjithësi apo në masën e duhur ka qenë në shërbim të kryerjes së veprave penale, që në literaturë ky dënim konsiderohet si

296 Ilic, Goran P. *Marginalije uz zakon o odgovornosti pravnih lica za krivicna dela*. Marrë nga:

http://www.ius.bg.ac.rs/crimenjournal/articles/Crimen_002-2010/Crimen%20002-2010%20_%205%20Ilic.pdf (parë më 07.05.2014).

“vdekje” e personit juridik ²⁹⁷, edhe pse për nga pasoja nuk është i njëjtë me dënimin me vdekje që i shqiptohet personit fizik ²⁹⁸.

Ligji për përgjegjësinë penale të personave juridikë në Serbi në mënyrë të njëjtë ka paraparë kushtet dhe elementet që duhet plotësuar për përgjegjësi penale, nga përgjegjësia penale dhe nga dënimi ka përjashtuar personat juridikë siç janë: shteti dhe organet e tij, për dallim nga ligji i Kosovës, ku nga përgjegjësia ka përjashtuar edhe organizatat ndërkombëtare por jo edhe personat përgjegjës të tyre.

Instituti i tentativës, sanksionet penale, kufijtë e përgjegjësisë penale, rehabilitimin, përgjegjësinë penale me rastin e falimentimit i ka rregulluar identik me Ligjin për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë në Kosovë. Prandaj, konsideroj që legjislacioni për përgjegjësinë penale të personave juridikë është i plotë dhe në përputhje “açjue komunitere”

4.10. Përgjegjësia penale e personave juridikë që ushtrojnë aktivitete në fushën ekonomike në Bosnjë e Hercegovinë

Futja e Institutit të përgjegjësisë penale për personat juridikë në Bosnjë e Hercegovinë nuk ishte me vullnetin e ligjvënësit dhe objektivave të shtetit për të ruajtur ekonominë nga kriminaliteti po ishte pa dyshim imponimi i Konventave Ndërkombëtare

297 Durdevic. Zllata, *Komentar zakona o odgovornost pravnih osoba za kaznjena djela*, Narodna novina, Zagreb 2005, fq. 75. Marrë nga: http://www.fzplus.hr/product_info.php?products_id=677 (parë më 26.7.2014).

298 Stojanović. Zoran, R. Shine: *Komentar zakona o odgovornost pravnih lica za kaznjena djela*, Republike Crne Gore, Podgorica, 2007, fq. 85. Marrë nga: http://www.antikorupcija.me/index.php?option=com_phocadownload&view=category&download=102:odgovornost-pravnih-lica-za-krivicna-djela-povracaj-dobara&id=12:izvjestaji&Itemid=306&start=20 (parë më 28.7.2014).

që kanë kërkuar nga shtetet anëtare që të parashihet përgjegjësi penale për personat juridikë në legjislacionet e tyre. Prandaj, në kohën e miratimit të Kodit Penal të Bosnjë-Hercegovinës të vitit (2003), detyrimisht për shkak të përputhshmërisë së legjislacionit me standardet evropiane është paraparë përgjegjësia penale e personave juridikë. Bosnja ka pranuar konceptin e gjerë të përgjegjësisë penale, që nënkupton se personi juridik është përgjegjës për të gjitha veprat penale, e jo konceptin e kufizuar të përgjegjësisë penale për një grup të caktuar të veprave penale apo veprat e caktuara penale²⁹⁹, siç ishte rasti me Kodin Penal të Francës. Sipas Kodit Penal të Bosnjë-Hercegovinës, përgjegjësia penale e personave juridikë ekziston kur kryerësi i veprave penale ka vepruar në:

- emër të tij,
- për llogari të tij, apo në dobi të tij.³⁰⁰

Andaj, mund të konstatohet se në dukje, përgjegjësia penale sipas legjislacionit penal të Bosnjës, është më e gjerë se ajo që kanë paraparë konventat ndërkombëtare³⁰¹, por megjithatë konsideroj që interpretimi i personave juridikë në këto akte ndërkombëtare posaçërisht rreth organit drejtues dhe përfaqësuesve të personave juridikë është më i zgjeruar. Gjithashtu, sipas legjislacionit të Kosovës dhe Shqipërisë, por edhe vendeve tjera të Ballkanit, konsiderohet se është prezent koncepti më i gjerë

299 Shih: Kodi Penal i Bosnjë e Hercegovinës, (Fletorja zyrtare, B. e H.) nr. 3/03, 32/03, 37/03, 54/04, 61/04, 30/05, i dt. 22 nëntor 2003.

300 Shih: Kodi Penal i Bosnjë e Hercegovinës, kreu XIV, neni 12.

301 Drino. Galicic, “Uvodenje Pravni Lica Pod Krivicnu Juridiksiu Sudova u Francuskoj i Bosnje Hercegovine, seminar “O Odgovornosti Pravni Lica za Kriviqna Djela” - Kolloshin 21-24 tetor 2009. Marrë nga:

http://www.antikorupcija.me/index.php?option=com_phocadownload&view=category&download=102:odgovornost-pravni-lica-za-krivica-djela-povracaj-dobara&id=12:izvjestaji&Itemid=306&start=20 (parë më 27.8.2014).

për përgjegjësinë penale të personave juridikë sesa ai që është paraparë me konventat ndërkombëtare.

Përgjegjësia penale e personit juridik ekziston edhe në rastet kur kryerësi i veprës penale nuk është penalisht i përgjegjshëm. Sipas ligjit gjithashtu përgjegjësia penale e personit juridik nuk e përjashton përgjegjësinë penale të personit fizik dhe personit përgjegjës për kryerjen e veprës penale (neni 125 pika 1 dhe 2). Personi juridik mund të përgjigjet penalisht edhe për veprat penale nga pakujdesia, bazuar në kushtet sipas (nenit 124 pika d), që nënkupton kur drejtuesit apo organet përgjegjëse të personit juridik kanë vepruar gjatë në kundërshtim me të drejtat ligjore të punëtorëve.

Tentativa e veprës penale është e ndëshkueshme, vetëm nëse shprehimisht është paraparë me ligj. Personi juridik në raste të caktuara mund të lirohet nga dënimi nëse organet drejtuese të tij kanë ndaluar kryerjen e veprës penale nga kryerësi (neni 127, pika 3). Personave juridikë për kryerjen e veprave penale mund t’iu shqiptohen këto dënime:

- Dënimi me të holla,
- Marrja e pasurisë dhe,
- Përfundimi i personit juridik, (neni 131).

Dënimi me marrjen e pasurisë mund t’i shqiptohet personit juridik vetëm për veprat penale që janë të dënueshme me 5 vjet burg apo më shumë, në këtë rast mund t’i merret së paku gjysma e pasurisë, pjesa më e madhe e pasurisë apo edhe e gjithë pasuria.

Bosnjë e Hercegovina, institutin e përgjegjësisë penale të personave juridikë e ka të rregulluar në Kodin Penal të vitit 2003, ende nuk ka ligj të posaçëm që e rregullon

këtë çështje. Sa i përket aspektit krahasues me legjislacionin e Kosovës, konsideroj që ka ndryshime në disa nga institutet.

Në legjislacionin e Bosnjë e Hercegovinës është paraparë se personat juridikë mund të kryejnë vepra penale nga pakujdesia³⁰², çështje që nuk është paraparë në legjislacionin e Kosovës dhe që konsideroj se në të ardhmen duhet të parashihet edhe kjo formë e kryerjes se veprës penale.

Gjithashtu personi juridik përgjigjet penalisht edhe në rastet kur personi fizik, që e ka kryer veprën penale nuk përgjigjet penalisht për dallim që te ne përgjegjësia e personit juridik bazohet në fajësinë e personit përgjegjës.³⁰³ Sa i përket dënimeve legjislacioni i Bosnjës ka paraparë si dënim marrjen e pasurisë (neni 133, pika 1 dhe 2), ndërsa sipas legjislacionit të Kosovës nuk është paraparë si dënim, por ligji ka paraparë te masat e sigurisë “konfiskimin e dobisë pasurore” të fituar me vepër penale (neni 13 pika 1.3), kujtoj, parashikimi i këtij dënimi është i domosdoshëm dhe do të ndikonte në ruajtjen e shoqërisë dhe sistemit ekonomik nga kriminalitet.

302 Shih: Kodi Penal i Bosnje e Hercegovinës, kreu i XIV, neni 125 pika 3.

303 Shih: Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Veprat Penale të Kosovës, nr. 04/L-030, 31 gusht 2011, neni 5, parag. 3.

KAPITULLI V

RAPORTI I VEPRAVE PENALE KUNDËR EKONOMISË ME GRUPET E TJERA TË VEPRAVE PENALE TË ORIENTUARA SIPAS OBJEKTIT MATERIAL

5.1. Vështrim i përgjithshëm

Veprat penale, si veprime të kundërligjshme, me të cilat cenohen të mirat juridike të mbrojtura me ligj, siç është: jeta e njeriut, pasuria, ekonomia, lëvizja e lirë, shëndeti etj. Legjislacioni penal i Kosovës këto vepra penale i ka sistemuar në grupe të veçanta, megjithatë duke parë objektin mbrojtës të këtyre veprave shpeshherë është vështirë të bëhet një ndarje e plotë në mes tyre. Ajo që këto vepra penale i bën që të mos dallohen në mes vete janë elementet themelore të veprës penale, siç janë: veprimi i njeriut, përcaktueshmëria e saj me ligj, kundërligjshmëria, faji dhe dënueshmëria³⁰⁴.

Megjithatë, përkundër elementeve themelore të përbashkëta që kanë veprat penale, ato kanë specifikat e veta sipas objektit material dhe të mirës materiale që i kundërvihen.

Veprat penale kundër ekonomisë, kanë ngjashmëri shumë të madhe me veprat penale kundër pasurisë, detyrës zyrtare apo siç parashihen në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012, me emërtimin “korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”³⁰⁵.

Për të kuptuar ndarjen e veprave penale kundër ekonomisë nga grupet e tjera të

304 Kambovski. Vllado, *E drejta penale pjesa e përgjithshme*, Botues “Furkan ISM”, Shkup 2010, fq. 125

305 Shih: Kodi Penal i Kosovës, i vitit 2012, Gazeta zyrtare 19/13, kapitulli XXXIV.

veprave penale do të trajtojmë në mënyrë të veçantë raportin e tyre me veprat penale kundër pasurisë dhe detyrës zyrtare.

5.2. Raporti i veprave penale kundër ekonomisë me veprat penale kundër pasurisë

Veprat penale në përgjithësi, posaçërisht ato kundër ekonomisë, kanë një ngjashmëri me grupet e tjera të veprave penale. Për këto arsye paraqiten vështirësi për ligjvënësit që të bëjë një ndarje të qartë për t'i sistemuar disa nga veprat penale në grupin adekuat.

Kjo vështirësi është jashtëzakonisht e theksuar te veprat penale kundër ekonomisë dhe pasurisë. Te ky grup i veprave penale objekti kundër të cilit është ndërmarr veprimi i kundërligjshëm është pasuria e personit fizik apo juridik. Qëllimi i kryerësve është përfitimi i kundërligjshëm pasuror. Andaj, me vështirësi vërehen ndryshimet në mes të veprave penale kundër ekonomisë dhe pasurisë. Mirëpo, megjithatë, ndryshimet janë të pranishme tek subjektet të cilët e kryen veprën penale janë të ndryshëm si për shembull veprat penale kundër ekonomisë si: shkaktimi i falimentimit, dëmtimin e kreditorëve apo keqpërdorimin e autorizimeve në ekonomi mund t'i kryejnë vetëm personat që janë përgjegjës në organizatën e biznesit apo personin juridik³⁰⁶.

Ndërsa, mashtrimi si vepër penale kundër pasurisë³⁰⁷, e cila mund të kryhet edhe në fushën e afarizmit ekonomik kryhet nga cilido person i cili vetes apo tjetrit i sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror. Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike në disa shtete janë paraparë vetëm në një grup si në: Kodin Penal të Francës

306 Dr. Salihu. Ismet, *E drejta penale pjesa e posaçme*, Kolegji "Fama", Prishtinë, 2009, fq. 298.

307 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i vitit 2004, nenin 261.

(1994), në Kodin Penal të Zvicrës, në kreun e dytë, në Kodin Penal të Shqipërisë të vitit 1995, në kreun e tretë. Vlen të theksohet se shumica e veprave penale kundër ekonomisë dhe pasurisë në Kodin Penal të Përkohshëm dhe Kodin Penal të ri të Kosovës të vitit 2012, janë të parapara edhe në Kodin Penal të Shqipërisë, të vitit 1995. Për mendimin tim disa vepra penale që gjenden në grupin e veprave penale kundër pasurisë në Kodin e Përkohshëm Penal si: Mashtrimi (neni 261), mashtrimi lidhur me subvencionet (neni 262), keqpërdorimi i besimit (neni 269), Kontrabandimi i mallrave (neni 273), krimi i organizuar (neni 274)³⁰⁸, do të duhej ta kishin vendin në grupin e veprave penale kundër ekonomisë.

Vlen të përmendet fakti se këto vepra penale kanë mbetur në kuadër të veprave penale kundër pasurisë edhe në Kodin e Ri Penal të Kosovës 2012³⁰⁹. Gjithashtu kujtoj se disa vepra penale, që gjenden në grupin e veprave penale “kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore” si shkretime të pyjeve (neni 357), vjedhja e pyllit (neni 358), gjuetia e kundërligjshme (neni 359) të parapara në Kodin Penal të vitit 2012³¹⁰ dhe atij të vitit 2004³¹¹, duhet të ishin të sistemuar në grupin e veprave penale kundër ekonomisë, për faktin se ato shkaktojnë dëm shumë të madh për ekonominë e vendit. Kujtoj që ligjvënësi ndarjen e veprave penale kundër ekonomisë dhe pasurisë ka qenë dashur ta bëjë mbi bazën e veprimtarisë së kundërligjshme dhe cenimit të pasurisë.

Të gjitha veprimet e kundërligjshme të drejtuara kundër ekonomisë, sistemit financiar, doganave dhe pasurisë së subjekteve afariste, do të duhej të ishin të

308 Po aty, kapitulli XXIII.

309 Shih: Kodi Penal i Kosovës, i vitit 2012, kapitulli XXVII.

310 Shih: Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012, kapitulli XXVIII.

311 Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës i shpallur me rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2003/25 i dt. 6 korrik 2003 dhe hyri në fuqi më 6 prill 2004, kapitulli XXIV.

inkriminuar në veprat penale kundër ekonomisë, ndërsa veprimet e drejtuara kundër pasurisë së personave fizikë do të duhej të ishin inkriminuar në grupin e veprave penale kundër pasurisë. Mendoj që ligjvënësi kosovar ka vepruar drejt kur e ka hequr nga grupi i veprave penale kundër pasurisë veprën penale “krimin e organizuar” (neni 283), duke e vendosur në grup të veçantë të veprave penale ³¹², ngase konsideroj që krimi i organizuar ka specifika si në aspektin e organizimit, strukturimit, të mirave juridike që i drejtohet si dhe pasojat që i sjell për qytetarët dhe shtetin në përgjithësi.

Termi “Krim i organizuar”, ishte përdor për herë të parë në vitin 1986, në raportin e Shoqatës për Parandalimin e Krimit në Nju Jork. Raporti si krim të organizuar konsideronte bizneset ilegale në të cilat ishin përfshirë politikanë, oficerë policie, juristë dhe hajna profesionistë kur krimi i tyre ishte i organizuar³¹³. Kjo formë e rrezikshme e kriminalitetit ka aftësi dhe premisa të shfaqet në veprimtari të ndryshme shoqërore dhe ekonomike jo vetëm brenda shteteve por edhe në planin ndërkombëtar. Mandej forma e tillë e kriminalitetit krijon kapital të madh, ku pastaj kriminelët përmes kapitalit ushtrojnë ndikimin në institucionet e rendit juridik, që mund të jetë me pasoja për vendin³¹⁴.

Pikërisht, për faktin që kriminaliteti ekonomik i organizuar paraqet rrezik të madh për dëmtimin e shtetit dhe kërcënim serioz edhe për njerëzimin konsideroj që me të drejtë ligjvënësi kosovar e ka sistemuar këtë vepër në kapitull të veçantë në Kodin Penal

312 Shih: Kodi Penal të Kosovës, kapitulli XXIV.

313 Vula. G. Veton, *Krimi i organizuar*, Kolegji Evropian “Dukagjini”, Prishtinë 2013, fq. 23.

314 Halili. Ragip, *Disa karakteristika të kriminalitetit të organizuar në Kosovë dhe parandalimi i tij*, Revista “E drejta” nr. 4, Prishtinë 2002.

të Kosovës, dhe ka hartuar strategjinë shtetërore³¹⁵, për ta luftuar këtë formë të sofistikuar të kriminalitetit në përgjithësi e posaçërisht në fushën ekonomisë.

5.3. Raporti i veprave penale kundër ekonomisë me veprat penale kundër detyrës zyrtare

Veprat penale kundër detyrës zyrtare, po ashtu sikur edhe veprat penale kundër ekonomisë, cenojnë të mirën juridike që i është dhënë mbrojtje juridiko-penale me ligj siç është ekonomia e vendit qoftë private apo publike. Prandaj, duke parë objektin mbrojtës të këtyre dy grupeve të veprave penale që është i njëjtë dhe gjithashtu kryerësit e këtyre veprave në shumicën e rasteve janë zyrtarë me përgjegjësi publike, mund të thuhet se pa dyshim ekziston një lidhmëni ndërmjet veprave penale kundër ekonomisë dhe detyrës zyrtare.

Disa vepra penale, që janë të sistemuar në grupin e veprave penale kundër detyrës zyrtare siç janë: “marrja e ryshfetit” (neni 343), “dhënia e ryshfetit” (neni 344), “zbulimi i fshehtësive zyrtare” (neni 347)³¹⁶, kanë shumë elemente të ngjashme me disa vepra penale kundër ekonomisë dhe atë: me veprën penale “marrja e paarsyeshme e dhuratave” (neni 250), me veprën penale “dhënia e paarsyeshme e dhuratave” (neni 251) dhe veprën penale “kumtimi i paautorizuar i sekretit të punës” (neni 238)³¹⁷.

Dy veprat e para penale, marrja e ryshfetit dhe dhënia e ryshfetit, kanë për qëllim të korruptojnë personin zyrtar që pastaj ai të ndërmarrë apo të mos ndërmarrë ndonjë

315 Shih: Strategjia shtetërore e Republikës së Kosovës, kundër krimit të organizuar dhe planin e veprimit 2009-2012. Marrë nga: https://www.mpb-ks.org/repository/docs/STRATEGJIA_KKT_30_QERSHOR_Alb.pdf (parë më 2.4.2014).

316 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i vitit, 2004, kapitulli, XXIX.

317 Po aty, kapitulli, XXII.

veprim në kuadër të autorizimeve të tij me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër. Këto dy vepra penale kujtoj që do të ishte më mirë të ishin të sistemuar në kuadër të veprave penale, kundër ekonomisë. Këtë fakt e mbështes në raportin e Zyrës së Kombeve të Bashkuara, të vitin 2013, me titull: Biznesi, Korrupsioni dhe Krimi në Kosovë- Ndikimi i ryshfetit dhe krimit tjetër në ndërmarrjet private, ku raporti tregon përbërjen themelore të ryshfetit të paguar në pesë sektorë ekonomikë në Kosovë. Në raport konstatohet se sektori i tregtisë me shumicë dhe asaj me pakicë përbën pjesën më të madhe të përhapjes së ryshfetit në nivelin e normës totale kombëtare. Në vazhdim nga raporti përmes përqindjes po paraqes shpërndarjen e gjithë ryshfetit të paguar në sektorët ekonomikë për vitin 2012 dhe atë: në prodhimin industrial 20.5%, tregti, 62.3%, akomodim 9%, transport dhe ndërtimtari 8.2%³¹⁸.

Prandaj, duke parë që ryshfeti si dukuri është më tepër i përqendruar në fushën e tregtisë me të drejtë do ishte që këto vepra penale të jenë të sistemuara në veprat penale kundër ekonomisë. Gjithashtu vepra penale “Kumtimi i paautorizuar i sekretit të punës është i njëjtë në përmbajtje me veprën penale zbulimi i fshehtësisë zyrtare dhe që të dy këto vepra penale kanë për qëllim të ruajnë sekretin e punës, posaçërisht atij në fushën e tregtisë prandaj edhe kjo vepër atakon ekonominë, andaj mendoj që ka qenë dashur të jetë e sistemuar në grupin e veprave penale kundër ekonomisë për faktin se këtë vepër e kryen vetëm personat që janë përgjegjës për ruajtjen e sekretit dhe qëllimi është njoftimi i personave të paautorizuar me të dhëna nga sfera e sektorit ekonomik. Këtë lidhmëni ndërmjet këtyre grupeve të veprave penale e vërtetojnë edhe vepra të tjera penale si

318 Shih: Raporti i Zyrës së Kombeve të Bashkuara nga United Nations Office on Drugs and Crime, Biznesi, Korrupsioni dhe Krimi në Kosovë: Ndikimi i ryshfetit dhe i krimit tjetër në ndërmarrjet private, botuar në mbështetje financiare të Bashkimit Evropian, Qeverive: Të Gjermanisë, Norvegjisë, dhe Suedisë, në vitin 2013, fq. 18.

shkaktimi i falimentimit (neni 234)³¹⁹, ngase këtë vepër penale e kryen personi duke e keqpërdorur pozitën zyrtare, ndërsa pasojat shkaktohen në ekonomi.

5.4. Raporti i veprave penale kundër ekonomisë me veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë

Me veprat penale kundër ekonomisë cenohet ekonomia e vendit, sistemi financiar, buxheti, konkurrenca e lirë etj. Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë, cenojnë të mirën themelore më të rëndësishme jetën, por gjithashtu ato cenojnë dhe paraqesin rrezik të madh për pasurinë dhe ekonominë e tyre.

Prandaj, me të drejtë mund të thuhet se ekziston një lidhmëni reciproke ndërmjet këtyre dy grupeve të veprave penale. Megjithatë, ajo që i bën të dallohen është natyra e objektit mbrojtës, ngase te veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme dhe pasurisë për shkak të zhvillimit të madh dhe masiv të mjeteve teknike, përdorimit të energjisë elektrike, pajisjeve të komunikacionit rrugor, hekurudhor, ajror etj., përdorimi i këtyre mjeteve në çdo moment paraqet rrezik shumë të madh për jetën e shumë njerëzve³²⁰.

Andaj, objekti mbrojtës primar është jeta e njerëzve dhe krahas jetës pastaj pasuria apo ekonomia e tyre e kjo e bën të dallohet me veprat penale kundër ekonomisë pasi objekti mbrojtës është më i gjërë. Lidhmëninë që e kanë këto dy grupe të veprave penale e vërteton vepra penale “asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike” (neni 292), ku në paragrafin e parë thuhet: Kushdo që asgjëson, dëmton apo heq instalimet publike siç janë: përçuesit elektrikë, instalimet e gazit, ujit, ngrohjes, pajisjeve të

319 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i vitit 2004, neni 234 .

320 Salihu. Ismet: *E drejta penale pjesa e posaçme*, Kolegji “Fama”, Prishtinë 2009, fq. 403.

telekomunikimit etj. dhe me këtë rast shkakton çrregullime në furnizimin e popullsisë apo të ekonomisë dënohet me burg deri në 5 vjet³²¹. Nga kjo shihet se ligjvënësi te kjo vepër fillimisht i ka dhënë mbrojtje juridiko-penale ekonomisë së qytetarëve dhe plotësisht me të drejtë se këto veprime mund t'i shkaktojnë dëme jashtëzakonisht të mëdha ekonomisë qoftë private apo publike. Kurse në paragrafin 3, ligjvënësi ka paraparë edhe formën e rëndë të kësaj vepre penale, nëse vepra rezulton me lëndime të rënda trupore apo rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave kryerësi dënohet me burgim nga 1 deri në 12 vjet³²².

Prandaj kjo vepër, por edhe veprat e tjera penale si “ dëmtimi apo heqja e pajisjeve mbrojtëse (neni 293), vepra penale “shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm” (neni 291), tregojnë raportin e ngushtë që mund ta kenë me veprat penale kundër ekonomisë ngase objekti kundër të cilit është drejtuar veprimi i kundërligjshëm është ekonomia dhe pasuria e tyre.

Vlen të përmendet fakti edhe pse kjo vepër sipas kodit tonë penal nuk është e paraparë në grupin e veprave penale kundër ekonomisë, por në grupin e veprave penale kundër sigurisë së përgjithshme dhe pasurisë, duke pasur parasysh pasojat që asgjësimi i këtyre pajisjeve dhe instalimeve zakonisht shkakton dëm të madh ekonomik, me të drejtë kjo vepër mund të konsiderohet edhe si vepër penale kundër ekonomisë³²³.

321 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i vitit 2004, kapitulli XXV, neni 292, parag. 1.

322 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i vitit 2004, neni 292, parag. 3.

323 Dr. Salihu. Ismet, *E drejta penale (pjesa e posaçme)*, Kolegji “Fama”, Prishtinë, 2009, fq. 409.

5.5. Dëmtimet në fushën e pronës

Prona si e drejtë themelore është e mbrojtur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në nenin 46, në paragrafin e parë thuhet: “E drejta e pronës është e garantuar”³²⁴. Sistemi ekonomik i Republikës së Kosovës, bazohet në pronën private dhe publike dhe në ekonominë e tregut të lirë, kjo e drejtë është e rregulluar me ligj bazuar në nenin 121 të Kushtetutës së Kosovës.

Mbrojtjen juridiko-penale të pasurisë e rregullon edhe Kodi Penal i Kosovës, i vitit 2012 në kapitullin XXVII, në grupin veprave penale kundër pasurisë ³²⁵. Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet e tona e mbrojnë dhe sigurojnë pronën e personave fizikë dhe organizatave të huaja ndërkombëtare. Sipas Kushtetutës së Kosovës neni 121, parag. 2, thuhet “personat fizikë të huaj dhe organizatat e huaja në pajtim me ligjin mund të sigurojnë të drejtën e pronësisë mbi pronën e paluajtshme në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj dhe me marrëveshje ndërkombëtare”³²⁶.

Mbrojtjen juridiko-penale të pasurisë e siguron edhe Kodi Penal i Shqipërisë, i vitit 1995, në kreun e tretë, seksioni i tretë, në grupin e veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike³²⁷. Mbrojta e pronës është e rregulluar edhe me dokumente ndërkombëtare, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në protokollin shtojcë neni 1 thotë: “ Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t’i respektohet pasuria e tij, askush nuk mund të privohet nga pasuria e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe

324 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në fuqi nga 15 qershori, 2008, neni 46.

325 Shih kreun XXVII të Kodit Penal të Kosovës, të vitit 2012.

326 Shih Kushtetutën e Republikës së Kosovës të vitit 2008, neni 121 parag. 2.

327 Shih: Kreu III i Kodit Penal të Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 dhe të ndryshuar në vitin 1977, 2008 dhe 2001.

në kushtet e parashikuar nga ligji dhe nga parimet e së drejtës ndërkombëtare”³²⁸.

Pra, prona private e personave fizikë, juridikë dhe prona shtetërore për shkak të rëndësisë së madhe ekonomike që kanë, gëzon mbrojtje me akte kushtetuese dhe akte ligjore, akte ndërkombëtare dhe mbrojtje juridiko-penale në kodet penale të të gjitha shteteve, nga të gjitha veprimet kriminale siç janë: vjedhjet, mashtrimet, shkatërrimet etj. Pra këto veprime kriminale të drejtuara kundër pronës sjellin pa dyshim humbje të mëdha dhe dëm ekonomisë së shtetit, personave fizikë e juridikë, prandaj me të drejtë Kodi Penal i Kosovës dhe Shqipërisë kanë paraparë sanksione penale kundër kryerësve të këtyre veprave penale. Qëllimi kryesor i kryerësve të këtyre veprave në përgjithësi është përvetësimi i pasurisë private apo shtetërore dhe dëmtimi apo shkatërrimi i pronës. Pra, nga elaborimi qëllimi i kryerësve të këtyre veprave penale është t’i sjellin dëm material ekonomisë –pasurisë së shtetit dhe personave fizikë dhe juridikë.

Natyrisht se te këto vepra penale figura e tyre ndryshon sepse kryerësi për shembull te vjedhja ka për qëllim përfitimin material të kundërligjshëm për vete apo për tjetrin, ndërsa te dëmtimi apo shkatërrimi i pronës, ky qëllim nuk ekziston. Kjo kategori e veprave penale të drejtuara kundër pronës në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012 , gjenden në kapitullin e veprave penale kundër pasurisë. Objekt grupor i përbashkët i këtyre veprave janë: marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar të drejtën e pronës si e drejtë themelore.

328 Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950.

5.6. Natyra e disa veprave penale lidhur me dëmtimet e pronës e orientuar sipas objektit material

Natyra e secilës vepër penale, kundër ekonomisë, ka specifikat e veçanta të objektit material por specifike e përbashkët e objekt material dhe mbrojtjes juridiko-penale janë vendosja e marrëdhënieve juridike për zhvillimin normal të ekonomisë, afarizmit ekonomik, mbrojtjen e pronës nga dëmtimet etj. Pra, objekt material i veprave penale, të drejtuara kundër pronës, janë prona private apo publike në përgjithësi. Pra, mjafton që të këtë vlerë ekonomike, pra thjesht të mos jetë hedhurinë³²⁹.

Për disa vepra penale kundër dëmtimit të pronës objekti material ndryshon si për shembull vepra penale: “Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike” e paraparë në nenin 366 në Kodin Penal të Kosovës, të vitit 2012. Objekt i kësaj vepre penale janë pajisjet dhe instalimet publike, që shërbejnë për plotësimin e nevojave të qytetarëve. Pra, këto instalime kanë rëndësi të madhe për veprimtarinë ekonomike dhe në përgjithësi për jetën e njerëzve dhe shkatërrimi i tyre mund të shkaktojë çrregullime të mëdha të qytetarëve me ujë, rrymë, ngrohje dhe pa dyshim shkakton dëm të madh ekonomik, prandaj kjo vepër penale mund të konsiderohet edhe si vepër penale kundër ekonomisë³³⁰.

Andaj, asgjësimi i këtyre pajisjeve shkakton rrezikimin e jetës, integritetin trupor dhe shëndetin e njerëzve apo pasurinë në përmasa të mëdha, prandaj me të drejtë Kodi Penal i Kosovës, i vitit 2012, këtë vepër e ka paraparë në grupin e veprave penale kundër sigurisë së përgjithshme dhe pasurisë, çka d.m.th. se edhe objekti material është specifik dhe ndryshon nga veprat tjera të drejtuara kundër pronës.

329. Elezi. Ismet, *E drejta penale (pjesa e posaçme)*, Botimet “Erik”, Tiranë, 2009, fq. 254.

330 Dr. Salihu. Ismet, *E drejta penale (pjesa e posaçme)*, Kolegji “Fama”, Prishtinë, 2009, fq. 408-409.

Pjesa e punimit, që ka të bëjë me natyrën e disa veprave penale që e dëmtojnë pronën, të vështruar sipas objektit material, të paraparë në legjislacionin penal të Kosovës, është pranuar dhe publikuar në revistën shkencore ndërkombëtare: "Mediterranean Journal of Social Sciences".

5.7. Dëmtimet në fushën financiare

Dëmtimet në fushën financiare në çdo shtet, pa dyshim, zënë vend të veçantë në sistemin monetar dhe kreditor. Në të gjitha shtetet për realizimin e kësaj veprimtarie dhe për marrjen e masave që emisioni i monedhave dhe letrave me vlerë të mos falsifikohen dhe vënia e tyre në qarkullim, i është besuar Bankave Kombëtare. Kosova, tani si shtet i pavarur dhe sovran, por edhe në të kaluarën gjersa ishte në kuadër të ish-Jugosllavisë nuk ka pas monedhën e saj.

Aktualisht vendi ynë e ka në përdorim monedhën e Bashkimit European-euron. Duke pasur parasysh se sistemi financiar i shtetit është bazë për zhvillimin ekonomik, në mbrojtje të këtij sistemi, shtetet kanë ofruar mbrojtje penalo-juridike.

Kosova në këtë fushë ka nxjerrë legjislacion adekuat, të hartuar me standarde ndërkombëtare dhe në pajtim me konventat ndërkombëtare në këtë fushë. Kodi Penal i Kosovës këto vepra penale që e dëmtojnë ekonominë e vendit dhe sistemin financiar i ka sistemuar në grupin e veprave penale kundër ekonomisë³³¹. Ligjvënësi kosovar, duke pasur parasysh dëmin financiar, që i shkaktojnë shtetit veprat penale si: "Shpëlarja e parasë"³³², "Falsifikimi i parasë", "Falsifikimi i shenjave me vlerë", "Falsifikimi i

331 Shih: Kodi Penal i Kosovës, i vitit 2012, kapitullin XXV.

332 Kosova me qëllim të parandalimit të kësaj vepre penale, por edhe veprave tjera në fushën ekonomiko-financiare ka nxjerrë Ligjin nr. 03L/-196, për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe luftimin

letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës”, ka paraparë dënime jashtëzakonisht të larta për kryerësit eventuale të këtyre veprave dhe atë deri në (10) vjet burgim dhe konfiskimin e pasurisë nëse vërtetohet se është fituar me vepër penale³³³.

Qëllimi i shtetit për të inkriminuar këto veprimtari kriminale, duke paraparë dënime të larta ka për objektiv për të mbrojtur rregullat e vendosura për të siguruar ekonominë dhe sistemin financiar nga veprimet kriminale. Ky lloj krimi në rritje të vazhdueshme, sipas gjitha raporteve që flasin, por edhe nga rastet konkrete që i hasim në vendin tonë, por edhe në vende tjera të rajonit, vitet e fundit paraqesin rrezikshmëri të madhe shoqërore për lulëzimin e krimit të organizuar. Në disa nga vendet e rajonit dhe më gjerë parat e fituara nga këto vepra të trajtuara, në këtë punim, përdoren për financimin e organizatave më të njohura të kriminalitetit të organizuara si: Cosa Nostra Amerikane, Mafia siciliane, Mafia serbe³³⁴ etj. Si bazë juridike për luftimin e kësaj dukurie kriminale shërben edhe Konventa Ndërkombëtare e dt. 20 prill 1929³³⁵.

Përvojat e shteteve ndërkombëtare kanë treguar se dëmtimet në fushën financiare sjellin efekte shkatërruese në besueshmërinë financiare të shtetit, ndikojnë në stabilitetin ekonomik, prishin ekuilibrin e raporteve të kërkesës në nivele makroekonomike, krijojnë paqëndrueshmëri valutore, dëmtojnë konkurrencën e ligjshme, sjell rritje të çmimeve në ofrimin e shërbimeve të njëjta. Prandaj, vepra penale “falsifikimi i parave” dhe “shenjave me vlerë” duhet trajtuar në aspektin e dëmit financiar sepse çdo para paraqet

e financimin e terrorizmit i shpallur në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 85, Prishtinë 2010. Kjo vepër penale është inkriminuar edhe në Kodin Penal të Kosovës, të vitit 2013, në nenin 308, në fillim kjo vepër penale ka qenë e inkriminuar me Rregulloren e UNMIK-ut, 2004/2 e dt. 5.2.2004.

333 Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012, parasheh konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprës penale në nenet 96, 97 dhe 99.

334 Vula. G. Veton, *Kriminaliteti i organizuar*, Kolegji Evropian “Dukagjini”, Prishtinë, 2013, nga fq. 279-295.

335 Elezi. Ismet, *E drejta penale (pjesa e posaçme)*, Botimet “Erik”, Tiranë, 2009, fq. 307.

sasinë e mallit të prodhuar të një vendi dhe çdo vend lëshon para në qarkullim aq sa ka prodhuar mallra, andaj falsifikimi dhe lëshimi në qarkullim i parave ose i letrave me vlerë, drejtpërsëdrejti ndikojnë në çrregullimin e prodhimtarisë së vendit³³⁶ dhe gjithashtu dëmtime në sistemin financiar të shtetit dhe mirëqenies sociale në përgjithësi.

5.8. Natyra e disa veprave penale në fushën financiare e orientuar sipas objektit material

Veprat penale kundër ekonomisë në përgjithësi, në veçanti ato në fushën financiare, kanë rëndësi të veçantë për ekonominë e një vendi dhe për qytetarët në përgjithësi. Paraja si mjet pagese për mallra, punë dhe shërbime, është e domosdoshme dhe do të ishte e paimagjinueshme jeta normale pa to. Andaj, imitimi i saj është në kompetencë të shtetit. *Objekti material* i këtyre veprave penale janë: marrëdhëniet juridike të vendosura në sistemin financiar e monetar dhe të kreditit, të mbrojtura posaçërisht me legjislacion penal nga veprimet kriminale³³⁷. Objekti material i veprës penale “Falsifikimi i parasë”, është:

- prodhimi i parasë,
- falsifikimi duke ndryshuar paranë e vërtetë,
- vendosja e saj (parasë) në qarkullim.

Objekti material i veprës penale “Falsifikimi i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës”, është:

336 Demolli. Haki, *Kriminaliteti ekonomik në Kosovën e viteve të tetëdhjeta*, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2009, fq. 31.

337 Elezi. Ismet, *E drejta penale (pjesa e posaçme)*, Botimet “Erik”, Tiranë, 2009, fq. 307.

- Falsifikimi çeqeve,
- Falsifikimi i kambialeve dhe letrave tjera me vlerë,
- Vendosija në qarkullim e tyre,
- Prodhimi i letrave me vlerë.

Duke parë se objekti material i këtyre veprave shpeshherë atakohet përmes veprimeve të falsifikimit, prodhimit dhe përdorimit si të vërteta, ato sjellin dëme shumë të madh material dhe financiar, rrezikojnë ekzistencën materiale të qytetarëve, humbasin pasurinë e tyre, shkaktojnë inflacion, humbin besimin në paranë dhe në letrat me vlerë ashtu që çrregullojnë ekonominë e vendit dhe mund ta sjellin atë në kolaps³³⁸.

Shtetet duke parë rrezikshmërinë nga ky grup i veprave penale ato i kanë inkriminuar dhe sistemuar në grupin e veprave penale kundër ekonomisë në ligjet e tyre penale.

Gjithashtu, pothuaj të gjitha shtetet kanë paraparë dënime të rënda për këto vepra deri në 10 vjet burgim. Këto vepra penale shpeshherë paraqiten edhe në nivel ndërkombëtar, sepse shkaktojnë pasoja të mëdha edhe në planin ndërkombëtar. Andaj në luftimin dhe parandalimin e tyre janë miratuar dokumente ndërkombëtare si konventa për luftimin e prodhimit të parasë së rrejshme. Kombet e Bashkuara kanë konstatuar se shpëlarja e parave më së shpeshti bëhet nga institucionet financiare, shoqëritë e sigurimeve dhe korporatave që merren me paluajtshmëri³³⁹.

Sipas Kodit Penal të Shqipërisë, të vitit 1995 dhe vitit 2001, kjo vepër penale është sistemuar në grupin e veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.

338 Dr. Salihu. Ismet, *E drejta penale (pjesa e posaçme)*, Kolegji “Fama”, Prishtinë, 2009, fq. 322-323.

339 Latifi. Vesel, dhe Prof. as. Beka. Agron, *Vrasjet, krimi i organizuar dhe terrorizmi*, Kolegji Evropian “Juridica”, Prishtinë, 2013, fq. 115.

Ligji ka paraparë dënime për falsifikimin dhe vënien në qarkullim të parasë së falsifikuar nga (5) deri në (15) vjet burgim, pra ligjvënësi shqiptar ka paraparë mënyrën e kualifikuar të veprës, nëse ajo është kryer në rrethana veçanërisht të rënda³⁴⁰.

Procesi i larjes së parave kalon nëpër tri faza dhe atë:³⁴¹

- Faza e parë, ka të bëjë me instalimin dhe transferimin fizik të parave të fituara me veprimtari kriminale,
- Faza e dytë, ka për qëllim të bëjë mbulimin, duke shtresuar paranë dhe duke e kyçur në transaksione të ndryshme financiare me qëllim t'i humb gjurmët dhe prejardhjen e krijimit të saj,
- Faza e tretë, është përpjekja që parat e lara të paraqiten në formë të kapitalit të krijuar apo të depozituara në veprimtari ekonomike-financiare legale.

Për parandalimin e shpëlarjes së parasë burojnë konstatime nga Këshilli i Evropës, ku thuhet se “Globalizimi i financave në treg ka sjell shumë të mëdha të parave në qarkullim sa paratë e imituara mund të përzihen pa u vërejtur dhe pa u penguar me parat legale”³⁴².

Sipas disa vlerësimeve sot në botë vlerësohet se shpëlahen 300 deri në 500 miliardë dollarë amerikanë. Studiuesit shkencorë konstatojnë se përfitimi financiar, për ato që merren me këtë punë, sillet rreth 2% të bruto prodhimit shoqëror, ndërsa paraja e shpëlarë duhet të jetë shumë më e lartë³⁴³. Kohën e fundit janë aprovuar edhe shumë

340 Shih: Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i vitit 2001, neni 183.

341 Latifi. Vesel, & Beka. Agron, *Vrasjet, krimi i organizuar dhe terrorizmi*, Kolegji Evropian “Juridica”, Prishtinë, 2013, fq. 115.

342 Sukeska. Mirsida, *Bazat e kriminalitetit ekonomik*, AAB, Prishtinë, 2006, FSK/07, fq. 153.

343 Vula. G. Veton, *Kriminaliteti i organizuar*, Kolegji Evropian “Dukagjini” Prishtinë, 2013, nga fq. 127.

dokumente ndërkombëtare, duke krijuar metoda të përparuara për parandalimin e shpëlarjes së parave. Në vazhdim po i paraqesim disa nga to:

- Konventa për shpëlarjen e parave dhe gjurmimin, marrjen e përkohshme të hyrave të fituara me vepër penale nr. 141 e Këshillit të Evropës,
- Direktiva e Këshillit të Evropës për ndalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar me qëllim të shpëlarjes së parave.

Vepra penale “shmangia nga tatimi” është e karakterit blanket, ngase me ligje tjera është përcaktuar se kush është i obliguar të paguajë tatimin. Vepra penale “shmangia nga tatimi”, sipas një hulumtimi të bërë në Prokurorinë Komunale në Ferizaj, nëpërmjet kallëzimeve penale të paraqitura ndaj kryerësve për periudhën kohore 2008-2012, është konstatuar se në vitin 2008 ka marrë pjesë me 20.83% nga numri i përgjithshëm i veprave penale kundër ekonomisë.

Në vitin 2009 ka marrë pjesë me 13.42%³⁴⁴, që shihet një rënie e cila vazhdon pothuaj me këtë trend deri në vitin 2012, ku kjo vepër penale merr pjesë me 10%³⁴⁵ nga numri i përgjithshëm i kallëzimeve penale kundër të dyshuarve për veprat penale të ekonomisë, që sipas kodit penal të përkohshëm ishin 20 lloje të tyre.

5.9. Dëmtimet në fushën doganore

Kriminaliteti në fushën e doganave, pa marrë parasysh format në të cilat shfaqet, paraqet krim të rëndë. Krimet si kontrabandë janë shumë të përhapura dhe paraqesin

344 Raport i Prokurorisë Komunale në Ferizaj, përkitazi me kallëzimet penale dhe numrin e personave të dyshuar për veprat penale në fushën e ekonomisë për periudhën 2009.

345 Raport i Prokurorisë Komunale në Ferizaj, përkitazi me kallëzimet penale dhe numrin e personave të dyshuar për veprat penale në fushën e ekonomisë për periudhën, 2012.

rrezik të madh për shoqërinë dhe për interesat shtetërore. Kosova, por edhe vendet e tjera nëpërmjet taksave dhe tatimeve doganore, krijojnë të ardhura të konsiderueshme për buxhetin me qëllim që të sigurohet funksionimi i institucioneve dhe shërbimeve publike. Andaj, që nga themelimi i Shërbimit Doganor në Kosovë, më 30 gusht 1999³⁴⁶ e deri më tani, dogana është kontribuesi më i madh për buxhetin, dhe është i njohur fakti që 70% e të hyrave të gjithfarshme të buxhetit bëhen nga Shërbimi Doganor. Por më i rëndësishëm është fakti që përveç mbushjes së arkës së buxhetit i njëjti gjithashtu ka qenë i angazhuar në mbrojtjen e ekonomisë vendore si dhe në luftimin e dukurive negative.

Asnjë shoqëri, posaçërisht shoqëritë në tranzicion, nuk janë imun nga krimet financiare që dëmtojnë buxhetin e shtetit dhe krijojnë pasiguri dhe jostabilitet në sistemin ekonomik-financiar. Për shkak të mashtrimeve që kryhen në mbledhjen e detyrimeve doganore, Kosova humb me miliona euro, të cilin fakt e ka pranuar edhe vetë Shërbimi Doganor se 20% e mallrave që hynë në Kosovë nuk i nënshtrohen pagesës së taksës doganore³⁴⁷. Pasojat e këtij krimi shkaktojnë dëm jashtëzakonisht të madh për ekonominë, tregun, për importuesit e ndërgjegjshëm që i nënshtrohen pagesave doganore, sepse kur futen mallra në Kosovë me shmangie nga tarifat doganore, malli i paraqitur në treg “ është mall nga tregu i zi” siç e përcakton edhe ligji i Administratës Tatimore të Kosovës³⁴⁸.

Prandaj, malli i importuar nga tregtia informale i bën konkurrencë jolojale importuesve të ndërgjegjshëm dhe gjithashtu zvogëlon aftësinë konkurruese të

346 Rregullorja e UNMIK-ut, nr.1999|3, për themelimin e Doganës së Kosovës.

347 Raporti vjetor i Shërbimit Doganor i Kosovës, i vitit 2006, publikuar nga Dogana e Kosovës. Marrë nga: <http://dogana.rks-gov.net/repository/docs/raporti%202006.pdf> (pare më 20.08.2014).

348 Shih: Ligji i Administratës Tatimore i Kosovës me nr. 03/L-222, të shpallur me dekretin nr. DL-032-2010.

produkteve që janë prodhues vendorë sepse ky mall shitet në treg me çmime më të lira. Ndër efektet kryesore që sjell dëmi në fushën tregtare do të veçoja: krijimi i pabarazisë në botën e biznesit, duke krijuar një bindje të një masë të gjerë të subjekteve tregtare se ligji nuk po funksionon, dhe duke çuar në drejtim të paligjshëm në rrugën e mospagimit të detyrimeve tatimore, ku krijohen fshehje dhe fitime të paligjshme, duke prodhuar edhe pa barazi sociale.

Nga një gjendje e tillë pritet pastaj të lindin edhe dhjetëra pasoja të tjera negative që paraqesin rrezik për rendin dhe shëndetin publik³⁴⁹. Gjithashtu krijohen para të tepërta dhe të lira, ku pastaj mund të përdoren për korruptimin e nëpunësve doganorë që pastaj të kryhen financime të paligjshme. Dëme tjera të shkaktuara mund të jenë edhe pasojat e rënda sociale që vijnë si pasojë se bizneset e tilla mund të dënohen penalisht dhe aktiviteti i tyre tregtar të pushojë që sjell papunësi, varfëri dhe gjithashtu humbje për arkën e shtetit buxhetin³⁵⁰.

Prandaj, për t'u mbrojtur nga këto krime në fushën e doganave shumica e vendeve, duke përfshirë Kosovën dhe Shqipërinë, këto vepra i kanë paraparë me ligje doganore. Në Kosovë, në vitin 2004, është aprovuar Kodi i Përkohshëm Doganor i Kosovës, i cili e ka zëvendësuar ligjin e aplikueshëm doganor dhe atë: Ligjin Doganor të Jugosllavisë, të vitit 1992 dhe Ligjin mbi Kundërvajtjet Doganore me të cilin abrogohen dispozitat federative nga viti 1977³⁵¹. Në Kodin Doganor ligjvënës ka paraparë 9 vepra penale që kanë të bëjnë me oficerët doganorë dhe personat që paraqiten në qarkullimin ndërkombëtar të mallrave. Veprat penale në fushën e doganave i ka inkriminuar edhe

349 Rakipi. Arben, *Korrupsioni dhe evazioni fiskal*, Shtypshkronja "Klean", Tiranë, 2003, fq. 123.

350 Po aty, fq. 124.

351 Kodi i Përkohshëm Doganor i Kosovës, i vitit, 2004, (Rregullorja e UNMIK-ut, 2004/1).

Kodi i Akcizave³⁵². Duke pasur parasysh që këto vepra në Kosovë, pas luftës kanë qenë të shpeshta dhe i kanë sjellë humbje buxhetit të shtetit me miliona euro, me çrast nga këto vepra penale shprehen evazion fiskal dhe varfëri të buxhetit.

Shteti i Kosovës, në këtë drejtim, ka krijuar legjislacion adekuat për të mbrojtur ekonominë dhe sistemin financiar në përgjithësi. Aktualisht mbrojtje juridiko- penale përveç kodit doganor dhe të akcizave kësaj fushe i jep edhe kodi penal, që për mendimin tim në mënyrë detaje i ka rregulluar të gjitha format e mundshme të paraqitjes së këtij krimi, duke paraparë përveç dënimeve me burg edhe konfiskim të mallrave dhe pasurisë që është burim nga vepra penale.

5.10. Natyra e disa veprave penale në fushën doganore e orientuar sipas objektit material

Kontrabanda paraqet një dukuri negative me rrezikshmëri shoqërore të lartë, e cila manifestohet në forma të ndryshme, duke e bërë atë si formën më të organizuar të kriminalitetit në fushën doganore. Fillet dhe zhvillimi i kontrabandës së mallrave janë të lidhura me dukurinë e paraqitjes së kufijve shtetërorë, përmes të cilave u krijuan pengesa për qarkullim të lirë mallrave³⁵³.

Natyra e objektit material, të këtyre veprave penale, nuk janë vetëm llojet e ndryshme të mallrave por edhe format dhe kontrabandimi i tyre. Objekt material i këtyre veprave janë mallrat e ndaluar për importim dhe eksportim, posaçërisht ato të veçanta, të ndaluara me ligj. Pra, objekti i këtyre veprave penale janë mallrat për të cilat nëse

352 Shih: Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 2005/32, mbi Kodin e Akcizës në Kosovë, të dt. 21 qershor. 2005.

353 Latifi. Vesel, *Kriminalistika*, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2006, fq. 189.

bëhet tregti me to duhet paraprakisht të merret leja, licenca nga organi kompetent³⁵⁴. Mallrat e ndaluar për import dhe eksport, sipas kodit doganor në Shqipëri janë: lëndët helmuese, bimë dhe kafshë të infektuara, armët e të gjitha llojeve, mbeturinat skarbobakri, alumini, plumbi, dhe metale tjera të çmuara³⁵⁵. Nga ajo që pamë objekt i përgjithshëm i këtyre veprave penale në fushën e doganave janë marrëdhëniet juridike të vendosura për funksionimin normal të doganave në Republikën e Kosovës. Qëllimi është mbrojtja e interesave ekonomike nga çdo veprimtari e kundërligjshme që ka për qëllim shmangien nga pagimi i detyrueshëm i tatimeve dhe kontributeve për buxhetin e shtetit.

Gjatë krahasimit të legjislacionit të Kosovës, me atë të Republikës së Shqipërisë, vërehet një unifikim që kanë dispozitat ligjore në përcaktimin e natyrës së objektit material dhe formave të paraqitjes së tij.

Objekt material i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për importimin e mallrave të ndaluara për import. Këto mallra, me rastin e importimit, paraqiten me emërtime tjera, numër tarifor tjetër nga numri autentik, duke fshehur origjinën.

Rastet në praktikë që kanë ndodhur me rastin e importimit të mallrave në Doganën e Kosovës janë sidomos me produktet farmaceutike, kur është tentuar të futen viagra duke i futur nëpër kutitë e vitaminave, duke fshehur përmbajtjen, origjinën e mallit me qëllim të shmangies mashtruese të ndaluara apo të kufizuar me ligj, apo importimi i veturave më të vjetra se tetë vite³⁵⁶. Në dëmtimin e buxhetit të Kosovës ndikim të madh

354 Salihu. Ismet, *E drejta penale, (pjesa e posaçme)*, Kolegji “Fama”, Prishtinë, 2009, fq. 373.

355 Elezi. Ismet, *E drejta penale (pjesa e posaçme)*, botimet “Erik”, Tiranë, 2009, fq. 287.

356 Shih: Rregulloren e UNMIK-ut, 2005/11, mbi ndryshimin e Rregullores 1999/3 mbi themelimin e doganave dhe shërbimeve tjera të ngjashme në Kosovë, të dt. 28. shkurt. 2005.

kanë këto vepra penale për faktin që pikat kufitare në pjesën veriore të Kosovës, nuk janë vendosur nën kontrollin e plotë të zyrtarëve doganorë të Kosovës.

Sipas raportit vjetor të punës së doganës, për vitin 2010, theksohet se ka lulëzuar krimi në atë pjesë dhe kjo mbështetet me faktet si në vijim: Janë paraqitur 49 kallëzime penale për shmangie të mundshme apo të vërtetuar në lartësi prej 42 milionë euro, në hetime sipas raportit kanë qenë 64 lëndë, ku shmangia e mundshme mund të jetë 4 milionë euro, mandej janë bastisur 18 lokacione të ndryshme, ku ka rezultuar me 4 persona të arrestuar, ndërsa janë konfiskuar mallra në vlerë 868.236.29 euro.³⁵⁷

Këtë vepër penale nuk e kanë inkriminuar, Kodi Penal i Kosovës i vitit 2004 dhe 2012. Këtë vepër dhe disa vepra të tjera penale, që kanë të bëjnë me mashtrimet e ndryshme doganore: shpërdorim i pozitës zyrtare nga oficerët, falsifikimet e dokumenteve të prezantuara për qëllime doganore janë të parapara në kodin doganor, si ligj special.

Ne mendojmë se Kodi Doganor i ka rregulluar në detaje këto vepra, me dispozita të qarta, konkrete, të përshtatura me veprimet dhe format e kryerjes së veprës në praktikë, për dallim nga Kodi Penal, që ka formulime të përgjithësuara, jo shumë konkrete.

357 Shih:Raportin vjetor të Doganës së Kosovës të vitit 2010, të publikuar nga dogana e Kosovës, Prishtinë, shkurt, 2011.

KAPITULLI VI

ASPEKTI KRIMINOLOGJIK I VEPRAVE PENALE KUNDËR EKONOMISË NË TERRITORIN E GJYKATËS KOMUNALE (THEMELORE) NË FERIZAJ NË PERIUDHËN 2008-2012

6.1. Analiza

Kriminaliteti ekonomik është dukuri shumë komplekse, e që manifestohet në forma të veçanta në shoqëri dhe ka specifika të veçanta kriminologjike, prandaj ai nuk është i njëjtë por i ndryshëm pasi që ka karakteristika dalluese të tij. Trajtimin e këtyre karakteristikave kriminale e bën fenomenologjia kriminale³⁵⁸. Gjatë trajtimit kriminologjik një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet shkaqeve të natyrës objektive dhe subjektive, formës dhe mënyrës së paraqitjes, dinamikës dhe zhvillimit të kriminalitetit ekonomik në territorin e Prokurorisë dhe Gjykatës Komunale – Themelore në Ferizaj në bazë të kallëzimeve penale dhe aktgjykimeve në periudhën kohore 2008-2012.

Për kriminalitetin ekonomik si dukuri ka pasur mendime të ndryshme, Qojeviqi konsideronte se veprat penale në fushën e ekonomisë paraqesin rrezik për ekonominë e vendit³⁵⁹. Davidović kriminalitetin ekonomik e ndërlidh me çfarëdo forme përmes së cilës sulmohet sistemi ekonomik, duke përfshirë veprat penale, kundërvajtjet dhe deliktet ekonomike³⁶⁰.

358 Bajgora. L. Ali, *Krimet Kundër të Drejtave dhe Lirive në Kosovë*, Qendra për të Drejtat e Njeriut-Gruas "Elena", Prishtinë, 1998, fq. 85.

359 Cejović. Bora, *"Kriviqno Pravo"*, Beograd, 1998, fq. 257.

360 Davidović. Dragomir, *"Privredni kriminalitet i uloga drushtvene kontrole na njegovom suzbijanju"*, Beograd, 1965, fq. 10.

Ky grup i veprave penale edhe pse shkakton pasoja të mëdha materiale për buxhetin dhe ekonominë në përgjithësi, është vështirë që në fillim të vërehen ndryshimet qoftë te personat fizikë apo juridikë.

Sa i përket veprimtarisë apo sferës, ku kryhen më shumë këto vepra penale, sipas profesorit Haki Demolli gjatë krahasimit të veprave penale kundër ekonomisë në territorin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për periudhën 1979-1988, ka konstatuar se printe vepra penale e shpërdorimit dhe plaçkitjes³⁶¹. Ndërsa aktualisht sipas statistikave nga prokuroria e shtetit për vitet 2008-2012³⁶² dhe nga statistikat e Gjykatës Komunale në Ferizaj³⁶³, prin vepra penale “falsifikimi i parasë”(neni 244).

Kriminaliteti ekonomik edhe në të kaluarën ishte mjaft i lartë. Profesor Raxhep Gashi, gjatë analizimit të veprave penale në fushën e ekonomisë gjatë periudhës 1984-1988, ka konstatuar se veprat penale kundër ekonomisë kanë marrë pjesë në strukturën e përgjithshme të kriminalitetit me 30.1%³⁶⁴. Gjithashtu kryerës të këtyre veprave penale janë edhe të miturit. Nga të dhënat e siguruara numri më i madh i të dënuarve ka qenë në Gjykatën Komunale të Gjilanit dhe në atë të Prizrenit dhe Ferizajt³⁶⁵.

361 Demolli. Haki, *”Kriminaliteti ekonomik në Kosovën e viteve të tetëdhjeta”*, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2009, fq. 44.

362 Prokuroria e Shtetit në Republikën e Kosovës, raport për periudhën 2008-2012, për veprat penale kundër ekonomisë. Marrë nga: <http://www.psh-ks.net/?page=1,41&ddate=2012> (parë më 10.10.2013).

363 Raport i Gjykatës Komunale në Ferizaj për periudhën, 2008-2012, për lëndët e pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura.

364 Gashi. Rexhep, *”Kriminaliteti në Kosovë gjatë viteve 1984-1998”*, E drejta, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2004, fq. 116.

365 Azem. Hajdari, *”Kriminaliteti i të miturve në Kosovë, 2001-2003”*, Botues “autori”, Prishtinë, 2004, fq. 88.

6.2. Disa karakteristika fenomenologjive të veprave penale kundër ekonomisë në territorin e Gjykatës dhe Prokurorisë Komunale në Ferizaj në periudhën 2008-2012

Pas krijimit të realitetit të ri në vitin 1999, në Kosovë filloi një epokë e re në të gjitha sferat e jetës. Statusi ende plotësisht i padefinuar, legjislacioni i shumëllojshëm dhe heterogjen, prezenca ndërkombëtare nga shumë vende të botës, krijuan rrethana të reja për zhvillimin dhe ndërtimin e Kosovës. Nga kjo gjendje u krijua edhe një terren i përshtatshëm për zhvillimin e kriminalitetit në përgjithësi e posaçërisht atij në fushën ekonomike. Kjo pjesë e Evropës që fatkeqësisht doli nga lufta plotësisht e shkatërruar, privatizimi i ndërmarrjeve publike dhe kalimi në ekonominë e tregut të lirë, hapja e shumë bizneseve private, ndikuan që të paraqitet kriminaliteti ekonomik, i cili nuk ishte i panjohur edhe për vendet që kishin kaluar transicionin e tillë si Kosova. Nga ky ndikim nuk ishte përjashtuar as territori ku vepronte Gjykata - Prokuroria Komunale e Ferizajt me rrethinë.

Gjatë transicionit që kaloi Kosova dhe atë: periudha 1999-2008, shpallja e pavarësisë më 17 Shkurt 2008, vendosja e Misionit të Eulex-it 2009, pothuajse të gjitha llojet e industrive të vendit ishin falimentuar dhe krahas saj kishte lulëzuar industria e krimit të organizuar³⁶⁶. Një fenomen tjetër që e bën këtë territor të jetë i përfshirë në krimet kundër ekonomisë, sidomos për periudhën e 2008-2012, është edhe fakti se ky territor i gjykatës përfshin edhe dy pika kufitare atë të Hanit të Elezit dhe Glloboqicës, ku persona fizikë dhe juridikë shpeshherë hasen duke kontrabanduar mallra, duke bërë shmangie mashtruese nga obligimet doganore me deklarata të pavërteta për mallin që e

366 Haziri. Fatos, “*Krimi i organizuar si fenomen kërcënues për sigurinë publike dhe sundimin e rendit dhe ligjit në Republikën e Kosovës*”, Revista shkencore, Kolegji Evropian “Juridica”, Prishtinë, 2013, fq. 81

rrisin numrin e veprave penale në fushën e ekonomisë e që sipas të dhënave nga prokuroria e shtetit vetëm për vitin 2008 janë paraqitur 54 kallëzime penale për veprat penale në fushën e ekonomisë nga neni 231 e deri te neni 251³⁶⁷.

Nëse e krahasojmë këtë grup të veprave penale, në raport me numrin e përgjithshëm të kallëzimeve penale të paraqitura në Prokurorinë Komunale të Ferizajt për periudhën 2008, që është gjithsej 2045³⁶⁸, konsideroj se ende ekziston një pjesëmarrje relativisht e vogël e këtij grupi të veprave penale.

Mendoj se numri i vogël i kallëzimeve penale është për shkak të natyrës që kanë veprat penale kundër ekonomisë, zbulimi i tyre me vështirësi dhe se kryerësit e tyre janë të profileve të ndryshme duke mos i përjashtuar edhe vetë zyrtarët publikë të shtetit kujtoj që numri i këtyre veprave është shumë më i madh sesa ato që paraqiten apo zbulohen nga organet e ndjekjes. Andaj, për të kuptuar më qartë specifikat, kategorinë e kryerësve të këtyre veprave penale në fushën e ekonomisë, dinamikën dhe strukturën e tyre do të analizojmë paraqitjen e kallëzimeve penale në Prokurorinë Komunale të Ferizajt nga viti 2008 deri më 2012.

6.2.1. Dinamika e veprave penale kundër ekonomisë sipas kallëzimeve penale

Dinamikën e paraqitjes së veprave penale kundër ekonomisë në territorin e Prokurorisë Komunale të Ferizajt, do të paraqitet përmes kallëzimeve penale të ushtruara gjatë periudhës kohore 2008-2012. Krahasimi do të bëhet përmes kallëzimeve

367 Raport i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për kallëzimet penale të pranuar për vitin 2008 në Prokurorinë Komunale të Ferizajt për veprat penale kundër ekonomisë.


368 Raport i Prokurorisë Komunale në Ferizaj për vitin 2008, për kallëzimet penale të paraqitura nga ana e policisë dhe të tjerëve përfshin edhe territorin e komunave: Kaçanik, Hani i Elezit, Shtërpçë dhe Shtime.

penale të paraqitura kundër veprave penale, kundër ekonomisë, sipas Kodit Penal të Përkohshëm të Kosovës të vitit 2004, nga neni 232 deri në nenin 251³⁶⁹. Në vazhdim do të paraqesim dinamikën e veprave penale kundër ekonomisë në Prokurorinë Komunale të Ferizajt në bazë të kallëzimeve penale të paraqitura sipas:

- Numrit të personave të përfshirë në kallëzim penal,
- Numrit të kallëzimeve penale të pazgjidhura në fillim,
- Numrit të kallëzimeve penale që kanë mbetur të pazgjidhura,
- Kallëzimet penale të parashtruara e që janë pranuar,
- Numrit të kallëzimeve të zgjedhura,
- Numrit të personave rastet e të cilëve janë zgjidhur,
- Numrit të kallëzimeve penale të pazgjidhura për periudhën raportuese,
- Numrit të rasteve që kanë mbetur të pazgjidhura në fund.

369 Shih: Kodi Penal i Përkohshëm i Kosovës, që hyri në fuqi më 6 prill 2004, neni 232-251.

Tabela 2. Pasqyra e të dhënave për kallëzimet penale kundër veprave penale kundër ekonomisë në Prokurorinë Komunale të Ferizajt për periudhën 2008-2012³⁷⁰



Burimi: Prokuroria Themelore, Ferizaj

Duke analizuar dinamikën e paraqitjes së kallëzimeve të reja penale në Prokurorinë e Ferizajt, nga 2008 e deri në vitin 2010, vërehet një ngarkesë e

³⁷⁰ Raportet e Prokurorisë së Shtetit për vitin 2008-2012.


vazhdueshme me kallëzime të reja penale dhe paraqitja e tyre është në rritje nga viti në vit, që nënkupton se kemi rritje të veprave penale në fushën e ekonomisë.

Gjatë krahasimit të pjesëmarrjes së veprave penale kundër ekonomisë për vitin 2008, kundër të cilave ishin paraqitur gjithsej 54 kallëzime, në raport me numrin e përgjithshëm të veprave penale të paraqitura në tërësi për vitin e njëjtë, që rezulton të jetë 2045, konstatohet se ky grup i veprave penale përbën vetëm 2.62% të numrit të përgjithshëm. Ndërsa për vitin 2011 dhe 2012, veprat penale kundër ekonomisë kanë pasur rënie. Nga krahasimi me numrin e përgjithshëm të veprave penale të paraqitura për vitin 2011, që rezulton të ishin 2642 kallëzime, ndërsa për veprat penale kundër ekonomisë vetëm 120, konstatohet pjesëmarrja e tyre vetëm 2.2% .

Gjatë hulumtimit të kallëzimeve penale, të paraqitura në prokurori sipas %, për veprat penale kundër ekonomisë pasqyra e tyre është si në vijim:

- Gjatë vitit 2008 , janë paraqitur gjithsej 48 kallëzime penale,
- Në vitin pasues, 2009, janë paraqitur gjithsej 82 kallëzime të reja penale ose për 70.83%, më shumë krahasuar me vitin 2008,
- Gjatë vitit 2010, janë paraqitur gjithsej 86 kallëzime penale ose 4.88% më shumë, krahasuar me vitin paraprak,
- Viti 2011 është viti në të cilin kjo prokurori ka pranuar 82 kallëzime penale ose më pak për 4.65%, , krahasuar me kallëzimet e pranura në vitin paraprak,
- Trendi i paraqitjes të zvogëluar të kallëzimeve penale ka vazhduar edhe në vitin 2012, janë paraqitur gjithsej 70 kallëzime penale ose për 14.63% më pak krahasuar me vitin 2011.

Nga ky krahasim i bërë kujtoj se trendi i zvogëlimit të ardhjes së kallëzimeve penale, gjatë dy viteve të fundit, na bënë të supozojmë se kemi të bëjmë me forcimin e sundimit të ligjit.



Grafiku 1. Numri i personave kundër të cilëve janë parashtruar kallëzimet penale

Prokuroria e Ferizajt, nga viti në vit, ka zgjidhur numër gjithnjë më të madh të kallëzimeve penale të ushtruara kundër veprave penale kundër ekonomisë të kësaj natyre.


Pasqyra e kallëzimeve penale të zgjidhura nga prokuroria sipas viteve në % ishte si në vazhdim:

- Gjatë vitit 2008 janë zgjidhur 47 kallëzime penale,
- Në vitin 2009 Prokuroria e Ferizajt ka zgjidhur gjithsej 67 kallëzime penale ose për 42.55% më shumë krahasuar me vitin paraprak,
- Trendi i rritjes ka vazhduar edhe në vitin 2010 janë zgjidhur 70 kallëzime penale ose 4.48% më shumë,

- Prokuror në vitin 2011, ka zgjidhur gjithsej 72 kallëzime penale ose për 2.86% më shumë, krahasuar me vitin paraprak,

- Në vitin 2012 prokuroria ka zgjidhur 94 kallëzime ose ka rritje prej 30.56%, krahasuar me vitin 2011.

Nga hulumtimi vërehet se prokuroria ka bërë një angazhim më të madh në procedimin e akteve akuzuese ndaj kryerësve të veprave penale.




Grafiku 2. Numri i personave rastet e të cilëve janë zgjidhur

Nga hulumti vërejmë se ka dinamikë në zgjidhjen e kallëzimeve penale edhe për persona. Ne konsiderojmë se rezultati i zgjidhjes së kallëzimeve penale, pa marrë parasysh mënyrën e zgjidhjes, qoftë duke ngritur akt akuzues ose duke hedhur apo pushuar hetimet, janë falë angazhimit më të madh të prokurorëve.

6.2.2. Struktura sipas llojit të veprave penale kundër ekonomisë

Gjatë analizimit të kallëzimeve penale të parashtruara në Prokurorinë Komunale të Ferizajt për periudhën kohore 2008-2012, duke përfshirë territoret që kjo prokurori i ka në kompetencë: Kaçanikun, Shterpcën dhe Shtimen, vërehet kjo strukturë e veprave penale kundër ekonomisë ndaj të cilave janë drejtuar kallëzimet penale sipas kodit penal të vitit 2004, të parapara nga neni 232 e deri te neni 251. Hulumtimi është bërë edhe për numrin e personave të dyshuar, ndaj të cilëve janë parashtruar kallëzime penale.

Tabela 3. Struktura e veprave penale kundër ekonomisë dhe numrit të personave të dyshuar sipas kallëzimeve penale të parashtruara në Ferizaj për vitin 2008³⁷¹



Burimi: Prokuroria Themelore, Ferizaj

Gjatë hulumtimit të kallëzimeve penale të parashtruara, kundër veprave penale të ekonomisë të pasqruara në formë tabelare, konstatohet se numri më i madh i tyre është i drejtuar për vepra penale “Falsifikimi i parasë”, me 38 kallëzime penale ose 79.16 %, nga numri i tërësishëm i kallëzimeve të parashtruara ndaj veprave penale kundër ekonomisë, pastaj vijnë veprat penale “Shmangia nga tatimi” (neni 249), me 5 kallëzime penale ose me 20.83%, vepra penale “Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm”, (neni 243), me 1 kallëzim penal ose me 2.08%, “Keqpërdorimi i


³⁷¹ Raport i Prokurorisë Komunale në Ferizaj, përkitazi me strukturën e kallëzimet penale dhe numrin e personave të dyshuar për veprat penale në fushën e ekonomisë për periudhën 2008.

autorizimeve në ekonomi” (neni 236), me 1 kallëzim penal ose me 2.08% ³⁷².

Nga hulumtimi konstatojmë se, nga 20 sosh sa është numri i tërësishëm i veprave penale të parapara, kundër ekonomisë sipas kapitullit 22 të Kodit Penal të vitit 2004 vetëm për 6 vepra penale të përmendura më lart është ushtruar kallëzim penal, ndërsa ndaj 14 veprave penale si: shkaktimi i falimentimit, dëmtimi i kreditorëve, veprimtaria e papërgjegjshme ekonomike etj., nuk është parashtruar asnjë kallëzim penal. Kjo sjell dilema dhe lë të kuptohet se ende ky grup i veprave penale ose nuk kallëzohen në tërësi ose zbulohen me vështirësi. Ndërsa sa i përket numrit të personave të përfshirë si të dyshuar në kryerjen e këtyre veprave penale, kundër ekonomisë, që ishte gjithsej 61 persona, krahasuar në raport me numrin e përgjithshëm të personave të përfshirë si të dyshuar në kallëzimet penale për vitin 2008, që rezulton të jetë 2558 për të gjitha veprat penale, pjesëmarrja e tyre ishte 2.38%, që përbëjnë një numër të vogël të personave të dyshuar, krahasuar me krimet e tjera në përgjithësi.

372 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal, i vitit 2004, kapitulli XXII, Veprat penale kundër ekonomisë.

Tabela 4. Struktura e veprave penale kundër ekonomisë dhe numri i personave të dyshuar, sipas kallëzimeve penale në Prokurorinë Komunale të Ferizajt, për vitin 2009³⁷³



Burimi: Prokuroria Themelore, Ferizaj


Duke krahasuar strukturën e veprave penale, kundër ekonomisë, të paraqitura përmes kallëzimeve penale për periudhën 2009, vërejmë se ka një rritje të veprave

³⁷³ Raport i Prokurorisë Komunale në Ferizaj, përkitazi me kallëzimet penale dhe numrin e personave të dyshuar për veprat penale në fushën e ekonomisë për periudhën 2009.

penale në fushën e ekonomisë për 70.83% më shumë se viti 2008. Gjithashtu edhe gjatë vitit 2009 prin vepra penale “Falsifikimi i parasë” (neni 244), e përcjell nga vepra penale “Shmangja e tatimit”, (neni 249). Ajo që vlen të theksohet është se në vitin 2009 kemi kallëzime penale në drejtim të veprës penale “Veprimtaria e pandërgjegjshme ekonomike”, (neni 233), dhe veprës penale “Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo kreditit”, (neni 248).

Ndërsa sa i përket numrit të dyshuarve të përfshirë në kallëzime penale për vitin 2009 është 96 nga numri tërësishëm i personave të dyshuar për të gjitha veprat penale që është 2582 persona ose 3.71%, nëse e krahasojmë me vitin paraprak shihet një rritje e kallëzimeve penale për veprat penale kundër ekonomisë dhe të dyshuarve. Sa i përket rritjes së kallëzimeve penale, kundër veprave penale kundër ekonomisë, për 2009, kujtoj është rezultat i një pune të mirë të prokurorisë dhe policisë.

Tabela 5. Struktura e veprave penale kundër ekonomisë dhe numri i personave të dyshuar, sipas kallëzimeve penale në Prokurorinë Komunale të Ferizajt, për vitin 2010³⁷⁴




Burimi: Prokuroria Themelore, Ferizaj

Gjatë hulumtimit të strukturës së kallëzimeve kundër veprave penale në fushën e ekonomisë për vitin 2010, kemi vërejtur se ka pasur rritje të numrit të kallëzimeve për veprat penale kundër ekonomisë si: “Cenimi i të drejtës së patentës (neni 240)” etj.,

³⁷⁴ Raport i Prokurorisë Komunale në Ferizaj, përkitazi me kallëzimet penale dhe numrin e personave të dyshuar për veprat penale në fushën e ekonomisë për periudhën 2010.

ndërsa edhe gjatë vitit 2010 vërehet se vepra penale më së shumti e kallëzuar është falsifikimi i parasë dhe shmangia e tatimit, në përqindje ishte 90.69 %, nga numri i tërësishëm i kallëzimeve kundër veprave penale në fushën e ekonomisë. Ndërsa numrin i të dyshuarve për këto vepra penale që rezultonë të ishte gjithsej 104 në raport me numrin e përgjithshëm të të dyshuarve në Prokurorinë Komunale në Ferizaj, për vitin e njëjtë që rezultoj të ishte 2444 persona , shihet se numri i të dyshuarve për veprat penale kundër ekonomisë mbetet në përqindje të vogël 4.25% , krahasuar me krimet e tjera .

Tabela 6. Struktura e veprave penale kundër ekonomisë dhe numri i të dyshuarve, sipas kallëzimeve penale në Prokurorinë Komunale të Ferizajt për vitin, 2011 ³⁷⁵




Burimi: Prokuroria Themelore, Ferizaj

³⁷⁵ Raport i Prokurorisë Komunale në Ferizaj, përkitazi me kallëzimet penale dhe numrin e personave të dyshuar për veprat penale në fushën e ekonomisë për periudhën 2011.

Gjatë hulumtimit dhe analizimit edhe përmes formës tabelare për strukturën e kallëzimeve penale të parashtruara kundër llojit të veprave penale, kundër ekonomisë rezulton se për vitin 2011 kanë qenë të parashtruara kallëzime penale vetëm për 7 vepra penale nga 20, sa ishte numri i përgjithshëm i tyre. Hulumtimi tregoi se edhe në vitin 2011, vepra penale falsifikim i parasë është më e atakuar me 66 kallëzime penale apo në përqindje me 80.48%, nga numri i tërësishëm e ndjekur nga vepra penale shmangia nga tatimi me 6.09%. Në këtë vit kishte risi ngase për herë të parë parashtrohet një kallëzim penal për veprën penale “mashtrimi i blerësve” neni 242 që nuk ishte kallëzuar në vitet e mëparshme. Ndërsa sa i përket numrit të personave të dyshuar si kryerës potencialë të veprave penale kundër ekonomisë në këtë periudhë që ishte 94 persona, krahasuar me numrin e përgjithshëm të dyshuarve që ishte 3489, persona për vitin e njëjtë, konstatohet se vetëm 2.69% janë të dyshuar në krimet kundër ekonomisë, që është një përqindje e vogël dhe kjo tregon se përveç rënies të kallëzimeve penale në fushën e ekonomisë kemi edhe rënie të përqindjes së personave të involvuar.

Tabela 7. Struktura e veprave penale kundër ekonomisë dhe numri i personave të dyshuar, sipas kallëzimeve penale në Prokurorinë Komunale të Ferizajt, për vitin 2012 ³⁷⁶




Burimi: Prokuroria Themelore, Ferizaj

Gjatë analizimit të strukturës së kallëzimeve kundër veprave penale, kundër ekonomisë, vërehet një rënie e kallëzimeve penale, kundër ekonomisë gjatë vitit 2012,

³⁷⁶ Raport i Prokurorisë Komunale në Ferizaj, përkitazi me kallëzimet penale dhe numrin e personave të dyshuar për veprat penale në fushën e ekonomisë, për periudhën 2012.


në përqindje është 14.63% më pak, krahasuar me vitin 2011. Gjithashtu ka një rënie të kallëzimeve penale në tërësi për të gjitha veprat penale të paraqitura në Prokurorinë e Ferizajt, që për vitin 2012 që ishte 2502 kallëzime apo në përqindje 9.47% , më pak nga numri i tërësishëm i kallëzimeve të vitit paraprak. Ndërsa edhe në vitin 2012 prin vepra me më shumë kallëzime penale “falsifikimi i parasë” dhe “shmangia nga tatimi” që lë të kuptohet se në të ardhmen duhet organizim dhe një preventivë më efikase e organeve shtetërore për t’i luftuar dhe parandaluar këto dy vepra penale, duke pasur parasysh se këto vepra mund të ndikojnë në destabilizimin e ekonomisë së vendit, por edhe në rritjen e krimit të organizuar. Numri i personave të involvuar, sa i përket veprave penale kundër ekonomisë, është 77 ose në përqindje 2.42% në raport me numrin e përgjithshëm të të involvuarve që ishte 3171 për të gjitha veprat penale.

**Grafiku 3. Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale nga ana e Prokurorisë
Komunale të Ferizajt për veprat penale kundër ekonomisë për periudhën
hulumtuese**



Të dhënat në grafikun tregojnë se shumica e kallëzimeve penale të paraqitura ose 42% , kanë përfunduar me propozimakuzë, ku dënimi për këto vepra penale kundër ekonomisë është paraparë me gjobë ose burgim deri në tre vjet, ndërsa vetëm rreth 4% janë aktakuza ku dënimi parashihet prej tre vjet e më shumë burgim për kryerësit e veprave penale, ndërsa një numër rreth 0.25%, prokuroria i ka pushuar hetimet në mungesë të provave.

Tabela 8. Prezantimi i kallëzimeve penale për persona sipas mënyrës së zgjidhjes për secilin vit veç e veç




Burimi: Prokuroria Themelore, Ferizaj

Nga hulumtimi shihet se një pjesë e kallëzimeve penale në përqindje 24.75%, për periudhën e hulumtimit 2008-2012, janë hedhur çka na bënë të mendojmë se policia e Kosovës nuk ka siguruar në fillim prova të mjaftueshme për dyshimin e arsyeshëm për të ngritur kallëzimin penal. Kjo nuk e përjashton faktin tjetër se prokuroria (prokurorët e

çështjes) ka vendosur që këto kallëzime t'i hedhin nën ndikim apo ndonjë formë tjetër. Hulumtuesi në këtë çështje nuk është lëshuar në mungesë të bazës ligjore dhe kompetencës duke pasur parasysh se prokurori i shtetit në punën e tij është i pavarur³⁷⁷ dhe mbikëqyrja e tij bëhet vetëm përmes subkordinimit nga një prokuror i nivelit më të lartë.

³⁷⁷ Ligji për Prokurorin e Shtetit me nr. 03/L-225, i dt. 30 shtator 2010, neni 3, parag. 1 dhe 3.

Tabela 9. Paraqet pjesëmarrjen e të dyshuarve sipas gjinisë për periudhën kohore 2008-2012.



Burimi: Prokuroria themelore, Ferizaj


Sipas të dhënave të pasqyruar në mënyrë tabelare kryerësit e gjinisë mashkullore marrin pjesë në krimet kundër ekonomisë mbi 93%, në raport me gjininë femërore e cila merr pjesë diku më pak se 6%, me tendencë të rritjes.

Disa faktorë të tjerë që kanë ndikuar në rritjen e kallëzimeve penale të pazgjidhura për vepra penale kundër ekonomisë

Me gjithë faktin se Prokuroria e Ferizajt nga viti në vit ka zgjidhur gjithnjë e më shumë kallëzime penale, megjithëatë numri i kallëzimeve penale të pazgjidhura është në rritje të vazhdueshme. Nga hulumtimi i bërë kemi arritur në përfundim dhe kemi konstatuar disa nga faktorët që kanë ndikuar në rritjen e numrit të kallëzimeve penale, ku janë të paraqitura si më poshtë:

- Mosefikasiteti i organeve dhe institucioneve shtetërore në përmbushjen e detyrave nga kompetenca e tyre (policia, organet e tjera shtetërore etj.),
- Numri i pamjaftueshëm i prokurorëve ,
- Kushtet e punës (mungesa e hapësirës, numri i pamjaftueshëm i automjeteve për terren, mungesa e teknologjisë informative, stimulimi material i prokurorëve dhe stafit mbështetës, etj.),
- Numri i vogël i bashkëpunëtorëve dhe praktikantëve,
- Çështja e dëshmitarëve,
- Pasojat e luftës,
- Shfrytëzimi joracional i kohës së punës nga ana e disa prokurorëve dhe zyrtarëve të prokurorëve, (mungesa e prokurorëve dhe zyrtarëve nga puna për shkak të trajnimeve dhe seminareve të ndryshëm, etj.),
- Buxheti i limituar për punësimin e stafit të nevojshëm,...
- Mungesa e sistemit të menaxhimit të lëndëve,...etj.

Kallëzimet penale të pazgjidhura në fillim krahasuar me kallëzimet penale të pazgjidhura në fund të periudhës sipas viteve për veprat penale kundër ekonomisë, prej nenit 232 deri 251)



Grafiku 4. Numri i kallëzimeve të pazgjidhura në fillim dhe fund

Gjatë hulumtimit të kallëzimeve të pazgjidhura në fillim dhe në fund të periudhës hulumtuese 2008-2012, shihet se për çdo vit kemi një numër më të madh të kallëzimeve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese, në vazhdim shihet kjo rritje për vitin 2008 kemi një kallëzim penal, më tepër të pazgjidhur, për vitin 2009, 15, për vitin 2010, 16, për vitin 2011, 10 kallëzime të pazgjidhura më shumë se në fillim të vitit, ndërsa vetëm për vitin 2012 kemi një numër më të vogël të kallëzimeve penale të mbetura të pazgjidhura nga 48 që ishin në fillim të vitit 2012, kishin mbetur 24 ose 24 më pak.



Periudha krahasuese e veprave penale, në fushën e ekonomisë, është bërë sipas Kodit Penal të Përkohshëm të Kosovës, të vitit 2004, ku ende kishte ekzistuar instituti për konfirmimin e aktakuzës. Andaj, akti i ngritur si propozim akuze nuk ka pasur nevojë për konfirmim, por për ato është zhvilluar procedura gjyqësore pa u konfirmuar më parë. Ndryshimi thelbësor tani me kodin e ri penal, që është në fuqi nga viti 2013, nuk ekziston fare propozimakuza si akt akuzues.

Në vazhdim do të përcjellim vendimet e Gjykatës Komunale në Ferizaj për periudhën hulumtuese 2008- 2012.

Gjatë periudhave raportuese, në fazën e konfirmimit të Aktakuzës dhe para shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Komunale në Ferizaj ka konfirmuar aktakuza dhe pezulluar procedurën për personat si në vijim, shih tabelat dhe grafikonet.

Grafiku 5. Konfirmimi i aktakuzës

Grafiku 6. Pezullimi i procedurës




Marrë në përgjithësi gjykatat, përkitazi me aktet akuzuese të prokurorive kanë vendosur si në vijim:

- Aktgjykim me urdhër ndëshkimor kanë vendosur për 20.18% të personave
- Për 32.46% të personave gjykatat kanë vendosur me aktgjykim refuzues
- 9.65% persona janë liruar nga aktakuza, dhe

- Janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar 37.72% të personave nga numri i përgjithshëm i personave kundër të cilëve janë dërguar aktet akuzuese në gjykatat kompetente.


Grafiku 7



Nga hulumtimi vihet në dukje se vendimet e gjykatës në 32.46 %,ishin me aktgjykim refuzues që ne mendojmë është fakt tejet shqetësues ngase tregon se aktet akuzuese janë ngritur pa pasur prova të mjaftueshme materiale dhe prokurori është tërhequr nga akuza apo për shkak se lënda është parashkruar me parashkrim absolut apo relativ.

Kujtojmë se praktika e dënimit me urdhër ndëshkimor është praktikë e mirë për arsye të efikasitetit dhe qëllimit të dënimit.

Tabela 10. Vendimet e Gjykatës Komunale në Ferizaj, për strukturën e veprave penale, numrin e personave të gjykuar apo të liruar, mënyrën e zgjidhjes dhe sanksionin e shqiptuar për veprat penale kundër ekonomisë nga neni 232-251 për vitin 2008 ³⁷⁸



³⁷⁸ Raporti i Gjykatës Komunale të Ferizajt për vitin 2008, për veprat penale kundër ekonomisë për strukturën e veprave penale, llojin e aktgjykimeve, mënyrën e vendosjes, numrin e personave të gjykuar dhe sanksionin penal.

Sipas të dhënave që kanë dalë nga studimi, është nxjerrë një pasqyrë që tregon se Gjykata Komunale në Ferizaj, për vitin 2008, ka nxjerr gjithsej 24 aktgjykime vetëm për tri lloje të veprave penale, ku nga këto vepra penale prin vepra penale falsifikimi i parasë me 23 aktgjykime ose 92% nga numri i tërësishëm i aktgjykimeve të shkallës së parë për veprat penale kundër ekonomisë. Gjykata komunale me rastin e vendosjes për akuzën ka sjell 10 aktgjykime refuzuese, 3 aktgjykime liruese, 6 aktgjykime dënuese, 1 aktgjykim me vërejtje gjyqësore, 1 pushim të procedurës, 3 hedhje të aktit akuzues, 1 lëndë ka mbetur e pakryer. Nga të dhënat e krahasuara shihet se 40 % e akuzave kanë përfunduar me aktgjykime refuzuese që është tejte shqetësuese për faktin se disa lëndë janë parashkruar e në disa raste organi i ndjekjes në mungesë të provave është tërhequr nga akuza. Siç shihet Gjykata Komunale në Ferizaj ka nxjerr vetëm 7 aktgjykime dënuese ose 28% nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve.

Gjithashtu gjykata ka shpallur fajtorë vetëm 9 persona, ndërsa 21 persona të tjerë janë liruar apo ndaj tyre ka pushuar procedura penale ose në përqindje 30% janë shpallur fajtorë, ndërsa 63% janë liruar me aktgjykim ose me aktvendim ka pushuar procedura penale. Dënimet e shqiptuara: shumica e tyre janë me gjobë 5 raste, në 1 rast ka shqiptuar dënim me kusht dhe 1 rast vërejtje gjyqësore. Vlen të theksohet se vetëm një lëndë ka mbetur e pakryer me nr. 734/08, vepra penale "tregtia e ndaluar" neni 246 KPPK-së, ose në përqindje 4%.

Krahasuar me Gjykatën Komunale në Kaçanik, e cila për vitin 2008, kishte nxjerr vetëm katër aktgjykime përfundimtare dhe atë vetëm për veprën penale të falsifikimit të parasë neni 244, konstatohet se 100% e vendimeve janë për këtë vepër penale, ndërsa nuk ka pasur asnjë vendim gjyqësor për veprat e tjera. Politika ndëshkimore është e njëjtë me Gjykatën në Ferizaj, ku të gjitha dënimet janë me kusht.

Në vazhdim do të paraqiten disa aktgjykime përfundimtare, duke respektuar procedurën e publikimit të tyre.

Gjykata komunale në Ferizaj në çështjen penale: P. Nr. 43/2008, kundër të akuzuarve: B. K. nga Ferizaj, me përgatitje të mesme shkollore, menaxher i gjendjes së mesme ekonomike, F.D. nga Ferizaj, me përgatitje të mesme shkollore, biznesmen, i gjendjes së mesme ekonomike, R. R. nga Ferizaj, me përgatitje të mesme shkollore, biznesmen, i gjendjes së mesme ekonomike dhe A. B. nga Ferizaj, me përgatitje të mesme, biznesmen, i gjendjes së mesme ekonomike i ka shpallur fajtorë veç e veç për veprën penale “Përdorimi i paautorizuar i firmës, i markës apo modelit nga neni 241 par. 2 të KPPK-së, duke i dënuar që të gjithë veç e veç me dënim me gjobë nga 300 euro, të cilin dënim ishin obliguar që ta paguajnë brenda afatit prej 15 ditëve, pasi vendimi ta merrë formën e prerë, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor secili nga të dënuarit të paguajë nga 20 euro. Të akuzuarit janë shpallur fajtorë sepse kanë vënë në qarkullim libra dhe pajisje tjera shkollore nga persona të paautorizuar, duke vendosur pa autorizim mostrën e Shtëpisë botuese “Libri shkollor” me seli në Prishtinë, e cila ka qenë e autorizuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë³⁷⁹.

Gjykata Komunale në Ferizaj, në çështjen penale P. NR. 148/2008, kundër të akuzuarve L. A. dhe B. I. që të dy nga Ferizaj, të gjendjes së mesme ekonomike dhe të miturit F. B., gjithashtu nga Ferizaj, ky i fundit me shkollim fillor dhe i gjendjes së varfër ekonomike me dt. 25 maj 2010, ka nxjerr aktgjykim refuzues kundër L. A. dhe B. I. të akuzuar për veprën penale në bashkëkryerje “Falsifikimi i parasë” nga neni 244. parag. 3. lidhur me nen. 23 të KPK-së, ngase ka arritur parashkrimi i ndjekjes penale. Gjykata në kuptim të nenit 489 parag. 1, të KPPK-së, ka konfiskuar bankënotën e

³⁷⁹ Aktgjykimi P. nr. 43/2008, Gjykata Komunale Ferizaj, i dt. 10.2.2010.

falsifikuar prej 100 dollarëve me nr. serik DC22051526 B, ndërsa ndaj të miturit F. B. në kuptim të nenit 71 parag. 2 të Ligjit Penal për të Mitur ka nxjerr aktvendim, për pushimin e procedurës penale për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Shpenzimet e procedurës penale bie barrë e mjeteve buxhetore. I dëmtuari R. B. për kërkesën pasurore juridike ishte udhëzuar në kontest civil³⁸⁰.

Gjykata Komunale në Kaçanik ka nxjerr këto aktgjykime për veprat penale kundër ekonomisë për vitin 2008:

1. P.89/2008, i dt. 02.02.2009, vepra falsifikim i parasë neni 244 i KPPK-së, dënimi i shqiptuar me kusht.³⁸¹
2. P.108/2008,i dt. 06.02.2009 , vepra falsifikim i parasë neni 244 i KPPK-së, dënimi i shqiptuar me kusht.³⁸²
3. P.194/2008,i dt.06.02.2009, vepra falsifikim i parasë neni 244 i KPPK-së, dënimi i shqiptuar me kusht.³⁸³
4. P.237/2008, i dt. 06.02.2009, vepra falsifikim i parasë neni 244 i KPPK-së, dënimi i shqiptuar me kusht³⁸⁴

380 Aktgjykimi P. nr. 148/2008, Gjykata Komunale Ferizaj i dt. 25 maj 2010.


381 Aktgjykimi P. nr. 89/2008, Gjykata Komunale Kaçanik i dt. 2.2.2009.

382 Aktgjykimi P. nr. 108/2008, Gjykata Komunale Kaçanik i dt. 6.2.2009.

383 Aktgjykimi P. nr. 194/2008, Gjykata Komunale Kaçanik i dt. 6.2.2009.

384 Aktgjykimi P. nr. 237/2008, Gjykata Komunale Kaçanik i dt. 6.2.2009.

Tabela 11. Vendimet e Gjykatës Komunale në Ferizaj për strukturën e veprave penale, numrin e personave të gjykuar apo të liruar, mënyrën e zgjidhjes, sanksionin e shqiptuar për veprat penale kundër ekonomisë nga neni 232-251 për vitin 2009



Gjatë hulumtimit të strukturës së veprave penale kundër ekonomisë për të cilat ka nxjerr vendim Gjykata Komunale për vitin 2009, është nxjerr një pasqyrë, që tregon se vetëm për 4 vepra penale, personat janë gjykuar apo është vendosur në ndonjë mënyrë tjetër, ndërsa nuk ka asnjë vendim gjyqësor për 16 vepra tjera penale, siç janë të parapara në Kodin Penal të vitit 2004. Gjithashtu 95% e vendimeve të gjykatës ishin për veprën penale “falsifikimi i parasë” apo 39 vendime gjyqësore, nga gjithsej sa ishin 42. Shqetësuese mbetet fakti edhe për këtë vit me numrin e aktgjykimeve refuzuese që ishin 22 ose 40.74% nga numri i tërësishëm i vendimeve.

Ndërsa vetëm 10 aktgjykime ishin nxjerr, ku të akuzuarit ishin shpallur fajtorë ose në përqindje 18.51% nga numri i përgjithshëm i akuzave të vendosura ose 10% më pak se në vitin 2008. Numri i të akuzuarve të shpallur fajtorë ishte 10 persona ose 17.85% nga numri i përgjithshëm i të akuzuarve që ishte 56. Nga kjo rezulton se 33, nga të akuzuarit ose 76%, janë liruar me aktgjykim apo në ndonjë mënyrë tjetër ka pushuar procedura penale. Në këtë periudhë shihet një rënie e efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve ngase 13 lëndë mbeten të pazgjidhura ose 24%, ka rënie në efikasitetin e zgjidhjes së lëndëve për 20% nga viti paraprak 2008. Sa i përket dënimeve gjykata ka shqiptuar vetëm në 1 rast dënim me burg, në 8 raste dënim me gjobë, dhe në 1 rast ka shqiptuar vërejtje gjyqësore.

Me qëllim të vërtetimit të efikasitetit të punës së Gjykatës në Ferizaj, kemi krahasuar edhe vendimet gjyqësore të nxjerra nga Gjykata Komunale e Kaçanikut për periudhën e njëjtë. Nga krahasimi rezultoi se Gjykata në Kaçanik ka nxjerr gjithsej tre vendime përfundimtare për veprat penale kundër ekonomisë dhe atë vetëm për veprën penale të falsifikimit të parasë nga neni 244 i KPPK-së.

Ja disa nga vendimet e Gjykatës Komunale në Ferizaj dhe Kaçanik.

1. Gjykata Komunale në Ferizaj, në çështjen penale P. nr. 690/2009³⁸⁵, kundër të akuzuarit XH. H. nga Prishtina, me përgatitje të mesme shkollore, tregtar, i gjendjes së mesme ekonomike e ka shpallur fajtor për veprën penale në vazhdim “Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose i rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo kreditit nga neni 248 par 1. i KPK-së, dhe e ka dënuar me dënimin me burg në kohëzgjatje prej një vit e gjashtë muaj, duke obliguar gjithashtu t’i paguaj marketit “Viva” shumën prej 315 euro. Gjithashtu, i pandehuri ishte obliguar në emër të shpenzimeve për paushallin gjyqësor të paguaj 100 euro. I pandehuri gjatë shqyrtimit gjyqësor e kishte pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës për 12 raste, për të cilat akuzohet se kishte vënë në qarkullim “Visa” kartelën e falsifikuar në emër të XH. H. dhe të A. G., duke bërë pagesa për mall në këtë market. **2.** Gjykata Komunale në çështjen penale P. nr. 847/2009, kundër të akuzuarës L. F. nga Ferizaj, mësimdhënëse e gjendjes së mesme ekonomike e akuzuar për veprën penale “Falsifikimi i parasë nga neni 244, parag. 3 të KPPK-së, ka nxjerr aktgjykim refuzues, ngase prokurori është tërhequr nga akuza. Gjykata ka marrë vendim që të konfiskohet bankënota e falsifikuar prej 100 euro me nr. serik L10310257128. Shpenzimet mbeten barrë e buxhetit³⁸⁶.

Gjykata Komunale në Kaçanik ka nxjerr këto aktgjykime për vitin 2009, për veprat penale kundër ekonomisë:

385 Aktgjykimi P. nr. 690/2009, i Gjykatës Komunale në Ferizaj, i dt. 8.10.2009.

386 Aktgjykimi P. nr. 847/2009, Gjykata Komunale Ferizaj, i dt. 21.7.2011.


1. P. nr. 156/2009, i dt. 03.06.2009, vepra falsifikimi i parasë neni 244, dënimi i shqiptuar është me kusht³⁸⁷.
2. P.nr.309/09, i dt.06.11.2009, vepra falsifikimi i parasë neni 244, numri i personave të dënuar 3 (tre). G. S. 6 (gjashtë) muaj burg, V. S. Dënim me kusht, dhe Xh. A. 7 (shtatë) muaj burg.³⁸⁸
3. P. Nr.318/2009, i dt. 02.12.2009, vepra falsifikimi i parasë neni 244, dënimi i shqiptuar me kusht.³⁸⁹

387 Aktgjykim P. nr. 156/2009, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 3.6.2009.

388 Aktgjykimi P. nr. 309/2009, Gjykat a Komunale Kaçanik, i dt. 6.11.2009.

389 Aktgjykimi P. nr. 318/2009, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt.. 2.12.2009.

Tabela 12. Vendimet e Gjykatës Komunale në Ferizaj për strukturën e veprave penale, numrin e personave të gjykuar apo të liruar, mënyrën e zgjidhjes dhe sanksionin e shqiptuar për veprat penale kundër ekonomisë nga neni 232-251 për vitin 2010



Gjatë hulumtimit të strukturës së veprave penale, kundër ekonomisë, është nxjerr një pasqyrë, që tregon se gjykata ka nxjerr vendim gjyqësor për vitin 2010, vetëm për 3 vepra penale për të cilat ka pasur aktakuzues, ndërsa për 17 vepra të tjera penale nuk ka pasur aktakuzues. Falsifikimi i parasë mbetet vepra penale që i prin veprave penale të ekonomisë me një përqindje shumë të madhe mbi 90%, çka lë të kuptohet se paraja falsifikuar në këtë periudhë ka qenë shumë prezente në territorin e Kosovës. Vazhdon edhe më tutje që pjesa më e madhe e akuzave në gjykatë të përfundojë me aktgjykim refuzues. Numri i përgjithshëm i lendeve të vendosura nga gjykata komunale për vitin 2010 që rezultoi të ishte 17, konstatohet se 11 prej tyre kanë përfunduar me aktgjykim refuzues apo në përqindje 64% , ndërsa kishte vetëm 4 aktgjykime dënuese apo 23.52%. Ne mendojmë se është tejte shqetësuese pavarësisht se a ka hequr dorë prokurori në rastet e caktuara apo ka ndodhur parashkrimi, kjo lë të kuptohet që ka nevojë për rishikim serioz të punës së organeve të drejtësisë. Efikasiteti në zgjidhjen e lëndëve edhe në vitin 2010 mbetet problem sepse nga 25 lëndë sa ishin për zgjedhje në këtë gjykatë kanë mbetur 8 prej tyre pa u zgjidhur ose 32%, që kujtoj se kemi rënie të mëtutjeshme të efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve. Shkaku mund të ketë qenë reforma e filluar për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe dështimi i disa prej tyre në kalimin testit të etikës, fakt që ka ndikuar të mos jenë efikas duke pasur parasysh faktin që pas dështimit nuk do të kishin mundësi për vazhdimin e punës si gjyqtar.

Në vazhdim do të paraqesim disa aktgjykime të plotfuqishme për periudhën e hulumtimit, mënyrën e vendosjes dhe sanksionet penale që janë shqiptuar ndaj kryerësve të veprave penale kundër ekonomisë:

1. Gjykata Komunale në Ferizaj në çështjen penale P. nr. 56/2010, kundër të pandehurit SH. B. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale “Shmangia nga tatimi nga neni 249 par. 1 të KPK-së, ka nxjerr aktvendim me të cilin ka hedhur propozim akuzën e PPK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale. Pala e dëmtuar Administrata Tatimore, zyra në Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore juridike ishte udhëzuar në kontest civil³⁹⁰.

2. Vepra penale “Falsifikimi i parasë” nga neni 244. par. 3 të KPPK-së³⁹¹, ka qenë objekt i shqyrtimit penal ndaj të akuzuarit B. A. nga Ferizaj, ekonomist i gjendjes së mirë ekonomike nën akuzën se ka vënë në qarkullim paranë e falsifikuar prej 100 euro, por e cila është zbuluar se është e falsifikuar nga punëtori i bankës, gjykata për këtë rast ka nxjerr aktgjykim refuzues me Nr. P. 109/2010, për shkak se prokurori publik ka hequr dorë nga akuza në shqyrtimin gjyqësor. Bankënota konform nenit 489 parag. 1 të KPPK-së, i është konfiskuar. Shpenzimet në rastin në fjalë mbeten barrë e buxhetit.

Me qëllim që të nxirren përfundime më të qëndrueshme kemi krahasuar edhe vendimet e Gjykatës Komunale në Kaçanik për veprat penale kundër ekonomisë për vitin 2010. Nga studimi rezultoi se kjo gjykatë ka nxjerr 3 (tre) aktgjykime të gjitha për veprën penale falsifikimi i parasë neni 244 i KPPK-së, si më poshtë :

390 Aktgjykimi P. nr. 56/2010, i Gjykatës Komunale në Ferizaj, i dt. 23.5.2012.

391 Aktgjykimi P. nr. 109/2010, i Gjykatës Komunale në Ferizaj, i dt. 23.11.2011.


1. P.nr. 82/2010, i dt.08.04.2010, vepra penale falsifikimi i parasë, neni 244, dënimi i shqiptuar me kusht.³⁹²
2. P.nr.98/2010, i dt. 07.05.2010,vepra penale falsifikimi i parasë, neni 244, dënimi i shqiptuar me kusht.³⁹³
3. P. nr.155/2010,i dt.20.04.2012, vepra penale falsifikimi i parasë, neni 244, Gjykata e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar E. D. me dënim me gjobë 250 euro, ndërsa ndaj M. D. ishte refuzuar akuza.³⁹⁴

392 Aktgjykimi P. nr. 82/2010, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 8.4.2010.

393 Aktgjykimi P. nr. 98/2010, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 7.5.2010.

394 Aktgjykimi P. nr. 155/2010, Gjykata Komnale Kaçanik, i dt. 20.4.2012.

Tabela 13. Vendimet e Gjykatës Komunale në Ferizaj për strukturën e veprave penale, numrin e personave të gjykuar apo të liruar, mënyrën e zgjidhjes dhe sanksionin e shqiptuar për veprat penale kundër ekonomisë nga neni 232-251 për vitin 2011



Nga hulumtimi është nxjerr, kjo pasqyrë me të dhënat tabelare, që tregon se gjatë vitit 2011, kemi 5 lloje të veprave penale për të cilat gjykata ka nxjerr vendime gjyqësore. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve të vendosura që rezultoi të ishte 38, mbi 94%, ishin vendime për veprën penale të falsifikimit të parasë. Edhe gjatë këtij viti nuk kishte asnjë vendim gjyqësor- aktgjykim, për 15 vepra penale tjera të parapara në Kodin Penal të Kosovës 2004, si për shembull “shkaktimi i falimentimit”, “dëmtimi i kreditorëve”, “prodhimi i ndaluar”³⁹⁵. Gjkata për 38 lëndë ka nxjerr vendim dhe atë: aktgjykim refuzues në 18 raste, ose 47.36%, aktgjykim lirues për 2, raste ose 5.26%, aktgjykim dënues për 12, raste ose 31%, ndërsa parashkrimi absolut dhe relativ kishte arritur për 6 raste ose 15.78%. Gjkata nuk kishte arritur t’i zgjedhë 5 raste ose 11.62%. Gjkata ka shpallur fajtorë 12 të akuzuar ose 31.57 %, nga numri i përgjithshëm sa ishin të akuzuar 38. Andaj, hulumtimi tregon se gjykata për 26 të akuzuar ka nxjerr vendim refuzues, lirues apo ka pushuar procedurën penale që në përqindje është 68.42%. Kjo gjendje e konstatuar kërkon nga organet e drejtësisë që të shtohet numri i gjyqtarëve, akuzat e ngritura nga prokuroria të ngriten në mbështetje të provave materiale, por nuk përjashtohen edhe faktorë të tjerë, siç janë korrupsioni dhe keqpërdorimet e tjera. Sanksionet penale të shqiptuara janë shumica me gjobë 91.66%.

1. Lënda penale P. nr. 392/11, kundër D. B. nga Ferizaj, pronar i biznesit privat, me përgatitje të mesme shkollore, i akuzuar për veprën penale “Shmangia e tatimit” nga neni 249 parag. 2, nënparag. 1 të KPK-së³⁹⁶, Gjkata me aktgjykim e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej një viti nuk kryen vepër tjetër

395 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i vitit 2004, kapitulli XXII.

396 Aktgjykimi P. nr. 392/2011, Gjkata Komunale e Ferizajt, i dt. 20.9.2012.

penale. Gjykata të njëjtit i ka shqiptuar edhe dënimin me gjobë në shumë prej 1000/euro, të cilin ishte i obliguar ta paguajë brenda 30 ditësh. I akuzuari ishte obliguar t'i paguajë Administratës Tatimore në Prishtinë, në emër të kërkesës pasurore juridike, në shumën e përgjithshme 24.623.58 euro, dhe për shpenzimet e procedurës penale të paguaj 50 euro.


Nga hulumtimi rezultoi se Gjykata Komunale në Kaçanik, për vitin 2011, ka nxjerr vetëm dy aktgjykime dhe atë:

1. P.nr.366/2011 i dt. 09.01.2013, vepra penale falsifikimi i parasë, neni 244, dënimi i shqiptuar ishte me gjobë.³⁹⁷
2. P. nr.377/2011, vepra penale tregti e ndaluar, neni 246, dënimi i shqiptuar ishte 200 euro.³⁹⁸

397 Aktgjykimi P. nr. 366/2011, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 9.1.2013.

398 Aktgjykimi P. nr. 370/2011, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 9.1.2013.

Tabela 14. Vendimet e Gjykatës komunale në Ferizaj për strukturën e veprave penale, numrin e personave të gjykuar apo të liruar, mënyrën e zgjidhjes dhe sanksionin e shqiptuar për veprat penale kundër ekonomisë nga neni 232-251 për vitin 2012



Sipas të dhënave, të paraqitura në formë tabelare për vitin 2012, pasqyra tregon se Gjykata Komunale në Ferizaj ka nxjerr 46 vendime për raste penale, kundër veprave penale të ekonomisë, ku për dallim nga vitet paraprake kemi 6 raste për veprën penale “organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm” që ishte risi pasi për herë të parë gjykata kishte nxjerr vendim për një vepër të tillë.

Gjykata kishte nxjerr 22 aktgjykime dënuese ose 48.88%, 13 aktgjykime refuzuese ose 28.88%, kishte arritur parashkrimi për 10 raste ose 22.22%. Nëse e krahasojmë me vitet paraprake shihet se gjykata nuk ka nxjerr asnjë aktgjykim lirues, kështu që kemi një numër shumë më të vogël të refuzimit të akuzave se në vitet e mëparshme, që ishte përçdo vit nga 40% e deri në 67% , kurse në vitin 2012, refuzimi i akuzave kishte rënë në 28.88%. Shqetësuese mbetet instituti i parashkrimit, ku ishin parashkruar 9 raste me parashkrim absolut dhe 1 rast me parashkrim relativ apo 22.22% nga numri i përgjithshëm i rasteve. Gjykata nuk kishte vendosur vetëm për 1 rast që ka treguar efikasitet më të madh nga vitet paraprake. Numri i përgjithshëm i personave të shpallur fajtorë dhe të dënuar është 22 apo 48.88%, ndërsa ishin liruar në forma të ndryshme me aktgjykim refuzues apo për shkak të parashkrimit 23 të akuzuar apo 51.11%, që lë të kuptohet se dështimi i organeve të drejtësisë ka vazhduar si më parë. Në të gjitha këto raste gjykata nuk ka shqiptuar asnjë dënim me burg efektiv.

1. Një çështje me vlerë tejet të vogël që ka të bëjë me vënien në qarkullim të monedhës të falsifikuar prej 20 euro, për të cilin rast prokurori publik në Ferizaj e ka akuzuar B. H. nga Ferizaji tregtar, Gjykata i ka shqiptuar urdhër ndëshkimor, sipas aktgjykimit P. nr. 914/12, duke e shpallur fajtor për veprën

penale “Falsifikimi i parasë” nga neni 244, parag. 3 të KPK-së³⁹⁹, dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë 150 euro, të cilin i akuzuari do ta paguajë në afat prej 30 ditësh, gjykata bazuar në nenin 244 parag. 4 të KPK-së e ka konfiskuar paranë e falsifikuar, gjithashtu në emër të paushallit gjyqësor i dënuari ishte obliguar të paguajë 20 euro.

Nga të dhënat e siguruara përmes aktgjykimeve përfundimtare në Gjykatën Komunale të Kaçanikut, rezultoi se kjo gjykatë për vitin 2012, ka marrë vetëm dy vendime dhe atë:

1. P.nr. 83/2012, për veprën penale shmangie nga tatimi neni 249, dhe ka shqiptuar dënim me burg 60 ditë ose me pajtimin e të dënuarit t’i shndërrohet me pagesë.⁴⁰⁰
2. P. nr. 560/2012, për veprën penale lëshimi i çeqeve pa mbulesë, neni 248 i KPPK-së.⁴⁰¹

Nga hulumtimi i aktgjykimeve në Gjykatën Komunale të Ferizajt, për periudhën hulumtuese 2008-2012, numri i rasteve për veprat penale kundër ekonomisë është tejet i vogël. Gjykata pjesën më të madhe të aktakuzave i ka refuzuar për faktin se një numër i madh i të akuzuarve ka qenë për veprën penale “Falsifikim i parasë”, për vënien në qarkullim të saj në shumicën e rasteve në institucionet bankare, prandaj shpeshherë prokurori është tërhequr nga aktakuza ngase nuk është vërtetuar mjaftueshëm dashja-qëllimi si element themelor i veprës penale.

Gjendja e njëjtë ka rezultuar nga hulumtimi të jetë edhe në Gjykatën Komunale të

399 Aktgjykimi P. nr. 914/2012, i Gjykatës Komunale në Ferizaj, i dt. 8.10.2012.

400 Aktgjykimi P. nr. 83/2012, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 4.12.2013.

401 Aktgjykimi P. nr. 560/2012, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 3.12.2012.

Kaçanikut. Gjykata për periudhën 2008- 2012, ka nxjerrë gjithsej 14 vendime. Mbi 90% e vendimeve janë për veprën penale falsifikimi i parasë. Politika ndëshkimore është joadekuate, gjë që rezultoi të jetë e njëjtë si në Ferizaj.


6.2. Disa karakteristika personale të kryerësve të veprave penale kundër ekonomisë

6.3.1. Mosha e kryerësit

Mosha është karakteristikë e rëndësishme e fenomenit kriminal⁴⁰². Nga shënimet dhe të dhënat e ndryshme statistikore, praktika gjyqësore, vijmë në përfundim se cila moshë e popullsisë është më tepër e involvuar në kryerjen e veprave penale kundër ekonomisë. Në hulumtimin e bërë fillimisht në Prokurorinë Komunale - Themelore të Ferizajt e më pas në Gjykatë, ku nuk janë përfshirë të miturit, por vetëm madhorët nga mosha 18 vjeç. Nga 167 vendime gjyqësore, të nxjerra për periudhën 2008-2012, rezultoi të jetë kjo pjesëmarrje.

402 Halili. Ragip, “*Kriminologji me penologji*”, 2008, fq. 76.

Grafiku 8. Mosha e kryerësve



Burimi: Gjykata Komunale, Ferizaj

Nga hulumtimi i bërë, për periudhën kohore 2008-2012, në Gjykatën Komunale në Ferizaj ka rezultuar që kryerësit i përkasin moshave të ndryshme, por numri më i madh i tyre sipas vendimeve gjyqësore, është për personat nga mosha 35 vjeç, ku pjesëmarrja e tyre është 60.41%. Nga hulumtimet del se si kryerës të veprave penale janë edhe moshat e reja nga mosha 18 -25 vjeç, por me një pjesëmarrje të vogël 10.41%, ndërsa grupmosha nga 25-35 vjeç, ka shënuar një pjesëmarrje 29.16%⁴⁰³.

Ndërsa nga hulumtimi shumë pak ka informata për kryerësit e panjohur, siç është karakteristikë e krimeve tjera. Mendojmë se nga të dhënat e analizuara në përgjithësi mosha e kryerësve të veprave penale është relativisht e re, ashtu siç është edhe vetë popullsia e Kosovës .

⁴⁰³ Sipas aktgjykimeve dhe kallëzimeve penale në Gjykatën, Prokurorinë Komunale Ferizaj, periudha 2008-2012.

6.3.2. Niveli profesional dhe social


Struktura profesionale dhe ajo sociale, gjithashtu janë karakteristika të rëndësishme personale. Këto karakteristika kanë rëndësi për faktin që nga ato mund të konstatojmë se cila kategori profesionale dhe sociale e kryerësve janë të prirë të kryejnë veprat penale në fushën e ekonomisë.

Një kohë ka mbizotëruar mendimi se kriminaliteti është karakteristikë e shtresave të varfëra⁴⁰⁴. Hulumtim i bërë në Gjykatën Komunale të Ferizaj ka treguar se në ditët e sotme kriminaliteti në përgjithësi, por edhe ai në fushën ekonomike, është duke u kryer nga shtresa të ndryshme dhe vërehet një rritje e krimit nga shtresat e pasura shoqërore.

Nga hulumtimi i vendimeve gjyqësore është vërtetuar se të dënuarit janë zakonisht me përgatitje të mesme shkollore me një pjesëmarrje 41.66%, me arsim të lartë si inxhinier, ekonomist, arsimtar etj., pjesëmarrja e tyre në përqindje është e ulët vetëm me 4% dhe është karakteristikë sidomos për llojet e veprave penale në fushën ekonomike, që kanë të bëjnë me doganat, pastrimin e parave, keqpërdorimet në ekonomi etj. Ndërsa si kryerës kishte edhe me përgatitje të ulët shkollore.

404 Po aty, fq. 124.

Grafiku 9. Niveli arsimor



Burimi: Gjykata Komunale, Ferizaj

Nga hulumtimi rezultoi se shumica dërrmuese e të dyshuarve për kryerjen e këtyre veprave penale, kundër ekonomisë, ishin me arsim të mesëm, që ishin në detyrën e tregtarit apo pronar të bizneseve private.

Nëse e krahasojmë me periudhën e viteve 1990-1995, ku kategoria më e involvuar në kriminalitet ishin bujqit individualë me një përqindje 30.72%, në krahasim me strukturën e personave ekspertë, afaristë dhe bashkëpunëtorë që ishte në përqindje 3.26%⁴⁰⁵, tani kemi një lëvizje kah shtresa me përgatitje të lartë shkollore. Ndërsa sa i përket përgatitjes shkollore, në këtë periudhë 1990-1995, kemi këtë strukturë të kryerësve të veprave penale diku 38.94 % ishin me shkollë të mesme, ndërsa vetëm 2.67% e kishin të kryer shkollën e lartë.⁴⁰⁶ Andaj, nga hulumtimi mund të konstatojmë se kategoria e personave që merren me kriminalitet ekonomik janë tregtarë apo njohës të mirë të kësaj dukurie negative për shoqërinë dhe shtetin.

⁴⁰⁵ Dr. Bajgora. Ali, “Disa karakteristika të kriminalitetit dhe politikës ndëshkimore në Kosovë”, Qendra Profesionale për të Drejtat e Njeriut dhe Iniciativa Juridike, Prishtinë 2001, fq. 72-73.

⁴⁰⁶ Po aty, fq. 74.


6.3.3. Recidivi i kryerësve

Recidivizmi si fenomen i kriminalitetit, në kohën bashkëkohore, paraqet problem serioz dhe tejet aktual në fushën e kriminalitetit në përgjithësi posaçërisht atij në fushën ekonomike. Recidivizmi, si formë e veçantë e sjelljes kriminale të kryerësve nga hulumtimet statistikore, konsiderohet se merr pjesë në kriminalitetin e përgjithshëm, varësisht nga lloji i veprave penale.

Hulumtimet kanë treguar se në të gjitha veprat penale recidivizmi sillet rreth 30-35%⁴⁰⁷. Recidivistët, si kategori e kryerësve përsëritës të veprave penale edhe me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale, gjykata kur gjen se janë fajtorë, shqipton sanksione më të larta për shkak se recidivizmi konsiderohet rrethanë rënduese. Nga krahasimi i bërë, 167 vendimeve gjyqësore në Ferizaj, për periudhën hulumtuese 2008-2012, rezultoi se recidivi është i pranishëm edhe te kjo kategori e veprave penale me pjesëmarrje si në grafikun.

407 Dr. sc. Hajdari. Azem, “*Kriminaliteti i të miturve në Kosovë 2001-2003*”, Botues “autori”, Prishtinë 2004, fq. 114.

Grafiku 10. Recidivi i kryerësve



Burimi: Gjykata Komunale, Ferizaj

Gjatë analizimit, të periudhës 2008-2012, në Gjykatën Komunale në Ferizaj, konstatohet se recidivistë në kryerjen e veprave penale në fushën ekonomike janë sidomos përfaqësuesit e personave juridikë me rastin e importimit apo eksportimit të mallit jashtë Kosove.

6.3.4. Gjinia e kryerësve


Po ashtu edhe gjinia si karakteristikë personale e kryerësve është fakt i rëndësishëm i fenomenit kriminal. Nga përshtypjet e përgjithshme por edhe nga kërkimet kriminologjike, në botën bashkëkohore, del se në kryerjen e veprave penale marrin pjesë më tepër gjinia mashkullore sesa ajo femërore.

Gjatë përgatitjes së këtij punimi është konstatuar se meshkujt ishin prezentë më shumë se femrat në kryerjen e veprave penale kundër ekonomisë. Këtë pjesëmarrje e

determinon edhe fakti se gjinia femërore më pak është e angazhuar në jetën shoqërore në përgjithësi. Kurse ajo mashkullore përveç integrimit ajo është e angazhuar në numër më të madh në punë dhe në ushtrimin e detyrave publike në përgjithësi, në jetën ekonomike dhe shoqërore.

Nga 167 vendime gjyqësore ka rezultuar se pjesëmarrja e meshkujve si kryerës të veprave penale kundër ekonomisë është mbi 90%.

Grafiku 11. Gjinia



Burimi: Gjykata Komunale, Ferizaj

Kjo dukuri nuk është karakteristike vetëm e këtij grupi të veprave penale, por në përgjithësi për kriminalitetin, mirëpo raportet e fundit nga organet e drejtësisë flasin se kohët e fundit edhe gjinia femërore është e përfshirë në krim të organizuar dhe vepra tjera penale.

6.II. DISA KARAKTERISTIKA THEMELORE ETIOLOGJIKE TË VEPRAVE PENALE KUNDËR EKONOMISË NË KOSOVË

Etiologjia, si degë shkencore, konsiderohet si sektor shumë i rëndësishëm në të gjitha kriminologjitë bashkëkohore. Si degë kryesore e kriminologjisë ajo studion lidhjet kauzale në mes të rrethanave dhe faktorëve të ndryshëm të kriminalitetit⁴⁰⁸. Kriminaliteti, si dukuri negative në shoqëri, posaçërisht ai në fushën ekonomike është e pamundur të analizohet dhe të realizohet suksesshëm nëse nuk dihen shkaqet dhe kushtet të cilat e determinojnë paraqitjen e tij. Gjithherë ka qenë diskutuese fakti se në literaturën kriminologjike, a mund të evidentohen të gjitha veprimet kriminale që ndodhin në shoqëri⁴⁰⁹. Kjo për faktin se krimet në ekonomi ndryshojnë nga krimet e dhunës personale sepse te kjo kategori autori i veprës dhe viktima janë të pranishëm në të njëjtin vend dhe të njëjtën kohë, ndërsa te krimi ekonomik viktima mund të jetë kudo në botë dhe asnjëherë të mos takohet me autorin e veprës.⁴¹⁰

Duke marrë parasysh faktorët e përgjithshëm të kriminalitetit, konsideroj se në Kosovë para dhe pas luftës së fundit, të vitit 1999, për shkak të statusit politik të pazgjidhur, ekonomisë plotësisht të shkatërruar gjatë luftës dhe para saj, zhvillimit të ngadalshëm ekonomik, aplikimit të legjislacionit heterogjen janë krijuar rrethana dhe kushte të volitshme që një pjesë e popullsisë të merret me veprimtari kriminale në fushën e ekonomisë. Nga kjo dukuri shpreh mendimin nuk janë imun edhe shtetet që nuk i kishin prezent faktorët e përmendur.

408 Halili. Ragip, “*Kriminologji me penologji*”, Prishtinë, 1995, fq. 105.

409 Halili. Ragip, “*Kriminologjia*”, botimi i katërt, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik. Dinor-Mg, 2005, fq. 55.

410 Russell. G. Smith, Cross- Border Economic Crime, Australion Institute of Criminology GPO-Boks-2944, April 2011, fq. 1. Marrë nga http://www.aic.gov.au/about_aic/research_programs/staff/smith_russell.html (parë më 14.02.2015).

6.2.1. Disa karakteristika etiologjike të veprave penale kundër ekonomisë në rajonin e komunës së Ferizajt

Gjatë analizimit të shkaqeve etiologjike për paraqitjen e veprave penale kundër ekonomisë në territorin e Gjykatës komunale në Ferizaj, për periudhën kohore 2008-2012, ne mendojmë se shkaktarët kryesor janë:

6.2.2. Kriza ekonomike

Ekonomia e Kosovës në periudhën e tranzicionit u zhvillua në kushte specifike dhe mjaft të ndërlikuara politike, shoqërore dhe ekonomike⁴¹¹. Krizat ekonomike pa dyshim janë faktorë stimulues i kriminalitetit në përgjithësi po ashtu edhe atij ekonomik. Ne jemi dëshmitarë se njerëzit nuk zgjedhin mjete për të siguruar përkujdesjen ndaj familjeve të tyre, andaj ata shpeshherë zgjedhin rrugën e përfitimit përmes kryerjes së veprave penale. Disa persona bëhen kriminelë jo për shkak se motivi i tyre themelor ndryshon, nga ajo e personave të tjerë në shoqëri, por për shkak se ndryshon përfitimi dhe kostoja e tyre, nga ajo e personave të tjerë⁴¹². Si pasojë e krizave ekonomike në vend, vjen deri te mbyllja e fabrikave, bizneseve, ngecjes së prodhimit, ku pastaj kjo manifestohet me pasojën e rritjes së çmimeve, papunësisë, ngritjes së çmimeve për të mirat materiale. Andaj, popullata për shkak të vështirësive apo edhe bizneset për të mbijetuar nga krizat involvohen në veprimtari të dyshimta, në kryerjen e veprave penale, në të gjitha fushat por edhe në atë ekonomike.

411 Limani. Musa, *Rrjedhat ekonomike në Kosovë në fazën e tranzicionit*, publikuar në Revistën shkencore, “Norma” në Gjiilan, 2012, fq. 30.

412 Becker. Gary S. “Crime and Punishment: An economic approach Un”, iversity of Chicago – National Bureau of Economic Research, Volume Publisher: NBER 1974 f-1-54. Marrë nga <http://www.nber.org/chapters/c3625.pdf> (parë më 12.02.2015).

Në vendin tonë kriza ekonomike kishte arritur si pasojë e disa faktorëve dhe atë: mungesës së një politike adekuate zhvillimore në ekonomi, ku procesi i privatizimit ishte sfidues kryesor i ekonomisë, prania e madhe e ekonomisë informale, prania e korrupsionit dhe krimit të organizuar, evazioni fiskal⁴¹³ janë pa dyshim faktorë determinues etiologjik të kriminalitetit ekonomik.

6.2.3. Varfëria

Kushtet materiale të jetës janë gjithashtu faktor i rëndësishëm dhe objektiv në shfaqjen e kriminalitetit ekonomik ngase ato ndikojnë në paraqitjen e sjelljeve kriminale, apo siç thotë filozofi grek Aristoteli se “Varfëria është nëna e krimit, ndërsa begatia nëna e amoralitetit”.

Kjo është një e vërtetë se kushtet e vështira materiale ndikojnë te individët, sidomos ata të cilët kanë dilema për inkuadrim në veprimtari kriminale⁴¹⁴. Këtë konstatim e vërteton edhe fakti i hulumtimit të kryer në Gjykatën Komunale të Ferizajt, për vitin 2008, del se të dënuarit për vepra penale kundër ekonomisë, janë 12 persona ku më tepër se gjysma e tyre janë me gjendje të dobët ekonomike, ndërsa vetëm 2 nga ata janë të gjendjes së mesme ekonomike dhe vetëm një i gjendjes së mirë ekonomike. Andaj, mendimi im është se kushtet e vështira materiale janë faktorë shtytës, që ndikojnë në kryerjen e veprave penale, sepse po të ekzistonin kushtet e mira për jetesë kujtoj që pak njerëz do ta kryenin veprën penale “Kontrabandimi i mallrave”⁴¹⁵, duke pasur parasysh rrezikun që mund t’i kanoset kryerësit gjatë kalimit të vijës kufitare me

413 Po aty.

414 Hajdari. Azem, *Kriminaliteti i të miturve në Kosovë*, 2001-2003, botues “Autori”, Prishtinë, 2004, fq. 166-167.

415 Shih: Kodi Penal i Kosovës, i vitit 2012, veprat penale kundër ekonomisë neni 317.

mallin e kontrabanduar dhe zakonisht gjatë natës, meqenëse kufiri është gjithherë nënë vëzhgim të forcave të rendit.

Megjithatë, sipas hulumtimeve kjo vepër penale ka tendenca të rritjes, varësisht nga pasojat që mund t'i bartin kryerësit. Në shumicën e rasteve kryerësit e kësaj veprë pranojnë fajësinë, por përgjigja e tyre para organeve të drejtësisë është se nuk kanë rrugë tjetër të mbijetesës. Mirëpo mendoj se kriminaliteti ekonomik nuk është vetëm faktor i kushteve të varfëra ekonomike, por edhe i ndikimit të kushteve dhe faktorëve tjerë.

6.2.4. Papunësia

Kriza ekonomike dhe niveli i ulët i zhvillimit ekonomik në Kosovë, i përcjellë me faktorë të tjerë si: korrupsioni, evazioni fiskal, mbyllja e fabrikave, privatizimi i kompanive publike, shkatërrimi i ekonomisë, largimi i punëtorëve nga puna para dhe pas luftës së fundit, në përgjithësi, kanë sjellë papunësi të madhe. Papunësia, si dukuri por edhe problem social, ndikon në personalitetin e kryerësve, kudo që ata i gjen si në mjedisin e punës, mjedisin e jetës që ndikon në pozitën materiale të individëve dhe familjes⁴¹⁶. Andaj, në raste të caktuara te njerëzit e papunësuar krijohet një zhgënjim dhe këta persona, duke mos e duruar këtë gjendje, fillojnë të merren me dukuri negative si prostitucion, bredhje rrugëve, largohen nga familja dhe kështu krijojnë predispozita të merren me veprimtari kriminale në përgjithësi, por edhe në sferën kundër ekonomisë. Këtë konstatim e vërteton fakti që gjatë hulumtimit të personave, të cilët janë akuzuar dhe shpallur fajtorë për kryerjen e veprave penale kundër ekonomisë në Gjykatën

416 Pushka. Asllan, *Faktorët dhe iniciatorët e transformimit social-ekonomik të KSA-së*, Revista "Përparimi", Prishtinë, 1978, fq. 787-788.

Komunale në Ferizaj për periudhën 2009, vërejmë se nga 10 personat e dënuar 50% prej tyre janë pa punë⁴¹⁷, që për mendimin tim është një shifër jashtëzakonisht e lartë e të papunëve për faktin që kryerësit e veprave, në fushën e ekonomisë, më tepër janë kategoria e personave që kanë biznese dhe detyrat publike.

6.2.5. Rrethanat e krijuara shoqërore pas luftës

Organizimi shoqëror gjithashtu ka elemente të cilat në një formë ndikojnë në kriminalitet. Një lidhje e ngushtë që mund të ndikojë në kriminalitet është urbanizmi apo dendësia e popullsisë. Viteve të fundit vërehet një urbanizim i shpejtë dhe i pakontrolluar i dalë nga lufta, ku lëvizjet e mëdha të qytetarëve nga vendet rurale në qytet ka krijuar mundësi më të mëdha për shfaqjen e kriminalitetit. Kriminaliteti në zonat urbane edhe për nga struktura edhe për nga lloji i veprave penale dallon nga ai në zonat rurale⁴¹⁸. Andaj, duke pasur parasysh që kriminaliteti ekonomik është tejet i përsosur, atëherë vetvetiu nënkupton që në vendet urbane mund të jetë më i pranishëm. Gjithashtu lufta përbën një çorganizim social dhe si e tillë mund të ndikojë në rritjen e kriminalitetit, sidomos në fushën e ekonomisë - pasurisë. Prandaj, me të drejtë mund të konkludohet se luftërat sjellin efekte ekonomike ngase nevoja për produkte dhe gjëra materiale e simulon edhe tregun e zi⁴¹⁹. Kujtoj që faktorët e përmendur, por edhe faktorët e tjerë kriminogjenë, kanë treguar se rritja e ekonomisë ndikon edhe në rritjen e kriminalitetit.

417 Sipas aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Ferizaj, për vitin 2009.

418 Hysi. Vasilika, *Kriminologjia*, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2005, fq. 216.

419 Po aty.

KAPITULLI VII

MASA THEMELORE PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E VEPRAVE PENALE KUNDËR EKONIMISË ME THEKS TË VEÇANTË NË TERRITORIN E GJYKATËS KOMUNALE TË FERIZAJT PËR PERIUDHËN 2008-2012

7.1. DISA MASA PREVENTIVE PËR VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË

Kriminaliteti në përgjithësi, e në veçanti ai në fushën ekonomike, paraqet një dukuri kriminologjike mjaft të ndërlikuar, që dëmton shoqërinë dhe sistemin juridik në përgjithësi, të mbrojtur me Kushtetutë⁴²⁰. Ky lloj krimi është shfaqur në forma dhe mënyra të ndryshme, ai ngërthen në vete lloje të ndryshme të veprave penale në fushën ekonomike, financiare, doganore, të taksave dhe tatimeve, në fushën e falimentimit, falsifikimin e dokumenteve, në fushën e marrëdhënieve pronësoro-juridike, me rrezikshmëri të madhe për sistemin ekonomik.

Andaj, për të parandaluar veprat penale, në fushën e ekonomisë, duhet të merren masa preventive nga të gjithë subjektet shoqërore. Por preventiva në radhë të parë duhet ushtruar nga vetë shoqëria, përmes emancipimit dhe vetëmbrojtjes së vetë⁴²¹. Si masa preventive që luajnë rol të rëndësishëm primar dhe sekondar ndaj kriminalitetit ekonomik janë:

420 Sahiti. Ejup, *E Drejta* nr. 3, *Të provuarit në procedurën penale – mundëitë dhe vështirësitë*, Prishtinë, 1996, fq. 37.

421 Hajdari. Azem, *Kriminaliteti i të miturve në Kosovë*, botues “autori”, Prishtinë, 2004, fq. 191.

- Legjislacioni penal adekuat,
- niveli profesional i kuadrove në sistemin juridik,
- roli preventiv i shoqërisë dhe familjes,
- ngritja e agjencive të specializuara nga ana e shtetit,
- bashkëpunimi i organeve dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare,
- reformimi bashkëkohor i sistemit të drejtësisë,
- media dhe shoqëria civile,
- caktimi i dënimeve të rrepta nga ana gjykatave dhe
- përsosja e mjeteve teknologjike për ushtrimin e kontrollit ndaj organeve të posaçme⁴²² etj.

Në vazhdim do të paraqesim disa nga masat parandaluese që mendojmë se janë më themelore.

7.2. Parandalimi i kriminalitetit ekonomik në Kosovë me masa legjislative

Rol të rëndësishëm në luftën për parandalimin e krimit kundër ekonomisë kanë institucionet shtetërore, siç janë: policia, prokuroria, agjencitë e zbulimit dhe kontrollit, gjykata. Institucionet e theksuara janë të obliguar të veprojnë në bazë të përgjegjësisë dhe procedurave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe akteve ligjore të dala nga zbatimi i saj⁴²³.

422 Elezi. Ismet, & Hysi. Vasilika, *Politika kriminale*, botim i parë, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2006, fq. 112.

423. Latifi. Vesel, & Beka. Agron, *Vrasjet, krimi i organizuar terrorizimi-zbulimi dhe të provuarit*, Kolegji Evropian “Juridica” Prishtinë, 2013, fq. 142-147.

Një rol të rëndësishëm në parandalimin e kriminalitetit ekonomik, përveç ligjeve penale, luajnë edhe ligjet e tjera të cilat rregullojnë sferat dhe veprimtaritë e ndryshme. Kosova, duke pasur parasysh faktin që ka dalë nga lufta para pak kohe, nuk ka qenë immune ndaj kësaj kategorie të veprave penale, që janë në dinamizëm, vështirë të zbulueshme, me veprimtari afatgjate dhe të pandërprerë, kriminaliteti që nuk njeh kufi, profesionalizim permanent dhe sofistikimi i veprimtarive kriminale, operacione ekonomike fiktive, ndërmarrje joekzistuese, organizimin e falimentimeve ekonomike⁴²⁴ etj. Në këtë drejtim Kosova ka nxjerr legjislacion adekuat, në përputhje me standardet ndërkombëtare, që garanton se kriminaliteti ekonomik nuk do të mbetet i pandëshkuar. Në të kaluarën, në mungesë të ligjeve adekuate, janë krijuar lehtësi për veprimtari të kundërligjshme dhe terren të përshtatshëm për shpëlarjen e parave, falsifikimin e parave dhe letrave me vlerë, mashtrimet, kontrabandimin e mallrave, shmangiet doganore dhe falimentimin.

Në vazhdim paraqes ligjet të cilat drejtpërsëdrejti ose indirekt kanë trajtuar kriminalitetin në fushën ekonomike:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës,⁴²⁵
- Kodi i Procedurës Penale të Kosovës,⁴²⁶
- Kodi Doganor dhe Akcizave të Kosovës,⁴²⁷
- Ligji për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit,⁴²⁸

424 Ibid.

425 Kodi Penal me nr. 04/L-82, është miratuar më 20 prill 2012, hyri në fuqi më 1 janar 2013.

426 Kodi i Procedurës Penale nr. 04/L, është miratuar më dt. 13 dhjetor 2012, hyri në fuqi më 1 janar 2013.

427 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe Akcizave me nr. 03-L-109, i miratuar në Kuvendin e Kosovës më 13.5.2012. ndërsa është shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës me nr. DL-023-2012, të dt. 17.5.2012.

- Ligji Kundër Korrupsionit,⁴²⁹
- Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë,⁴³⁰
- Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Vepra Penale,⁴³¹
- Ligji për Tatimin e Normës së Akcizave në Kosovë,⁴³²
- Ligji për Administrimin e Pasurisë të Sekuestruar ose të Konfiskuar,⁴³³
- Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit,⁴³⁴
- Ligji për Prokurorinë e Shtetit,⁴³⁵
- Ligji për Gjykatat,⁴³⁶
- Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit në Kosovë.⁴³⁷

Kosova ka bërë hapa pozitivë në kompletimin e legjislacionit që të ndikojë në

428 Ligji nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit, i miratuar në Kuvend më dt. 11.2.2013, i shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-03-2013, të dt. 26.2.2013.

429 Ligji është miratuar në Kuvend më dt. 22.4.2005, i aplikueshëm së bashku me rregulloren e UNMIK-ut, për shpalljen e tij nr. 2005/26 të dt. 12.5.2005 të shpallur nga PSSP-ja.

430 Ligji është miratuar në Kuvend më dt. 31.8.2011, kurse është shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-028-2011 më dt. 31.8.2011.

431 Ligji nr. 04/L-30, është miratuar në Kuvend, më dt. 31.8.2011, është shpallur në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës”, me nr. 16. Prishtinë, 2011, ka hyrë në fuqi me dt. 1 janar 2013.

432 Ligji nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizave është miratuar në Kuvend, me dt. 12.7.2010. kurse është shpallur me dekretin e Presidentit të Kosovës me nr. DL-031-2010, me dt. 15.7.2010.

433 Ligji nr. 03/L-141, është miratuar në Kuvend, më dt. 10.7.2009, kurse është shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës me nr. DL-021-2009, më dt. 17.7.2009.

434 Ligji nr. 03/L-159, është miratuar në Kuvend, më dt. 29.12.2009, kurse është shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës me nr. DL-006-2010, me dt. 19.1.2010.

435 Ligji nr. 03/L-225, është miratuar në Kuvend, më dt. 30.9.2010, kurse është shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, me nr. DL-049-2010, më dt. 18.10.2010.

436 Ligji nr. 04/L-171, është miratuar në Kuvend, më dt. 20.12.2012, kurse është shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, me nr. DL-58-2012, më dt. 21.12.2012.

437 Ligji nr. 03/L-067, është miratuar në Kuvend më dt. 31.8.2011, është shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-025-2011, më dt. 31.8.2011.

parandalimin e krimit në fushën ekonomike, por ka mangësi serioze në zbatimin e ligjeve. Kjo vërtetohet nga praktika gjyqësore ngase institucionet e drejtësisë ende nuk kanë treguar sukses që ndaj kryerësve të këtyre veprave penale të zbatojnë dispozitat ligjore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar me vepra penale⁴³⁸.

Rezultatet e dobishme dhe rekomandimet duhet të mbështeten në disa parime:

- parandalimin e krimit ekonomik
- . Zyra e Kombeve të Bashkuara për drogën dhe krimin në bashkëpunim me institucionet relevante duhet të zhvillojë strategji më efektive në parandalimin e krimit kundër ekonomisë.
- Kodet, ligjet financiare dhe kontrollet administrative duhet të reformohen⁴³⁹

Prandaj, kujtoj që pa legjislacion përkatës dhe bashkëkohor nuk mund të luftohet me sukses parandalimi i kriminalitetit në përgjithësi e posaçërisht parandalimi i veprave penale kundër ekonomisë që është mjaft kompleks me përmasa dhe aktivitete të mëdha joligjore.

438 Shih: Gazeta “Jeta në Kosovë”, dt. 21 maj 2012, shkrimi i autores Tinka Kurti, ku thuhet pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar, kryesisht e përbëjnë lopët, vëçat e kuajt, sipas raportit të kësaj agjencie vlera e përafërt për administrimin e pasurive nga ana e saj është 261.210.96 euro, me 1.720.00 për vitin 2010, 73.882.66 për 2011, 186.107.30 për vitin 2012. Deri më 30 prill, sipas saj kishte pas 36 vendime për sekuestrim ose konfiskim nga organet kompetente dhe atë: 7 nga gjykata, 1 nga prokuroritë, 21 nga AVU dhe 7 nga KPPM.

439 Al-Sarraj, Dr. Abboud “Concept of Economic Crimes as Perceived Across the World - Typology, New Trends and Countermeasures”, Publisher UNAFEI 2006. Fq.108. Marrë nga https://www.google.com/search?q=Concept+of+Economic+Crime+and+New+Trends&oq=Concept+of+Economic+Crime+and+New+Trends&aqs=chrome..69i57.8166j0j4&sourceid=chrome&esprv=2&es_sm=93&ie=UTF-8#q=Al-Sarraj,+Dr.+Abboud+Concept+of+Economic+Crimes+as+Perceived+Across+the+World+-+Typology,+New+Trends+and+Countermeasures+,+Publisher++UNAFEI+2006 (parë më 18.2.2015).

7.3. Përgatitja profesionale e zyrtarëve në sistemin juridik të vendit

Një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e veprave penale, kundër ekonomisë, e kanë organet shtetërore dhe kuadri profesional që punon në policinë e Kosovës, agjencitë e specializuara dhe organet e drejtësisë (prokuroria dhe gjykata). Në këtë drejtim sistemi gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës me gjithë reformat e bëra në legjislacion dhe në përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve mbetet ende institucioni me më pak besim për qytetarët⁴⁴⁰. Shkollimi dhe specializimi i kuadrove në policinë e Kosovës, agjencinë e inteligjencës, në prokurori dhe gjykata janë të domosdoshme, nëse dëshirohet që me sukses të parandalojmë veprimet inkriminuese në fushën e ekonomisë. Aktualisht në Kosovë ekziston Instituti Gjyqësor i Kosovës⁴⁴¹, që ka përgjegjësi për aftësimin profesional të vazhdueshëm për gjyqtarë dhe prokurorë, por kujtoj që i njëjti nuk ka kapacitete të mjaftueshme për një gjë të tillë. Mungesa e policisë gjyqësore dhe moskrijimi i saj, edhe pse është paraparë me ligj, paraqesin sfida për sistemin e drejtësisë dhe paraqesin mungesë të kuadrove që do të luftonin me sukses krimin ekonomik.

Prokuroria e Kosovës është e mbështetur në luftimin e veprave penale kundër ekonomisë nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit. Kjo drejtori vepron në kuadër të Policisë së Kosovës⁴⁴². Për mendimin tim sistemit juridik të

440 Gazeta “Start” e dt. 30 tetor 2013, publikon lajmin se kryetari i delegacionit të Parlamentit Evropian, Eduart Kukan, ka deklaruar se Kosova duhet të kryejë reforma kryesisht në sistemin e drejtësisë dhe korrupsionit.

441 Instituti Gjyqësor i Kosovës është themeluar me ligjin nr. 02/L-25, miratuar në Kuvend, më dt. 23 shkurt 2006, në nenin 1 pika 1.8 parasheh se Instituti Gjyqësor si institucion i pavarur në bashkëpunim me Këshillin gjyqësor dhe prokurorial është përgjegjës për aftësimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

442 Drejtoria për hetimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit është krijuar me vendim të drejtorit të përgjithshëm të policisë së Kosovës në fund të muajit prill 2009, kjo drejtori funksionon në bazë të tre sektorëve: Sektori i Hetimeve të Krimeve Ekonomike, Sektori i Hetimeve të Korrupsionit dhe Sektori i Hetimeve Financiare.

Kosovës i duhen të specializojë ekspertë të fushës ekonomike, me status të zyrtarit publik shtetëror që do vepronin në bashkërendim me prokurorët, gjyqtarët dhe policinë.

Një aspekt tjetër, që do të ndihmonte në profesionalizimin e kuadrove të sistemit juridik është aftësimi dhe trajnimet në fushën e teknologjisë informative, sepse krahas zhvillimit të teknologjisë informative, kryerësit kanë përsosur teknikat kriminale në kryerjen e krimeve⁴⁴³. Përgatitja profesionale e kuadrit në sistemin juridik sado që të jetë në nivelin më të lartë nuk do të ketë rezultat në parandalimin e krimeve në fushën ekonomike, nëse atyre i mungon vullneti dhe guximi profesional.

7.2. Hartimi i planeve dhe strategjive si preventivë në parandalimin e kriminalitetit ekonomik

Për parandalimin me sukses të veprave penale në fushën e ekonomisë është e domosdoshme të krijohen plane preventive. Planet dhe strategjitë si tilla mund të formohen në të gjitha nivelet shoqërore dhe shtetërore në fusha përkatëse. Një plan i tillë preventiv në rastet e tilla përmban: kontakte me persona përgjegjës nëpër organe dhe organizata të ndryshme private apo shtetërore, pastaj plani për shfrytëzimin e lidhjeve miqësore me qëllim të zbulimit të informatave për shpenzimet dhe keqpërdorimet eventuale nga ana e zyrtarëve, kontrole interne për vërtetimin e fakteve për abuzimet e ndryshme, raportimi për pasurinë dhe të ardhurat⁴⁴⁴.

Është fakt që korrupsioni është problem serioz për ekonominë e shumë vendeve,

443 Latifi. Vesel, *Kriminalistika-zbulimi dhe të provuarit e krimit*, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2006, fq. 42.

444 Demolli. Haki, *Kriminaliteti ekonomik në Kosovë i viteve të tetëdhjeta*, Fakulteti Juridik, Prishtinë, shtator, 2009, fq. 150.

sipas një raporti të Bankës Botërore, të vitit 1998, thuhet më të korruptuarit janë zyrtarët publikë të doganave, të pasuar nga punonjësit e drejtësisë dhe policisë⁴⁴⁵. Andaj në këtë drejtim është mëse e domosdoshme krijimi i strategjive për ta parandaluar rritjen e kriminalitetit ekonomik. Kosova në këtë drejtim ka hartuar strategji në nivel kombëtar për ta luftuar krimin siç janë:

- Strategjia shtetërore e Republikës së Kosovës kundër krimit të organizuar dhe plani i veprimit 2009-2012,
- Plan Strategjik për bashkëpunim ndërinstitucional në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit 2013-2015⁴⁴⁶,
- Projekti kundër krimit ekonomik në Kosovë⁴⁴⁷,
- Strategjia antikorrupsion - policia kufitare 2009⁴⁴⁸.
- Strategjia kundër korrupsionit-Kuvendi i Kosovës 2013⁴⁴⁹.

Konsideroj se miratimi i planeve dhe strategjive në Kosovë do të duhej të kishte

445 Zeneli. Ismail, Kambovski. Vllado, Janičević. Nenad, Latifi. Vesel, Sulejmanov. Zoran, Netkova Bistra, Jovan. Ilievski, Millovanović. Zllata, Kikerekova. Tanja, *Kriminaliteti i organizuar aspekte juridike* - disa masa të luftimit të kriminalitetit të organizuar në vendet në tranzicion, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2009, fq. 116.

446 Këshilli Prokurorial i Kosovës, më dt. 19.11.2012, ka hartuar planin strategjik 2013-2015, për ngritjen e bashkëpunimit ndërmjet prokurorit të shtetit dhe agjencive që zbatojnë ligjin në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Marrë nga: http://www.psh-ks.net/respository/docs/Nr.1284.2012-Plani_strategjik-2013-2015.pdf (parë më 05.09.2014).

447 Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, ka filluar më 1 shkurt 2012, zbatues të këtij projekti janë: Drejtoria e shoqërisë informative dhe veprimi kundër krimit, DGI, Këshilli i Evropës.

448 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë - policia kufitare, pas një analize të bërë për policinë kufitare për korrupsionin policor, për vitin 2006-2008, ka konstatuar se 44 oficerë policorë të nivelit lokal dhe regjional kanë qenë të dyshuar për vepra penale të korrupsionit, andaj ka lindur nevoja e hartimit të strategjisë me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie. Marrë nga: https://www.mpb-ks.org/respository/docs/Strategjia_shqip_FINAL_Strategjia_kombetare_e_Republikes_se_Kosoves_2009.pdf (parë më 12.6.2014).

449 Gazeta “Jeta në Kosovë” të dt. 21 shkurt 2013, shiko shkrimin nga Donjeta Hoxha, ku ajo thekson se shoqëria civile aprovimin e strategjisë kundër korrupsionit nga ana e Kuvendit e konsideron si dokument të thatë që nuk do të prodhon asnjë efekt në terren.

një mbështetje më të madhe nga të gjitha subjektet, posaçërisht të sistemit juridik përmes ideve, informatave, mjeteve teknologjike, planeve operative, organizimeve shkencore. Preventivat e tilla do të kontribuojnë në zvogëlimin e kriminalitetit në përgjithësi e në veçanti të veprave penale kundër ekonomisë.

7.3. Ndikimi i mjeteve të komunikimit masiv si parandalues i kriminalitetit

Rol të rëndësishëm parandalues në pengimin dhe zhvillimin e kriminalitetit, në fushën ekonomike, ka informimi i drejtë dhe transparent i qytetarëve lidhur me dukuritë kriminale⁴⁵⁰. Këtë rol e kanë mjetet e komunikimit masiv siç janë: shtypi, televizioni, interneti, filmi, literatura, debatet televizive etj⁴⁵¹. Po ashtu kjo luftë parandaluese kundër veprave penale kundër ekonomisë është e pamundur dhe jo e suksesshme pa ndihmën e shoqërisë në përgjithësi, gazetarisë hulumtuese dhe shoqërisë civile.

Natyrisht që gazetarët, me rastin e publikimit të informacioneve, duhet të kenë kujdes që artikujt e tyre të jenë objektivë, të shkurtër dhe në frymën e gjykimit për kryerësit e veprave penale. Dihet se shtypi ka një vend të rëndësishëm në kuadër të mjeteve të komunikimit masiv, prandaj është e rëndësishme që shtypi të ketë efekt pozitiv tek qytetarët që t'i kundërvihen dukurive antisociale⁴⁵².

Në kuadër të masave parandaluese është formimi i vetëdijes juridike përmes shtypit dhe mjeteve të tjera të komunikimit masiv, ngase në shoqëritë bashkëkohore masat parandaluese në luftimin e kriminalitetit gjithënjë e më shumë po ia zënë vendin

450 Milutinović. Milan, *Kriminologjia*, Savremena Administracija., Beograd, 1985, fq. 548.

451 Halili. Ragip, *Kriminologji me Penologji*, 2008, fq. 126.

452 Latifi. Vesel, Elezi. Ismet & Hysi. Vasilika, *Politika e luftimit të kriminalitetit*, Instituti Evropian për Studime Juridike dhe Administratë Publike “Juridica”, Prishtinë, 2012, fq. 298-299.

masave represive. Këtu po zbatohet rregulli themelor i mjekësisë: më mirë të parandalohet, se të shërohet një sëmundje⁴⁵³. Gjithashtu shtypi luan rol të rëndësishëm për njohjen e opinionit publik, lidhur me ligjet, normat penale dhe nivelimin e tyre. Kjo ndikon që opinionin publik të njihet me normat penale dhe të kuptojë se cilat veprime janë të dënueshme, kjo ka efekt parandalues të njerëzit që t'i shmangen shkeljes së këtyre normave⁴⁵⁴.

Mjetet e komunikimit masiv luajnë rolin edhe të propagandës antikriminale, që ka për qëllim të ndikojë në masë apo tek opinionin publik që të frikësohen në ndërmarrjen e aksioneve për kryerjen e veprave penale. Kujtoj se shumica e shteteve dhe Kosova, vetëm me organet që kanë, e kanë të pamundur dhe jo të suksesshme parandalimin e veprave penale kundër ekonomisë pa mbështetjen e të gjithë organizmave tjerë shtetërorë dhe shoqërorë. Pra, mjetet e komunikimit masiv me një informim objektiv dhe pozitiv ndikojnë pozitivisht në parandalimin e krimit.

7.4. Roli parandalues i organeve shtetërore dhe organeve të tjera në luftimin e kriminalitetit

Një rol parandalues të rëndësishëm në shtetet bashkëkohore kundër veprave penale, kundër ekonomisë dhe kriminalitetit në përgjithësi, pa dyshim e luajnë organet shtetërore, që me ligj i është besuar: hetimi, zbulimi i krimit, ndjekja penale dhe dënimi i kryerësve të veprave penale. Ky rol i është besuar policisë, prokurorisë, gjykatave dhe agjencive të specializuara. Në luftën kundër kryerësve të veprave penale, që cenojnë

453 Mr.sc. Kajtazi. Besim, *Ndikimi i shtypit në kriminalitet*, Qendra për Studime Shqiptare "Albanica", Lubjanë, 2007, fq. 119.

454 Po aty, fq. 122.

ekonominë private dhe publike të vendit dhe kriminalitetit në përgjithësi si dukuri, organet shtetërore (policia dhe prokuroria) janë gjithherë të parët në vijën e frontit⁴⁵⁵.

Në ditët e sotme, veprimtaria e policisë dhe organeve të drejtësisë, në luftën kundër kriminalitetit, para së gjithash, është e karakterit represiv. Luftimi i kriminalitetit, me masa preventive përmes ligjeve e konventave, është objekt i veçantë në politikën e luftimit të kriminalitetit⁴⁵⁶. Policia ka rol të rëndësishëm në luftën preventive kundër kryerësve të veprave penale në fushën ekonomisë ngase Kodi i Procedurës Penale⁴⁵⁷ i mundëson që të ndërmarrin veprime hetimore dhe atë:

- të mbledhë informata nga personat dhe t'i verifikojë,
- të kryejë kontrolle të përkohshme,
- të kufizojë lëvizjen në zona të caktuara,
- të konfiskojë sendet e kontrabanduara,
- Të ndërmarrë veprime operative për parandalimin e krimit etj.

Pra, puna e policisë është mjaft delikate dhe ajo mban barrën kryesore në parandalimin e veprimeve kriminale. Rol të veçantë në parandalimin e kriminalitetit luan prokuroria dhe gjykatat, ngase si organe shtetërore vendosin përfundimisht për përgjegjësinë penale, aplikimin e masave të fshehta, për zbulimin e kryerësve dhe në fund shqiptojnë dënime dhe sanksione penale, të cilat kanë karakter parandalues jo vetëm për kryerësit e veprave, por edhe për qytetarët në përgjithësi që mund të ishin

455 Bajgora. L. Ali, *Veprat penale kundër lirisë së personit në planin krahasues*, Qendra Profesionale për të Drejtat e Njeriut dhe Iniciativa juridike, Prishtinë, 1999, fq. 205.

456 Latifi. Vesel, Elezi. Ismet & Hysi. Vasilika, *Politika e luftimit të kriminalitetit*, Instituti Evropian për Studime Juridike dhe Administratë Publike “Juridica”, Prishtinë, 2012, fq. 310.

457 Shiko: Kodi i Procedurës Penale të Kosovës nr. 04/L-123, i shpallur me dekretin e Presidentit, nr. DL-057-2012, më dt. 21.12.2012, neni 70.

kryerës eventuale të veprave penale në të ardhmen.

Kujtoj që për shkak të specifikave që kanë veprat penale, kundër ekonomisë, është mjaft shqetësuese fakti se ka informacione se në raste të caktuara, inkriminuesit mund të kenë lidhje me prokurorë dhe gjyqtarë, për atë tregojnë neglizhencë dhe pak angazhim në luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar. Këtë supozim e mbështes në faktin që sot në Kosovë janë duke u zhvilluar procese penale ndaj disa gjyqtarëve dhe prokurorëve për keqpërdorime eventuale, që kanë bërë me ekonominë e vendit dhe krimin e organizuar në përgjithësi⁴⁵⁸.

458 Shih: Raportin e Organizatës për Demokraci, Korrupsion dhe Dinjitet (ÇOHU) me titull: Integrimi Evropian, Gjyqësori dhe lufta kundër korrupsionit, ku potencohet se në disa raste organet e drejtësisë kosovare duket se janë shfrytëzuar prej individëve apo grupeve të caktuara për të avancuar interesat e tyre në kompanitë publike apo në institucione të tjera. Marrë nga: <http://www.cohu.org/> (parë më 14.9.2014).

II

7.1. DISA MASA REPRESIVE PËR VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË

Në luftimin e kriminalitetit dhe parandalimin e tij, në fushën ekonomike, një rol të veçantë përpos masave preventive e ka edhe politika ndëshkimore. Politika ndëshkimore, shikuar në kuptimin e saj të gjerë, ajo përfshin një tërësi veprimesh, që janë në funksion të inkriminimeve juridiko-penale, që ka të bëjë me zbulimin e veprave penale dhe kryerësit e tyre, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale të kryera, shqiptimin e dënimeve dhe sanksioneve penale, ekzekutimin e dënimeve dhe sanksioneve penale⁴⁵⁹.

Politika ndëshkimore, si pjesë e posaçme e politikës kriminale, realizohet përmes zbatimit të masave represive, qëllimi i të cilave është luftimi i veprimeve të kundërligjshme që cenojnë të drejtat themelore të mbrojtura me ligj⁴⁶⁰. Andaj, shikuar në këtë aspekt nxirret përfundimi se “sa më demokratike që të jetë një shoqëri, sa më shumë që ajo të zhvillohet në shenjë të afirmimit të personalitetit dhe përvetësimit të njohurive të kriminologjisë, të së drejtës penale dhe të shkencave të tjera, aq më shumë do të ngushtohet fusha e represionit dhe politikës ndëshkimore”⁴⁶¹. Andaj, për të reaguar suksesshëm kundër kryerësve të veprave penale kundër ekonomisë, ndërmerren masa represive ndaj tyre nga ana e organeve shtetërore dhe të specializuara, të parapara me ligj siç janë: organet e punëve të brendshme, prokuroritë themelore dhe ajo speciale, gjykatat dhe organet për ekzekutimin e dënimeve etj.

Masat represive dallohen për nga karakteri dhe efekti nga masat preventive, ngase

459 Dr. Bajgora. Ali, *Disa karakteristika të kriminalitetit dhe politikës ndëshkimore në Kosovë*, Qendra Profesionale për të Drejtat e Njeriut dhe Iniciativa Juridike, Prishtinë, 2001, fq. 18.

460 Po aty, fq. 19.

461 Ibid.

ato manifestohen me shqiptimin e sanksionit penal vetëm ndaj kryerësit të veprës penale. Pra, efekti i tyre është më i kufizuar, në raport me masat preventive që kanë efekt më të gjerë që synojnë parandalimin e përgjithshëm të veprave penale.

7.2. Politika adekuate ndëshkimore dhe e ndjekjes penale ndaj kryerësve të veprave penale kundër ekonomisë

Luftimi dhe parandalimi i kriminalitetit në përgjithësi, e në veçanti i veprave penale kundër ekonomisë, varet nga puna e organeve të ndjekjes dhe zbulimit. Kjo nënkupton faktin se sa këto organe janë efikase në zbulimin e veprave penale dhe politikën ndëshkimore që e aplikojnë ndaj kryerësve të veprave penale.

Kujtojmë se disa nga faktorët që kanë ndikim të suksesshëm si masa represive të cilat ndikojnë pozitivisht në zvogëlimin e veprave penale kundër ekonomisë janë :

- Funksionimi i shtetit ligjor,
- Legjislacioni penal adekuat,
- Funksionimi i organeve të drejtësisë i pandikuar nga shtyllat e tjera të pushtetit, atij legjislativ dhe ekzekutiv,
- Zbulimi dhe ndjekja e kryerësve të veprave penale,
- Shqiptimi i sanksioneve penale adekuate nga gjykata,
- Mbrojtja juridiko-penale adekuate nga kriminaliteti,
- Ngritja profesionale e vazhdueshme e organeve të ndjekjes.

Kujtojmë se bashkëveprimi i institucioneve të përmendura në efikasitetin e ndjekjes dhe zbulimit të veprave penale dhe kryerësve të tyre, shqiptimi i sanksionit

penal adekuat, duke u bazuar në peshën dhe natyrën e veprës penale, karakteristikat personale të kryerësve të veprave penale me rastin e matjes së dënimit rezultojnë në suksesin e ndalimit dhe luftimit të veprave penale kundër ekonomisë si masa represive.

7.3. Llojet e sanksioneve penale ndaj kryerësve të veprave penale kundër ekonomisë

Sanksionet penale janë masa represive dhe ato paraqesin reagimin e shoqërisë dhe shtetit ndaj kryerësve të veprave penale, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave themelore dhe vlerave të përgjithshme shoqërore dhe individuale nga veprimet kriminale. Sanksionet penale janë masa të detyrueshme të parapara me ligj, të cilat i shqipton gjykata nëpërmjet vendimit gjyqësor të detyrueshëm si reaksion për veprën e kryer penale⁴⁶². Sanksionet penalo-juridike, si masa shtrënguese kanë për qëllim të krijojnë pasoja juridike për kryerësin e veprës penale, ndërsa veprat penale kanë edhe pasoja tjera juridike si zhvillimi i procedurës penale, kompensimi i dëmit, i shkaktuar me vepër penale, konfiskimi i pasurisë të fituar me vepër penale, marrja e sendeve⁴⁶³ etj. Historikisht ndryshimet e bëra në legjislacionin penal bashkëkohor kanë qenë si rrjedhojë e ndryshimeve të mëdha të sanksioneve penale, që kanë pasur për qëllim vendosjen e një raporti të ri ndaj shoqërisë me kryerësin e veprës penale, që ai të mos konsiderohet armik i shoqërisë por pas trajtimit adekuat të kthehet si anëtar i barabartë i shoqërisë⁴⁶⁴.

462 Kambovski. Vlado, *E drejta penale-pjesa e përgjithshme*, botues SHB”Furkan ISM”, Shkup, 2010, fq. 447.

463 Po aty.

464 Bajgora. L. Ali, *Disa karakteristika të kriminalitetit dhe politikës ndëshkimore në Kosovë*, Qendra Profesionale për të Drejtat e Njeriut dhe Iniciativa Juridike, Prishtinë 2001, fq. 25.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës i ka paraparë sanksionet penale si: dënime kryesore, dënime alternative, dënime plotësuese dhe vërejtjen gjyqësore⁴⁶⁵. Sipas kodit dënimet kryesore janë: dënimi me burgim të përjetshëm, dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë, ndërsa dënimet alternative janë: dënimi me kusht, gjysmëliria dhe urdhri për punë në dobi të përgjithshme, kur gjykata shqipton dënimin me kusht mund të shqiptojë edhe: urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues dhe urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, kurse dënimet plotësuese si: heqja e së drejtës për të zgjedhur, urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit, ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik, ndalimi i ushtrimit të profesionit i veprimtarisë ose detyrës, ndalimi i drejtimit të automjetit, marrja e lejes së vozitjes, konfiskimi, urdhri për publikimin e aktgjykimit dhe dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës, mund të shqiptohen së bashku me dënimet kryesore ose alternative⁴⁶⁶.

Kodi penal ndaj kryerësve të papërgjegjshëm penalisht ose te personat me çrregullime të zvogëluara mendore apo që janë të varur nga droga dhe alkooli mund t'i shqiptojë masat e trajtimit të detyrueshëm dhe atë: trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionet e kujdesit shëndetësor, trajtimi psikiatrik i detyrueshëm në liri dhe trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm të personave të varur nga droga dhe alkooli⁴⁶⁷.

Ndaj kryerësve të veprave penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës mund të shqiptohen: dënimi me burg, dënimi me gjobë dhe dënimet plotësuese. Sa i përket politikës ndëshkimore konsideroj që kodi penal në fuqi,

465 Kodi Penal me nr. 04/L-82, është miratuar më 20 prill 2012, hyri në fuqi më 1 janar 2013, neni 42.

466 Shih: Kodi Penal i Kosovës, nr. 04/L-82, neni 43, 49 dhe 62.

467 Shih: Kodi Penal i Kosovës nr. 04/L-82, neni 88.

nga viti 2013, kujtoj që në mënyrë adekuate ka paraparë shqiptimin e sanksioneve penale ndaj kryerësve të veprave penale, në fushën e ekonomisë, në proporcion me dëmin dhe natyrën e veprës penale. Konsideroj që politika ndëshkimore është më e rreptë në krahasim me politikën ndëshkimore të paraparë me Kodin e Përkohshëm Penal të vitit 2004.

Duke analizuar sanksionet penale të parapara për shumicën e veprave penale, kundër ekonomisë, mund të vijmë në përfundim se Legjislacioni Penal i Kosovës, që është në fuqi nga 1 janari i vitit 2013, ka përcaktuar politikën ndëshkimore për këtë kategori të veprave penale, në mbështetje të standardeve ndërkombëtare. Nëse këtë politikë ndëshkimore e krahasojmë me ligjet e mëhershme penale konstatojmë se për disa vepra penale Kodi i Përkohshëm Penal i vitit 2004 ishte më i favorshëm, ndërsa Ligji Penal i Kosovës i viteve 1977 për disa vepra ishte më i disfavorshëm ngase kishte paraparë dënime deri në 20 vite burgim, për shembull për veprën penale “Bërja dhe përdorimi i shenjave të rreme të vlerës ose i letrave me vlerë”⁴⁶⁸.

Gjatë krahasimit të politikës ndëshkimore, për veprat penale në fushën ekonomike, në disa shtete të rajonit që janë pjesë e këtij punimi, është konstatuar se legjislacioni penal: i Francës, Kroacisë, Maqedonisë dhe Bosnjë e Hercegovinës ka paraparë dënime maksimale deri në 10 vite burg dhe dënim me gjobë, ndërsa Italia, Sllovenia dhe Kosova kanë paraparë dënimin maksimal për këtë kategori të veprave penale, dënim me gjobë dhe burgim deri në 12 vite. Kurse vendi që aplikon sanksione më të rrepta nga shtetet e krahasuara është Shqipëria, ku dënimet e parapara që mund t’i shqiptohen kryerësit për veprat penale “kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”, janë me gjobë dhe burgim deri në 20 vjet, e pasuar nga Serbia e cila për veprën penale

468 Shih: Ligji Penal i Kosovës, i vitit 1977, neni 113.

“Falsifikimi i parasë”, për mënyrën e kualifikuar të kryerjes ka paraparë dënim me gjobë dhe burgim deri në 15 vjet. Kujtoj se të gjitha shtetet e rajonit kanë paraparë në ligjet e tyre penale masa represive adekuate që garantojnë preventivë dhe mbrojtje penalo-juridike nga kriminaliteti ekonomik.

7.4. Politika ndëshkimore e aplikuar ndaj kryerësve të veprave penale kundër ekonomisë në praktikën e Gjykatës Komunale të Ferizajt, për periudhën kohore 2008-2013

Rol të rëndësishëm në luftimin e suksesshëm të veprave penale, kundër ekonomisë, ka zbatim adekuat të politikës ndëshkimore. Legjislacioni i tanishëm Penal i Kosovës, por edhe i mëhershmi kanë ndërtuar një politikë ndëshkimore adekuate, ndaj kryerësve të veprave penale, kundër ekonomisë. Luftimi i kriminalitetit në Kosovë në fushën ekonomike varet shumë edhe nga lloji i sanksioneve penale, që i shqiptohen kryerësit të veprës penale⁴⁶⁹.

Vlerësuar sipas statistikave, të siguruara nga ish-Gjykata Komunale e Ferizajt, tani (Gjykata Themelore), pas hulumtimit dhe analizimit të bërë politikës ndëshkimore përmes aktgjykimeve të plotfuqishme, për periudhën kohore 2008-2013, kemi arritur në përfundim se politika ndëshkimore në praktikën e kësaj gjykate është jashtëzakonisht e butë, për faktin se në shumicën e dënimeve të shqiptuara ndaj kryerësve të veprave penale janë shqiptuar dënime me gjobë, ose me kusht dhe dënime të tjera, që ne mendojmë se me këto dënime nuk arrihet qëllimi i dënimit. Ky konstatim mbështetet duke u bazuar në faktin se ish-Gjykata Komunale në Ferizaj gjatë vitit 2008 kishte

469 Dr. Bajgora. L. Ali, *Disa karakteristika të kriminalitetit dhe politikës ndëshkimore në Kosovë*, Qendra Profesionale për të Drejtat e Njeriut dhe Iniciativa Juridike, Prishtinë, 2001, fq. 55

shqiptuar 5 dënime me gjobë, një dënim me kusht dhe vetëm një vërejtje gjyqësore.⁴⁷⁰

Siç shihet se në asnjë rast gjykata komunale për vitin 2008, nuk kishte shqiptuar dënim me burg efektiv me çka jep të kuptohet se dënimet janë tejet të buta, në krahasim me dënimet e parapara në kodin penal për këto vepra penale.

Gjithashtu gjatë analizimit të aktgjykimeve është parë se dënimet e shqiptuara me gjobë janë tejet të ulëta si p.sh. 150 euro⁴⁷¹. Situata përafërsisht ishte e njëjtë edhe për vitin 2009, ku Gjykata ka shqiptuar ndaj kryerësve të veprave penale, që ishin shpallur fajtorë: 9 dënime me gjobë, 1 dënim me kusht dhe gjobë, 1 vërejtje gjyqësore dhe 1 dënim me burg efektiv. Duke krahasuar politikën ndëshkimore - sanksionet penale që i ka shqiptuar Gjykata Komunale shihet se ajo në 75% të rasteve ka shqiptuar dënim me gjobë, ndërsa në 25%, të rasteve ka shqiptuar sanksione tjera penale, duke përfshirë në këtë përqindje edhe një dënim me burg efektiv.

Gjykata Komunale në Ferizaj nuk e ka ashpërsuar politikën ndëshkimore edhe gjatë vitit 2010, ku të gjitha dënimet e shqiptuara ishin vetëm 4 dhe që të gjitha me gjobë, ose në % -100%. Nga analizat e bëra shihet se dënimi kryesor që ka shqiptuar gjykata në Ferizaj, ishte dënimi me gjobë. Për mendimin tim shumë më shqetësuese është fakti se mbi 50% e aktakuzave të ngritura nga prokuroria shumica e tyre kanë përfunduar me aktgjykim refuzues apo lirues. Nga hulumtimi vërtetohet se shumica e rasteve, në të cilat prokurori ka hequr dorë apo gjykata ka nxjerrë aktgjykim lirues, është për veprën penale “falsifikimi i parasë” (neni 244 paragrafi 3), që lë të kuptohet se të gjitha vendimet e nxjerra nga gjykata kanë qenë ndaj personave që e kanë vënë në qarkullim paranë e falsifikuar dhe e kanë ditur se e njëjta është e falsifikuar. Dënimi për

470 Të dhënat janë siguruar nga raporti i gjykatës komunale në Ferizaj, për vitin 2008.

471 Shih aktgjykimin P. nr. 914/12, të Gjykatës Komunale në Ferizaj, të dt. 8.10.2012.

këtë formë të veprës penale ishte me gjobë ose burgim deri në një vit⁴⁷², që deri në një masë pak a shumë e arsyeton politikën e butë ndëshkimore.

Situatë pothuaj e njëjtë ka qenë edhe gjatë vitit 2012, sa i përket dënimeve të shqiptuara vazhdon pothuaj politika e njëjtë ndëshkimore, gjykata ka shqiptuar: dënime me gjobë në 20 raste, dënime me kusht në 2 raste në mënyra të tjera është zgjedhur një rast, ndërsa gjykata nuk ka shqiptuar në asnjë rast të vetëm dënim me burg⁴⁷³. Gjatë vitit 2012, vërehet një rënie e aktgjykimeve refuzuese, por ka një rritje të parashkrimit absolut, që nënkupton se në mungesë të efikasitetit të gjykatës në zgjedhjen e lëndëve personat nuk marrin dënimin eventual nëse do të shpallehin fajtorë.

Viti 2013, Kosovën e gjen me reforma të dyanshme ligjore dhe profesionale. Nga janari i vitit 2013, fillon të zbatohet ligji i ri për gjykatat⁴⁷⁴ dhe Kodi i ri Penal dhe Procedural. Reformat ishin bërë edhe në radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Megjithëse pritjet ishin të mëdha, rezultatet e arritura pas reformave janë tejet të vogla. Për ta mbështetur këtë konstatim është krahasuar efikasiteti dhe politika ndëshkimore e Gjykatës Themelore të Ferizajt dhe Kaçanikut, për vitin 2013.

Nga analiza vërehet se Gjykata e Ferizajt ka pasur në punë gjithsej 112 lëndë kundër kryerësve të veprave penale, kundër ekonomisë, dhe ka arritur t'i zgjedhë vetëm 4 prej tyre ose 3.57%⁴⁷⁵, që për mendimin tim është jashtëzakonisht shqetësuese për faktin se 96.42 % e lëndëve kanë mbetur të patrajtuara në fund të vitit apo më mirë të

472 Shih: Kodi i Përkohshëm Penal 2004, neni 244, parag. 3.

473 Sipas nenit 107 parag. 8 të Kodit Penal të Kosovës, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

474 Ligji për Gjykatat në Republikën e Kosovës, nr. /L-199, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2013, Ligji është miratuar në Kuvend më 22.7.2010, kurse është shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-047-2010, dt. 9.8.2010.

475 Shih: Raportin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, për zgjedhjen e lëndëve penale për periudhën kohore 1 janar 2013 e deri më 31 dhjetor 2013.

themi se këtyre lëndëve gjykata nuk i'u ka qasur fare edhe pse ky grup i veprave penale paraqet rrezik të madh për evazion fiskal dhe për buxhetin e shtetit. Ndërsa sa i përket dënimeve të shqiptuara vlen të theksohet se kemi një rast ku gjykata ka shqiptuar dënim me burg, në dy raste dënim me gjobë, ndërsa për një rast është shqiptuar urdhër ndëshkimor. Ky konstatim mund të jetë jo i qëndrueshëm për faktin se analiza është bërë vetëm për 4 lëndë të zgjidhura, por duke pasur parasysh faktin që në dy vitet e mëparshme 2011 dhe 2012 nuk kishte asnjë dënim me burg e kemi konsideruar që ka filluar një politikë e re ndëshkimore.

Dega e Gjykatës Themelore të Ferizajt në Kaçanik, për vitin 2013, ka kryer vetëm një lëndë dhe atë: veprën penale “keqpërdorimi i autorizuar në ekonomi, neni 236 i KPPK-së⁴⁷⁶. Kjo tregon qartë që, veprave penale kundër ekonomisë, nuk i kanë kushtuar fare kujdes për vendosje as Gjykata Themelore e Ferizajt e as dega e saj.

Nga krahasimi i bërë mund të konkludojmë se Gjykata Komunale në Ferizaj, gjatë periudhës kohore 2008-2013, për veprat penale kundër ekonomisë ka aplikuar politikë ndëshkimore, joadekuate në raport me peshën dhe pasojat që ka ky grup i veprave penale, d.m.th. ka qenë joefikase në zgjidhjen e tyre dhe shqiptimi i dënimeve me gjobë, e në disa raste edhe me kusht, lirimi dhe refuzimi i shumë akuzave nuk janë garanci se reformat kanë qenë të qëlluara dhe se nuk janë garanci se në të ardhmen priten ditë të mira për sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Situatën e njëjtë e kishte edhe Gjykata Komunale e Kaçanikut, tani degë e Gjykatës Themelore të Ferizajt, në aspektin e efikasitetit dhe politikës ndëshkimore.

476 Aktgjykimi P. nr. 147/2013, Gjykata Themelore në Ferizaj, dega në Kaçanik, i dt. 26.12.2014.

PËRFUNDIMI

Ky studim nxjerr në pah të dhënat se në ditët e sotme, veprat penale kundër ekonomisë, pavarësisht statistikave që tregojnë se në Kosovë ka një rënie të tyre, praktika dhe gjendja faktike në të cilën gjendet ekonomia jonë tregon të kundërtën, se ky grup i veprave penale është në rritje të vazhdueshme në nivelin nacional dhe ndërkombëtar. Gjetjet kryesore në këtë punim janë:

1. Veprat penale kundër ekonomisë rrezikojnë ekonominë e vendit, shkaktojnë humbje dhe zbrazje të buxhetit, evazion fiskal, pasurim të paligjshëm. Andaj ka shtyrë nevojën e Kosovës dhe shteteve të Ballkanit dhe më gjerë, që të bëjnë ndryshime në legjislacionet e tyre penale dhe t'i japin mbrojtje të veçantë juridiko-penale ekonomisë dhe të mirave juridike të shoqërisë të mbrojtura me ligj.
2. Gjatë vështrimit historik të paraqitjes dhe zhvillimit të legjislacionit penal në Kosovë, vihet në pah se Kosova, ka pasur një rrugë të veçantë të nxjerrjes dhe zbatimit të kodeve që e bën të dallohet nga të gjitha vendet e Ballkanit dhe më gjerë. Deri në vitin 1977, ajo nuk e ka pasur fare kodin e saj penal, ajo ka aplikuar Kodin Penal të RSFJ-së. Pas vitit 1977, ajo për herë të parë ka nxjerr kodin penal të saj, por ka vazhduar ta zbatojë Kodin Procedural të RSFJ-së, pas vitit 1999, ka zbatuar legjislacionin e UNMIK-ut, mision ndërkombëtar i vendosur në Kosovë.
3. Ky grup i veprave penale për shkak të kompleksitetit që kanë për zbulim, për faktin se pasojat e tyre për një kohë të gjatë nuk zbulohen, mënyrës se si ato kryhen, subjektet që i kryejnë e që shpeshherë janë persona që janë të thirrur

për t'i luftuar mbesin shpeshherë të pazbuluara dhe të pagjykuara.

4. Rëndësi të veçantë këtyre veprave penale i është kushtuar nga ligjvënësi kosovar, për faktin se Kodi Penal i vitit 2012, ka shtuar numrin e tyre në 34 lloje me qëllim t'i ofrojë një mbrojtje më të madhe shoqërisë dhe ekonomisë në përgjithësi. Krahasuar me disa nga shtetet evropiane si: Francën, Italinë, Slloveninë, Kroacinë dhe shtetet e Ballkanit, Kosova prin me numrin më të madh të veprave penale kundër ekonomisë, të parapara në legjislacionin penal.
5. Mendimi ynë është se vendi ynë Kosova ka treguar një përkushtim për ta luftuar kriminalitetin ekonomik, por në praktikë nuk ja ka arritur për faktin se mbetet ndër shtetet me nivel shumë të lartë të korrupsionit, ekonomisë joformale dhe me një ekonomi të pazhvilluar si pasojë privatizimit të dështuar dhe të manipuluar.
6. Gjatë këtij studimi është vënë në pah se legjislacioni penal i shteteve të krahasuara jo gjithherë ka bërë ndarje të drejtë të grupit të veprave penale në fushën ekonomisë, bazuar në objektin material. Disa prej këtyre shteteve kanë përfshirë edhe vepra penale që ne kujtojmë se vendin e kanë në grupe tjera të veprave penale, për shembull, Italia ka paraparë në grupin e veprave penale kundër ekonomisë edhe disa vepra penale në fushën e agrokulturës, si për shembull “përhapja e sëmundjeve të bimëve dhe kafshëve” që kujtoj se duhet të trajtohen ndaras nga veprat penale kundër ekonomisë.
7. Gjatë punimit, duke krahasuar objektin material të disa veprave penale në fushën e ekonomisë, kemi arritur në përfundim se përmes objektit material bëhet ndarja më e drejtë e veprave penale se në cilin grup duhet të trajtohen.

Natyrisht që është konstatuar se vështirësi hasen gjatë ndarjes me veprat penale që kanë objektin material pothuaj të njëjtë, siç është rasti me veprat penale “kundër pasurisë” dhe veprat penale kundër “korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare”.

8. Shqipëria nuk ka arritur trajtimin e këtyre veprave penale ta bëjë ndaras, por e ka bërë në kuadër të veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, duke i ndarë ato në seksione varësisht prej objektit material të tyre.
9. Gjatë studimit në këtë punim kemi konstatuar se natyra e objektit material të veprave penale kundër ekonomisë është e drejtuar kundër: dëmtimeve të pronës, dëmtimeve në fushën financiare dhe dëmtimeve në fushën doganore, pra objekti mbrojtës i tyre është sistemi ekonomik, afarizmi ekonomik dhe marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar veprimtari normale në ekonomi.
10. Në këtë punim gjatë analizimit të përgjegjësisë penale të personave juridikë në kryerjen e veprave penale kundër ekonomisë në Kosovë dhe disa shtete të Evropës, kemi arritur në përfundim se nga viti 2011, në bazë ligjit Nr. 04/L-30, në Kosovë zbatohet përgjegjësia penale ndaj personave juridikë të vendit dhe të huaj.
11. Personat juridikë janë përgjegjës për kryerjen e veprave penale jashtë shtetit dhe në dëm të Republikës së Kosovës. Nga përgjegjësia penale, sipas ligjit, janë të përjashtuar Republika e Kosovës, organet e saj të administratës shtetërore dhe vendore, si dhe organizatat e huaja qeveritare që veprojnë në Republikën e Kosovës.

12. Dënimet që mund t'i shqiptohen personit juridik janë: dënime, dënimi me kusht dhe masa sigurie. Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më i ulët se 1000 euro dhe më i lartë se 100.000 euro, ndërsa si dënim i rëndë konsiderohet suprimimi i personit juridik dhe ai aplikohet kur konstatohet se personi juridik është krijuar me qëllim të kryerjes së veprave penale.
13. Nga studimi është konstatuar se Kosova është shteti i fundit që ka filluar të zbatojë përgjegjësinë penale për personat juridikë në rajon.
14. Në këtë punim gjatë analizimit dhe krahasimit të legjislacioni penal të Kosovës me disa ligje penale të shteteve evropiane nga aspekti se ku dhe si i kanë definuar veprat penale, kundër ekonomisë, mendimi ynë është se pavarësisht ndryshimeve të shpeshta të ligjeve penale krimi ekonomik por edhe kriminaliteti në përgjithësi në ditët e sotme është sofistikuar shumë, falë teknologjisë informative, dhe me të drejt konstatohet se është gjithherë para atyre që janë të thirrur për ta luftuar por edhe përpara vetë shkencës dhe ligjeve.
15. Mendimi ynë është që shtetet kanë lënë disa veprime të painkriminuara, siç ishte rasti me shfrytëzimin e impulseve sim-to-sim nga Telekom i Kosovës.
16. Mangësi në definimin e qartë të veprave penale kundër ekonomisë kemi hasur gjatë trajtimit përmbajtësor të tyre, gjatë këtij punimi por edhe nga ana e punës si prokuror për disa nga veprat penale kundër ekonomisë, sidomos atyre që kanë të bëjnë me fushën e doganës si për shembull te vepra penale “shmangia nga pagesat e detyrueshme doganore”, kodi penal ka përcaktuar mënyrën e kualifikuar të kryerjes, kur vlera e pagesës së shmangur doganore

është 15.000 euro, kryerësi dënohet me gjobë dhe burgim deri në 5 vjet, nëse shmangia doganore kalon 30.000 euro dënohet me gjobë dhe burgim nga 1 deri në 8 vjet.

17. Në praktikën gjyqësore për këtë vepër penale gjatë trajtimit është hasur në vështirësi kur shmangia nga pagesat e tarifave të detyrueshme nuk kalon vlerën 500 euro, në këto raste oficerët doganorë këtë veprim e konsiderojnë kundërvajtje doganore që bie ndesh me nenin 318 parag. 1 të KPRK-së, ngase ai nuk ka përcaktuar fare vlerën e shmangies doganore të mënyra të zakonshme të kryerjes së veprës penale.

18. Ne mendojmë se kjo zgjidhje e praktikuar ia humb efektin pozitiv normës ngase për veprimin e njëjtë, por dallimi në vlerë monetare vetëm qoftë edhe për një euro do të vendosë se a përgjigjet personi penalisht apo jo, si p.sh: nëse shmangia nga pagesa detyrimeve doganore është 499 euro, në këtë rast personi nuk ka përgjegjësi penale e nëse kalon vlera në 501 euro, personi ka përgjegjësi penale. Kjo çështje ligjore është komplikuar edhe më shumë pas opinionit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. 128/2014, të dt. 21.03.2014, ku vepër penale konsiderohet vetëm nëse shmangia kalon mbi 5000 euro.

19. Gjatë analizimit përmbajtjesor të veprave penale kundër ekonomisë është konstatuar një situatë e tillë është edhe të vepra penale e “Kontrabandimit me mallra” nga neni 317, ku sipas kodit penal të Kosovës është paraparë konfiskimi i mallit dhe mjeteve për bartjen e mallit që ne mendojmë se nuk është sqaruar sa duhet se a është fjala për mjetet e dedikuara për kryerjen e veprës penale apo në përgjithësi për të gjitha mjetet. Kjo normë në mungesë

edhe të komentareve është duke u zbatuar në praktikë në mënyrë jounikate.

20. Nga hulumtimi është konstatuar fakti se nuk është duke u zbatuar në praktikë në gjykatat themelore dispozita për veprën penale “kontrabandimi i mallrave” (neni 317) e paraparë në Kodin Penal të Kosovës, por gjykatat janë duke zbatuar mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. 954/26 i dt. 12.12.2013, ku thuhet se kontrabandimi ekziston vetëm nëse shmangia nga pagesat e tarifave doganore është mbi 5.000 euro.
21. Në bazë të të dhënave të analizuara në këtë punim është konstatuar se veprat penale kundër ekonomisë, krahasuar përmes aktgjykimeve në Gjykatën Komunale dhe përmes kallëzimeve penale në Prokurorinë Komunale në Ferizaj, për periudhën hulumtuese 2008-2012, marrin pjesë me më pak se 5% nga numri i përgjithshëm i veprave penale. Për mendimin tim është numër relativisht i vogël dhe kjo sjell dyshime se këto vepra penale nuk janë duke u zbuluar apo kallëzuar të gjitha.
22. Gjatë analizimit të strukturës së veprave penale kundër ekonomisë të parapara në Kodin Penal (2004), nga neni 232 e deri në nenin 251, është konstatuar se mbi 90% e vendimeve gjyqësore, apo e kallëzimeve penale është për veprën penale: “Falsifikimi i parasë” (neni 244) dhe “Shmangia nga tatimi” (neni 249). Ndërsa për veprat penale nga neni 232, 234, 235, 237, 238, 239, 240, 242, 243, 245, 247, 248, 250 dhe 251, hulumtimi nxjerr në pah se fare nuk janë të konsumuara.
23. Autorë të veprave penale kundër ekonomisë, parashikuar nga neni 232-251, të Kodit Penal, janë 432 persona, prej të cilëve 409, janë meshkuj. Shprehur në

përqindje 94.67%. Ndërsa numri i femrave si autorë të këtyre veprave penale ishte 23. Shprehur në përqindje del se është 5.32%.

24. Mosha e kryerësve të kësaj kategori të veprave penale është e ndryshme, hulumtimi ka treguar se personat nga mosha 18-25, marrin pjesë me 10.41%, grupmosha nga 25-35 vjeç ka pjesëmarrje me 29.16%, ndërsa mosha nga 35, ka pjesëmarrje 60.41%.

25. Faktorët që kanë ndikuar në paraqitjen e veprave penale kundër ekonomisë në territorin e Komunës së Ferizajt, në periudhën kohore nga viti 2008-2012, janë: mosefikasiteti i organeve dhe institucioneve shtetërore në përmbushjen e detyrave nga kompetenca e tyre siç janë: (policia, doganat organet e tjera shtetërore), numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve, kushtet e punës (mungesa e hapësirës, numri i pamjaftueshëm i automjeteve për terren), mungesa e teknologjisë informative, stimulimi material joadekuat i prokurorëve dhe stafit mbështetës, numri i vogël i bashkëpunëtorëve dhe praktikantëve, pasojat e luftës, shfrytëzimi joracional i kohës së punës nga ana e disa prokurorëve dhe zyrtarëve të prokurorisë, mungesa e prokurorëve dhe zyrtarëve nga puna për shkak të trajnimeve dhe seminareve të ndryshme, buxheti i limituar për punësimin e stafit të nevojshëm, mungesa e sistemit të menaxhimit të lëndëve etj.

26. Po ashtu gjatë këtij punimi janë analizuar edhe vendime gjyqësore që i ka marrë Gjykata Komunale dhe tani Themelore në Ferizaj, për veprat penale kundër ekonomisë, në periudhën kohore 2008-2012. Gjatë analizës kemi hasur se Gjykata ka refuzuar 32.46%, të akteve akuzuese të ngritura nga ana e prokurorisë, 20.18% të rasteve i ka zgjidhur me aktgjykim me urdhër

ndëshkues, 37.72%, të akuzave i ka përfunduar me aktgjykim dënues, ndërsa vetëm në 9.65% të akuzave kishte nxjerr aktgjykim lirues.

27. Gjithashtu nga hulumtimi është konstatuar se ka përshkrimi absolut dhe relativ të akuzave dhe numri më i madh i lëndëve ka mbetur pa u zgjidhur, vetëm gjatë vitit 2013, kanë mbetur pa u zgjidhur mbi 96% të akuzave.

28. Ne kujtojmë, përveç faktorëve të përmendur më lartë, ka mungesë të profesionalizmit, guximit për t'u ballafaquar me kategorinë e personave që janë kryerës të këtyre veprave penale.

29. Kjo gjendje ka ardhur edhe si pasojë e mungesës të policisë gjyqësore, policëve dhe prokurorëve të specializuar në këtë fushë, dhe ekspertëve në këto institucione.

30. Një vështrim i veçantë në këtë punim i është bërë edhe politikës ndëshkimore që ka aplikuar Gjykata e Ferizajt ndaj kryerësve të veprave penale kundër ekonomisë. Gjatë analizimit është konstatuar se politika ndëshkimore është tejte joadekuante në raport me natyrën e veprave penale, për periudhën kohore 2008 - 2013, gjykata ka shqiptuar, shumica e dënimeve me gjobë vetëm për vitin 2008 kishte shqiptuar 5 dënime me gjobë, 1 dënim me kusht dhe 1 vërejtje gjyqësore, duke parë se dënimet me gjobë janë tejte të ulëta si 150-200, kujtoj se politika ndëshkimore është tejte e butë dhe nuk garanton se do të arrihet qëllimi i dënimit.

31. Dënimi kryesor që ka shqiptuar Gjykata në Ferizaj, gjatë periudhës hulumtuese 2008-2012, ishte me gjobë dhe atë në 75% të rasteve.

32. Gjendja e së njëjtës situatë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2013 në Gjykatën

Komunale në Ferizaj pas reformave ligjore pos asaj që vërehet një rënie drastike në zgjidhjen e lëndëve, që rezultoi të ishte vetëm 3.57%, nga lëndët që i kishte në punë për veprat penale kundër ekonomisë, edhe politika ndëshkimore ka vazhduar të jetë e njejtë.

33. Kujtojmë se është tejet shqetësuese zgjidhja aq e vogël e lëndëve, ngase fatkeqësisht veprimtaria kriminale në fushën ekonomike është duke u zhvilluar për çdo ditë në përmasa më të mëdha, që nënkupton se për luftimin e suksesshëm të veprave penale kundër ekonomisë duhet angazhim shumë më i madh i të gjithë faktorëve, posaçërisht organeve shtetërore, që kanë obligim ligjor dhe kushtetues për ta bërë një gjë të tillë.

REKOMANDIME

1. Plotësimi i legjislacionit penal, sa i përket veprave penale, kundër ekonomisë.

Kosova ka nxjerr kodin e saj penal, i cili është në përputhje me standardet ndërkombëtare, por reformat e bëra në organizimin e sistemit të drejtësisë në vitin 2013, kanë nxjerrë në pah se normat juridike, në disa raste, janë të paqarta dhe kërkojnë plotësimin dhe ndryshimin e tyre në mënyrë detaje, ngase gjykatat shpeshherë bëjnë interpretime vetanake të normave penale. Ndryshimi i legjislacionit penal duhet të bëhet me kujdes të veçantë, institutet e reja të parapara duhet të ndikojnë pozitivisht në cilësinë dhe qartësinë e dispozitave ligjore sepse e kundërta do të determinojë amendamente të sërishme të kodit penal, që në praktikën gjyqësore kjo formë nuk është shumë e pranueshme.

2. Harmonizimi i legjislacionit të Doganës së Kosovës me Kodin Penal të Kosovës për veprat penale kundër ekonomisë.

Ligjvënësi i Kosovës duhet sa më parë të ndërmarrë veprime për ta harmonizuar legjislacionin e doganës, sa i përket veprave penale kundër ekonomisë, sepse nga studimi është konstatuar se disa nga veprat penale të parapara në Kodin Penal (2012) , nuk janë duke u zbatuar në praktikën gjyqësore, ngase gjatë hartimit ligjvënësi ka qenë i pakujdesshëm në harmonizimin e dispozitave ligjore, andaj kjo mospërputhshmëri ka ndikuar që Gjykata Supreme e Kosovës të nxjerrë qarkore – udhëzime për zbatimin e normave penale për disa vepra penale si “Kontrabandimi me mallra” (neni 317 KPK) dhe “Shmangia mashtruese nga pagesa e detyrueshme doganore” (neni 318 KPRK). Ndryshimet janë të domosdoshme për të sqaruar rastet se kur kemi të bëjmë me kundërvajtje doganore e kur me vepër penale.

3. Krijimi i policisë gjyqësore

Policia e shtetit pa dyshim e ka rolin primar në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit në përgjithësi. Në këtë drejtim, Këshilli Gjyqësor dhe Prokuroria duhet në bashkërendim me Policinë e Shtetit të krijohet sa më parë policia gjyqësore me theks të veçantë në sektorin e veprave penale kundër ekonomisë. Policia gjyqësore e specializuar në bashkëveprim me organin e ndjekjes duhet të kenë rolin kryesor në parandalimin dhe zbulimin e autorëve të veprave penale në fushën e ekonomisë. Policia e shtetit duhet të veprojë që në këtë strukturë të përfshijë persona me përgatitje të lartë shkollore dhe me eksperiencë që do të ndikonin në rritjen e efikasitetit në zbulimin e këtyre veprave penale dhe në bashkëpunimin sa më të mirë me qytetarët.

4. Shtimi i numrit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë.

Kujtoj se Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial duhet të rrisin numrin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, ngase krahasuar numrin e tyre me numrin e rasteve penale dhe të tjera të paraqitura në shtetin e Kosovës është disbalancë e madhe. Kjo do t'i shërbente rritjes së efikasitetit në zbulimin e veprave penale kundër ekonomisë dhe gjykimin e tyre, duke pasur parasysh natyrën e vështirë të zbulimit të tyre. Shtimi i numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve do të rrisë cilësinë e vendimeve në ndjekjen dhe gjykimin e autorëve të veprave kundër ekonomisë.

5. Forcimi i politikës ndëshkimore nga ana gjykatës për kryerësit e veprave penale kundër ekonomisë. Gjykata Themelore në Ferizaj duhet në të ardhmen ta forcojë politikën ndëshkimore kundër kryerësve të veprave penale kundër ekonomisë, sepse nga studimi ka rezultuar se në periudhën hulumtuese 2008-2012, dhe pas reformave në sistemin e drejtësisë edhe për vitin 2013, dënimi kryesor i shqiptuar ka qenë ai me

gjobë. Ky dënim i përgjigjet kësaj kategorie të veprave penale dhe të gjitha shtetet e krahasuara e kanë zbatuar si dënim kryesor. Mirëpo dënimet e shqiptuara në Gjykatën e Ferizajt në të shumtën e rasteve ishin me gjobë në vlerë 150-200 euro, që për mendimin tim, nuk ishte synimi i ligjbërësit sepse ai ka paraparë dënime më të larta, duke paraparë edhe dënimin kumulativ për disa nga veprat penale me burg dhe gjobë, me synimin që autorët ta ndjejnë peshën e dënimit, në aspektin ekonomiko-financiar dhe në aspektin e dekurajimit për ta dhe të tjerët, që të vazhdojnë rrugën kriminale.

6. Trajnimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve, prokurorëve, policëve dhe stafit mbështetës për legjislacionin penal të Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Vendi ynë ka objektivë, anëtarësimin në Bashkimin Evropian, andaj është e domosdoshme njohja e gjyqtarëve dhe prokurorëve tanë me praktikën dhe legjislacionin e BE-së. Duke pasur parasysh zhvillimin shoqëror të vendit dhe përpjekjet që përmes normave penale të përcillet ky zhvillim me qëllim që t'i jepet mbrojtje juridiko-penale, është më se e domosdoshme të bëhen trajnime brenda dhe jashtë Kosovës, për t'u njohur, më për së afërmi, me sfidat apo praktikën e mira të shteteve të BE-së. Kjo do të ishte e mundur përmes organizimit të konferencave, seminareve, vizitave studimore. Trajnimet duhet të vazhdojnë në Institutin Gjyqësor të Kosovës, por jo në formën dhe mënyrën aktuale.

7. Krijimi i një databaze në Gjykatën për kryerësit recidivistë.

Recidivizmi si fenomen i kriminalitetit paraqet problem serioz në kohën bashkëkohore. Ky fenomen është i pranishëm edhe në fushën e veprave penale kundër ekonomisë. Hulumtimet kanë treguar se ai është i pranishëm pothuaj në të gjitha kategoritë e veprave penale, me 30-35%. Gjykatat duhet sa më parë të krijojnë një

databazë, të veçantë, e cila do të ndihmonte gjyqtarët me rastin e nxjerrjes së vendimeve dhe shqiptimit të sanksioneve penale, që ndaj kësaj kategorie të shqiptohen dënime adekuate, ngase recidivizmi duhet të merret si rrethanë rënduese me rastin e matjes së dënimit.

8. Krijimi i një databaze të veçantë për dënimet e shqiptuara me kusht.

Nisur nga praktika gjyqësore e Gjykatës Themelore të Ferizajt, gjatë hulumtimit të veprave penale kundër ekonomisë, ka rezultuar se në disa raste gjykata ka shqiptuar dënime me kusht. Dënimi me kusht, sipas ligjeve në fuqi, mund t'i shqiptohet edhe personave juridikë. Andaj, është e domosdoshme të krijohet databaza e veçantë për këtë kategori të dënimeve, sepse në mungesë të databazës pothuaj në asnjë rast nuk është revokuar dënimi me kusht. Kjo problematikë ka ndikuar që autorët, përsëritës të veprave penale, ngapamundësia për të siguruar të dhënat se brenda periudhës së verifikimit kanë kryer vepër të re penale, kanë mbetur të pandëshkuar dhe në të njëjtën kohë ndaj tyre janë shqiptuar dy dënime me kusht, pa u reviduar dënimi i parë me kusht.

9. Angazhimi i mjeteve të informimit publik dhe aktorët e ndryshëm të shoqërisë, si faktorë për parandalimin e krimeve kundër ekonomisë.

Në parandalimin e kriminalitetit, në fushën e ekonomisë, përveç që organeve të shtetit që kanë rolin primar, si obligim kushtetues dhe ligjor, rol të rëndësishëm kanë media dhe shoqëria civile në përgjithësi. Ata duhet të jenë pjesë aktive e të gjitha nismave që ndërmerren në formë të fushatave apo strategjive për të parandaluar numrin e veprave penale kundër ekonomisë. Kjo duhet të bëhet për faktin se media dhe shoqëria civile e kanë mbështetjen dhe besimin e qytetarëve nga organizimet shoqërore si: shkollat, bashkësitë fetare, organizatat sportive etj.

LITERATURA

- Av. Buzheku N. Ersi & Prof. Dr Ismet Elezi, *Përgjegjësia Penale e Personave Juridikë*, Botimet Teona, Tiranë, 2012
- Al-Sarraj, Dr. Abboud “*Concept of Economic Crimes as Perceived Across the World - Typology, New Trends and Countermeasures*”, Publisher UNAFEI 2006.
- Bora Cejović “*Krivično Pravo*”, Beograd, 1998.
- Bacic Franjo, Pavloviq Shime, *Kažneno pravo*, pesbni dio, Informator d.d, Zagreb 2001.
- Beka Agron, *Abuzimet në lëmin e qarkullimit të pronës së paluajtshme në Kosovë*, Prishtinë, 2007.
- Becker Gary S. “*Crime and Punishment: An economic approach*”, University of Chicago – National Bureau of Economic Research, Volume Publisher: NBER 1974.
- Bajgora L. Ali, *Krimet Kundër të Drejtave dhe Lirive në Kosovë*, Qendra për të Drejtat e Njeriut - Gruas”Elena”, Prishtinë, 1998.
- Bajgora Ali, *Disa karakteristika të kriminalitetit dhe politikës ndëshkimore në Kosovë*, Qendra Profesionale për të Drejtat e Njeriut dhe Iniciativa Juridike, Prishtinë 2001.
- Bajgora L. Ali, *Veprat penale kundër lirisë së personit në planin krahasues*, Qendra Profesionale për të Drejtat e Njeriut dhe Iniciativa juridike Prishtinë, 1999.
- Bahri Hyseni, *Nature of Certain Criminal Acts Against the Property Foreseen by Kosovo Legislation Overvieëed by Material Target*, Mediterranean Journal of Social Sciences Vol. 5. No. 19, August, Mcser Publishing, Rome, Italy, 2014.

- Demolli Haki, *Kriminaliteti ekonomik në Kosovë i viteve të tetëdhjeta*, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2009.
- Demolli Haki, *Disa karakteristika të kriminalitetit në Kosovën e pasluftës*, E drejta nr. 1-2, Prishtinë, 2008.
- Durdević Zlata, *Komentar zakona o odgovornost pravnih osoba za kažnjena djela*- Narodna Novina, Zagreb, 2005.
- Davidović Dragomir “*Privredni kriminalitet i uloga društvene kontrole na njegovom suzbijanju*,” Beograd, 1965.
- Elezi Ismet, *E drejta penale*, pjesa e posaçme, botimet Erik, Tiranë, 2009.
- Elezi Ismet, Elezi Ela, *Zhvillimi historik i mendimit teorik-juridik*, Tiranë, 2010.
- Elezi Ismet, Elezi Ela, *Historia e së drejtës penale*, Libri Universitar, Tiranë, 2010.
- Elezi Ismet, *Mbrojtja juridiko penale e pasurisë*, Albin, Tiranë, 2002
- Elezi Ismet , Hysi Vasilika, *Politika kriminale,Shtëpia botuese*, Pegi, Tiranë, 2006.
- Elezi Ismet, Hysi Vasilika, *Politika kriminale*, botimi i parë, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2006.
- Gashi Rexhep, *Kriminaliteti në Kosovë gjatë viteve 1984-1998*, E drejta nr. 1, Fakulteti Juridik, Prishtinë 2004.
- Galić Drino, “ *Uvodenje pravnih lica pod krivicnu juridiksiu sudova u Francuskoj i BIH*, seminar “*O odgovornosti pravih lica za krivična djela*”- Kollošini 21-24 tetor 2009.
- Hoxha Artan, *Ekstradimi dhe urdhri evropian i ndalimit*, Shtëpia Botuese Morava Tiranë , 2011.

- Hajdari Azem, *Kriminaliteti i të miturve në Kosovë*, 2001-2003, Botues autori, Prishtinë, 2004.
- Hysi Vasilika, *Kriminologjia*, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2005.
- Halili Ragip, *Kriminologjia*, AAB-Riinvest, Prishtinë, 2011.
- Halili Ragip, *Kriminologji me Penologji*, Prishtinë, 2008.
- Halili Ragip, *Kriminologjia*, botimi i katërt, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik. Dinor-MG, 2005.
- Jean Pardel, Geert Corstens dhe Gert Vermeulen, *E drejta penale evropiane*, botimi Papirus, Tiranë, 2009.
- Kambovski Vllado, *E drejta penale-pjesa e përgjithshme*, Botues “Furkan ISM”, Shkup, 2010.
- Kambovski Vlado, *Kažneno - pravnata reforma pred predizvicite na XXI vek*, Pravni Fakultet, Skopje, 2002.
- Kajtazi Besim, *Ndikimi i shtypit në kriminalitet*, Qendra për Studime Shqiptare-Albanica-Lubjanë, 2007.
- Latifi Vesel, *Kriminalistika*, Prishtinë, 2006.
- Latifi Vesel & Elezi Ismet &Hysi Vasilika, *Politika e luftimit të kriminalitetit*, Prishtinë, 2012.
- Latifi Vesel & Beka Agron, *Vrasjet, krimi i organizuar dhe terrorizmi*, Kolegji Evropian “Juridica”, Prishtinë, 2013.
- Licensoski B, *Tok i trajanje postupka po predmetima privrednog kriminaliteta*, Privredni kriminalitet, Institut za Kriminološka i sociološka istraživanja, Beograd, 1977.

- Milan Milutinović, *Kriminologia*, Savremena Administracija, Beograd, 1985
- Noel Malcolm, *Kosovo: A Short History*, New York University Press, 1998.
- Pesic V, *Bitne karakteristike stanje privrednog kriminaliteta u Jugoslaviji u savremenim uslovima*, Privredni kriminalitet, institut za kriminološka i socioloska istraživanja, Beograd, 1977.
- Rakipi Arben, *Korrupsioni dhe evazioni fiskal*, Shtypshkronja "Klean", Tiranë, 2003.
- Russell G. Smith, "Cross- Border Economic Crime", Australian Institute of Criminology GPO-Boks-2944, April 2011.
- Stephan Heidenhain, *Hyrje në të Drejtën Evropiane*, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2010.
- Stojanović Zoran, *Krivično Pravo, Opšti deo*, Pravni Fakultet, Univeziteta u Beogradu, Beograd, 2006.
- Stojanović Zoran, R. Shine: *Komentar zakona o odgovornost pravnih lica za kažnjena djela-Republike Cerne Gore*, Podgorica, 2007.
- Salihu Ismet, *E Drejta Penale*, pjesa e posaçme, "Fama", Prishtinë, 2009.
- Sueska Mirsida, *Bazat e kriminalitetit ekonomik*, Prishtinë, 2006, FSK/07/.
- Sadiku Isuf, *Ekzekutimi i sanksioneve penale në dritën e akteve më të reja ndërkombëtare*, Prishtinë, autori, 2010.
- S. Weatherill and P. Beaumont, *EU Law*, 3rd edition , *Penguin Books*, University of Oxford Press, London, 1999.
- Sahiti Ejup, *E Drejta nr. 3, Të provuarit në Procedurën Penale – mundësitë dhe vështirësitë*, Prishtinë, 1996.

- Shala Afrim “ *Hyrje në të drejtën penale*”, Qendra Juridike e Kosovës, Prishtinë, 2011.
- Shala Afrim, *E Drejta Penale*, pjesa e posaçme, me raste nga praktika gjyqësore, Kolegji “Gjilani”, Gjilan, 2010.
- Tomić Zvonimir, *Krivično pravo*, posebni deo, magistrat, Sarajevo, 2003.
- Vula Veton, *Krimi i organizuar*, Prishtinë, 2013.
- Vodinelić Vlado, *Kriminalistka, Savremena Administracija*, Beograd, 1978.
- Zeneli Ismail & Kambovski Vlado & Janićević Nenad & Latifi Vesel & Sulejmanov Zoran & Netkova Bistra & Ilievski Jovan & Millovanović Zlata & Kikerekova Tanja : *Kriminaliteti i organizuar - aspekte juridike-disa masa të luftimit të kriminalitetit të organizuar në vendet në tranzicion*, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2009.

REVISTA SHKENCORE

- Asllan Pushka, *Faktorët dhe iniciatorët e transformimit social-ekonomik të KSAK-së*, „Revista ” Përparimi”, Prishtinë 1978.
- Besnik Çerekja, *Përgjegjësia Penale e Personave Juridikë nën Këndvështrimin e Legjislacionit Penal Shqiptar*, Revista “Studime Juridike”, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2009.
- Bala Eriselda, *Dënimi penal i personave juridikë*, 03 gusht 2012.
- Bozheku Ersi, *Probleme Interpretuese dhe aspekte krahasuese me legjislacionin italian*, Revista shkencore, Përgjegjësia penale e personave juridikë, Revista shkencore,

“Ligji dhe Shoqëria”, Fakulteti Juridik, Tiranë, nr. 4/2010.

- Bashota Nuri, *Zhvillimi ekonomik i Kosovës, dje, sot dhe në perspektivë*, Revista Shkencore Ndërkombëtare, “Iliria”, Prishtinë, 2010.

- Bahri Hyseni, *Roli i OKB-së në zgjidhjen e krizave*, Rasti i Kosovës, (tema e masterit), Konferenca e ambasadorëve në Londër e mbajtur më 1912 dhe 1913, e njohur edhe si “Konferenca e Paqes në Londër”, Universiteti “Iliria”, Prishtinë, 2010.

- Bahri Hyseni, *Comperative Aspects of Criminal Legislation for Criminal Offenses in the Field of Economi in Kosovo and some Europian Countries*, me referencen SBSPRO18842, Revista shkencore ndërkombëtare, “Procedia- Sociall and Behavioral Sciences”, Iasi, Rumani, 5 shtator 2014.

- Haziri Fatos: *Krimi i organizuar si fenomen kërcënues për sigurinë publike dhe sundimin e rendit dhe ligjit në Republikën e Kosovës*, Revista shkencore, “Juridica”, Kolegji Evropian, Prishtinë, 2013.

- Tashi Igli, *Tregu i pamonitoruar*, Revista “Monitor”, botuar nga Media Union, Tiranë, 2007.

- Fana Neshat, *“Përgjegjësia penale e personave juridik”* temë e masterit, e mbrojtur në Universitetin e Tiranës.

- Osmani Ilir, PhD candidate, *Krimi ekonomiko-financiar si pengesë për zhvillim të Kosovës*, Revista shkencore “Juridica” Instituti Evropian për Studime Juridike dhe Administratë Publike, Prishtinë, 2011.

- Zajmi Iva, *Qarkullimi i lirë i kapitalit - Bashkimi Ekonomik dhe Monetar*, Revista “Studime Juridike”, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2009.

- Uruci Esmerallda, MBA Borici - Begani Albana, *Globalizimi dhe ekonomia botërore*, Revista shkencore ndërkombëtare “Iliria” Universiteti Mbretëror “Iliria”, Prishtinë, 2009.
- Halili Ragip, *Disa karakteristika të kriminalitetit të organizuar në Kosovë dhe parandalimi i tij*, Revista “E drejta” nr. 4, Prishtinë, 2002.
- Osmani Afrim, *Përgjegjësia penale e personave juridikë në Republikën e Maqedonisë*, Revista edukative, kulturore dhe shkencore “Vepra”, 2009.
- Limani Musa, *Rrjedhat ekonomike të Kosovës në fazën e tranzicionit*, Revista Shkencore “Norma”, Gjilan, 2012.
- Prof. dr. Latifi Vesel, *Luftimi korrupsionit dhe konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me veprë penale*, Revista “Juridica” Instituti Evropian për Studime Juridike dhe Administratë Publike, Prishtinë, 2011.
- Ndrepepaj Valbona , *Përgjegjësia penale e personave juridikë*, 2012.
- Ilić P. Goran, *Marginalije uz zakon o odgovornosti pravnih lica za krivična dela 2002-2010*.

AKTE LIGJORE, KONVENTA DHE BURIME TJERA

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008
- Kushtetuta e Italisë
- Kushtetuta e RSFJ-së, e vitit 1974
- Korniza Kushtetuese e Kosovës, e vitit 2001
- Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i vitit 2004
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, i vitit 2012 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr. 13/19)
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, i vitit 2012
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur, nr. 03-L-193, i vitit 2010
- Kodi Penal i Republikës së Sllovenisë, i vitit 2004
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i vitit 1995 (Ligji me nr. 7895, i dt 27.01.1995)
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i vitit 2001 (Ligji nr. 8733, Fletorja zyrtare nr. 4 shkurt 2001)
- Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë, i vitit 1952, (Gazeta zyrtare nr. 15, datë 01.08.1952)
- Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë, i vitit 1977
- Kodi Penal Shqiptar, i vitit 1927 (Fletorja zyrtare nr. 1 janar 1928)
- Kodi Penal i Francës, i vitit, 2002
- Kodi Penal i Italisë, i vitit 1992
- Kodi Penal i Republikës së Kroacisë, i vitit 1977 .

- Kodi Penal i Republikës së Kroacisë, i vitit 2011, (Gazeta zyrtare me nr. 124/11)
- Shih: Kodi Penal i Sllovenisë, 2008.
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, i vitit 2006, (Gazeta zyrtare nr. 37/96)
- Kodi Penal i Maqedonisë, (Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë) nr. 19/2004)
- Kodi Penal i Republikës së Serbisë, i vitit 2012, (Gazeta zyrtare nr. 121/2012)
- Kodi Penal i Serbisë, (fletorja zyrtare RS), nr. 85/2005,88/2005, (plotësuar), 107/2005, (plotësuar), 72.2009, 111/2009 dhe 121/2012
- Kodi Penal i Bosnjë e Hercegovinës, i vitit 2003 (Fletorja zyrtare e BeH nr. 37/2003)
- Kodi i Përkohshëm Doganor i Kosovës, i vitit, 2004, (Rregullorja e UNMIK-ut, 2004/1)
- Kodi Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, i vitit, 2009
- Ligji për Prokurorinë e Shtetit, me nr. 03/L-225 i dt. 30 shtator 2010
- Ligji për Gjykatat në Republikën e Kosovës, Nr./L-199, miratuar në Kuvend, më 22.07.2010
- Ligji për pengimin e spekulimit të palejuar dhe sabotimin ekonomik, i dt. 23.04.1945, neni 9. parag. 3, (Fletorja zyrtare e RSFJ,nr .26/45)
- Ligji Penal i RSFJ-së, i vitit 1977
- Ligji Penal i KSAK-së, 1977, Kuvendi i Kosovës nr. 011-25|77
- Ligji i Procedurës Penale i RSFJ-së, i vitit, 1977 (Gazeta zyrtare e RSFJ-së, Nr.4/77)
- Ligji Penal i Republikës së Kroacisë, (Gazeta Zyrtare nr. 110/1997)
- Ligji për ndryshimin e ligjit për përgjegjësi penale të personit juridik (Gazeta zyrtare e R. së Sllovenisë, me nr. 50/04) i dt. 06.05.2004

- Ligji për ndryshimin e ligjit për përgjegjësi penale të personit juridik (Gazeta zyrtare e R. së Sllovenisë, me nr .65/08) i dt. 30.06.2008
- Ligji për “Përgjegjësinë e Personave Juridike për Vepra Penale” në Kroaci, i dt. 24 shtator 2003, (Gazeta zyrtare nr. 151)
- Ligji për përgjegjësinë penale të personave juridike, Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë, nr. 97/2008, të dt. 27.10.2008
- Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë, është miratuar në Kuvend më dt. 31.08.2011, kurse është shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-028-2011, më dt. 31.08.2011
- Ligji për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridike në Kosovë, nr. 04-L-30, i vitit 2011
- Ligji për mbrojtjen e konsumatorit në Kosovë, me nr. 2004/17, i vitit 2004
- Ligji nr. 03/L-196 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit, i miratuar në Kuvend, më dt.11.02.2013, i shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-03-2013 të dt. 26.02.2013
- Ligjin për përgjegjësinë penale të personave juridike në Shqipëri, me nr. 9754, i datës 14.06.2007
- Ligjin kundër korrupsionit të Kosovës, nr. 2004/34, i miratuar më 22 prill 2005
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e kodit doganor dhe akcizave, me nr. 03-L-109, i miratuar në Kuvendin e Kosovës, më 13.05.2012, ndërsa është shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, me nr. DL-023-2012, të dt. 17.05.2012
- Ligji i Administratës Tatimore i Kosovës, me nr. 03/L-222, të shpallur me dekretin nr.

DL-032-2010

- Ligji nr.03/L-112 për tatimin e normës së akcizave është miratuar në Kuvend, më dt. 12.07.2010, kurse është shpallur me dekretin e Presidentit të Kosovës, me nr. DL-031-2010, më dt. 15.07.2010
- Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 1 e vitit 1989
- Council Regulation (EC, EURATOM) NO.2988/95 OF 18 December 1995 on the protection of the European Communities financial interest.

KONVENTAT

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e nënshkruar në Rome, më 4 nëntor 1950.
- Konventa penalo juridike “për pengimin e korrupsionit”, e Këshillit të Evropës (1988).
- Konventa për larjen e parave dhe gjurmimin, marrjen e përkohshme të hyrave të fituara me vepër penale nr. ETS 141 e Këshillit të Evropës, e miratuar në Strasburg 08.11.1990.
- Konventa “për mbrojtjen e ambientit” në aspektin e të Drejtës Penale (1998).
- Konventa Penalo-Juridike, “Për Pengimin e Korrupsionit”, nga Këshilli Evropian e vitit 1998.
- Konventën e Brukselit të datës 26.05.1995, e përgatitur në bazë të nenit K-3 të Bashkimit Evropian, mbi mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Evropiane.
- Raport nga United Nations Office on Drugs and Crime, Biznesi, Korrupsioni, dhe Krimi në Kosovë, botuar në mbështetje financiare të Bashkimit Evropian, Qeverive: Të

Gjermanisë, Norvegjisë, dhe Suedisë, në vitin 2013.

- Raport i përgjithshëm për veprat penale në Gjykatën Komunale- Themelore në Ferizaj, për periudhën 2011-2013.

- E drejta civile, Doracaku për përgatitjen e provimit të Jurisprudencës, Prishtinë, 2009.

- Konferenca e Ambasadorëve në Londër e mbajtur më 1912 dhe 1913, e njohur edhe si “Konferenca e Paqes në Londër”, më 29 korrik 2013, ambasadorët njohën me një vendim formal njohjen e Principatës së Shqipërisë si shtet të pavarur, por fatkeqësisht la jashtë territoreve të saj Kosovën, e cila i u dha Serbisë.

- Raportin shpjegues të Konventës të Këshillit të Evropës mbi pastrimin, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit, e vitit 1990, nr. 1 deri 7.

- Raportin shpjegues të Konventës së Këshillit të Evropës mbi pastrimin ,zbulimin ,sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit, e vitit 1990, nr. 18.

- Raportin shpjegues të Konventës së Këshillit të Evropës mbi pastrimin, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit, e vitit 1990 nr. 35

- Protokolli i dytë, i hartuar në mbështetje të nenit K-3 të Traktatit të Bashkimit Evropian, të Konventës për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komunitetit Evropian, Gazeta zyrtare C 221 , 19.07.1997. P0012-0022.

- Traktatin e Komunitetit Evropian dhe protokollin e Statutit të ESCB-së, (Fletorja zyrtare e Bashkimit Evropian, e dt. 30 mars 2010.

- Traktatet për Bashkimin Evropian, posaçërisht atë të Romës, Romë, 25 mars 1957, themelimi gradual i tregut të përgjithshëm, të përbashkët (EEC) dhe Bashkësia Evropiane e Energjisë Atomike (EAEC ose Euratom).

- Traktatet e Romës, të dt. 25 marsit të vitit 1957, të cilat krijuan Komunitetin Ekonomik Evropian dhe Komunitetin Evropian të Energjisë Atomike (EUROATOM).
Online Education Centar.
- Rregullorja e Këshillit Evropian, e dt. 18.12.1995.
- Rregullorja e Këshillit të aprovuar më 06.02.1962.
- Rregullorja e UNMIK-ut, nr.1999/3, për themelimin e Doganës së Kosovës.
- Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2005/32, mbi Kodin e Akcizës në Kosovë, të dt. 21 qershor 2005.
- Shiko sondazhin e korporatave në Itali në linku www.cliffordchance.com për më tepër informata shfrytëzoni McDermott www.mwe.com .
- Shiko numrin e padive të ngritura në Itali ndaj korporatave dhe kompanive të vogla në linkun www.cliffordchance.com -corporate liability in Europe.
- Akti mbi përgjegjësinë e personave juridikë për kundërvajtje penale (Gazeta zyrtare e R së Sllovenisë, nr. 59/99) i dt. 23.07.1999.
- Strategjinë shtetërore të Republikës së Kosovës, kundër krimit të organizuar dhe planin e veprimit 2009-2012.
- Raportin e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe krim, Vjenë, Biznesi, Korrupsioni dhe Krimi në Kosovë: Ndikimi i ryshfetit dhe i krimit tjetër në ndërmarrjet private.
- Direktiva e Këshillit të Evropës për ndalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar me qëllim të shpëlarjes së parave, Qipro ,1991/308/EEC, 2001/97/EC.
- Raport i Prokurorisë Komunale në Ferizaj, përkitazi me strukturën e kallëzimet penale

dhe numrin e personave të dyshuar për veprat penale në fushën e ekonomisë për periudhën 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012.

- Raportin vjetor të Doganës së Kosovës të vitit 2010, të publikuar nga dogana e Kosovës, Prishtinë, shkurt 2011.

- Raporti vjetor i Shërbimit Doganor të Kosovës, i vitit 2006, publikuar nga Dogana e Kosovës.

- Raportet vjetore të shërbimit doganor të Kosovës, nga viti 2005 e deri më 2013.

- Gazeta ditore “Kosova Sot” e datës 8 mars, Prishtinë, 2006, nr. 2316.

- Gazeta “Jeta në Kosovë”, e dt. 21 maj, Prishtinë, 2012.

- Gazeta “Start” e dt. 30 tetor 2013.

- Gazeta ”Jeta në Kosovë”, Donjeta Hoxha, në dt. 21 shkurt 2013.

- Këshilli Prokurorial i Kosovës, më dt. 19.11.2012, ka hartuar planin strategjik 2013-2015.

- Raporti i Organizatës për Demokraci, Korrupsion dhe Dinjitet (ÇOHU) me titull: Integrimi Evropian, Gjyqësori dhe lufta kundër korrupsionit.

- Raport i Gjykatës Komunale në Ferizaj, për periudhën 2008-2012, për lëndët e pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura.

- Këshilli Prokurorial i Kosovës, më dt. 19.11.2012, ka hartuar planin strategjik 2013-2015, për ngritjen e bashkëpunimit ndërmjet prokurorit të shtetit dhe agjencive që zbatojnë ligjin në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

AKTGJYKIME GJYQËSORE

- Aktgjykimi P. nr. 43/2008 , i Gjykatës Komunale Ferizaj, i dt. 10. 02.2010.
- Aktgjykimi P. nr. 148/2008, i Gjykatës Komunale Ferizaj, i dt. 25. 05. 2010.
- Aktgjykimi P. nr. 690/2009, i Gjykatës Komunale Ferizaj, i dt. 08.10.209.
- Aktgjykimi P. nr. 847/2009, i Gjykatës Komunale Ferizaj, i dt. 21.07.2011.
- Aktgjykimi P. nr. 56/2010, i Gjykatës Komunale Ferizaj, i dt. 23.05.2012.
- Aktgjykimi P. nr. 109/2010, i Gjykatës Komunale Ferizaj, i dt. 23.11.2011.
- Aktgjykimi P..nr. 392/2011, i Gjykatës Komunale Ferizaj, i dt. 20.09.2012.
- Aktgjykim P. nr. 914/2012, i Gjykatës Komunale Ferizaj, i dt. 08.10.2012.
- Aktgjykimi P. nr. 89/2008, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 02.02.2009.
- Aktgjykimi P. nr. 108/2008, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 06.02.2009.
- Aktgjykimi P. nr. 194/2008, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 06.02.2009.
- Aktgjykimi P. nr. 237/2008, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 06.02.2009.
- Aktgjykim P. nr. 156/2009,Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 03.06.2009.
- Aktgjykimi P. nr. 309/2009, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 06.11.2009.
- Aktgjykimi P. nr. 318/2009, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 02.12.2009.
- Aktgjykimi P. nr. 82/2010,Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 08.04.2010.
- Aktgjykimi P. nr. 98/2010, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 07.05.2010.
- Aktgjykimi P. nr. 155/2010, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 20.04.2012.
- Aktgjykimi P. nr. 370/2011, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 09.01.2013.
- Aktgjykimi P. nr. 366/2011, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 09.01.2013.
- Aktgjykimi P. nr. 83/2012, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 04.12.2013.

- Aktgjykimi P. nr. 560/2012, Gjykata Komunale Kaçanik, i dt. 03.12.2012.
- Aktgjykimi P. nr. 147/2013, Gjykata Themelore Ferizaj, dega në Kaçanik, i dt. 26.12.2014.

ADRESA NË INTERNET

- <http://www.cohu.org/>
- http://www.wipo.int/wipolex/en/text.jsp?file_id=331030
- <http://www.dadalos-europe.org/alb>
- <http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/st06655-re01.en08.pdf>
- <http://www.akk-ks.org/index.php?cid=1,44>
- <http://www.conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/Html/198.htm>
- <http://www.akk-ks.org/index.php?cid=1,44>
- http://europa.eu/legislation_summaries/fight_against_fraud/protecting_european_communitys_financial_interests/I33018_en.htm
- <http://www.zavodsz.gov.rs/PDF/zakoni/24.Закон%20о%20одговорности%20правних%20лица%20за%20кривична%20дела.pdf>
- <http://www.zakon.hr/z/110/Zakon-o-odgovornosti-pravnih-osoba-za-kaznena-djela>
- <http://legislationline.org/documents/section/criminal-codes>
- <http://legislationline.org/documents/section/criminal-codes>
- <http://www.pravda.gov.mk/documents/KRIVICEN%20ZAKONIK%20pre-cisten%20%20tekst.pdf>

- <http://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/en/si/si045en.pdf>
- <http://legislationline.org/documents/section/criminal-codes>
- <http://wwwext.comune.fi.it/costituzione/albanese.pdf>
- <http://legislationline.org/documents/section/criminal-codes>
- <http://legislationline.org/documents/section/criminal-codes>
- <http://legifrance.gouv.fr>
- http://www.ius.bg.ac.rs/crimenjournal/articles/Crimen_002-2010/Crimen%20002-2010%20-%205%20Ilic.pdf
- <http://drejtesiashqiptare.com/?p=1669>
- <http://www.furkan.com.mk/VEPRA%2099.pdf>
- <http://drejtesiashqiptare.com/?p=1856>
- <http://www.law.ox.ac.uk/profile/weatherills>
- http://www.antikorupcija.me/index.php?option=com_phocadownload&view=category&download=102:odgovornost-pravnih-lica-za-krivicna-djela-povracaj-dobara&id=12:izvjestaji&Itemid=306&start=20
- http://www.antikorupcija.me/index.php?option=com_phocadownload&view=category&download=102:odgovornost-pravnih-lica-za-krivicna-djela-povracaj-dobara&id=12:izvjestaji&Itemid=306&start=20
- <http://www.h-net.org/review/shoepdf.php?id=3058>
- http://www.fzplus.hr/product_info.php?products_id=677
- <http://authors.elsevier.com/sd/article/S1877042814048836>

- https://www.mpb-ks.org/repository/docs/STRATEGJIA_KKT_30_QERSHOR_Alb.pdf
- <http://dogana.rks-gov.net/repository/docs/raporti%202006.pdf>
- <http://www.psh-ks.net/?page=1,41&ddate=2012> http://www.psh-ks.net/respository/docs/Nr.1284.2012-Plani_strategjik-2013-2015.pdf
- https://www.mpb-ks.org/respository/docs/Strategjia_shqip_FINAL_Strategjia_kombetare_e_Republikes_se_Kosoves_2009.pdf
- http://www.aic.gov.au/about_aic/research_programs/staff/smith_russell.html
- <http://www.nber.org/chapters/c3625.pdf>
- https://www.google.com/search?q=Concept+of+Economic+Crime+and+New+Trends&oq=Concept+of+Economic+Crime+and+New+Trends&aqs=chrome..69i57.8166j0j4&sourceid=chrome&espv=2&es_sm=93&ie=UTF-8#q=Al-Sarraj,+Dr.+Abboud+Concept+of+Economic+Crimes+as+Perceived+Across+the+World+-+Typology,+New+Trends+and+Countermeasures+,+Publisher++UNAFEI+2006

Appendix / Shtojca

Metodologjia

Shteti: Kosova

Studimi: Materiale hulumtuese rreth veprave penale ndaj ekonomisë në Komunën e Ferizajt, 2008-2012

Grumbulluesi i të dhënave:

Me synim për t'u njohur nga së afërmi me veprat penale ndaj ekonomisë në Ferizaj, në vitet 2008-2012, kam bërë identifikimin e problemit në bazë teorike, duke marrë në shqyrtim literaturë të kualifikuar shkencore sipas metodologjisë analitike, krahasimore mbështetur në praktikën e elaborimit gjeneral të problemit, duke vështruar nga aspektet e njohjes të së përgjithshmes deri tek e përveçmja, ku kam marrë në shqyrtim disa raste konkrete, pastaj në ndërtimin e bazës sqaruese si dhe për krahasim të burimeve jam shërbyer edhe me materiale nga revista, gazeta, publikime dhe libra të ndryshëm me renome dhe kredibilitet, në mënyrë që përmbajtja të jetë sa më e qëndrueshme dhe shkencore.

Pas analizimit të të hyrave sekondare; pra materialeve editoriale, nisur nga imperativi i shtjellimit dhe vërtetimit të hipotezës kam ndërmarr një hulumtim në terren me çrast në vitin 2012 me kërkesë i kam siguruar të gjitha kallëzimet penale nga Prokuroria Themelore në Ferizaj për veprat penale kundër ekonomisë, duke përfshirë edhe numrin e personave të akuzuar, strukturën e veprave, gjininë, përgatitjen personale, për më shumeë duhet referuar kapitullit VI, të temës. Në vitin 2013 nga Gjykata Themelore në Ferizaj dhe Kaçanik, kam siguruar aktgjykimet për vitin 2008-2012, ndërsa në vitin

2014 i kam siguruar për vitin 2013. Prej këtyre burimeve unë jam pajisur me materiale të bollshme analitike prej ku kam ndërtuar vështtrimin metodologjik dhe të burimit të dhënave primare.

Pra, siç mund të vërehet studimi është zhvilluar në dy faza. Faza e parë përfshiu kallëzimet penale, për të përgatitur një mostër përfaqësuese në këtë pjesë unë kam ndërtuar grafikohet dhe tabelat, të cilat edhe shtjellojnë problematikën përgjithësisht nga terreni, ashtu siç kërkohet në metodologjinë e punës së shtjellimit gjeneral të materies. Kjo pjesë nuk mjaftoi për krijimin e tablosë së përgjithshme nga të dhënat primare dhe në fazën e dytë, e cila përfaqëson marrjen nga Gjykata Kompetente aktgjykimet, për arsye të analizimit dhe identifikimit të pika konkrete referuese këtë fazë e kam realizuar në dy vite, edhe për arsyen e fleksibilitetit të bartjes së të dhënave nga institucionet kompetente.

Metodat e kontrollit të cilësisë

Prej të dhënave nga prokuroria si dhe gjykata, 27% i kam verifikuar në terren, në këtë proces një lehtësi kishte tek faza e dytë e analizimit, ngase trajtoheshin aktgjykimet të cilat përmes procedurës së protokollimit mund të vërtetoheshin si të qena.

Ndërsa, sa i përket të dhënave nga prokuroria unë kam zhvilluar biseda edhe me disa kolegë mbi problematikën, të cilat konsulta i kam shfrytëzuar edhe për verifikim të rasteve të kallëzimeve penale, denoncimeve të veprave penale ndaj ekonomisë.

TERMINOLOGJIA SIPAS KODEVE PENALE

KOSOVË

SHQIPËRI

- | | |
|---------------------------------|---------------------------------|
| - Procedurë penale | - Procedim penal |
| - Shkresat | - Aktet |
| - Bashkimi i procedurës | - Bashkimi i procedimeve |
| - Veçimi i procedurës | - Ndarja e çështjeve |
| - Masat për sigurimin e pranisë | - Masat shtrënguese |
| - Paraburgimi | - Arresti në burg |
| - Kallëzimi penal | - Kallëzimi |
| - Paraqitja e veprës penale | - Referimi i veprës penale |
| - Aktgjykim lirues | - Vendim i pafajësisë |
| - Aktakuza | - Akuza |
| - Ankesa | - Ankimi |
| - Kryerës i veprës | - Autor i veprës |
| - Aktgjykim dënues | - Vendim i dënimit |
| - Aktgjykim lirues | - Vendim i pafajësisë |
| - Aktgjykim refuzues | - Vendim i pushimit të çështjes |

